



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 1, 2 DHE 5 NËNTOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 1., 2. I 5. NOVEMBRA 2012. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv,
5. Votimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar,
6. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e pagesave,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës,
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e tre anëtarëve në Bordin për Ankesa të Medieve,
15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje o N/zakona o ratifikaciji amandmana članova Sporazuma Medjunarodnog monetarnog fonda o reformi Izvršnog borda,
5. Glasanje o N/zakona o povećanju kvote Republike Kosova u Medjunarodnom monetarnom fondu,
6. Informisanje Skupštine Republike Kosova od strane Premijera Kosova, g. Hashim Thaçi o održanom susretu u Briselu sa premijerom Srbije,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o profesionalnim komorama medicinskih stručnjaka,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o kontroli duvana,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o platnom sistemu,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o ekonomskim zonama,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o knjiženju zalogu u registar pokretnih stvari,
13. Razmatranje Izveštaja Komisije za rad, zdravstvo i socijalno staranje o praćenju sprovođenja Zakona o radu,
14. Razmatranje preporuke Ad hoc komisije za izbor tri članova Odbora medija za žalbe,
15. Formiranje Ad hoc komisije o izboru članova Borda Radio-televizije Kosova.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete,
Zotërinj deputetë
Të nderuar zotërinj ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë, ju kisha lutur t'i thirrni deputetët, me qëllim që t'i votojmë dy ligjet që i kemi debatuar në seancën e kaluar, prandaj duhet t'i kemi 80 deputetë në sallë.

Paraprakisht desha t'i përshëndes dy deputetë në delegacionin nga Libia, të cilët kanë ardhur për vizitë në Kosovë dhe kanë pasur një takim sot në Parlamentin e Kosovës. Përshëndetje!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për diskutime jashtë rendit të ditës

Siç e dini, sipas Rregullores, koha është e kufizuar. Fjalën e ka kërkuar zoti Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndiej obligim që para deputetëve, qytetarëve dhe veçanërisht para intelektualëve të bëj disa sqarime rreth iniciativës sime për ndryshimin e Ligjit të Akademisë, të përkrahur nga 18 deputetë. Këtë iniciativë e kam marrë me qëllim të dinamizmit të ASHAK-ut, ashtu që edhe ajo më në fund t'u ngjajë për nga aktiviteti dhe përbërja së paku akademike të rajonit.

Kërkesë kyçe ka qenë që ASHAK-u ta ndryshojë mënyrën e përzgjedhjes të anëtarëve të rinj dhe kjo të bëhet sipas kriterëve bashkëkohorë që i aplikojnë akademitë e rajonit, ose ato të vendëve euro-perëndimore. Në asnjërin rast nuk kam menduar për emra që do të vijnë në ASHAK, sepse, nëse krijohen kushte për kriterë të tilla, procesi do t'i zbulojë vetë ata. Ndërkohë, u shpallën zgjedhjet sipas ligjit të vjetër dhe avazit të vjetër. Unë e kam përcjellë për së afërmi atë proces dhe me një rast kam reaguar me shkrim, por nuk kam marrë asnjë përgjigje nga Akademia. Kam reaguar pastaj edhe publikisht dhe kjo gjë ka filluar t'i tmerrojë disa njerëz në akademi dhe njerëzit e afërt me ta.

Mjerë për Akademinë dhe shkencën kosovare kush po përpiqet t'i dalë krah. Qëllimi im dhe i PDK-së nuk është që t'i fusë individët e vet aty, por që Akademia t'i përmbushë kërkesat minimale për shkencën e shekullit XXI. Për fat atë keq, po del parashikimi im se pa u ndryshuar ligji, Akademia nuk ka mundësi dhe kapacitete t'i vlerësojë akademikët e

rinj dhe praktika e deritanishme ka treguar që hyrja në të varet vetëm nga vullneti i njerëzve që janë brenda aty, e aspak nga vepra shkencore e kandidatit.

Është tragjikomike dhe absurde që akademikët e shekullit XX, me kritere të shekullit XIX, t'i zgjedhin shkencëtarët e shekullit XXI për anëtarë të Akademisë.

E di që janë absurde për zotin Beqiri fjalët “publikim shkencor”, “impakt faktor”, “recenset në revistën ndërkombëtare”, “shpikje”, “patentim”, “index i hirshit”, “ICI web of knowlegde”, “motor-kërkues”, por unë nuk kam faj që këto i kam mësuar në Francë dhe për shkak që këta parametra i përdor tërë opinioni shkencorë ndërkombëtar, unë mund t'ia mbaj një ligjëratë për këtë zoti Beqiri dhe mentorëve të tij. Prandaj, për mua nuk është befasuese që prononcimet e zotit Beqiri të jenë të atij niveli, sepse ai e ka të vështirë ta kuptojë esencën e nismës sime për akademinë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë nuk habitem me qasjen e zotit Vataj që tash i personalizon gjërat. Unë e kam thënë qëndrimin dhe mendimin e fuqishëm të Grupit Parlamentar të LDK-së, që ajo që e keni bërë ju herën e parë dhe që po e bëni edhe tash është ndërhyrje direkte dhe tentim direkt për involvim të politikës në këtë punë, do të thotë në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Dhe, unë nuk e kam ditur që ti tash e luan edhe rolin e hoxhës e të priftit dhe të profesorit, e moralizon këtu për nivele të dikujt, unë nuk po ta vlerësoj nivelin tënd, por kemi aq nivel sa ta kuptojmë që ti ke qëllime të këqija dhe politike karshi Akademisë. Fundi i fundit, merreni dhe lexojeni, nëse edhe kryetari i Akademisë për ty nuk ka nivel, edhe në intervistë të ka treguar se cilat janë qëllimet tua, atëherë ke punë me Akademinë, e nuk ke punë me Grupin Parlamentar të LDK-së. Po me ne ke punë se iniciativat e tilla nuk do t'i përkrahim asnjëherë.

Merreni, shikojeni! Ju flitni për kritere bashkëkohore. Bashkëkohore apo jo bashkëkohore, ato kritere për zgjedhje i përcakton ligji. Ai ligj i Akademisë është në fuqi. Statuti është në fuqi, Rregullorja për zgjedhje është në fuqi. Ju nuk mund të bëni grushtet në Akademi me metoda të tilla, se ky është tentim për ta bërë këtë. Nëse është Ligji i Akademisë, nëse është Statuti, nëse është Rregullorja, i mirë - i keq, duhet t'i përmbahemi, e ju këtu tentoni në një mënyrë të mos i shihni se ekzistojnë.

Po ashtu flitni për emra. Unë e kam parë atje veç që nuk ia keni “vizatuar” emrin. Ka njeri që i bën nder Akademisë dhe Kosovës po të ishte zgjedhur. Kështu e thoni ju, por nuk jeni ju ai që e vlerëson këtë. Është komisioni dhe njerëzit që e vlerësojnë këtë. As ju e as unë nuk jemi që e vlerësojmë këtë në mënyrën siç e keni bërë ju. Nuk e keni këtë të drejtë. Mund ta jepini mendimin, por jo të tentoni të impononi. Dhe, pastaj disa fjalë që po i thoni këtu, nuk po dua të ndalem më tepër, por të them: Mos harroni zoti Vataj se më vjen mirë që jeni shkolluar në Francë. Xhavit Ahmeti ka qenë realisht ministër i viteve të '90-ta dhe LDK-ja nëpërmjet Xhavit Ahmetit ta ka mundësuar të shkollohesh. Këtë tregoju këtyre të tjerëve dhe asnjëherë nuk duhet të pendohemi për diçka të tillë nëse ka sukses. Qëllimi ynë ka qenë të ju edukojë, e jo ta keqpërdorni këtë me iniciativa të tilla.

Shikojeni deputetë të nderuar vetëm rekomandimin që e kanë bërë, përkatësisht e ka bërë zoti Vataj. Në rekomandim thuhet: “ASHAK-u ta formojë një komision me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për t’i shikuar CV-të e kandidatëve”. Po kjo është non sens!

Tentohet të involvohet në procesin zgjedhor, kur ai proces nuk ka përfunduar. Është ndikim dhe tentim i drejtpërdrejtë. Kjo emër tjetër nuk ka, është shumë e qartë. Dhe, të thuhet se nuk kemi qëllime politike në kohën kur atje është procesi zgjedhor, kjo nuk i shitet askujt, madje as fëmijëve, sepse e kuptojnë këtë. Prandaj, edhe një herë po e them: Lidhja Demokratike e Kosovës nuk do të pranojë, nuk do të përkrahë diçka që ka tentimin parësor t’ia marrë autonominë, përkatësisht pavarësinë institucionit më të lartë shkencor, siç është Akademia e Shkencave dhe të Arteve e Kosovës. Kjo është më se e qartë. Edhe një herë po e themi, ose po ua përsëris, lexojeni çfarë thotë edhe kryetari i Akademisë se çka po ndodh, ose po tentohet t’i bëhet Akademisë të Shkencave. Mos e merrni fare qëndrimin tim, që e kam thënë edhe në emër të Grupit, po pyetni shkencëtarët, pyetni njerëzit që janë meritore për këtë punë, pyetni çfarë mendimi kanë për iniciativa të tilla kuazi-bashkëkohore dhe të tjera të avancimit të Akademisë, që nuk e kanë këtë qëllim. Jam shumë i bindur për këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kjo është seanca e parë parlamentare që prej dhunës që është ushtruar ndaj protestuesve në aksionin fundit politik të Lëvizjes “Vetëvendosje” për ta kundërshtuar takimin poshtërues dhe shtet-shformues të kryeministrit Hashim Thaçi me Ivica Daçiçin në Bruksel.

Urdhri i dhënë Policisë nga ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, në këtë Kuvend, u realizua gjatë aksionit tonë politik. Realizimi i këtij urdhri pasoi me arrestimin e 63 qytetarëve, lëndimin trupor të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që morën pjesë në këtë aksion, dhe me lëndimin e një qytetareje gjermane, e cila e kaloi vdekjen klinike dhe momentalisht gjendet në trajtim intensiv.

Kulmimi i shpërfaqjes së regjimit policor, që po tentohet të vendoset në Kosovë, u dëshmuar në trajtimin e protestuesve të arrestuar. Dy nga ata përjetuan torturim gjatë intervistimit të tyre në stacionin policor, ku ishin ndaluar. Por, unë sot nuk do të ndalem në këtë, pasi, sa i përket dhunës policore, ajo është shfaqur mjaft nëpër medie dhe të gjithë që kanë dashur ta shohin atë, e kanë parë, përveç atyre që janë verbëruar qëllimisht nga pushteti dhe dëshira për të qenë në pushtet.

Qëllimi i ministrit Rexhepi ka qenë që protestuesve t’u shkaktohet dhembja fizike dhe shpirtërore, me qëllim që t’i heshtin qytetarët e Kosovës. Por, qytetarët e Kosovës nuk kanë mundur t’i heshtin as regjimet tjera, e aq më pak ky sot. Lëvizja “Vetëvendosje” është vetëm një prej zërave që janë ngrehur sot për t’i kundërshtuar këto negociata. Një numër i konsiderueshëm organizatash të shoqërisë civile janë mobilizuar për të

organizuar në Prishtinë, ditën e shtunë, një protestë paqësore kundër këtyre negociatave dhe kundër këtij shteti policor.

Deputetë dhe aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje” do t’i përgjigjen kësaj thirrjeje nga shoqëria civile dhe do të bashkohen me protestuesit në shesh. Ky Kuvend i votave të vjedhura të shumicës nuk e ka përfaqësuar asnjëherë vullnetin e lirë dhe demokratik të popullit tonë. Rrjedhimisht, ne u bëjmë thirrje të gjithëve, por edhe deputetëve këtu që t’i bashkëngjiten kësaj proteste, të bashkohen me qytetarët e Kosovës në këtë protestë paqësore që do të zhvillohet të shtunën kundër negociatave dhe kundër këtij shteti policor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BARJAMI: Ju faleminderit, nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola për të shprehur kënaqësinë për mbështetjen e fuqishme ndërkombëtare që Kosova e mori dje me rastin e vizitës së dy zonjave që i përfaqësojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Edhe vizita e djeshme është një mirënjohje që Kosova e ka një mbështetje të fuqishme dhe është në rrugë të drejtë dhe tregoi se Kosova e ka ruajtur partneritetin strategjik. Ky është një konfirmim i qasjes reale dhe i politikave të drejta që po udhëheqim ne karshi sfidave që kemi pas pavarësisë dhe mendoj se dje i dëgjuam zërat e qartë nga zonja Klinton, por edhe nga baronesha Eshton se pavarësia e Kosovës është çështje e kryer dhe integriteti territorial është i paprekshëm. Duhet të jetë një kurajë për të gjithë neve që të kemi guxim, të kemi unitet dhe ta mbështetim një proces shumë të rëndësishëm që po na pret - procesi i normalizimit të raporteve me Serbinë.

Pa dyshim që duhet të ndihemi të gjithë krenarë, sepse ky partneritet është krijuar me shumë mund, me shumë sakrifica, me dekada, dhe për Kosovën është fat që ne e kemi këtë mbështetje të fuqishme ndërkombëtare, e cila ka munduar për shumë shtete tjera dhe kjo mbështetje na bënë të gjithëve krenarë, që Kosova do të jetë shtet shumë i qëndrueshëm, do të jetë shtet që ka miq, do të jetë shtet që do të ketë lehtësira në proceset e integriteteve euro-atlantike, prandaj mendoj se ne tani duhet të hyjmë shumë të bashkuar, shumë të fuqishëm në këtë proces. Ne duhet t’i japim mbështetje Qeverisë dhe Kuvendit që të bashkëpunojnë në këtë proces dhe pa dyshim që Kuvendi i Kosovës do ta mbajë pronësinë për procesin, sepse Rezoluta e Kuvendit të Kosovës ia ka dhënë këtë të drejtë, që ta thotë fjalën e fundit.

Përpos kësaj çështjeje, dua të thërras për një qaje racionale sa u përket debateve për Akademinë e Shkencave. Nuk është detyrë e këtij Kuvendi që të debatojë për proceset e brendshme të Akademisë dhe të Universitetit.

Akademia dhe Universiteti janë dy institucione të shenjta, të pavarura, dhe ne si Kuvend kemi të drejtë të diskutojmë vetëm për ligjet, të cilat janë obligim i shtetit dhe Qeverisë, por jo edhe për proceset e brendshme, sepse me këtë do të kultivojmë që ky Kuvend ka

kredibilitet kushtetues për t'u marrë me çështjet nga kompetenca kushtetuese, jo tani ne çdo ditë dëgjojmë deklarata nga partitë e ndryshme për Akademinë e Shkencës. Kështu që unë apeloj që ky debat të jetë racional dhe të rezervohemi sa u përket kualifikimeve të proceseve dhe t'i bëjmë debatet kur të vijë ligji. Ajo që është detyrë e Kuvendit, e jo çdo ditë këtu të dërgohen mesazhe për institucionet e pavarura, sepse Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencës dhe institutet publike që financohen nga shteti janë institucione të pavarura dhe ne duhet t'i ruajmë si të tilla, sepse me këtë do ta ruajmë e imazhin para bashkësisë ndërkombëtare, që Kuvendi është institucion ligjvënës, e nuk është institucion që merret me institucionet e pavarura. Detyra jonë ndaj institucioneve të pavarura është që të kontrollojmë si po...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot bota perëndimore e ka një datë të rëndësishme, megjithëse nuk është adaptuar në kalendarin tonë. Ne këtë datë duhet ta kujtojmë për një rëndësi të veçantë, sepse 1 Nëntori i respekton të vdekurit. Të gjithë ata që janë ndarë në një mënyrë apo në mënyrën tjetër nga jeta, sot e kanë ditën kur të gjallët u gjunjëzohen apo luten, i vizitojnë, apo flasin për ta. Sot, kam dalë si deputet të kërkoj drejtësi për një numër të madh të vdekurish në Kosovë. Kjo drejtësi e vonuar, që nuk po vjen e që po vonohet, e ka trazuar gjithkënd, natyrisht që i trazon edhe familjet, në radhë të parë, por edhe ne si deputetë. Kjo bëhet edhe më e madhe kur individë, spekulantë e përfitues ndërhyjnë, duke dashur të vendosin drejtësi, duke bërë me gisht, duke treguar, por aty ku mungon shteti, dalin në plan spekulantët dhe natyrisht drejtësia vonohet.

Të gjitha ato vrasje, të gjitha ato zhdukje dhe të gjithë ata njerëz që na mungojnë sot, vërtet, duhet të dalin në plan të parë, jo vetëm sot, por çdoherë kur vepron institucioni. Sot nuk është këtu ministri i Drejtësisë, por Kosova e ka një obligim të madh në kuadër të dialogut mbi sundimin e ligjit që të merret seriozisht me masat që vendosin sundim të ligjit në Kosovë dhe që krijojnë besim në institucionet e drejtësisë.

Unë bëj apel në këtë ditë të sotme që të zbardhen vrasjet politike, të zbardhen të zhdukurit, të zbardhet gjithçka që sot është e errët lidhur me plagën e hapur që e ka Kosova.

Pjesën e dytë të diskutimit tim, kërkesën time në këtë pikë të rendit të punës, e kam për ministrin Buja. Zori ministër, 12 familje të 12 vajzave kanë bërë kërkesë te ju që t'ua ktheni fëmijët në shkollë. Ato padrejtësisht janë larguar nga bankat shkollore për shkak të bindjeve fetare. 12 fëmijë janë vajza, janë femra, për të cilat presidentja jonë, sekretarja e SHBA-ve dhe baronesha dje kanë folur aq shumë për të drejtat e grave, për avancimin e të drejtave dhe rolin të tyre, si dhe për rolin e femrës në shoqëri...

(Ndërprerje nga regjia, ndërhyrje e kryesuesit: Vazhdo në emër të Grupit!)

...Ju faleminderit!

12 vajza nuk shkojnë në shkollën fillore. Atëherë ose Ministria, ose drejtori i shkollës, ose familjet e tyre duhet të ndiqen penalisht. Fëmijët nuk mund të mos e vazhdojnë mësimin shkollor, duke e neglizhuar këtë çështje, sepse ato janë në shtëpi. Ato vajza sot qëndrojnë në shpi, nuk shkojnë në shkollë. Mosndërhyrja e autoriteti tuaj në këtë rast, ministër, bën që 12 fëmijë të mbeten të paedukuar, të paarsimuar dhe pre e edukimeve tjera. Unë e di se Kosova nuk ka kapacitete të ndërhyjë në edukimin fetar nëpër shkollat serbe, në mësimin është në gjuhën serbe. Besa të tregojmë drejt, ne krejt e dimë që edhe në mësimin në gjuhët tjera, d.m.th. jo shqipe, nuk mund të ndërhyjë, sepse atje vazhdon të zbatohet edukimi fetar. Atëherë është e padrejtë që shumicës shqiptare dhe vajzave që kanë besim dhe që e shprehin atë besim, të mos u lejohet të shkojnë në shkollë dhe nuk u lejohet ta vazhdojnë mësimin shkollor. Ju duhet të ndërhyni, sepse ky është me motivacion krejt tjetër dhe shkakton defekte serioze në shoqërinë tonë.

Diçka tjetër është nëse flasim për shkollimin superior. Është e drejtë e tyre mandej të zgjedhin a duan të edukohen apo jo, por në këtë nivel është e domosdoshme ndërhyrja juaj. Ju e keni listat e emrave, ju e keni kërkesën e prindërve dhe të familjarëve, prandaj duhet të ndërhyni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka zonja Mikić.

VESNA MIKIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani poslanici,

Dame i gospodo,

Zaista ne znam koliko je puta potrebno da se jedno te isto pitanje provlači kroz ovu Skupštinu, a to je pitanje vezano oko problema sa tablicama. Naime, Srpska zajednica još pre 4. meseci lišena prava na slobodu kretanja, tako što su im oduzete registarske oznake i propratna dokumenta. Tada su nam obećavali da će taj problem biti rešen za nekih 15-20 dana, međutim od tada je prošlo 4. meseca, a mi stojimo još uvek u mestu. Ne znam zaista šta je potrebno da se određena ministarstva pokrenu, i da ovo nepodnošljivo stanje učine boljim izdrživim.

Juče kao grom iz vedra neba odjeknula vest, nova vest, da će se Srbima zabraniti kretanje na teritoriji Kosova bez registarskih oznaka, što automatski znači da smo do sada bili u rezervatu, ali smo od sada osuđeni na samicu. Ja ne znam zaista gde je tu uloga međunarodne zajednice, gde je tu uloga zapada kada kaže da će učiniti sve da relaksira odnose između Beograda i Prištine. Zar čete na ovakav način gospodo relaksirati te odnose i zar se na ovakav način pokazuje napredak u demokratiji. Nažalost, da su uloge kojim slučajem promenjene i da se u našoj situaciji nalaze Albanska zajednica, ova vest bi odjeknula širom sveta u svim medijima. Ali, kada je Srpska zajednica u pitanju, svet čuti, međunarodnu zajednicu to ne zanima. Još da bude gore, međunarodna zajednica

nagrađuje ovakav akt, tako što pomaže Kosovu na putu ka evro-atlanskim integracijama. Izgleda da je nasilje glavni adut i karta za integrisanje u Evropu.

Ja zaista ovom prilikom molim moje građane, pošto smo dovedeni u takav položaj da nemamo izlaz, i da nam niko ne želi pomoći, i da svi zatvaraju oči na probleme koje se tiču Srpske zajednice, da olakšamo Albanskoj zajednici tako što ćemo izaći na ulice, pa neka nas sve onda, da se izrazim prosto rečeno - ubiju ili pritvore, jer kada se uskrati pravo kretanja, onda nema o čemu da se govori dalje. Zaista molim moje građane i one koji su pogođeni ovim aktom i one koji nisu, da izađu na ulice i da pokažu nezadovoljstvo i prema torturi koja ova Vlada, međunarodna zajednica i zapad već 12. godina, a da ne pominjem u vezi ovog problema već 4 meseca, vrše neviđenu torturu nad srpskim narodom. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Por, dua të ju paralajmëroj që nga foltorja e Kuvendit të Kosovës askush nuk ka të drejtë të thërrasë as rezistencë, as për kundërshtim ndaj organeve kushtetuese të Kosovës. Në qoftë se nuk e dini, po ju tregoj që kjo është e ndaluar me Rregullore dhe me Kushtetutë. Prandaj, ju kisha lutur të mos e keqpërdorni foltoren.

Fjalën e ka zoti Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë sot desha të ngre një çështje, sepse pikërisht pra muaji nëntor edhe një herë na e përkujton se para 14 vjetëve, pikërisht në këtë muaj sikur ky, janë sjellë në Kosovë eshtrat e heroit tonë kombëtarë, Isa Boletini, dhe të 7 bashkëluftëtarëve të tij. Edhe kjo nuk ishte një çështje e lehtë, sepse në vitin 1998 të sillen eshtrat e Isa Boletinit në Kosovë ka qenë një sakrificë dhe jo me pak rrezik. Por, duke e falënderuar imamin e Mitrovicës, Asllan Murati, në bashkëpunim me myftiun e Bashkësisë Islame të Malit të Zi, me seli në Podgoricë, pastaj angazhimin e profesor Latif Berishës, profesor Muhamet Shukriut, pas disa vizitave intensifikimit u bë e mundshme që nëpër shumë rreze eshtrat të sillen në Kosovë. Me këtë rast dua edhe një herë t'i falënderoj këta njerëz për kontributin e tyre, që e bënë të mundur që pas 100 vjetësh, eshtrat e Isa Buletinit dhe bashkëluftëtarëve të tij të kthehen në Kosovë.

Ata janë vendosur në një vend ku janë ruajtur, janë fshehur deri në vitin 1999-2000. Pas vitit 1999-2000 u janë dërguar të gjitha shkresat të gjitha institucioneve kompetente dhe të vullnetit të mirë që të bëhet e mundshme kthimi i eshtrave pranë kullës Isa Boletini, që tash është shpallur edhe muze kombëtar. Dhe, pikërisht ky nëntor dhe me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, për të cilën Isa Boletini, bashkëluftëtarët dhe bashkëmendimtarët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm, është momenti i fundit që ajo të ndodhë, pra të kthehen eshtrat pranë kullës së Isa Boletini dhe që të gjithë ta dinë se ku pushojnë eshtrat e këtij burri të madh dhe të shumë bashkëmendimtarëve të tij. Nëse eventualisht ka planifikime të tilla, atëherë unë jam në mbështetje, por thërras që të bëhen

përgatitjet të mira që të mos ndodhë sikur në vitet 2000, 2003, 2005, 2007, 2008, 2009 e 2010, se nuk janë krijuar kushtet, se po pengon kjo çështje, se po pengon ajo çështje. Unë nuk shoh sot pengesa që të gjithë aktorët kompetentë, që nga niveli qendrorë deri te niveli lokal, të mobilizohen dhe kjo të ndodhë, e pastaj të gjithë bashkë do të shkonim, që së paku pak t'i dalim haku kontributit të madh të Isa Boletinit, bashkëluftëtarëve dhe asaj periudhe, që ka shënuar një periudhë të pashlyeshme në historinë tonë kombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Para një jave, Banka Botërore e bëri publik raportin për të bërë biznes për vitin 2012, të cilin e publikon në secilin vit.

Sipas tij, Kosova radhitet në vendin e 98-të, që është një përparim i madh, meqenëse në vitin 2011 ishte në vendin e 117-të.

Sipas këtij raporti, del se Kosova e ka pasur një avancim të madh në mesin e 185 shtete, të cilat çdo vit i trajton Banka Botërore.

Ngritje kaq e madhe tregon për përmirësimin e ambientit për biznes. Pasi prej 10 kriterëve, sa ka parasysh Banka Botërore, janë përmirësuar 8 prej tyre, me një koordinim më të mirë ndërmjet administratës qendrore dhe asaj lokale, mund të kishte përmirësime, posaçërisht për regjistrimin e pronës, ku gjendja është përkeqësuar.

Me këtë rast i kam vetëm dy vërejtje.

Në një, ndryshimet e përmendura, përkatësisht avancimi i Kosovës në këtë listë, del nga ndryshimet dhe plotësimet që kanë ndodhur në ligje. Po ashtu, në shumë komuna janë hapur qendra për regjistrimin e biznesit, gjë që ka lehtësuar punën e reduktuar mbi shpenzimet. Me këtë i mbetet Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të bëjë më shumë për aftësimin e stafit, përkatësisht eliminimin e sjelljeve burokratike të tyre.

Me këtë dua të them se transformimet nuk duhet të vërehen vetëm te ligjet, por edhe duke e përmirësuar kulturën e punës dhe sjelljen ndaj palëve. Njëkohësisht, është vështirë të pritët që reagimi në këtë listë mund të reflektojë edhe në rritjen e vlerësimeve, përderisa korrupsioni, krimi i organizuar dhe informaliteti mbeten në nivel më të lartë.

Nën dy, në këtë listë Kosova është e fundit krahasuar me vendet fqinja. Për shembull, Maqedonia është në vendin 23, Mali i Zi në vendin 51, Shqipëria në 85, kurse Serbia në vendin 86. Pra, konkurrentët e drejtpërdrejtë të shtetit tonë qëndrojnë shumë më mirë se vendi ynë. Kjo do të thotë se përparimi i vendit duhet të vështrohet në krahasim me fqinjët, ambienti më i favorshëm për biznes që kanë krijuar fqinjët tanë. Kjo mund të

ndikojë investimet, por edhe biznesi të ikin nga Kosova. Siç e dimë, edhe kanë ikur disa biznese dhe tash janë duke investuar në Maqedoni. Prandaj, ato duhet t'i merren si modele dhe të gjendet zgjidhja që i përshtatet ambientit tonë. Do të ishte mirë që Ministria e Financave të punojë edhe më shumë në pakon fiskale, posaçërisht për aplikimin e pushimeve tatimore. MTI-ja, përkatësisht Qeveria e Kosovës, të kërkojë që pushteti lokal të jetë shumë më efikas, kur janë në pyetje lejet e ndërtimit, regjistrimi i pronës, apo sigurimi i lokacioneve për bizneset prodhuese e shërbyese.

Këto intervenime do të mundësonin që Kosova të jenë një vend më atraktiv, seç është sot, pa marrë parasysh pozitën më të mirë që e ka në listën e Bankës Botërore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit nënkryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Para se ta lexoj fjalën, dua ta bëj një mesazh. Përkrahjen ndërkombëtare nuk e kemi fituar duke na i hequr targat. Kjo ka ndodhur një kohë gjatë, deri kur kanë filluar të na i heqin kokat. Kur kanë filluar të bien kokat dhe të vriten njerëzit, atëherë ka ardhur përkrahja ndërkombëtare.

Unë në këtë moment e kam pak më të lehtë fjalën time, sepse është krijuar një relaks në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në raportet e Kosovës me forcat e vendosjes, pas vizitës së dy zonjave të mëdha dhe të nderuara. Por, një praktikë që është në komunikimet tona, dua ta ngre si shqetësim timin.

Modeli i dy Gjermanive, si formulë për zgjidhjen e raporteve Kosovë - Serbi ka konotacione të dëmshme, duke u nisur nga ato utilitare, deri te ato strategjike, prej atyre aspekteve perceptuese që krijohen mbi një problem, e deri te ato esenciale në akceptin e thelbit të tij.

Nëse nuk ndalet ky komunikim në komunikimet tona, sado kundërime dashamirëse që kemi si përdorues të këtij modeli, do të krijojmë përshtypje në opinion observerues se kemi të bëjmë me një ndarje të padrejtë të një tërësie, e cila mund të supozohet edhe nga vegimet e ndërrijes, meqenëse konstelacioni i ndarjes në sfera të interesit gjithfarë ka krijuar një realitet ireal, këto dy pjesë duhet të komunikojnë e të bashkëpunojnë deri në ribashkimin e tyre.

Aspektet perceptuese, përveç që janë të dhimbshme, janë edhe të rrezikshme, sepse ndikojnë në aspektet esenciale dhe në trajtimin e çështjes dhe e bëjnë atë më të lëndueshme.

Nga rasti i Gjermanive mund të merret vetëm një praktikë e rallë nga raportet ndërmjet dy shteteve. Rasti i Gjermanisë si model do të duhej të shërbejë vetëm si kërcënim të atyre pushteteve agresore dhe të atyre shteteve që duan zgjerimin mbi territorin e popujve tjerë me politikat e pushtimit. Do të duhej të shërbejë si kërcënim dhe si leksion për të tashmen

e për të ardhmen. Do të duhej të shërbejë për mobilizim dhe për qasje të emancipuar për t'u bashkuar në një front. Sistemet e ndryshme shoqërore politike dhe besimet e ndryshme fetare, ku rrezikohet sistemi i vlera njerëzore. Sikur i bashkërenduan forca Amerika dhe Anglia në Luftën e Dytë Botërore, dy shtete kapitaliste me një shtet socialist, BRSS-në, kundër një shteti me rend kapitalist.

Gjithashtu, edhe shtetet me besim fetar katolik i bashkërenduar në forca të tyre me një shtet fetar me dominim ortodoks për ta mundur dhe për ta shkatërruar një shtet me besim katolik. Ky rast në histori ka thyer teori e definicione filozofike, ka ndryshuar koncepte e leksione politike dhe ka korrigjuar aksioma e predikime teologjike.

Ky mobilizim dhe kjo qasje do të duhej të vazhdonte edhe pas bombardimeve mbi Serbinë, do të duhej të ndaheshin patjetër gjithsesi ato territore, ë cilat janë banuar edhe sot me shumicë nga popujt joserbë dhe t'u bashkohen territoreve dhe origjinave të tyre, si Lugina e Preshevës dhe Sanxhaku me Kosovën, dhe Vojvodina e hungarezëve Hungarisë. Kështu do të vendosej një drejtësi nga hapësirat e Evropës dhe kështu do të ndërtohej raporti real dhe i qëndrueshëm, duke mbjellë një herë e përgjithmonë një vetëdije edukative mbi territoret, mbi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hajzeraj-Beqaj, me kartelën e zotit Sadriu, prandaj s'ka dalë emri juaj, e keni fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit zoti kryesues!

Edhe pse po më duket se ka pasur probleme teknike, unë jam ndër të parat që e kërkoja fjalën. Unë dua të shpreh ngushëllim dhe solidarizim me popullin amerikan dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që po ballafaqohen me një tragjedi natyrore, e që mund të na ndodhë të gjithëve. Tash më në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më shumë se 60 milionë njerëz janë të shpërngulur nga shtëpitë e tyre, kurse deri më tani 51 persona njerëz të pafajshëm e kanë humbur jetën. Pra, këta janë ata që dihen, e mund të dalë një numër edhe shumë më i madh i tyre. Andaj, unë kërkoj nga ky Parlament, meqenëse është edhe Dita Botërore e të Vdekurve, që me një minutë heshtje t'i nderojmë dhe të solidarizohemi në mënyrë modeste me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me popullin amerikan.

Unë mendoj që shumica e deputetëve të Parlamentit të Kosovës janë dakord me propozimin tim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit nënkryetar!

Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Edhe 13 vjet pas luftës, pas shkatërrimeve masive që janë bërë nga regjimi kriminal i Slobodan Milosheviqit, ende në mënyrë sistematike po vazhdon një diskriminim në bazë të atij regjimi, i cili ka udhëhequr në shumë pjesë të Kosovës.

Qytetarët e Deçanit janë të dëmtuar nga një marrëveshje e paligjshme dhe shumë e dëmshme për zhvillimin ekonomik të asaj treve. Bëhet fjalë për një marrëveshje ndërmjet AKM-së dhe Manastirit të Deçanit, me të cilën barten 23 hektarë tokë, pronë e ndërmarrjes APIKO dhe “Iliria”, i njohur si hoteli “Iliria”.

Ky vendim bazohet në një vendim të kohës së regjimit të dhunshëm apo masave të dhunshme të viteve 1993-1999 ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit, dhe ky vendim është njohur po ashtu me një vendim të paligjshëm ekzekutiv të UNMIK-ut, 2005/5.

Kolegë deputetë,

Qytetarë dhe Qeveri,

Kjo kundërshtohet në mënyrë kategorike nga qytetarët e Deçanit dhe ata ftojnë njëkohësisht të gjitha institucionet vendimmarrëse, që nga Kuvendi e Qeveria, ta kthejnë pronën e tyre dhe kjo marrëveshje e dëmshme të shpallet e pavlefshme.

Kjo çështje duhet të ketë trajtim të veçantë, pa konteste politike dhe etnike, duke marrë për bazë vetëm të drejtën e atyre qytetarëve që jetojnë atje, sepse pikërisht këto prona ishin dhe mund të jenë gjenerator i zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo pikë e rendit të ditës është shteruar. Është koha e ministrave dhe Qeverisë. Zoti Buja e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Ndiej nevojë ta sqaroj një gjë, sepse nuk dua t’i marrë zotit Haziri as ndjeshmërinë më të madhe që e ka për këtë, po as më të voglën. Unë besoj që jemi të shqetësuar bashkë për rastin e 12 nxënësve që nuk e vijnë shkollën. Por, dua veç të ju rikujtoj që Ligjin për arsimin parauniversitar e keni aprovuar ju, dhe ligjet tjera po ashtu ju, si deputetë, edhe Kushtetutën. Dhe e dini po ashtu përgjigjen që e ka dhënë Gjykata Kushtetuese për një rast të vetëm, siç janë këto 12 raste, e unë jam shumë i interesuar, jetësisht i interesuar, që këto raste të mos përsëriten, por të gjithë njerëzit që janë të interesuar ta vazhdojnë shkollën pa asnjë telashe, por përsëri ju e dini që kjo marrëveshje duhet të ndodhë, jo në nivel kushtetues dhe ligjor, por në një nivel krejtësisht tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhepi e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Desha ta bëj një sqarim në çështjen që e shtroi deputetja më parë në lidhje me tabelat e regjistrimit, një sqarim se kanë të drejtë të gjithë t’i regjistrojnë ato, por prej nëntorit të

vitit të kaluar çdo importim i ri i atyre automjeteve i nënshtrohet akcizës dhe doganave dhe problemi është me ato automjete që janë importuar pas asaj date, meqë ka pasur shumë keqpërdorime dhe falsifikime. Pra, ka qenë shumë e qartë.

Vazhdimi i regjistrimit ka qenë permanent dhe tash po ashtu prej korrikut të këtij viti nuk kanë të drejtë qarkullimi në territorin e Kosovës as me tabelat e reja ilegale, as me të vjetrat. Por, prapë kemi dhënë mundësi që t'i bëjnë aplikimet, që për arsye të ndryshme nuk i kanë regjistruar. Komisioni i verifikon dhe i pajis me tabela RKS apo KS.

Prandaj, çdonjëri që ka dashur të pajiset, ka pasur mundësi dhe e ka këtë mundësi edhe më tutje.

Ndërsa ne nuk kemi të drejtë t'i thyejmë ligjet tona dhe të lejohet importimi pa paguar doganë dhe akcizë. Kjo ka qenë deri në nëntor të vitit të kaluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës është shteruar.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me menin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti në një mbledhje mund të parashtrojë më së shumti dy pyetje. Do ta kapërcejmë radhën, për shkak se ministri Beqaj e ka një takim dhe ka kërkuar që zoti Visar Ymeri t'ia parashtrojë pyetjen. Zoti Ymeri, e keni fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit kryesues!

Çështja për të cilën dua ta shtroj pyetjen është kontrata e nënshkruar me konsorciumin “Çalik & Limak Kosova Energy” për privatizimin e kompanisë kosovare për Distribuim dhe Furnizim. Pra, siç e dimë, kjo kontratë është nënshkruar më 17 tetor të vitit 2012 dhe përbëhet nga gjithsej 5 marrëveshje, ndërkohë që, me gjithë premtimeve tuaja, ju deri tash i keni publikuar vetëm dy, ato që janë shpërndarë për media, marrëveshja për shitblerje të aksioneve dhe marrëveshje për implementim.

Pyetja ime ka të bëjë me pjesët tjera të kontratës, pra me marrëveshjet tjera, pse nuk publikohen ato?

KRYESUESI: Ministri Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Ymeri,

Procesi i privatizimit të Distribucionit, siç kam deklaruar shumë herë deri më tani këtu, është realizuar duke u respektuar vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi dhe duke e siguruar transparencën maksimale.

Në këtë drejtim, Ministria e Zhvillimit Ekonomik i ka botuar në ueb-faqen e vet të gjitha dokumentet e këtij procesi.

Fillimisht, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, në ueb-faqe i kemi botuar vetëm dy dokumentet kryesore: marrëveshja për shitblerje të aksioneve dhe marrëveshja për implementim, por ndërkohë kur e kemi parë që ka interes dhe konform Ligjit mbi qasjen në dokumentet publike, këto dokumente janë botuar tashmë disa ditë në ueb-faqen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Përndryshe, dua të ju përkujtoj që të gjithë ata të cilët kanë dëshirë, që jo vetëm në ueb-faqe t'i marrin dokumentet, konform Ligjit për qasje në dokumentet publike, ato mund t'i marrin edhe në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe në Dhomën për Informim, e cila është themeluar, por gjithsesi duhet të respektohet Ligji për qasje në dokumentet publike, e ky ligj thotë që ata të cilët dëshirojnë të kenë kopje fizike, duhet ta bëjnë një kërkesë. Ligji në nenin 4.4 thotë: "Palët të cilat dëshirojnë t'i marrin dokumentet, ato nuk mund t'i përdorin për qëllime denigruese, propagandistike dhe komerciale". Pra, dokumentet janë publike, ato mund të merren dhe mendoj se u ka ikur këtu një informacion. Mund të merren edhe me kërkesë të shkruar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, por në asnjë rrethanë ligji nuk lejon që të përdoren për qëllime denigruese, propagandistike dhe komerciale. Kështu thotë ligji, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit kryesues!

Më shumë se pyetje, do ta quaja koment. Natyrisht që ekziston mundësia që nëpërmjet Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare të arrihet deri te dokumentet, por fatkeqësisht me këtë Qeveri kjo mundësi është vetëm formale për shkak se realisht nuk është zbatuar kurrë, të paktën për këtë proces privatizimi. Ju e dini që unë e kam shtruar edhe një pyetje parlamentare më herët për këtë çështje dhe i kam dërguar kërkesë Ministrisë suaj për t'i dorëzuar dokumentet që atëherë draftoheshin, por përgjigjja juaj ka qenë se meqenëse janë drafte nuk mund t'i shpërndani. Pra, pikërisht për këto marrëveshje. E tash, pas nënshkrimit të kontratës, këto nuk janë më drafte besoj. Meqenëse janë të nënshkruara, janë dokumente finale.

Në këto dy dokumente, që i përmenda, që i keni shpërndarë për media, edhe ato nuk i keni shpërndarë të tëra. Pra, aneksi i marrëveshjes për shitblerje të aksioneve dhe një pjesë e marrëveshjes për implementim nuk ka qenë e shpërndarë, e në tekstin e marrëveshjes si të tillë ka referenca të aneksit, i cili nuk ekzistonte. Pra, edhe atyre që kanë pas interes u është bërë e pamundur që t'i...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dua edhe një herë ta informoj deputetin Ymeri se Ligji për qasje në dokumentet publike është miratuar nga ky Kuvend dhe definojnë se çka quhet “dokumente publike”. Dua ta përkujtoj deputetin se dokumente publike nuk janë draftet, dhe ligji kështu e thotë, dhe duhet të dalloni çka është drafti dhe çka është dokumenti publik. Ligji mbi qasjen në dokumente publike e definojnë që dokument publik është dokumenti i cili është miratuar. Po flasim për ligjin, sepse u referua te ligji. Pra, ligji u siguron qasje të gjithë atyre të cilët kanë dëshirë të marrin informacione mbi dokumentin zyrtar, e dokumenti e merr formën zyrtare atëherë kur aprovohet. Përndryshe, për të gjitha dokumentet në fjalë, ky Kuvend ka pasur një debat publik. Është organizuar debat publik në këtë Kuvend. Ky Kuvend ka debatuar lidhur me këto dokumente. E keni pasur mundësinë që t’i jepni komentet tuaja aty. Pastaj, e kemi zgjatur edhe dy javë, meqenëse s’ka pasur komente. Fatkeqësisht, s’ka pasur komente profesionale dhe nuk keni dhënë komente. Por, po ju them edhe një herë, respektojeni ligjin, respektojeni Kushtetutën e Kosovës, bëjeni kërkesën konform këtyre bazave dhe normalisht do ta merrni informacionin e duhur të detajuar. Por, nuk merret informacioni nëpërmjet pyetjeve parlamentare dhe nëpërmjet gazetave. Është ligji i cili duhet ta respektoni dhe të veproni konform tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lama, pyetje për ministrin Hoxhaj. Ministri nuk është. Dëshironi ta bëni pyetjen? E keni tërhequr pyetjen? Në rregull. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit zoti kryesues!

Me themelimin e Komunës së Junikut, stafi shëndetësor është ndarë ndërmjet Qendrës Kryesore Familjare në Deçan dhe në Junik.

Stafi shëndetësor aktual nuk është i mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore qytetarëve të Junikut dhe Rekës së Keqe. Për shkak të mungesës së stafit dhe të mjeteve të punës, qytetarëve nuk po mund t’u ofrohet shërbim në këtë institucion 24 orë, e as ditëve të festave.

Zoti ministër, e keni pranuar një shkresë nga kryetari i Komunës së Junikut me numër të protokollit 0104/18, të datës 12.7.2012, me të cilën është bërë kërkesë për rritjen e stafit të QKMF-së në Junik, në mënyrë që shërbimi shëndetësor të funksionojë 24 orë. Cila është përgjigjja juaj?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Koleg të Kabinetit qeveritar,

E nderuara zonja deputete,

Ministra e Shëndetësisë, në kuadër të zgjerimit të rrjetit të qendrave kryesore të mjekësisë familjare sidomos në zonat rurale, e ka realizuar projektin e ndërtimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Junik si prioritet në politikat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore sa më pranë qytetarëve.

Me shumë prioritet janë shqyrtuar edhe kërkesat për pajisjen me aparatura dhe në këtë drejtim edhe kërkesa e Kuvendit Komunal të Junikut dhe, të ju njoftoj se për të gjitha qendra kryesore të mjekësisë familjare, që kanë kërkuar që kanë paraqitur kërkesë për këtë, janë siguruar 240 mijë euro, midis tyre edhe për Komunën e Junikut, për sigurimin e aparaturave të rëntgenit. E bëra këtë hyrje për të treguar interesimin e Ministrisë për kujdesin parësor shëndetësor në komunën e Junikut, në veçanti.

Sa i përket rritjes së numrit të stafit, Kuvendi Komunal i Junikut duhet ta drejtoj kërkesën në Ministrinë e Financave, ndërsa Ministria e Shëndetësisë do t'i mbështesë në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë të nevojshëm, gjë të cilin e bën në vazhdimësi në ndarjen e specializimeve nga mjekësia familjare. Kjo është një përgjigje formale, por përgjigjja ime përmbajtjesore është se ne kemi obligim ligjor që të sigurojmë shërbim 24 orë për qytetarët, edhe të komunës së Junikut, dhe në këtë drejtim Ministria e Shëndetësisë ka arritur në kuadër të projeksioneve buxhetore për vitin 2013 ta sigurojë numrin plotësues të stafit shëndetësor. Ky numër do të shfrytëzohet edhe për përmbushjen e kësaj kërkesë të Komunës së Junikut.

KRYESUESI: Faleminderit, pyetje shtesë zonja Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit për përgjigje zoti ministër!

Në Projektligjin e ri të shëndetësisë, ju keni thënë gjatë amendamentimit se keni siguruar mjete nga Ministria e Financave për punësim të punëtorëve shëndetësorë, përkatësisht të mjekëve specialistë dhe mjekëve të praktikës së përgjithshme nga 100 mjekë për çdo vit. Atëherë, a është e mundur që në kuadër të kësaj, një numri të konsiderueshëm t'u lejohet punësimi në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Junik, në mënyrë që edhe aty të organizohet shërbimi shëndetësor 24 orë dhe gjatë ditëve të festave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën përsëri.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

Më duket se në përgjigjen time e thashë se janë siguruar mjetet financiare për punësimin e 200 punëtorëve shëndetësorë në vitin 2013 dhe të 100 punëtorëve shëndetësorë vetëm për komunën e Mitrovicës, plus kësaj edhe 30 punëtorë të tjerë shëndetësorë për nevojat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Prandaj, këto premtime që janë dhënë janë duke u mbajtur dhe brenda këtij numri prej 200 punëtorëve shëndetësorë që i kemi siguruar për vitin 2013, do të kemi zgjidhje edhe për kërkesën e Drejtorisë për Shëndetësi të Komunës së Junikut.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqu, pyetje për zotin Agani.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit nënkryetar!

I nderuar ministër,

Unë e kam një pyetje, të cilën e kam marrë si obligim nga grupi asambleistëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës. Është një punë fisnike, të cilën po e kryejnë dhe me këtë rast i përshëndes ato asambleiste. Ato e kanë bërë një projekt, me të cilin i kanë vizituar fëmijët nëpërmjet mjekeve të këtyre dy

komunave dhe ka dalë një rezultat, i cili unë uroj që të mos jetë i saktë, meqë fëmijët e dy komunave kanë jashtëzakonisht probleme, e nuk ka vizita sistematike mjekësore.

Pra, ky edhe është një obligim i drejtorive komunale, mirëpo në këtë drejtim, duke e ditur që e ka një kosto shumë të madhe, pyetja ime, duke i komentuar edhe të dhënat se mbi 80% e këtyre fëmijëve kanë probleme me dhëmbë të prishur, që drejtohet në emër të asambleisteve është kjo: A keni ju mundësi që ta ndërmerrni një veprim, që në bashkëpunim edhe me MASHT-in, të bëhen vizita sistematike komplete të fëmijëve së paku një herë në vit, në mënyrë që të bëhet një preventivë para se të arrihet vonë te hetimi i sëmundjeve të ndryshme, të cilat rezultojnë pastaj me pasoja që nuk riparojnë?

KRYESUESI: Zoti ministër Agani, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

E nderuar zonja deputete,

I kuptoj plotësisht shqetësimet tuaja, por duhet të theksoj se kujdesi parësor shëndetësor në Republikën e Kosovës në periudhën e pasluftës është i organizuar mbi konceptin e mjekësisë familjare, i miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Vizitat sistematike nëpër shkolla nuk janë pjesë e këtij koncepti. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë është e interesuar që ta avancojë zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe çrregullimeve në mesin e fëmijëve shkollorë dhe në këtë drejtim brenda mundësive të saj do t'i mbështesë iniciativat e drejtorive komunale të shëndetësisë, që janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor, që domosdoshmërisht duhet të mbështeten në bashkëpunimin me qendrat kryesore të mjekësisë familjare.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit ministër!

Unë e respektoj punën dhe angazhimin tënd në vazhdimësi. Mirëpo, kisha dashur të flas në detaje, se ato janë shqetësuese. Ka rezultate që gjatë rritjes së tyre, në moshën delikate ka devijime të kafazit të krahavorit, të cilat prindërit, disa në pamundësi, disa nga mosndërgjegjësimi, i vërejnë shumë me vonesë. Prandaj, që të arrihet të bëhet një detektim i mëhershëm, ato kërkojnë që nga Ministria e Shëndetësisë të përkrahen projektet, sipas të cilave së paku një herë në vit të bëhet një vizitë sistematike, duke përfshirë edhe analizat e gjakut, edhe përcjelljen e rritjes së tyre, edhe problemet me shikim e me dëgjim. Në këtë drejtim, unë e di që kostot e niveleve lokale nuk arrijnë ta përthejnë këtë. Pra, ky ishte vetëm një sugjerim dhe një përkrahje e iniciativës, të cilën e kanë filluar asambleistët e dy komunave. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, sqarim shtesë.

MINISTRI FERID AGANI: Në parim, sistemi shëndetësor i vendit është i organizuar në atë mënyrë që shërbimet shëndetësore, edhe për fëmijët shkollorë të ofrohen në qendrat kryesore të mjekësisë familjare dhe nuk duhet zhvendosur vëmendja nga institucionet shëndetësore në institucionet arsimore, kur është në pyetje zbulimi i hershëm i

sëmundjeve, sepse gjithsesi institucionet shëndetësore janë më të përgatitura, si në aspektin e kapaciteteve teknologjike, do të thotë pajisjeve, kapaciteteve profesionale, për të zbuluar në mënyrë kompetente sëmundjet dhe çrregullimet.

Gjithmonë ekziston mundësia e organizimit të vizitave grupore të nxënësve në qendrat kryesore të mjekësisë familjare dhe kjo është ajo që unë do ta kisha inkurajuar, por thashë prapë, Ministria e Shëndetësisë është e hapur ndaj projekteve konkrete, iniciativave të caktuara dhe do t'i mbështesë ato iniciativa dhe të themelohet njëllloj bashkëpunimi ndërmjet drejtorive komunale të shëndetësisë, qendrave kryesore të mjekësisë familjare dhe shoqërisë civile në këtë aspekt, çdo gjë në funksion të zbulimit të hershëm të sëmundjeve dhe të çrregullimeve të fëmijët.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Izma, pyetje për ministrin Buja.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëri është një pyetje që lidhet me shëndetin, pra të fëmijëve tanë, mirëpo në këtë rast të fëmijëve që janë në çerdhe dhe në institucione tjera parashkollore, mirëpo konkretisht në institucione parashkollore private.

I nderuar ministër, ne e dimë që vitin e kaluar ju keni nxjerr një rregullore për funksionimin e mirëfilltë të institucioneve private parashkollore, mirëpo në këtë drejtim ne nuk morëm asnjëherë pastaj një informacion nëse ju keni një staf apo keni një zyrtar, që po i përcjell se si po funksionojnë këto institucione parashkollore, pasi që kemi informacione që nuk kanë kushte të përshtatshme për mbajtjen e fëmijëve aty, për arsye se nuk përcillen me ushqim kualitativ dhe me ndarje të moshave, mirëpo ka institucione parashkollore ku vihen fëmijët prej moshës 6 muaj deri në 5 vjet, domethënë qëndrojnë bashkë në një dhomë dhe çështja e ushqimit kualitativ, pra është në pyetje.

A keni ju një zyrtar apo staf, që është duke e përcjellë këtë punë?

KRYESUESI: Faleminderit. Fjalën e ka ministri Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar deputete Izma, Faleminderit shumë për pyetjen e bërë!

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vazhdimësi është duke përcjell gjendjen në institucionet parashkollore private, përmes inspektorëve të arsimit dhe duke ndjekur procedurat e licencimit përmes komisionit përkatës.

Duhet ta dini që vetëm një çerdhe ose një institucion parashkollor, aktualisht ka licencë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në shtator të këtij viti është mundësuar që të aplikojnë të gjithë ata që kanë krijuar kushtet për të aplikuar, në bazë të Udhëzimit 6/2011 ose 19.9.2011, dhe në fakt kanë aplikuar jo më pak se 62 institucione të tilla.

Tani, institucioni që është bërë enkas për këtë çështje është duke i inspektuar, duke i vlerësuar nëse i plotësojnë apo s'i plotësojnë kushtet dhe në fillim të dhjetorit të gjitha ato institucione parashkolllore, që i plotësojnë kushtet për të qenë në nivelin e tillë, që të japin të gjitha ato mundësi për të qenë aty parashkollorët, por edhe në nivelin shëndetësor edhe edukativ, do të licencohen. Në të kundërtën, të tjerat do të pamundësohen për t'u licencuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E keni pyetje shtesë? Jo.

Deputetja, zonja Vjollca Krasniqi, pyetje për ministrin Çeku. Ministri më duket nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë edhe gjatë elaborimit të pyetjes kam theksuar që në këtë pyetje mund të përgjigjen edhe ministrat tjerë, ndoshta ministri i Punëve të Brendshme apo edhe dikush tjetër nga Kabineti qeveritar.

Çështja është, pas transformimit apo shndërrimit të TMK-së në FSK, shumë kazerma ushtarake kanë mbetur të pashfrytëzuara, të pambikëqyrura, në mëshirën e kohës dhe të qytetarëve të pandërgjegjshëm. Konkretisht, flas për kazermën ushtarake "Zahir Pajaziti", në fshatin Llukar.

Unë përgjatë kësaj kazerbe i bie çdo ditë dhe çdo ditë në pronën e kësaj kazerbe shihen: kamionë, traktorë, vetura, gjë që kjo kazermë dhe kjo pronë i është nënshtruar demolimit dhe shkatërrimit të plotë.

Pyetja ime është: Pse nuk janë ruajtur këto prona, apo të paktën pse nuk janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm deri në ndonjë vendim tjetër dhe sipas shënimeve kadastrale, këto objekte në emër të kujt figurojnë? Nëse përgjigjet dikush mirë, nëse jo, unë insistoq që këto pyetje prapë t'ia shtroj dikujt që është përgjegjës apo ka mandat dhe kompetencë të përgjigjet në këtë pyetje dhe kush i mbikëqyr këto objekte ushtarake?

KRYESUESI: Ministri nuk është këtu, tjetërkush nuk është përgatitur për të dhënë përgjigje.

Deputeti Ymeri, pyetje për kryeministrin Thaçi. Fjalën e ka zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Thaçi prapë nuk është në seancë, si zakonisht, por megjithatë unë po e shtroj pyetjen.

Javën e kaluar, nëpërmjet medieve, kryetari i të ashtuquajturit Këshill Nacional Serb, Milan Ivanoviqi, njëherësh edhe udhëheqësi i strukturave ilegale, kriminale të Serbisë në Kosovë, ka deklaruar se kryeministri dhe Bajram Rexhepi kanë pasur takime me serbët e veriut në Spitalin e Mitrovicës.

Pyetja ime ka të bëjë me atë se kur janë takuar, me kë janë takuar dhe çfarë kanë biseduar? Kjo është pyetje për kryeministrin.

KRYESUESI: Në rregull, është përmendur edhe zoti Rexhepi dhe ky mund të sqarojë. Nëse dëshironi, mund të sqaroni meqenëse fjala është edhe për juve.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Po është shumë e vërtetë që menjëherë pas mbarimit të luftës, themeluesi i UNMIK-ut në Kosovë, Sergjo Demello, që ka qenë 11 ditët e para, para ardhjes së Kushnerit, ka kërkuar të bëhet një vizitë në Spitalin Regjional në Mitrovicë.

Dhe, natyrisht që kemi shkuar atëherë, kryeministri i Qeverisë së Përkohshme dhe unë si kryetar i komunës, kemi qenë në delegacion, iu kemi bërë shpjegimin e kapaciteteve të spitalit dhe në fund është biseduar me gjithë stafin mjekësor, që kanë qenë aty, një ndër ta edhe Millan Ivanoviqi. Dhe, mund të them se, meqenëse nuk kemi pasur përkthyes zyrtar, unë kam qenë edhe në rolin e përkthyesit anglisht-serbisht dhe ky ka qenë i vetmi takim zyrtar. Ndërsa, me zyrtarë tjerë, që kanë qenë në Parlament, jemi takuar, mirëpo problemi është se nuk e kanë cekur këtë informatë, se në cilën kohë ka qenë. Kjo ka qenë në 11 ditët e para të pasluftës. Dhe, mund të them se ka qenë edhe komandanti Rrahman Rama, kanë qenë të uniformuar me uniforma të UÇK-së, kështu që ky ka qenë ai delegacion.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, a dëshironi pyetje shtesë?

VISAR YMERY: Prapë po e përsëris, nuk e pyeta Bajram Rexhepin, e pyeta kryeministrin dhe dua që kjo pyetje të bartet në seancën e radhës, kur shpresoj të jetë kryeministri, këtu.

KRYESUESI: Në rregull. Por, e përmende Bajramin dhe ai ka të drejtë të sqarojë. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Çështja ka të bëjë me organizimin e Policisë së Kosovës. Pyetja është se çfarë janë njësitë e inteligjencës në Policinë e Kosovës, zoti ministër? Sipas cilës Rregullore apo akt ligjor dhe në cilin zinxhir komandues janë, a është në dijeni drejtuesi i AKI-së, Komisioni Parlamentar, presidentja për ekzistencën e këtyre njësive?

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Po, ekziston Drejtoria e Inteligjencës, në kuadër të Departamentit të Hetimeve, i bazuar në Ligjin për policinë dhe strukturën organizative të policisë dhe kjo nuk është tash, është që sa vite. Dhe, mund të them se kjo drejtori është e centralizuar, ka edhe nëpër regjione oficerë që merren me çështjen e inteligjencës policore dhe nuk duhet të përzihen me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës.

Pra, është e bazuar në ligj, është e bazuar në strukturën organizative dhe t'ju citoj vetëm nenin 29, ku zyrtarë policorë pranojnë dhe vlerësojnë të gjitha informatat e marra nga

individë anonimë, që janë relevante për kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë.

Zyrtari policor mund të krijojë marrëdhënie bashkëpunuese të besueshme me persona, me qëllim që të marrë informata relevante që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë. Zyrtari policor do ta mbrojë besueshmërinë e marrëdhënieve të tilla bashkëpunuese dhe të informacioneve të marra, përderisa obligim ligjor për ta ruajtur besueshmërinë, të jetë përmbushur.

Dhe, qasja më e re e Policisë që është nga praktikat më moderne të shteteve demokratike, është qasja që Policia, e udhëhequr nga intelijenca, derisa në të kaluarën ka qenë vetëm vepruese, tash i merr informatat, i përpunon dhe bazohet më shumë. Qëllimi është të prevenohen dhe të veprohet me përgatitje paraprake, prandaj është drejtori e cila është shumë e domosdoshme për Policinë.

Se a e di, AKI-ja është një strukturë krejt e veçantë. E di me siguri edhe drejtori, për arsye se për interesin e sigurisë kombëtare kanë shkëmbim të informatave ditore. A e di presidentja, e di, se ka qenë në strukturë të Policisë dhe e di shumë mirë këtë strukturë. Ndërsa, a e di Komisioni Parlamentar, unë nuk e di, duhet ta pyetni atë, por këto janë dokumente zyrtare transparente, që çdokush që ka dashur t' i dijë e ka qasjen në ato dokumente.

Dhe, po ashtu në bazë të Ligjit të Policisë, neni 5, paragrafi 1, drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë ministrit, për administrimin dhe menaxhimin e Policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata dhe raporte, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Realisht, zinxhiri komandues respektohet komplet dhe kjo drejtori i nënshtrohet drejtorit të hetimeve, ai drejtor...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, a dëshironi pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, është dashur të jeni në dijeni se edhe a është i njoftuar Komisioni Parlamentar lidhur me Njësitin e Inteligjencës? Gjithashtu jam e vetëdijshme që presidentja mund ta dijë nëse ekziston apo jo, mirëpo a e informoni ju kohë pas kohe presidenten, drejtuesin e AKI-së, e tjerë?

Zoti ministër, do të doja t' ju pyesja, se a jeni në dijeni edhe për nenin 31 të Ligjit për Policinë, i cili në pikën 5 thotë se Policia nuk duhet të mbledhë e të ruajë informata dhe të dhëna personale për persona, me qëllim të mirëmbajtjes së regjistrave që kanë të bëjnë me bindjet apo anëtarësimet politike, religjioze apo filozofike? Ç'mund të thoni për këtë, zoti ministër?

KRYESUESI: Zoti Rexhepi!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Natyrisht, që presidenten e informojmë kohë pas kohe dhe sa herë që të kërkojë. Ne, drejtorin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës nuk jemi të obliguar ta informojmë, por kemi shkëmbim të informatave, për arsye se jemi institucione të ndara. Ndërsa, sa i përket komisionit, sikur të kërkojë komisioni, ne ia prezantojmë strukturën organizative dhe s’jemi të obliguar pa kërkesë të informojmë.

Dhe, po ashtu këtu pak i keni mbështjellë, për arsye se ne nuk marrim informata për shkak të bindjeve politike, religjioze e tjera, por për çështje që mund të ndikojnë në sigurinë e rendit publik.

Dhe, t’ ju shpjegoj edhe një gjë, që ju s’e përmendët, por ndoshta e keni në mendje. Çështja e përgjimeve të telefonave është e rregulluar me ligj dhe bëhet vetëm me urdhër të prokurorit. Nëse intelijenca ka informata të tilla, se do të bëhet një aktivitet, që e prish rendin publik, e bëjnë kërkesën te prokurori dhe prokurori lejon përgjimin e telefonave.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lama, ka pyetje për zëvendëskryeministren Tahiri.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në lidhje me bisedimet e zhvilluara në Bruksel, mes Kosovës dhe Serbisë, duke filluar nga data 8 mars 2011, deri më 22 shkurt 2012, shefja e delegacionit të Kosovës, zonja Edita Tahiri, ka zhvilluar 9 runde bisedimesh me homologun e saj serb, Borko Stefanoviç, me ndërmjetësimin e Robert Kuper.

Të gjitha këto takime kanë qenë të regjistruara dhe të filmuara zyrtarisht, për nevoja të brendshme të BE-së. Ato deri më tani nuk janë bërë publike për opinionin, pasi janë konsideruar tema të ndjeshme dhe gjithsesi për shkak të njëlloj konfidencialiteti që është karakteristikë e diplomacisë. Mirëpo, aktualisht një produksion privat danez, i ka marrë këto xhirime nga Zyra e zotit Kuper, janë rreth 80 orë material i filmuar dhe po përgatit një dokumentar, i cili pritet të shfaqet së shpejti. Madje, kam dëgjuar se do të marrë pjesë edhe në një nga festivalet e filmit dokumentar në Kosovë.

Prandaj, pyetja ime për zonjën Tahiri është - A ka dhënë miratimin e saj zonja Tahiri, që këto materiale të bëhen publike dhe nëse po, pse?

KRYESUESI: Zonja Tahiri e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuar deputete Lama,

Bisedimet teknike në Bruksel ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe pranisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, janë zhvilluar sipas kritereve ndërkombëtare për dialog mes shtetesh, duke respektuar konfidencialitetin, si një prej kushteve të duhura për mbarëvajtjen e proceseve të tilla.

Andaj, këto bisedime teknike nuk kanë qenë të filmuara zyrtarisht nga ana e Bashkimit Evropian, pra nuk ekzistojnë regjistrime zyrtare filmike për këtë proces.

Pyetja juaj bazohet në informacione të pasakta, që keni dhe për ta vërtetuar pasaktësinë e pyetjes suaj, ju sugjeroj që t'i drejtoheni Bashkimit Evropian, përkatësisht Zyrës së ndërmjetësit të dialogut. Dhe, unë dua të them se nuk është hera e parë, zonja Lama, që keni shtruar pyetje bazuar në informacione të pasakta. Në vazhdim, ndaras nga kjo pyetje, mund t'ju njoftoj se Bashkimi Evropian, për nevojat e afirmimit të diplomacisë së saj, është duke bërë një film dokumentar në bashkëpunim me kompaninë filmime “Bullitt-Film”, që mbështet financiarisht nga Ministria e Jashtme e Danimarkës, ku në kuadër të aktiviteteve diplomatike të Bashkimit Evropian në Ballkan, dialogu teknik paraqitet si një prej aktiviteteve të suksesshme të Bashkimit Evropian.

Për nevojat e BE-së, janë marrë edhe inserte filmike nga dialogu teknik dhe janë bërë intervista me pjesëmarrësit e dialogut teknik, por edhe me aktorë tjerë, në të tria palët. Pra edhe në Kosovë kam dëgjuar, madje që edhe “Vetëvendosja” ka dhënë intervistë për këtë kompani filmike, që unë e kam kuptuar si mbështetje për dialogun teknik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zonja Lama?

ALMA LAMA: Zonja Tahiri, më duket se keni bërë një gabim logjik, të shprehësh mendimin nuk do të thotë që të pajtohesh. Mund të shprehësh mendimin e kundërt. Besoj që kjo ka ndodhur edhe me “Vetëvendosjen”, nëse ka dhënë ndonjë intervistë.

Sidoqoftë, mendoj që përgjigja juaj është krejtësisht e pasaktë, sepse pyetja ime është që po bëhet një dokumentar. Dhe pyetja ime është, se përse ju keni dhënë lejen për një dokumentar të tillë, ndërkohë që Kuvendin e Kosovës nuk e keni njoftuar në lidhje me përmbajtjen e bisedimeve, sepse i keni quajtur konfidenciale, madje as në Komisionin për Punë të Jashtme nuk është raportuar pikërisht për këtë punë, duke i konsideruar konfidenciale? Ndërkohë, së shpejti pritet që këto të na vijnë në formën e një dokumentari, pra përmbajtja e bisedimeve të vijë në formën e një dokumentari. Atëherë, asgjë s'paska qenë konfidenciale. Unë nuk kam asgjë kundër dokumentarëve, por mendoj që zyrtarisht për përmbajtjen e bisedimeve, në radhë të parë, është dashur të informohet Kuvendi i Kosovës.

Pra, ose kanë qenë konfidenciale dhe nuk është dashur as produksioni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tahiri e ka fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

Pra, edhe një herë po e përsëris, dialogu teknik është zhvilluar në kushte të konfidencialitetit, andaj nuk ka pasur zyrtarisht filmime në asnjë rast. Prandaj, edhe nuk

është kërkuar leje dhe aprovim, sepse fare nuk ka pasur gjatë dialogut regjistrim filmik zyrtar, për jozyrtare, ju gazetare jeni, mund të dini më shumë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Atëherë zonja Tahiri, si duket paska pasur kamera te fshehta aty, në rregull. Pyetje në lidhje me mandatin e Misionit evropian për sundim të ligjit- pyetja është për zotin Hashim Thaçi.

A është pajtuar ai, pra a është pajtuar zoti Hashim Thaçi disa kohë më parë në Bruksel, që misioni i EULEX-it të ketë dy mandate në Kosovë, një për pjesën veriore dhe një për pjesën tjetër të Kosovës?

Kjo do të thotë, në rast se ai është pajtuar, se do të kemi një mision me mandat të dyzuar, me kompetenca të ndryshme, pra një për shqiptarët dhe një për serbët. Kjo gjë do të cenonte rëndë karakterin unitar të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministri nuk është këtu. Besoj që në pikat e ardhshme ose në seancën e ardhshme mund të thotë fjalën e tij. Zoti Aliu, pyetje për zotin Thaçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Edhe pse nuk është, se vazhdimisht në të gjitha pyetjen deri më tani zoti Thaçi nuk ka qenë këtu, pyetja ime ka të bëjë me atë që në seancën parlamentare të datës 18 tetor të këtij viti, kur është debatuar dhe miratuar Rezoluta për të ashtuquajturin normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, në fjalën e kryeministrit, nuk është përmendur asnjëherë takimi që do të mbahej ditën e nesërme, pra më datën 19 tetor, mes tij dhe kryeministrit serb, Ivica Daçiq.

Meqë ishte tejet e rëndësishme që në atë debat të diskutoheshin pikërisht takimet me kryeministrin serb, atëherë edhe pyetja është se a e dinte Hashim Thaçi, që ditën e nesërme nga debati në Kuvend, do të mbahej takimi me kryeministrin serb, Daçiq dhe nëse po, përse e mbajti të fshehtë këtë në Kuvend, pikërisht në kohën kur debatohej për këto takime?

KRYESUESI: Atëherë, konstatoj që pyetje tjera s'ka. Pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigjen në dy seancat plenare, publikohen në revistën e "Kuvendi", sipas Rregullores së Kuvendit.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 17 dhe 18 tetor

Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbale? Nuk ka. Atëherë konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 17 dhe 18 tetor 2012.

Ftoj deputetët të hyjnë në sallë, që t'i votojmë dy ligje, të cilat i kemi diskutuar në seancën e kaluar.

Zotit Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Para se të fillojmë me rendin e ditës, të miratuar në kryesi, dua vetëm të kërkoj që ta bëjmë kështu publikisht një qartësim për pikën 6. Është diskutuar goxha gjerë në mbledhjen e Kryesisë, nëse do të ketë edhe debat pas raportimit apo informatës, siç është quajtur këtu, të kryeministrit për takimin. Pra, dua ta qartësojmë këtë, nëse do të ketë debat apo jo, për shkak se nëse jo, ne duam të ngremë mocion, në mënyrë që të ketë debat pas kësaj fjale.

KRYESUESI: Ju e dini që unë e kam mbyllur në fjalën dhe kam thënë, që do të zbatohet Rregullorja e Kuvendit. Sipas Rregullores së Kuvendit nënkupton, që për të gjitha çështjet e ngritura, mund të thuhet fjala e secilit deputet. Kur nuk është e interesit, do të thosha të përgjithshëm, që të debatohet shumë për çështje të caktuara, kemi praktikuar që kryetarët e grupeve parlamentare ta thonë fjalën e tyre, në emër të grupeve të tyre parlamentare.

Prandaj, mendoj që seanca nuk ka nevojë që të votojë për këtë, por do të vazhdojmë sipas Rregullores. Besoj që s'ka nevojë për mocion, se e biseduam edhe më herët dhe...

A janë 80 deputetë? Nuk janë. Janë 76 deputetë.

Administrata, dilni ju lutem jashtë, e nëse është dikush në korridor, le të futet brenda!

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar zonja deputete dhe zotërinj deputetë, dua që t'ua rikujtoj që në seancën e kaluar, kur kemi diskutuar për këto projektligje, të gjithë keni qenë njëzëri që të miratohen, askush s'ka qenë kundër. Prandaj, ju kisha lutur që të votoni sipas përcaktimeve, që kemi pasur në seancën e fundit, sepse nëse nuk janë 80 vota, domethënë, bien poshtë.

Atëherë, në sallë janë 87 deputetë. Në rregull, janë 92 deputetë, 93, pra e hedh në votim. Tani lus deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Faleminderit! Konstatohet se me 89 vota për, asnjë kundër, një abstenim, Kuvendi miratoi Projektligjin për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar për Reformën e Bordit Ekzekutiv.

Pika e pestë e rendit të ditës e ka kaluar debatin, sikur pika e katërt e rendit të ditës:

5. Votimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar

Në mbledhje janë të pranishëm 93 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Faleminderit! Konstatohet se me 91 vota për, asnjë kundër, Kuvendi miratoi Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Faleminderit!

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, për takimin e zhvilluar në Bruksel, me kryeministrin e Serbisë

Më duhet të ju njoftoj se tani para dy minutash u njoftova se zoti kryeministër është në krye të detyrës në çështjet që i ka të ngarkuara dhe kërkon, ose më mirë të them na lut që ta shtyjmë për një orë, një orë e gjysmë derisa ai të bëhet gati. Tani, kërkoj të keni mirëkuptim në këtë kërkesë.

Derisa të vijë kryeministri, ne vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendi ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Agani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Agani e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush për miratim Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Odat e profesionistëve shëndetësorë janë organizatat e pavarura profesionale, të cilat mbrojnë dhe prezantojnë interesat profesionale të anëtarëve të saj, sigurojnë standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovojnë dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe

private, sigurojnë edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Për ofrimin e këtyre veprimtarive dhe përgjegjësive, projektligji parasheh që të formohen: Oda e Mjekëve, Oda e Stomatologëve, Oda e Farmacistëve, Oda e Infermierëve, e Mamive dhe Teknikëve të tjerë shëndetësorë. Anëtarësimi në oda është i obligueshëm dhe asnjë nga profesionistët shëndetësorë nuk mund ta ushtrojë veprimtarinë private shëndetësore pa u anëtarësuar në njërën nga odat mjekësore. Përgjegjësitë e odave, të parapara me këtë projektligj, janë mjaft të gjera dhe në pajtim me odat simotra në rajon. Shumica e funksioneve të Ministrisë së Shëndetësisë që kanë të bëjnë me menaxhimin e resurseve njerëzore në lëmin e shëndetësisë, kalojnë në përgjegjësitë e odave mjekësore. Kompetencat e odave mjekësore, sipas këtij projektligji, ndahen në kompetenca publike dhe kompetenca të tjera që quhen kompetenca vetjake të odave.

Dallimi ndërmjet këtyre qëndron në faktin se te kompetencat publike të odave, ato ushtrojnë autorizime të deleguara nga Ministria e Shëndetësisë, e cila ushtron mbikëqyrje të plotë në ligjshmërinë e ushtrimit të këtyre përgjegjësive. Projektligji i përcakton organet e odës dhe si organ kryesor përfaqësues është Kuvendi i odës, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga profesionistët shëndetësorë. Kuvendi i Odës më pastaj i zgjedh organet në vijim: kryetarin e odës, këshillin drejtues, këshillin mbikëqyrës për buxhet dhe financa, këshillin etik, gjyqin e nderit, prokurorinë e odës dhe komisionet e përhershme të odës. Projektligji parasheh edhe masa disiplinore në rast të shkeljes së etikës profesionale dhe dispozitave të këtij ligji. Projektligji gjithashtu parasheh aktet e odave mjekësore duke e përcaktuar statutin, si aktin më të lartë ligjor nëpërmjet të cilit shprehet autonomia e odave mjekësore.

Projektligji parasheh edhe burimet e financimit, duke përcaktuar se në tri vjetët e para të funksionimit të odave do të ketë një financim buxhetor nga Ministria e Shëndetësisë dhe pastaj oda do të financohet nga burimet vetjake të tyre.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për odat e profesionistëve shëndetësorë është më se i nevojshëm për realizimin e një vetëqeverisjeje substanciale të profesionistëve shëndetësorë, ngase rrit përgjegjësinë publike të profesionistëve shëndetësorë, promovon vlera dhe standarde ndërkombëtare dhe shton përgjegjësinë dhe llogaridhënien në menaxhimin e këtyre resurseve. Odat e profesionistëve shëndetësorë funksionojnë në të gjitha vendet e rajonit, ndërsa në vendet tjera perëndimore funksionimi i tyre ka filluar decenie më herët. Projektligji në fjalë, përveç se krijon autonomi substanciale vetëqeverisëse në kompetenca të zgjeruara, përmban edhe mekanizma të mbikëqyrjes profesionale nga Ministria e Shëndetësisë për të garantuar që ligji të respektohet.

Të nderuar deputetë,

Në procesin e draftimit të këtij projektligji ndihmë të çmueshme ka dhënë Oda Federale Mjekësore Gjermane, e cila në mënyrë permanente ka ofruar ndihmë profesionale, qoftë

nëpërmjet trajnimit të stafit të kyçur në këtë proces në Gjermani dhe në disa shtete tjera evropiane, apo nëpërmjet vlerësimeve dhe opinioneve në draftligjin që ndodhet para jush.

Gjithashtu, vlerësime pozitive për përmbajtjen e këtij draftligji dhe kontribut gjatë realizimit të tij kanë dhënë edhe ekspertë nga Oda Mjekësore e Sllovenisë.

I vetëdijshëm për rëndësinë e këtij ligji që në fillim kam përfshirë përfaqësues të komuniteteve mjekësore, të të gjitha komuniteteve, duke i inkorporuar në grupe punues përgatitore, të cilat kanë qenë aktive në të gjitha fazat dhe draftimit të këtij projektligji. Gjithashtu, janë zhvilluar debate të shumta publike me institucionet publike të të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor me pjesëmarrje aktive të profesionistëve shëndetësorë dhe mund të ju njoftoj se Projektligji është përkrahur në mënyrë plebishitare.

Të nderuar deputetë,

Është me rëndësi të veçantë që në procesin e konstituimit të organeve të odave të kemi zgjidhje të pranueshme me standarde ndërkombëtare dhe për këtë Ministria e Shëndetësisë është duke i përgatitur aktet nënligjore që mundësojnë një gjithpërfshirje, si në aspektin profesional, ashtu edhe në aspektin gjeografik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Sipas radhës, kryetari i Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2012, e shqyrtoi Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe me shumicë votash vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit që projektligji të miratohet në parim, ndërsa vërejtjet e deputetëve të adresohen në formë të amendamenteve gjatë shqyrtimit në komision.

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, fjalën e ka zonja Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe konsiderojmë se ky ligj do të duhej të miratohej para Ligjit të shëndetësisë, duke pasur parasysh faktin se në Projektligjin e shëndetësisë, odat e profesionistëve shëndetësorë kanë rol të rëndësishëm. Projektligji për odat e profesionistëve shëndetësorë, siç duket, është hartuar shpejt dhe në të ka shumë vërejtje. Ka mosharmonizim të neneve, pothuajse shumica e tyre janë pa emërtime. Në projektligj nuk ka fare përkufizime, domethënë nuk ka sqarime të duhura. Për shembull, neni 8 flet për kompetencat e odave, pastaj neni 9 për kompetencat e tjera të odave. Mendojmë se kompetencat e odave do të duhej të përshkruheshin në një nen të vetëm. Gjithashtu, paragrafi 1.4 i nenit 9, bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale, që adreson

çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit. Mendojmë se duhet të definohet saktë raporti i odave, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i shoqatave profesionale.

Gjithashtu, paragrafi 1.15 i nenit 9, i cili flet për bashkëpunimin në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale duhet të qartësohet bashkëpunimi me kë, me shërbimin spitalor klinik universitar, me Ministrinë e Shëndetësisë apo me komunat? Gjithashtu, është i paqartë neni 37, i cili flet për burimet e financimit të odave. Ky nen bie ndesh me nenin 71 paragrafi 5.1 i Projektligjit të shëndetësisë. Është e vërtetë që kjo lëmi po rregullohet për herë të parë në shtetin tonë, por nuk është e thënë që të kopjohen në tërësi projektligjet, ato duhet përshtatur rrethanave të vendit. Një dukuri tjetër që kemi hasur gjatë leximit të Projektligjit të odave, te ky projektligj janë dhënë sqarime për Ligjin e duhanit, derisa te Projektligji i duhanit mungojnë këto të dhëna. Me gjithë vërejtjet që i kemi në këtë projektligj, Grupi Parlamentar i PDK-së do ta votojë në lexim të parë këtë projektligj për shkak të rëndësisë që e ka në Ligjin e shëndetësisë. Por, ne si grup do ta japim kontributin tonë në komisionin, në mënyrë që të jetë sa më i zbatueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zonja Breca.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji i odave e profesionistëve shëndetësorë është i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me profesionistët shëndetësorë si organizata të pavarura dhe profesionale që mbrojnë dhe prezantojnë interesat e profesionistëve shëndetësorë.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta miratojë, mirëpo i kemi disa vërejtje, të cilat unë do t'i paraqes. Në kapitullin 1, dispozitat e përgjithshme në nenin 2, thuhet se odat e profesionistëve shëndetësorë sigurojnë edukim të vazhdueshëm profesional, mirëpo nuk ceket se nëpërmjet cilave institucioneve e sigurojnë këtë, kur dihet që odat nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme në staf. A do të thotë se i kontraktjnë këto trajnime, nëse po, cilat?

Në nenin 3, odat e profesionistëve shëndetësorë e kanë statusin e personit juridik me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë ligj dhe këtu përmenden se bëhen anëtarësimet, publikimet, lëshimi i certifikatave, e nuk ceket se çfarë bëhet me mjetet e grumbulluara. A i kthehen ato Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës?

Në kapitullin 2, anëtarësimi në oda thuhet se është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë. A do të thotë kjo se këtu duhet të përfshihen edhe profesorët në fakultet, në shkollat e mesme profesionale shëndetësore, e nëse po, atëherë a është kjo ndërhyrje në kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Punës?

Në kapitullin 3, te kompetencat e odave, zbatimin e aktiviteteve të ZHVP-së mendojmë se duhet ta bëjnë asociacionet, e jo odat. Odat mund ta aprovojnë, mbikëqyrin dhe vlerësojnë programin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ndërsa asociacionet profesionale janë ato të cilat duhet ta zbatojnë.

Në pikën 3 të nenit 8 thuhet se provimi i licencës bëhet nga odat, mirëpo ne mendojmë se provimi i licencës duhet të mbetet shtetëror, siç është në shumë shtete të Evropës, duke marrë parasysh papjekurinë e odave dhe mundësinë e manipulimeve nga odat.

Në pikën 5 të nenit 8 ceket bashkëpunimi me shoqatat tjera profesionale, por këtu gjithsesi duhet të ceket se të jenë shoqata profesionale përkatëse, sepse secila shoqatë është përgjegjëse për lëmin për specializimin e vetë përkatës.

Në pikën 6 thuhet se e ushtrojnë mbikëqyrjen profesionale dhe ligjore mbi punën e profesionistëve shëndetësorë. Mos është kjo përzjerje e kompetencave në Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, apo nënkupton se duhet të ketë një inspektorat vetjak dhe në qoftë se është kështu, atëherë a është ky duplikim i kompetencave dhe a mjaftojnë këta inspektorë që ta bëjnë këtë?

Në pikën 8 të nenit 8 thuhet se odat ndërmjetësojnë kontestet ndërmjet anëtarëve të odës dhe shfrytëzuesëve të shërbimeve shëndetësore. A do të thotë kjo se e marrin rolin e avokatit dhe a është ky rol formal apo joformal?

Në pikën 13 të nenit 8 thuhet se lëshohen certifikata. A kthehen këto mjete në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, në fund të vitit suficiti, e nëse jo, atëherë ku shkojnë këto mjete?

Në nenin 9, në pikën 3, thuhet se odat e mbajnë evidencën e anëtarëve të odave që ushtrojnë veprimtari private, ndërsa nuk përmenden institucionet publike.

Në pikën 7 thuhet se odat e bëjnë përcaktimin e shërbimeve shëndetësore, mirëpo çka do të ndodhë me Agjencinë Financiare Shëndetësore, e më vonë çka do të ndodhë me fondet? Domethënë, a mos po përzihen prapë këtu kompetencat?

Në pikën 8 thuhet bashkëpunimi në përpilimin e planprogrameve për edukimin e vazhdueshëm profesional për të gjithë profesionistët shëndetësorë. Me kë? Kush i bën planprogramet për edukimin e vazhdueshëm profesional? Ku është roli i shoqatave profesionale në këtë pikë?

Në pikën 14 të nenit 9 thuhet se oda bashkëpunon në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale. Nëpërmjet kujt bëhet kjo? Nëpërmjet inspektoratit, apo në çfarë mënyre? Kjo nuk ceket.

Në pikën 15 thuhet se përgatitja dhe lëshimi i formave të dokumenteve, si dhe i revistave, librave dhe publikimeve tjera bëhet nga odat, e nga shtrohet pyetja se a e marrin odat rolin e të drejtës së autorit?

Në pikën 18 thuhet ceket emërtimi i përfaqësuesve të odës në marrëveshje me institucionet të të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor. Cilat institucione dhe cilat emërtime? As kjo nuk ceket.

Në nenin 10, që ka të bëjë me regjistrimin e profesionistëve shëndetësorë, thuhet se regjistri i licencave lëshohet, por nuk ceket nga Ministria e Shëndetësisë apo nga odat. Domethënë bëhet lëshimi dhe revokimi.

Në nenin 13, regjistrat nga neni 10 i këtij ligji janë dokumente publike. A do të thotë kjo se do të ketë qasje edhe në internet dhe do të ketë ueb-faqe, pasi janë publike.

Në nenin 16 thuhet “Kryetari i odës, zëvendëskryetarët”. Nuk ceket se sa zëvendëskryetarë do të jenë.

Në nenin 18, që ka të bëjë me kompetencat e Kuvendit të odave, thuhet në pikën 1.6 “miraton dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës”. Kush i zgjedh? Nuk ceket kush i zgjedh këta anëtarë të këshillit.

Në pikën 1.16 nuk është e qartë se si zgjidhet dhe konstituohet Kuvendi. Kush e përbën atë? Sa anëtarë ka dhe si zgjidhen anëtarët e tij?

Në nenin 20, që ka të bëjë me kryetarin e odës, nën ‘d’ thuhet: “E emëron apo e shkarkon zëvendësin e tij/e saj, Kuvendi e zgjedh e kryetari mund ta shkarkojë”. Përsëri ekziston një moskuptim, domethënë Kuvendi e zgjedh, e kryetari ka të drejtë ta shkarkojë.

Në nenin 12, “kryetari dhe zëvendëskryetarët e Kuvendit, si dhe sekretari i odës janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare”. Mendojmë se sekretari i odës duhet të jetë vetëm person teknik, pa asnjë kompetencë.

Në nenin 23 thuhet se sekretari e përgatit programin e punës së odës. Mos është kjo e tepërt për sekretarin? Nuk është kjo kompetencë në asnjë vend të botës. Programi i punës së odave duhet të jetë multisektoral.

Në pikën 5, “përgatit dhe propozon aktet normative”, T’i përgatitë aktet normative vetëm një person shumë kompetencë shumë e madhe.

Në pikën 7 thuhet se sekretari udhëheq shërbimin profesional të odave dhe vendos mbi të drejtat ligjore dhe përgjegjësitë e shërbimit profesional të odës. Mendojmë se këto janë kompetenca shumë të mëdha për një sekretar.

Në nenin 25, te Këshilli Etik - mbikëqyrja e zbatimit të Kodit Etik dhe deontologjisë mjekësore në vendet e punës apo ankesave të parashtruara, nëpërmjet inspektorëve apo nëpërmjet kujt?

Në pikën 6 thuhet se u ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e të drejtës së cilësisë së shërbimeve, llojit dhe përmbajtjes së shërbimeve. Nuk ceket mënyra si e realizon këtë dhe si shkon më tutje.

Në kapitullin 6, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e punës së odës, në nenin 47, disa herë përmendet ministria përgjegjëse për shëndetësi, që mendojmë se është me siguri ndonjë gabim teknik se mjafton të thuhet: “Ministria e Shëndetësisë”, e jo “Ministria përgjegjëse për shëndetësinë”.

Në kapitullin 7, në aktet e përgjithshme të odës, në nenin 49 – Odat, mendojmë se këtu duhet të jetë Kuvendi i odave e miraton statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme në pajtim me statutin.

Janë edhe disa vërejtje tjera. Besojmë që ne do ta vazhdojmë kontributin në Komisionin Funkcional. Por, me gjithë këto vërejtje, ne si grup parlamentar do ta miratojmë, ngase mendojmë se është me rëndësi dhe disa herë përmendet në Ligjin e shëndetësisë, si dhe mendojmë që implementimi i të dyjave në të njëjtën kohë është i domosdoshëm. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, edhe pse kemi vërejtje të shumta, edhe në aspektin e mënyrës se si është përpiluar ligji, edhe në aspektin e fjalorit, por vërejtjet kryesore janë lidhur me atë se këtyre odave u jepen kompetenca jashtëzakonisht të mëdha dhe, në anën tjetër, nuk sqarohet qartë lidhja e këtyre odave me shtetin, apo me ministrinë.

Pra, në një anë, këtyre odave u jepet si kompetencë licencimi, pastaj u jepet si kompetencë edhe përcaktimi i çmimeve, që në këtë rast duhet të harmonizohet me Agjencinë Financiare të Shëndetësisë, me ligjin aktual, me Ligjin e shëndetësisë, që tani është duke u trajtuar. Në anën tjetër, u jepet kompetencë mbikëqyrja profesionale dhe ligjore. Kjo gjë duhet të sqarohet, meqenëse mbikëqyrja profesionale, respektivisht mbikëqyrja e cilësisë së punës së profesionistëve shëndetësorë është krejt në rregull, por në aspektin ligjor janë inspektoratet ato që do të duhej ta bënë mbikëqyrjen e punëtorit shëndetësor në bazë të ligjit. Pra, nuk do të duhej të ishte kompetencë e odave. Ato do të duhej ta bënin vetëm kontrollin e cilësisë së punës së punëtorëve shëndetësorë. Në aspektin e financimit, këto janë dy elemente të cilat do të duhej ta sqaronin pozitën e odës në raport me shtetin. Ajo që ministri e tha pak më herët, fillimisht që financimi do të mundësohet nga buxheti i Kosovës, pastaj do të jetë nga burimet vetjake nënkupton njëfarë pavarësie shumë të madhe për kompetenca shumë të rëndësishme që do t'i kenë. Dhe, sidomos duhet të definohet qartë mbikëqyrja nga Ministria. Këtu thuhet që mbikëqyrja e punës së odës, te neni 47, do të bëhet nga Ministria, “përgjegjëse për Shëndetësi”, pra nga Ministria e Shëndetësisë, por nuk sqarohet raporti me ministrinë.

Pra, a mund ministria ta shkarkojë dikë? Çka vetëm nëse e mbikëqyr, sepse këtu janë dhënë qartë se cilat janë organet e odave. Pra, ato kanë kuvend, e kanë kryetarin, nënkryetarin, e kryesi. Ato vetë zgjidhen, vetë e zgjedhin kryesinë, vetë i përcaktojnë kompetencat, pra e kanë njëfarë pavarësie të plotë, e në anën tjetër i mbikëqyr Ministria.

E çka nëse ato nuk e zbatojnë ligjin? Si do të ndërhyjë Ministria? Kjo gjë nuk definohet në këtë projektligj. Por, përgjithësisht, nevoja që të kemi oda të profesionistëve shëndetësorë bën që ne ta votojmë këtë projektligj me besimin, me bindjen që këto ndryshime do të bëhen gjatë trajtimit në komision.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Qëllimi i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë është që ato të themelohen si organizata të pavarura dhe profesionale, të rregullohet anëtarësia në oda, kompetencat e odave, organizimet dhe funksionimi i odave, mbajtja e regjistrit të anëtarëve të odave, organet e odave, përgjegjësia disiplinore.

Domethënë, të gjitha kompetencat që i ka Ministria e Shëndetësisë, të gjitha kompetencat e shëndetësisë kalojnë në odat e profesionistëve shëndetësorë. Ky ligj nuk është i rregulluar me Legjislacionin e BE-së, domethënë është një ligj i ri dhe po krijohet një organizatë e pavarur, së cilës po i japim shumë kompetenca. Atëherë, nuk mund ta dimë se si do të realizohet dhe si do të funksionojë Ligji i odave të profesionistëve shëndetësorë.

Për këtë ligj nuk është i paraparë financimi as për vitin paraprak, deri në vitin 2015. Mbetet të shihet se si ministri do t'i realizojë të ardhurat për realizimin e tij. Sipas ligjit, kjo organizatë do t'i mbrojë edhe prezantojë interesat profesionale të anëtarëve të saj, të sigurojë standarde të larta të Kodit të Etikës. A nuk ka këtu përzierje të kompetencave ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe funksionimit të odave të profesionistëve shëndetësorë. I kemi komisionet që aktualisht ekzistojnë në Ministrinë e Shëndetësisë. Këtu parashihet formimi i komisioneve për çështje etike, për licencim, për edukim specialistik, për edukim të vazhdueshëm profesional, që praktikën private profesionale, për komitetin për buxhet dhe financa. Çka do të bëhet me bordet, të cilat aktualisht ekzistojnë në Ministrinë e Shëndetësisë?

Nëse të gjitha këto kompetenca dhe të gjitha këto borde kalojnë në odat e profesionistëve shëndetësorë, atëherë në Ministrinë e Shëndetësisë do të mbetet veç stafi politik, sepse të gjitha kompetencat po i merr oda.

Sipas këtij ligji, odat vetë janë verifikues i shkeljeve ligjore, të shkeljes së Kodit të Etikës, të kodeve profesionale dhe vetë janë dënues. Atëherë, çfarë drejtësie do të realizohet kur vetë janë verifikues dhe vetë janë dënues të akteve dhe shkeljeve ligjore? Ku mbetet Inspektorati Shëndetësor nëse vetë odat e mbikëqyrin Kodin e Etikës, kodin profesional, respektimin e ligjshmërisë.

Kemi edhe vërejtje tjera të shumta të cilat kolegët paraprak i thanë. Ne sot do ta votojmë Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, mirëpo si Komision duhet ngadalë të bëjmë amendamentimin e ligjit dhe të nxjerrim një ligj të mirë sepse nuk ka definim të kompetencave, nuk ka definim të çështjeve të cilat janë adresuar në këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete. Për Koalicionin Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege, deputetë të nderuar,

Ne si Grup Parlamentar e përshëndesim procedimin e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës. Domosdoshmërinë dhe nevojën e këtij ligji, i mirë apo jo i mirë, e dëshmon më së miri praktika aktuale, konkretisht aktualiteti dhe përditshmëria jonë për faktin se Ministria e Shëndetësisë, si institucion në vend se kryesisht të përqendrohet në politikat menaxheriale, mbikëqyrjen, monitorimin dhe zbatimin e ligjeve, është dashur të merret edhe me disa çështje të cilat në kuptim të fjalës janë më sekondare se sa ato projektet madhore të Ministrisë së Shëndetësisë.

Prandaj, procedimi i këtij projektligji i cili paraqet në fakt decentralizimin e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë në Odën e Profesionistëve Shëndetësorë, përveç që është pjesë e pakos reformuese të Projektligjit për shëndetësi, në anën tjetër bën edhe menaxhim të mirëfilltë në aspektin e profesionistëve shëndetësorë, qoftë licencim, në edukimin postspecialistik specializime e tjera dhe licenca dhe themelimin e gjykatave të nderit. Prandaj, edhe është i mirëseardhur ky projektligj për faktin se ne gjatë këtij mandati jemi ballafaquar dhe kemi dëgjuar shpesh këtu në Kuvendin e Kosovës se Ministria e Shëndetësisë, kryesisht po i centralizon kompetencat, është bërë një autoritet në veti, ndërsa ky projektligj e dëshmon më së mirë se politikat menaxhuese të Ministrisë së Shëndetësisë shkojnë kah decentralizimi, konkretisht bartja e kompetencave në institucionet profesionale, siç është rasti i odave së profesionistëve shëndetësorë.

Se si funksionojnë odat në Republikën e Kosovës, unë mendoj që në aspektin praktik, nuk është diçka e re. E re është në aspektin nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa në aspektin praktik, nuk është diçka e re ngase këtu kemi edhe zëvendëskryeministrin, konkretisht ministrin e Drejtësisë, i cili mund të na dëshmojë se si funksionojnë odat e avokatëve të Kosovës, se sa me përgjegjësi dhe kuptimplotë i zbatojnë detyrat e tyre, prandaj një gjë e tillë i është dashur edhe shëndetësisë, në mënyrë që të kemi një bartje të kompetencave dhe një funksionalizim më të mirë në aspektin menaxherial dhe zbatues të kompetencave të profesionistëve shëndetësorë.

Unë nuk do të ndalem më shumë në nene, për faktin se jam edhe pjesë e Komisionit dhe detyra ime, kryesisht do të jetë në komision dhe në amendamentin e këtij projektligji, por

ne si koalicion i japim dritën e gjelbër dhe e përkrahim me shpresë që ndryshimet pozitive t'i inkorporojmë në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet. Për SLS-n, deputetja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Uvaženi članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Ova posebna komora urediće i daće mogućnosti da se stvore bolji uslovi za njihovu profesionalnu saradnju sa profesionalcima evropskih zemalja, koji funkcionišu i imaju višegodišnju tradiciju.

Imajući u obzir da će se ovim zakonom otvoriti granice između zdravstvenih profesionalaca i razmena iskustva među istima, jer danas ne funkcionisanje komore na Kosovu predstavlja administrativno otežavanje saradnje između zdravstvenih stručnjaka drugih zemalja.

Smatram da posebnu pažnju treba posvetiti činjenici da zakon obavezuje komore profesionalaca zdravstva da upoznaju javnost o važnim pitanjima iz delokruga Komore.

Najveći problem ovog zakona je mogućnost njihovog delovanja. Naime, u mišljenju Ministarstva financije u ovom zakonu koji smo dobili data je preporuka da zakon treba da sadrži klauzulu da će se ovaj zakon sprovesti u skladu sa budžetskim mogućnostima koji pruža budžet Kosova.

Nadam se da će Vlada naći načina da se stvore izvori za neophodno finansiranje, a poslanička grupa Samostalne liberalne stranke, podržaće ovaj zakon u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin “6+”, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim.

Sayın Meclis Başkanı yardımcısı, Sayın Bakanlar ve Değerli Milletvekiller

Tabipler odalarının düzenlenmesini içeren bu Yasa Taslağı, sağlık sektöründe yapılması beklenen reformların bir parçası olarak görmekteyiz.

Bu Yasa Taslağı ile bugün bazı odaların varlığının hukuksal zemine oturtulması öngörülmektedir, Yasada doktorlar, hemşireler, eczacılar ve dış hekimlerine ayrı ayrı odalar kurma yetkileri verilmektedir.

Sağlık sektöründe önemli bir rol oynaması beklenen bu Yasa Tasarısı, tabipler odalarına bugün Sağlık Bakanlığının bazı yetkilerinin bu odalara verilmesi öngörülmektedir, niceki doktorların lisanslarının verilmesi, uzmanlık alanlarının belirlenmesi, doktorların etik davranışları ve diğer bazı yetkiler verilmektedir. Bu yetkiler verilirken Sağlık Bakanlığı

dikktali olmalı, çünkü bu kanuna uygun çalışılacağı öngörülmesine rağmen, odaların bağımsız bir şekilde hareket etme olasılığı da doğabilir.

Tabipler odaları bugün her devlete bulunmaktadır. Bu devletlerde işleyiş ve düzenlemelere de dikkat edilerek, bu Yasanın ikinci okunuşuna kadar iyi incelenmesi gerektiğine inanmaktayız ve grup olarak önerilerimizi komisyona sunarak, bu Yasayı desteklemekteyiz.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash i kemi diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligjin, të cilin jemi duke e shqyrtuar, pra Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, synon të ketë për qëllim kryesor krijimin e odave të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve dhe kuadrit të mesëm shëndetësor, që do ketë për detyrë t'i mbrojë interesat e tyre në mënyrë parimore. Mirëpo, personalisht, gjatë leximit të këtij ligji kam fituar përshtypjen se fjala është për ndonjë organ hetimor a ndëshkues për profesionistët shëndetësorë dhe shumë më pak për organizatë që do të punojë në shërbim të atyre që e përbëjnë.

Dhe, ja pse po e them këtë. Duke filluar nga neni 24, i cili parasheh masat disiplinore, ku janë paraparë tetë forma të ndëshkimit, që pason me nenin 27 me gjyqin e nderit dhe vazhdon me nenin 30, ku parashihet prokurori i Odës. Gjithë kjo më jep përshtypjen, thua se fajtorin e një sistemi totalisht të dështuar shëndetësor, është tendencë e përhershme të gjendet te mantelbardhët që tanimë në përmasa të mëdha janë etiketuar si shkelës të etikës mjekësore, ligjeve dhe shumë shpesh jo profesionistë. Dhe, të tillë edhe mund të ketë, por ata nuk janë fajtorë të dështimit të shëndetësisë në vend. Ata e kanë shfrytëzuar një sistem të dështuar shëndetësor.

Pra, politikëbërësit shëndetësorë në vend, që në vazhdimësi kanë qenë pa vizion, e kanë sjellë shëndetësinë këtu ku është sot. Dhe e dyta, në këtë kontekst, paska nevojë t'u jepet hapësirë dhe vëmendje mantelbardhëve të pandërgjegjshëm, por pse nuk është paraparë asnjë formë shpërblimi apo stimulimi për ata punëtorë të ndërgjegjshëm shëndetësorë dhe të tillë besoni që ka shumë dhe pikërisht falë tyre dhe ndërgjegjes profesionale, mbijeton disi shëndetësia jonë.

Unë do të jap një propozim konkret dhe kjo është që për profesionistët e shquar shëndetësorë, të cilët janë dëshmuar me vite në lëmin e tyre, Oda e Profesionistëve të ketë kompetencën e ndarjes së titullit primarius. Titulli 'primarius' jepet edhe në vende tjera dhe propozimi im është që t'u jepet atyre profesionistëve që nuk kanë tituj shkencorë, por që janë përkushtuar në punën klinike. Duhet vendosur kriteret dhe të jetë një numër i limituar i atyre që mund të fitojnë titullin brenda vitit.

Dua të ritheksoj për fund edhe një herë pikëpamjen time se individit si punëtor shëndetësor as nuk mund ta shkatërrojë e as ta përparojë sistemin shëndetësor. Politikat e dështuara apo të suksesshme shëndetësore, mund ta bëjnë këtë.

Për vërejtjet tjera, shumë prej të cilave u përmendën nga parafolësit e mi, do ta jap kontributin tim në fazën e amendamentimit në Komisionin për Shëndetësi.

Ne si Lëvizje për Bashkim, në parim do ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë është hartuar me qëllim që të themelohen odat e profesionistëve shëndetësorë si organizata të pavarura dhe profesionale.

Me këtë ligj parashihet, domethënë rregullimi i anëtarësisë së odave, kompetencave të odave si dhe organizimi dhe funksionimi i odave. Në kuadër të kësaj, në nenin 2 pika 2, thuhet se për ushtrimin e këtij misioni dhe përgjegjësi formohet: Oda e Mjekëve, Oda e Stomatologëve, Oda e Farmacistëve, Oda e Infermierëve, mamive dhe të teknikëve tjerë shëndetësorë.

Këtu gjithsesi nuk janë përfshirë të gjitha profilet shëndetësore. Nuk është përfshirë Oda e Fizioterapisë që do të duhej të ishte njëra nga këto. Duke ditur se Ministria e Shëndetësisë licencon: mjekët, stomatologët, farmacistët, fizioterapeutët, infermierët dhe mamitë, andaj edhe krijimi i odave të profesionistëve shëndetësorë, do të duhej t'i përgjigjet të gjitha këtyre profileve.

Bazë për krijimin e këtyre odave është dashur të jenë profilet shëndetësore që i licencon Ministria e Shëndetësisë dhe profilet shëndetësore që prodhon Fakulteti i Mjekësisë dhe në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë, ekzistojnë drejtimit: e mjekësisë së përgjithshme, stomatologjisë, farmacisë, fizioterapisë, infermierisë dhe mamisë. Dhe me këtë ligj nuk është caktuar as funksionimi në të ardhmen i shoqatave të cilat kanë ekzistuar deri më tani, si i Shoqatës së Kirurgjisë, ortopedisë dhe shoqatave të ortopedëve dhe tjera. A do të inkorporohen këto shoqata në kuadër të odave të mjekëve, dhe si do të rregullohet funksionimi i këtyre shoqatave në të ardhmen, mendoj që do të ishte një çështje që do të duhej të parashihej me anë të këtij ligji.

Çështje tjetër që duhet trajtuar në këtë ligj, që në disa diskutime u tha edhe më herët, është edhe statusi i odave. Vërtet, a do të jenë ato institucione publike shëndetësore apo do të kenë një trajtim tjetër, do të thotë të funksionojnë si agjenci publike shëndetësore apo do të jenë organizata jo qeveritare. Prandaj, do të ishte mirë, do të thotë, të saktësohet me ligj funksionimi në të ardhmen, statusi i odave.

Unë i jap përkrahje në leximin e parë këtij projektligji, duke shpresuar se vërejtjet dhe sugjerimet do të inkorporohen gjatë amendamentimit. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, në emër të AAK-së, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në emër të AAK-së ka folur deputetja Time Kadrijaj, unë do të flas në emër timin personal dhe ndoshta është një mendim pakëz i ndarë nga ai i Grupit.

Një kohë kur kemi provuar të vendosim sistem shëndetësor pas luftës, një sistem i cili ka qenë i shkapërderdhur për shkak të luftës dhe për shkak të gjendjes para luftës, kemi diskutuar me njerëz jashtë vendit dhe më kujtohet një debat me një person që vjen nga një vend i Unionit Evropian. Meqenëse kam studiuar edhe vetë isha duke e pyetur, pse ata nuk e limitojnë, shembull të marrim numrin e specialistëve? Përgjigja ka qenë kështu. Limitimi i numrit të studentëve e ulë mundësinë për kualitet, e ulë mundësinë për të nxjerrë, shembull të marrim, njerëz gjenialë. Në vend se ta ulin, ose në vend se ta limitojnë numrin e atyre që aplikojnë, ata e kanë shtrënguar sistemin, që do të thotë se jo të gjithë ata që pranohen, edhe diplomojnë ose bëhen specialistë, por vetëm më të mirët. Për deri sa në Kosovë, për një kohë të gjatë, është një trashëgimi e të kaluarës, ndodh e kundërta. Do të thotë limitohet numri i atyre që aplikojnë, ndërsa të gjithë ata që aplikojnë, pa përjashtim gati dikur dalin specialistë. Do të thotë, është një sistem kontra sistemit të natyrës njerëzore, i cili e lejon konkurrencën dhe i zgjedh më të mirët.

Kjo ishte vetëm hyrje për të treguar se ne sot, nëse e kalojmë këtë ligj, po e ndërtojmë një sistem të institucioneve, ose një institucion. Një institucion i cili do të jetë i pavarur në pjesën më të madhe të punës së vet dhe i cili do të ketë karakter edhe publik për shkak se po e legjitimojmë me ligj.

Kur krijohen institucione të reja, vendet debatojnë shumë gjatë. I shohin aspektet profesionale, aspektet administrative, aspektet sociale, aspektet edhe të sundimit të ligjit, të korrupsionit e tjera, e tjera dhe pas debateve shumë të gjata, marrin vendim për krijim të institucioneve të reja. Nuk mund të krijohet një institucion i ri për një gjysmë ore debat.

Çështje tjetër është se nëse këto institucione tani vetëm krijohen, duhet ta dimë se institucionet marrin jetë të veten. I thonë anglisht, ipad dependenti, që kur një institucion, në momentin që krijohet dhe formësohet, merr jetë të veten dhe e vazhdon punën e vet në mënyrë seriozisht të paparapare ekzakt në fillim. Do të thotë, nuk mund të parashihet gjithçka që mund të sjellë puna e një institucioni i cili krijohet tani.

Çështjet tjetër që duhet të them këtu, është se krijimi i një ode të punëtorëve shëndetësorë, cilado që të jetë ajo nuk mund të krahasohet me krijimin e odave të avokatëve ose odave ekonomike, për një arsye krejt të thjeshtë, Oda e Avokatëve krijohet prej avokatëve të cilët nuk i paguan shteti, ata janë avokatë privatë, të cilët mbledhen në një odë e marrin vendime dhe një njëfarë forme i ndihmojnë sistemit, edhe vetvetes, “kundrejt” po them “kundrejt Qeverisë”.

E njëjta gjë ndodh me Odën Ekonomike. Oda Ekonomike themelohet prej bizneseve private, edhe tjerave, të cilat e mbrojnë biznesin dhe e ndihmojnë sistemin prapë kundrejt Qeverisë. Po tani, çfarë ode po krijohet këtu? Po krijohet odë prej njerëzve që i paguan Qeveria, do të thotë këta nuk janë privatë. Është sistem totalisht i ndryshëm prej kësaj që ne po themi. Dhe, pse është konflikt i interesit? Është konflikt i interesit se po kërkohet prej institucionit drejtpërdrejt ta korrigjojë vetveten, për deri sa ne kemi vënë mekanizma në sistem, që njëri-tjetrin e kontrollojnë, jo vetveten. Nëse secili institucion e kontrollon vetëm vetveten, ma merr mendja se shumica e deputetëve nuk e kanë asnjë dilemë se çka do të ndodhte, nëse institucionet të cilat kanë interesa vetjake, kanë interesa biznesore vetjake, kanë interesa të hyrave dhe të avancimit, qoftë në karrierë qoftë në shkencë, fillojnë ta kontrollojnë vetveten, mundeni ta merrni me mend se çka ndodh, e aq më tepër kur e kontrollojnë vetveten duke u financuar prej fondeve publike.

Tani, nëse ne themi se politikat shëndetësore i bën Ministria edhe që duhet të jetë ashtu, për shkak se Ministria është një institucion i cili zgjidhet nga Kuvendi e Kuvendi zgjidhet nga populli, që do të thotë, duhet të jetë në natyrën normale rrjedhojë e interesave të popullit.

Atëherë, pse duhet të kemi institucione tjera të cilat do të kenë qasje direkte në hartimin e politikave shëndetësore, tani nuk po flasim më për lobim, nuk po flasim për shfaqje të interesave sikur në formën e sindikatave, që janë krejt në rregull, sikur në formën e asociacioneve të mjekëve që janë krejt në rregull, por po flasim për ndërtim të institucionit jashtë strukturës normale të Ministrisë edhe të zhvillimit të institucioneve demokratike, e cila do të ketë qasje drejtpërdrejt dhe ndërhyrje të drejtpërdrejtë në institucione, në fakt duhet thënë që fjala “odë” është fjalë turke jo shqipe, për të mos u keqkuptuar nuk kam kurrgjë kundër gjuhës turke, por le të thuhet “dhoma” se “dhoma” është shqip, “odë” është turqisht. E di që na ka mbetur pas 500 vjetëve sundimi të Turqisë, mirëpo ndoshta do të ishte mirë këtë fjalën “odë”, të paktën në ligje ta zëvendësojmë me “dhomë” për shkak se është turqisht, nuk është shqip. Pra, po them, nuk ka kurrgjë të keqe me turqishten, po nëse ligji është shkruar shqip, atëherë le të shkruhet shqip, të përkthehet në turqisht “odë” atëherë, fjala “dhomë”.

Pyetja ime e fundit është kështu. Po më duket është tepër e qartë që po kërkoj të mos votohet ligji tani, të shtyhet dhe të diskutohet gjatë, është – Cilat janë rastet tjera në vende të Unionit Evropian ose edhe të regjionit ku funksionojnë këto oda kësisoj, të na sillen ato raste gjatë debatit, t’i shohim ato raste, të shohim pse funksionojnë, qysh funksionojnë, dhe a funksionojnë, a ka oda të këtilla?

Nëse nuk ka, debati duhet të jetë edhe më i gjatë, për shkak se ne duhet ta dimë çka po shpikim, në këtë sistemin tonë shëndetësor, i cili u tha nga të paktën dy ose tre parafolës se është dështim total. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me një ministër, të jemi të qartë, nuk po dua të jem ashtu tepër agresiv në këtë temë. Kam diskutuar disa herë edhe prej foltores së Kuvendit se çfarë sistemi shëndetësor ne kemi, qysh na pikojnë tualetet nëpër klinika, e tjera e tjera, por nuk po dua me fol për këtë çështje, as për infrastrukturën, as për sistemin si të tillë. Po dua të them , a është ky rast sui generis, dhe nëse është rast sui generis, ta

dimë çka po bëjmë, të diskutojmë më gjatë. Nëse nuk është, t'i shohim praktikat e mira dhe të këqija të vendeve tjera, se fundi i fundit Kosova nuk ka nevojë ta shpikë akullin.

Mendimi im është, që realisht është paksa i ndarë prej Grupit Parlamentar, është që nuk kemi nevojë as në parim ta votojmë ligjin sot, se nëse e votojmë në parim nuk kemi mundësi ta ndryshojmë konceptin i cili është sjellë këtu në lexim të dytë. Nuk po them që ky ligj bën katastrofë në Kosovë, por ta dini që as kurrfarë mrekullie nuk bën. Dhe nëse jemi në këtë gjendje, atëherë mendoj se Kosova ka nevojë për diskutim më të gjatë në këtë sistem për shkak se po flasim për diçka tepër jetike. Nuk po flasim për diçka anësore ose dytësore, e cila ndoshta edhe mund të rregullohet në të ardhmen.

Edhe një herë, mos harroni, nëse i jepet jetë një institucioni, ai institucion e ka jetën e vet aty e tutje dhe nuk mund ta parashohim me saktësi se cilat do të jenë efektet dytësore të cilat mundën shpeshherë të shndërrohen në më të mëdha se efektet të cilat ne i kemi paraparë.

E thërras Kuvendin, edhe ministrin që këtë ligj ta shtyjë për një kohë dhe të diskutojmë më gjatë se çka po ndërtojmë tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpos vërejtjeve që u thanë nga kolegët deputetë këtu lidhur me këtë projektligj, ndoshta njëra prej vërejtjeve që unë kam mund ta vërej, është edhe vlerësimi rreth deklaratave financiare dhe nuk ka të bëjë vetëm me këtë ligj, por ka të bëjë edhe me disa ligje, do të thotë, në këtë legjislaturë, të cilat në shumë ligje nga deklarata financiare është thënë se kanë implikime të mëdha buxhetore dhe në shumë raste ne i kemi miratuar këto ligje, të cilat nuk po implementohen. Do të thotë edhe në këtë ligj kemi të bëjmë me deklaratën financiare që ky projektligj nuk është i përfshirë në kornizën afatmesme 2013-2015.

Përderisa, do të thotë, ligjet të cilat miratohen nga Qeveria sillen në Parlament dhe po ashtu po miratohen në Parlament dhe nuk po implementohen, mendoj se nuk është mirë në këtë rast as për institucionin përkatës që e miraton këtë ligj, por njëkohësisht nuk është mirë as për Qeverinë, e po ashtu edhe për ata të cilët kërkojnë që të implementohen këto ligje.

Prandaj, vërejtjet të cilat kanë të bëjnë edhe me shkeljen e Rregullores së Parlamentit, pikërisht këto projektligje mendoj që Qeveria që në start ose në këtë rast institucioni përkatës, nuk duhet t'i sjellë në Qeveri për miratim dhe njëkohësisht këto ligje vetëm po rrinë, do të thotë janë të paimplementueshme dhe konsiderojmë që këto gjithsesi mendoj se duhet t'i kthehen Qeverisë, përpos shumë vërejtjeve që janë dhënë nga parafolësit, por njëkohësisht edhe nga deklarata financiare që është e paraparë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjetër të paraqitur. Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Unë falënderoj të gjitha grupet parlamentare për mbështetje në parim të këtij projektligji. Vetëm disa sqarime para votimit, sa i përket financimit, po nisem nga çështjet e ngritura herën e fundit. Kostoja financiare e këtij projektligji është i paraparë Projektbuxhetin për vitin 2013 dhe do të jetë pjesë e kornizës afatmesme të shpenzimeve në pajtim me këtë, kështu që në atë aspekt nuk kemi asnjë dilemë.

Çështja tjetër se a kemi të bëjmë me një zgjidhje sui generis në Kosovë, diçka që po shpikim ne në Kosovë, jo, deputeti Gjini, nuk bëhet fjalë për shpikje. Unë e thashë edhe në fjalën time hyrëse se bëhet fjalë për një institucion publik i cili ekziston me decenie të tëra në shumë shtete të Bashkësisë Evropiane. E përmenda se këtë projektligj e kemi shkruar së bashku me kolegët nga Federata e Odave Mjekësore të Gjermanisë. Kemi vizituar edhe Odën Mjekësore të Polonisë, të Sllovenisë. Nuk jemi duke zbuluar asgjë. Unë e kuptoj se ka hezitime dhe mund të ketë hezitime, sepse bëhet fjalë për një institucion që për herë të parë po themelohet në Kosovë dhe natyrisht që është përvojë e re. Plotësisht pajtohem me ju se ky institucion do ta marrë rrugën e vet dhe do të ketë tash një rrugëtim të cilën ne do të mundohemi ta kanalizojmë brenda politikave shëndetësore që jemi duke i zhvilluar.

Shumë bukur e tha deputeti Kelmendi se ky është ligj i cili është pjesë e pakos reformuese legjislative, është plotësisht komplementare me Ligjin e shëndetësisë, me Ligjin e sigurimeve shëndetësore që vjen menjëherë si ligj i cili do të sanksionojë fazën e dytë të reformës së sistemit shëndetësor. Është projektligj që synon decentralizimin e kompetencave menaxheriale të Ministrisë së Shëndetësisë në sektorin e resurseve njerëzore në shëndetësi.

Unë i dëgjova me kujdes vërejtjet që u dhanë edhe nga grupet parlamentare dhe nga deputetët e nderuar. Baraspesha ndërmjet kompetencave që do t'i kenë odat e profesionistëve shëndetësorë dhe mbikëqyrjes së autorizimeve politike, mbikëqyrjes ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, jemi munduar që ta arrijmë këtë baraspeshë. Si duket ka edhe paqartësi në këtë proces, do të definohen me siguri në procesin e më tutjeshëm të punës bashkë me Komisionin Parlamentar. Ne do të japim si Ministri një kontribut që t'i qartësojmë ato dilema në qoftë se janë të tilla që mund të korrigjohen në një dialog ndërmjet dy institucioneve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Janë 47 vota për, 5 kundër dhe 3 abstenime. Konstatohet që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Me propozim edhe të kolegëve, tani do të kemi pauzë për drekë deri në orën 14:00. Faleminderit!

(Vazhdimi i mbledhjes pasdite, e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Po vazhdojmë me rendin e ditës, me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri, zoti Hashim Thaçi, për takimin e zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Thaçi ka shprehur gatishmërinë që ta informojë Kuvendin e Kosovës për takimin e tij me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshës Eshton.

Zoti kryeministër, ju ftoj që ta merrni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!
I nderuar kryesues Haliti,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Kabinet qeveritar,
Të nderuar qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj;

Më lejoni që në fillim të kësaj seance t'ju falënderoj juve, të nderuar deputetë dhe kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për aprovimin e kërkesës sime për të informuar Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët tanë lidhur me procesin e filluar të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Pra, një informim edhe përmes Parlamentit të Kosovës.

Paraqitja ime sot përpara jush, të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës, ka së paku dy arsye apo qëllime kryesore.

Që të respektohet në tërësi obligimi im zyrtar për ta implementuar pikën 5 të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, të aprovuar nga një shumicë e madhe demokratike e Kuvendit të Kosovës, para dy javësh.

Siç e dini, kjo rezolutë na obligon neve si Qeveri dhe mua si kryeministër apo komisionet përkatëse parlamentare, që të informojmë - raportojmë rregullisht për procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, në Kuvendin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Ashtu siç e keni përcjellë edhe nga komunikimet e rregullta të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve më eminentë të diplomacisë botërore, ne tashmë edhe zyrtarisht kemi filluar procesin e dialogut politik për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ky proces ka filluar në Bruksel, me mbështetje të fuqishme edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Fillimit të procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, i kanë parapri konsulta gjithë-kosovare dhe mbështetja e gjerë politike, për çka edhe i jam mirënjohës skenës politike kosovare për mbështetje.

Mbështetje të fuqishme këtyre zhvillimeve i kanë dhënë edhe institucionet e Shqipërisë, liderhipi i shqiptarëve në Maqedoni, liderhipi i shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc dhe i falënderoj sot për mbështetje, para dhe pas takimit.

Dëshmia dhe konfirmimi më e mirë e kësaj mbështetje edhe botërore, është edhe vizita që dje i kanë bërë Republikës së Kosovës dhe rajonit, sekretarja e shtetit zonja Clinton dhe baronesha Eshton.

Më këtë rast, më lejoni t'iu përkujtoj se një proces i tillë i filluar pas miratimit të Rezolutës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka një bazë të gjerë ligjore që buron nga Kushtetuta e Kosovës.

Ky proces ka fituar një mbështetje të gjerë konsensuale, politike dhe shoqërore-gjithetnike.

Pastaj, është plotësisht në përputhje me procesin e integriteteve evropiane dhe përmbushjes së kriterëve të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, si dhe përmbushjen e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të vitit 2010, e cila verifikon, pa asnjë fije dyshimi mendimin e GJND-së për legalitetin dhe legjitimitetin e Deklaratës së Pavarësisë dhe njëkohësisht nis procesin e dialogut midis dy shteteve si pjesë të procesit të integriteteve evropiane.

Pas aprovimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës të Kosovës, unë si kryeministër i mandatuar nga ky Kuvend legjitim dhe demokratik dhe nga qytetarët e Republikës së Kosovës, kam marrë një ftesë zyrtare nga baronesha Eshton për të shkuar për takim zyrtar bilateral me zëvendëspresidenten e Komisionit Evropian dhe njëherësh Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshën Eshton.

Ky takim ka ndodhur të premten më datë 19 tetor. Baronesha Eshton, po ashtu i ka dërguar një ftesë zyrtare edhe kryeministrit të Serbisë, zotit Daçiq për takim bilateral, po të njëjtën ditë.

Përveç ftesës për takime bilaterale, baronesha Eshton ka konsideruar sa tashmë janë krijuar kushtet adekuate për të ndërmjetësuar, lehtësuar një takim të përbashkët, të nivelit të lartë ndërshtetëror ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë takimeve të ndara që i kemi pasur në Bruksel me baroneshën Eshton, ajo na i ka prezantuar çështjet që ajo do të dëshironte t'i diskutonte në takimin e përbashkët.

Ato çështje kanë qenë plotësisht të pranueshme, prandaj si rrjedhojë baronesha Eshton na ka ftuar në takimin e përbashkët, të ndërmjetësuar nga ajo dhe me mbështetje të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky takim është zhvilluar në zyrën e baroneshës Eshton.

Ky takim i parë i këtij niveli të lartë shënon fillimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura, me synimin e mbylljes së kapitullit të errët të së kaluarës dhe hapjen e kapitullit të paqes, bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe integriteteve euroatlantike.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë,

Më lejoni të përsëris atë që e kam thënë tashmë disa herë.

Unë personalisht nuk vuaj nga ndonjë nostalgji për të takuar udhëheqësit e një shteti që ka shkaktuar vuajtje shekullore deri në përmasa të gjenocidit, për qytetarët e vendit tim.

E kam thënë dhe po e them përsëri se kujtesa jonë për viktimat e luftës së shkaktuar nga Serbia, kujtesa jonë për bijtë dhe bijat më të mira që kanë rënë në altarin e lirisë, kujtesa për mijëra njerëz të zhdukur, do të mbetet gjithmonë e freskët. Kurrë nuk do të harrojmë tmerrin dhe dhimbjen e shkaktuar nga Serbia.

Gjithashtu, shteti ynë sovran, tashmë i ka të gjithë mekanizmat e sigurisë që garantojnë lirinë tonë, ekzistencën tonë, zhvillimin tonë dhe integritetin euroatlantik.

Por, ne të gjithë jemi pajtuar se e kaluara e jonë e hidhur nuk guxon ta mbajë peng të ardhmen tonë. Përkundrazi, vuajtjet dhe sakrificat tona duhet të jenë motivi ynë për të lëvizur sa më shpejt përpara drejt integritetit në NATO, Bashkim Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara e që kjo të ndodhë, patjetër na duhet të kemi fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet e rajonit, përfshirë edhe Serbinë.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës;

Unë si kryeministër nuk do të pranoja ta udhëheq një proces të tillë dhe nuk do të hyja në një dialog të tillë po të mos përmbusheshin disa parakushte.

E para, jam i sigurt në përkrahjen e partive politike, shoqërisë civile, botës akademike dhe qytetarëve të Kosovës, për procesin e integriteteve evropiane dhe për nevojën tonë historike t'i afrohem familjes evropiane si objektiv dhe vizion mbarëkombëtar i të gjitha partive dhe vullnetit të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Pastaj, Rezoluta e aprovuar e ka krijuar një rrethanë të re, një agjendë të re nga ky Kuvend.

Kjo agjendë, pra ishte agjenda unifikuese për të pasur progres në përmbushjen e kriterëve kryesore të Kopenhagës që po imponohet si imperativ i kohës e ajo është fqinjësia e mirë në mes të gjithë atyre që pretendojnë anëtarësim në Bashkimin Evropian e shteti i Kosovës si qëllim dhe vizion e ka integrimin në Bashkim Evropian.

Pastaj kemi kërkuar garanci ndërkombëtare që ky proces të jetë i strukturuar dhe krejtësisht i barabartë në nivelin ndërshtetëror për Kosovën dhe Serbinë, në reciprocitet të plotë politik dhe në hapjen e rrugëve integruese për Kosovën.

Involvimi i thellë dhe i drejtpërdrejt i kreut të diplomacisë amerikane dhe evropiane na garanton se procesi i dialogut është me përkrahje strategjike për Kosovën, për funksionalizimin e plotë, konsolidimin dhe fuqizimin e shtetit të Kosovës, Kosovës së re - Kosovës së evropiane.

Po ashtu kemi kërkuar të implementohen marrëveshjet e arritura deri më tani. Në këtë pikë ende kemi ngecje dhe paqartësi të cilat presim t'i zgjidhen brenda javëve në vijim.

Marrëveshjet e arritura që e përcaktojnë vijën kufitare dhe rregullojnë ligjërisht kalimet kufitare sipas modelit të integruar evropian, si dhe e drejta e pamohueshme e Republikës së Kosovës, të jetë pjesë e barabartë e organizmave rajonal, do të testohen në ditët, javët dhe muajt në vijim.

Serbia është obliguar nga Bashkimi Evropian që t'i përmbushë në plotësi këto marrëveshje.

Takimi im i parë si kryeministër i shtetit të Kosovës, me kryeministrin e Serbisë, rezultoi nga përmbushja e këtyre kriterëve tona minimale dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit.

Takimi u fokusua në kornizën e bisedimeve dhe natyrën e temave.

Është fakt i pamohueshëm nga të dy palët se dialogu është për zgjidhjen e çështjeve që nuk janë statusore e as që e rrezikojnë në asnjë rrethanë integritetin territorial të Republikës së Kosovës, përkundrazi, demokratizojnë dhe hapin kufijtë sipas modelit evropian për gjithë rajonin.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Çështjet që janë ngritur nga baronesha Eshton dhe diskutuar nga dy kryeministrat, i shtetit të Kosovës dhe Serbisë, në takimin e parë janë.

Zbatimi në praktikë i të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë;

Zbardhja e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës;

Zhbërja dhe largimi i plotë nga Kosova, i strukturave paralele të sigurisë, të financuara nga Serbia;

Mos pengimi për Kosovën për anëtarësim në organizatat dhe forumet ndërkombëtare, nga Serbia.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë;

Përmbyllja e procesit të decentralizimit në Kosovë, që nënkupton domosdoshmërinë e formimit të komunës së re, atë të Mitrovicës së veriut dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira në veri të vendit;

Arritja e marrëveshjeve në fushën e telekomunikacionit dhe energjisë, sipas standardeve evropiane, si dhe mundësinë e shpejt të hapjes së zyrave ndërlidhëse të Republikës së Kosovës, në Beograd dhe anasjelltas, të Serbisë në Prishtinë.

I nderuar kryesues Haliti,

Të nderuar deputetë;

Qytetarë të Kosovës;

Zonja dhe zotërinj;

Konkluzioni i takimit të parë ishte pajtimi për t'i adresuar temat e diskutuara dhe vazhdimi i takimeve tjera.

Besoj se takimi i ardhshëm do të ndodhë gjatë këtij muaji dhe jam i sigurt se do të jetë më përmbajtjesor.

Me lejoni, pra, të nderuar deputetë, edhe një herë t'ju bëj të qartë se nuk më ka marr ndonjë mall, apo më ka mbetur ndonjë “zhig” të flas me Daçiqin, por se jam thellësisht i bindur se dialogu do të dërgojë deri te përfundimi logjik që i hap rrugë anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, NATO dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Unë jam fare i vetëdijshëm dhe e di se këto takime nuk janë fare populiste, janë të rënda për mua personalisht, por të nderuar qytetarë të Kosovës, deputetë të nderuar, unë gjithë jetën time kam marrë vendime të rënda për mua, por të dobishme për vendin, për atdheun tonë, Kosovën.

Së pari do të vazhdojmë të punojmë që të pajtohemi për realitetin që e kemi, e ma vonë do ta quajmë realitetin edhe me emrin e vërtetë, njohjen reciproke.

Kjo ka qenë mesazhi dhe politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe evropiane, e cila i lejon Kosovës të ndërmarrë hapa të plotë në rumbullakim të integritetit, sovranitetit dhe anëtarësimit të Kosovës në organizmat gjithë ndërkombëtar.

Këto mesazhe i keni të qarta të gjithë, apo i kemi të qarta të gjithë ne, sidomos pas vizitës së baroneshës Eshton, sekretares Klinton dhe ministrit britanik Hejg.

Këto kanë qenë mesazhe të fuqishme të përkrahjes për unitetin politik që e kemi arritur të gjithë ne së bashku me rastin e përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur dhe fitimin e studimit të fizibilitetit, si parakusht për liberalizim të vizave.

Të nderuar deputetë,

Me këtë rast, dua të falënderoj sekretaren Klinton që për vite të tëra i dha mbështetje Kosovës dhe për miqësinë e treguar.

Qytetarët e Kosovës, kanë vetëm dashuri dhe respekt për sekretaren Klinton dhe lidhshypin demokratë dhe republikanë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që me dekada na kanë qëndruar si mbrojtës të shenjtë të drejtësisë në Kosovë dhe në gjithë rajonin. Jemi krenarë me fjalët emblematike të sekretares Klinton se Kosova është shembulli i progresit më të shpejtë pas lufte në historinë e kombeve. Dhe këto fjalë emblematike duhet të na bëjnë të ndihemi mirë të gjithë, të ndihemi krenarë të gjithë për suksesin e përbashkët.

E falënderoj edhe baroneshën Eshton, e cila në Kosovë ishte si në shtëpi të vetë sepse shtëpia jonë e përbashkët është Evropa.

Vizita e saj e përkrahur nga Sekretarja Klinton, paraqet fuqizim të agjendës evropiane dhe shtytje edhe më e madhe për të gjitha partitë dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Baronesha Eshton si dhe komisionari Fyle, kanë luajtur rol të madh dhe të paharrueshëm në arritjen e konsensusit brenda Bashkimit Evropian, që edhe Kosova është përfituese e barabartë e premtimit të Samitit të Selanikut, para dhjetë vjetësh se i tërë Ballkani do të integrohet në Bashkim Evropian.

Por, më lejoni që të shpreh një falënderim më të veçantë, edhe për ministrin Hejg.

Marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me Britaninë veçse po forcohen në fusha të politikës, diplomacisë, ekonomisë dhe vizita e tij e parë në Kosovë paraqet një moment të ri të forcimit të marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Falënderimet më të mëdha për përfundimin e një faze dhe fillimin e një etape të re ju takojnë juve, përfaqësues të partive politike të cilët me ndërgjegje kombëtare dhe politike, i keni kontribuar unitetit për qëllime të përbashkëta.

Jemi të hapur për të gjithë përfaqësuesit e të gjitha partive politike, të pozitës e opozitës, përfaqësuesit e shoqërisë civile, të botës akademike, që të marrin pjesë në proceset e ardhshme.

Të nderuar deputetë,

Ajo që na obligon të informojmë, raportojmë, sot është konfirmimi i Qeverisë së Kosovës, të çimentuar tani edhe nga ana e Qeverive të shteteve të QUINT-it, se Kushtetuta e Republikës së Kosovës do të jetë korniza e vetme operuese gjatë dialogut.

Platforma kosovare është e qartë dhe e fokusuar dhe e aprovuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Dhe, platforma ime dhe e Kosovës, e juaja, është Kushtetuta e Kosovës, ligjet e Kosovës dhe rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, natyrisht e përcjell me çështje operative.

Prandaj, t'i përsëris pikat të cilat janë edhe pjesë e raporteve respektive të progresit për dy shtetet.

Qëllimi i diskutimit për implementimin e plotë të marrëveshjeve për menaxhimin e integruar të kufijve, ashtu që të mundësohet operimi evropian i shërbimeve kufitare, pra të standardeve evropiane.

Pikat kufitare do të kenë: doganë kosovare, polici kosovare, prani të EULEX-it, sipas ftesës së presidentes Jahjaga dhe mandatit të ri, duke marrë parasysh nevojën e identifikuar për shtrirjen e autoritetit të plotë të EULEX-it në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe pjesën veriore të vendit.

Pasta, ndërprerja e shërbimeve ilegale të telefonisë dhe distribucionit, që paraqesin ndërhyrje në treg të lirë dhe shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

Tërheqja e plotë e të gjitha strukturave ilegale të sigurisë, këto janë mbetje të regjimeve të mëhershme, janë mbetje të pushtimit të periudhës së mëhershme.

Zgjerimi dhe ushtrimi i plotë i autoritetit të EEULEX-it dhe i ligjeve të Kosovës është hapi i ardhshëm, i natyrshëm dhe po punojmë me bashkësinë ndërkombëtare që qytetarët e veriut, të fitojnë qasje të njëjtë në sistemin e gjyqësisë.

Legalizimi i sistemit bankar dhe krijimi i transparencës së plotë të përkrahjes eventuale financiare të Serbisë, për arsimin dhe shëndetësinë në veri, sipas Planit të Ahtisaarit.

Njëkohësisht i drejtohem edhe përfaqësuesve të komunitetit serb, sot, përfaqësuesve politikë, por edhe qytetarëve serbë, të gjithë përfaqësuesve pra legjitim të qytetarëve serbë në Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe, Kosova nuk ka ndërmend që të menaxhojë apo drejtojë jetën e serbëve apo cilitdo qytetar në Kosovë.

Ne e kemi ndërmend të respektojmë vullnetin e tyre legjitim dhe demokratik, integrues në jetën institucionale dhe shoqërore.

Prandaj, jeni të lirë të flisni, të jetoni, të punoni dhe shpresoni e të guxoni, si të gjithë qytetarët e Kosovës demokratike, evropiane dhe shumetnike.

Ne ju kemi premtuar gjatë procesit të Vjenës se Kosova do të jetë shtet me shoqëri të hapur, sekulare, që respekton diversitetin, ku patriotizmi i njërit nuk paraqet rrezik për tjetrin, në rrugë të sigurt për t'u integruar në NATO dhe Bashkim Evropian, që do të thotë edhe respektimin me të lartë të drejtave dhe lirive të njeriut. Komunitetet tjera po ashtu i kanë të garantuara të drejtat e plota kushtetuese.

Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Më lejoni t'ju rikujtoj se sivjet i kemi dy përvjetorë të popujve tanë.

Është bërë një shekull prej fillimit të luftërave ballkanike që e copëtuan Ballkanin pas 500 vjetëve të Perandorisë Osmane dhe një shekull i shtetit modern shqiptar.

Ka kaluar shumë kohë dhe është derdhur shumë gjak prej asaj kohe.

Shteti i Kosovës është krijuar dhe atë jo në baza të luftërave etnike ballkanike, por në bazë të parimeve evropiane dhe drejtësisë ndërkombëtare.

Megjithatë, e kuptojmë se e drejta nuk ka fituar plotësisht. Ne do t'i mbesim besnik mbrojtjes së vlerave dhe idealeve dhe vizionit të qytetarëve të Kosovës dhe luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Do t'i fitojmë edhe reparacionet për dëmet e bëra nga Serbia. Krimi, të jeni të bindur se herë do kurdo do të ndëshkohet. Të zhdukurit do të kthehen dhe të prehen të qetë në atdheun e tyre.

Por, pasi kemi fituar luftën dhe shpallur pavarësinë tani ka ardhur koha të përfundojmë rrugën tonë të gjatë një shekull e t'i kthehemi Evropës.

Jam i nderuar që më keni autorizuar të përdorim dialogun për benefite të qytetarëve tanë. Si rrjedhojë, të përdorim procesin e integriteteve për reformat demokratike të thella shoqërore, ekonomike dhe politike.

Qeveria e Kosovës, në periudhën e ardhshme do të raportojë sipas hapjes dhe përfundimit të fazave të ndryshme të dialogut.

Mirëpresim angazhimin e gjithë spektrit politik, në forma që ne mendojmë se do të jenë më efektive për procesin, duke përfshirë edhe ekspertë të profileve më të larta kosovare dhe ato ndërkombëtare, siç kemi bërë vazhdimisht.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Kosovës,
Si rezultat përfundimtar i dialogut do të jetë medoemos normalizimi i marrëdhënieve dhe logjikisht në një fazë të mëvonshme edhe njohja e Kosovës nga Serbia si shtet.

Por, këtë vit, mund të them lirisht se kemi shënuar një progres të jashtëzakonshëm dhe

mund të konkludojmë se ky vit me të vërtetë është vit evropian për Republikën e Kosovës.

Kosova ka shënuar progres të madh në përmirësim e klimës investive. Sipas FMN-së, ne po ashtu e kemi ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe kemi rritur të ardhurat buxhetore përtej planeve që kemi pasur.

Njohjet po vijnë me një ritëm të pandalshëm për t'u afruar edhe 100-shit formal që do të krijojë një momentum krejtësisht pozitiv për Republikën e Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kemi edhe shumë sfida para nesh.

Unë jam i vetëdijshëm se vetëm të bashkuar si spektër politik dhe si qytetarë, mund t'i tejkalojmë ato.

Ju ftoj që t'i lëmë prapa dhe anash interesat partiake, të koncentrohemi mbi të gjitha në interesat shtetërore dhe vizionin për të ardhmen dhe të bashkëpunojmë për integritet evropiane.

Unë ju ftoj të mbetemi të bashkuar në qëllimet dhe interesat tona shtetërore. Qëllimi, vlerat dhe vizioni ynë kombëtar dhe euroatlantik duhet të na mbajnë të bashkuar.

Uniteti ynë politik dhe qytetar në Kosovë, forcon edhe më tepër pozicionin e miqve tanë në përkrahje të kauzës sonë të drejtë.

Sa herë kemi punuar dhe vepruar të bashkuar, kemi shënuar suksese historike për vendin dhe qytetarët tanë.

Kështu ishte në luftën tonë për liri të viteve 1990, 1998, 1999,
Kështu ishte në Konferencën historike në Rambuje.
Kështu ishte në bisedat për status në Vjenë, 2005-2007.
Kështu ishte kur vendosëm të bashkuar të shpallim pavarësinë e vendit tonë, më 17 Shkurt 2008.

Besoj fuqishëm se kështu të bashkuar do të vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Të kaluarën e rëndë e kemi fituar të bashkuar. Vetëm të bashkuar do të jemi fitimtarë edhe në të ardhmen. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar, zoti nënkryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër,
Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të shpreh kënaqësinë për këtë përgjegjësi kushtetuese prej lidërshit që ka treguar kryeministri me vetë faktin që në fillim të një procesi shumë të rëndësishëm dhe konsensual, po e njofton Kuvendin për fillimin e një procesi për të cilin ne kemi debatuar dhe kemi arritur një konsensus gati pothuajse të gjitha partive politike. Dhe, padyshim se kjo është një kulturë kushtetuese, kjo është një element i përgjegjësisë politike dhe unë jam i sigurt dhe uroj që ky proces deri në fund të shkojë në këtë proces të këtij partneriteti, sepse me këtë raportim ne po implementojmë Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, me të cilën kemi kërkuar që Qeveria dhe komisionet tjera parlamentare të njoftojnë me rregull Kuvendin për fillimin e procesit të normalizimit.

Tanimë ky proces është proces shtetëror. Tanimë ky proces është një proces ku ne po hyjmë në mënyrë të dinjitetshme, po hyjmë me një mbështetje të fuqishme ndërkombëtare, e cila u konfirmua edhe dje, po hyjmë me një kornizë të qartë të këtij procesi të normalizimit. Të gjithë i dëgjuam mesazhet e djeshme për të cilat edhe kemi qenë të sigurt, mesazhe që dhanë dy partnerët tanë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian dhe dëgjuam se qartë u bë e ditur që korniza e bisedimeve do të jetë Kushtetuta e Kosovës, pavarësia e Kosovës, statusi i panegociueshëm i Kosovës. Është jashtëzakonisht mirë që edhe lidërshi serb po e pranon që nuk do të flitet për statusin. Unë kam dëgjuar këto ditë liderët serbë dhe ata janë të vetëdijshëm se nuk do të mundë t'i imponojnë çështje që i kanë përdorur për konsum të brendshëm. Dhe, natyrisht ky proces duhet të vazhdojë vetëm në këtë mënyrë, me këtë konsensus, me këtë përgjegjësi duke i njohur personalisht nga afër përvojat dhe shkathtësitë e kryeministrit në proceset historike, në të cilat ka kaluar Kosova, në Rambuje dhe më tutje, të jemi të sigurt se me një vendosmëri të plotë dhe me një qëndrueshmëri të plotë institucionale, do të mbrohen interesat e Kosovës, në këtë proces të normalizimit të raporteve.

Është jashtëzakonisht mirë që kryeministri sot e përsëriti, platforma jonë është Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ne, në pikën 3 të Rezolutës, me rastin e miratimit të Rezolutës, kemi caktuar 5 vlera kombëtare që janë interes vital dhe të cilat janë shtyllë e çfarëdo procesi të normalizimit. Dhe, natyrisht, procesi i normalizimit të raporteve me Serbinë, është një proces që Kosova ka interes nacional ta fillojë, po ta fillojë në mënyrë të dinjitetshme, me qëndrime të qarta, sepse ne kemi problem me Republikën e Serbisë dhe ato probleme do t'i zgjedhim përmes një procesi të normalizimit, me qëndrime të qarta shtetërore, si dy shtete, si dy shtete plotësisht të pavarura.

Dhe, unë uroj që ky proces, i filluar jashtëzakonisht mirë, të vazhdojë kështu, të vazhdojë me njoftimin e rregullt të Kuvendit të Kosovës, pas çdo takimi dhe unë jam i sigurt se Qeveria dhe institucionet tjera që do të autorizohen për të marrë këtë përgjegjësi, do të vijnë në Kuvend dhe do ta njoftojnë Kuvendin rregullisht, në mënyrë që të sigurohet edhe transparenca politike, por edhe transparenca me qytetarët e Kosovës, sepse po shihet se ky proces tanimë ka një mbështetje të gjerë, jo vetëm të strukturave politike, por edhe të shoqërisë civile edhe të opinionit të gjerë të Kosovës.

U tha edhe dje, nga mikesha jonë, zonja Klinton, që lidershpi nuk matet vetëm me vendime popullore, por ne duhet të matemi edhe me vendime të guximshme. Ky është proces në të cilin Kosova duhet të hyjë shumë e vendosur, në mënyrë shumë të guximshme, me kërkesa dhe me qëndrimet e veta dhe jam i sigurt se edhe ky proces do të përfundojë në të mirën e Kosovës dhe shteti i Kosovës nuk do të ketë më asnjë pengesë, shteti i Kosovës do të fillojë të anëtarësohet brenda Bashkimit Evropian dhe do të neutralizohet çfarëdo destruksioni apo obstruksioni i qeverisë serbe.

Pak a shumë, janë kristalizuar edhe cilat do të jenë temat konkrete, dhe padyshim se zgjidhja e këtyre temave, sidomos tejkalimi i status quo-s në veri, është një interes nacional për Kosovën, sepse një ditë, vazhdimi i kësaj status quo-s do të dëmtonte interesat nacionale dhe është jashtëzakonisht mirë që atje të fillohet të vendoset ligji, të vendoset Kushtetuta, të vendoset sovraniteti dhe integrimi i qytetarëve serbë të Kosovës, brenda institucioneve. Shembulli më i mirë i këtij integrimi është integrimi i qytetarëve serbë anembanë Kosovës dhe unë jam i sigurt se edhe serbët në veri do ta kuptojnë se perspektiva e tyre apo rruga e vetme është integrimi, sepse Kushtetuta jonë, e bazuar në pakon e Ahtisarit, është oferta më e mirë legale dhe kushtetuese që mund të ofrojë ndonjë shtet për çështjet e pakicave dhe për çështjet e të drejtave të tyre legjitime, për të shprehur identitetin kulturor, identitetin gjuhësor dhe identitetin historik. Dhe, unë jam i sigurt që do të kemi ndërgjegjësim edhe te ajo pjesë e serbëve që janë ose pre e presioneve që bëhen nga grupe të caktuara, dhe do të fillojë ky proces me të cilin do të funksionalizohet pushteti legjitim dhe pushteti kushtetues në veri dhe do të integrohet plotësisht, në mënyrë që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, të jetë një akt nga i cili do të përfitojë edhe ajo pjesë e Kosovës, për shkak se përmes realizimit të drejtave të dhëna në Kushtetutën e Kosovës, serbët më së miri do t'i mbrojnë të drejtat e tyre legjitime.

Edhe një herë unë e përshëndes këtë raportim të kryeministrit dhe uroj që kjo praktikë e mirë, që është edhe praktikë kushtetuese, është edhe një përgjegjësi politike, të vazhdojë në mënyrë që Kuvendi të jetë i informuar me kohë. Së fundi, të nderuar kolegë, ne jemi edhe marrë vesh në Rezolutë se pronësia finale ndaj këtij procesi është te Kuvendi i Kosovës, i cili do të ratifikojë çfarëdo përfundimi logjik të këtij procesi, qoftë me marrëveshje apo me forma tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Meqenëse zoti Bajrami e tha në emër të Grupit, atëherë e nënkuptoj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kjo nënkuptohet që jo do të duhej, po e ndjejmë obligim që edhe në grupet tjera, në këtë rast Grupi Parlamentar i LDK-së, në emër të cilit flas, t'i themi dy-tri fjali.

E para që e kemi thënë vazhdimisht dhe e kemi përsëritur dhe po e themi edhe sot që ne kemi qenë dhe mbetemi ihtarë të zgjidhjes së problemeve me dialog. Kjo asnjëherë nuk ka qenë kontestuese në filozofinë politike dhe të veprimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ajo që e kemi thënë vazhdimisht, dhe kemi kërkuar, ka qenë nevoja për transparencë të këtyre bisedimeve, më mirë të themi obligimi që të mos dilet ose mos të flitet jashtë asaj që do të rrezikonte sovranitetin, integritetin dhe rregullimin e brendshëm, por mbi të gjitha, një kërkesë që ka qenë e vazhdueshme, e që në një mënyrë po plotësohet sot, është që të raportohet në Kuvend, çfarë po flitet dhe si po zhvillohen këto bisedime, një obligim që zoti Thaçi, kryeministri po e kryen karshi Kuvendit dhe qytetarëve dhe mbi të gjitha kthimi i rolit vendimmarrës në të gjitha proceset, po në këtë proces të jashtëzakonshëm në kuptimin e rëndësisë, rolin vendimmarrës të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo ka qenë ajo që vazhdimisht e ka shqetësuar LDK-në që nuk ndodhke dhe pikërisht këto janë ato arsyet kryesore që ne, edhe herën e kaluar, edhe te Rezoluta, kemi mbështetur, do të thotë, atë që e ka përmbajtur rezoluta, sepse realisht ka përmbajtur ose përfshirë të gjitha ato që i kemi thënë si shqetësime vazhdimisht, duke besuar thellë që nuk do të bëhet asnjë veprim dhe asnjë shmangie që do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me atë që është e pranuar ndërkombëtarisht, siç u tha. Sigurisht, ne rolin, gjegjësisht angazhimin tona do ta japim në Kuvendin

e Republikës së Kosovës, do t'i përcjellim me vëmendje të gjitha këto bisedime që do të bëhen, duke besuar po ashtu që kryeministri edhe për tjera bisedime që priten, të raportojë. Sepse, thënë sinqerisht, kjo sot ishte më tepër informatë dhe realisht informata dhe raporti duhet pasur të qartë se dallojnë, sepse në raport jepen edhe disa të dhëna edhe për çfarë është arritur. Në këtë rast s'ka pasur çka të na tregojë se çka është arritur, se s'është arritur asgjë, përpos një takimi zyrtar dhe zotimit të tij si kryeministër, siç e tha këtu, për atë që do ta bëjë ose nuk do ta bëjë, gjithmonë po mundohem ta them në kuptimin pozitiv.

Prandaj, ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, edhe një herë po them, inkurajojmë dhe kërkojmë njëkohësisht që të punohet, bisedohet e dialogohet gjithmonë në mbështetje dhe përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sigurisht që asgjë që del jashtë saj, për LDK-në, nuk do të jetë e pranueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Së pari, vetëm ta sqarojmë një gjë edhe për ju, por edhe për opinionin publik, kjo informatë apo ky raportim që e bëri Hashim Thaçi, para Kuvendit, nuk duhet të na ekzaltojë shumë, siç e pashë se po ekzaltohen me këto falënderime, disa deputetë, për shkak se është obligim i kryeministrit dhe Qeverisë që të vijë e të raportojë në Kuvend. Pra, nuk është se e bëri një punë të madhe në të mirën tonë, kryeministri tash. Erdh dhe e kreu minimalen e detyrës së vet, pra edhe tregoi që u takua me Daçiçin, do të flasë më vonë se si tregoi në mënyrë shumë sipërfaqësore, gjë që s'mund të quhet madje as informatë e as raportim.

Çështja e dytë, takimi me Ivica Daçiçin, është takim kriminal, për shkak se në njërën anë është takim i cili e shpërfill tërësisht tërë atë historik kriminal që Serbia e ka pasur në Kosovë, jo vetëm gjatë luftës së fundit, por veçanërisht gjatë luftës së fundit, ku ky

person, Ivica Daçiçi, si zëdhënës dhe bashkëpunëtor më i ngushtë i Milosheviqit, ka qenë drejtpërsëdrejti i inkorporuar dhe i përfshirë në të gjitha planet kriminale për shfatosjen e shqiptarëve nga Kosova. Pra, ky është ai që ka planifikuar, në bashkëpunim me babën e vet politik, Milosheviqin.

Dhe, tash, kryeministri i jonë , që po thotë se është kryeministër i Kosovës, shkon dhe e takon të njëjtin person, buzëqeshet me të para kamerave, ia shtrin dorën dhe asnjëherë nuk i qet kurrfarë kushti atij.

Pra, ky është takim kriminal. Po përveç se është takim kriminal, natyrisht që është edhe takim shumë i rrezikshëm dhe i dëmshëm për Kosovën, për shkak se është takim jo parimor, pra është takimi i parë i nisjes së një dialogu politik për Kosovën, i cili nuk bazohet në kurrfarë parimi universal të drejtësisë, që nënkupton, pra është takim edhe dialog politik që ia nënshton Kosovën Serbisë, dhe së dyti, është edhe takim i cili po zhvillohet pa kurrfarë kushti. Pra, asnjë prej kushteve që Kosova domosdoshmërisht do të duhej t'ia shtronte Serbisë, në mënyrë që Serbia ta fitojë denjësinë që të ulet në tavolinë me përfaqësuesit e Kosovës, në fakt këtu, kryeministri po sillet si i gëzuar, i ekzaltuar që ky e paska fituar denjësinë të shkojë e të ulet në tavolinë me Daçiçin. Pra, është një e vërtetë e kthyer kokë teposhtë.

Për dëmet e takimit, dhe për që ky takim është shumë i rrezikshëm për Kosovën, mendoj që edhe kryeministri u pajtua edhe në fjalën e vet, por veçanërisht me veprat e veta, për shkak se po ta kishte konsideruar vërtet që është takim shumë i mirë dhe në dobi të Kosovës, nuk do ta bënte takimin tinëz. Pra, një ditë para se të ndodhë takimi, ne gjithë jemi dëshmitarë këtu e kemi diskutuar gjer e gjatë një rezolutë, të cilën e quajtmë Rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe aty është folur për dialogun politik që Kosova, pritej ta nisë me Serbinë. Dhe në tërë këtë debat, ku ka folur edhe kryeministri, asnjëherë nuk e ka përmend, madje as mundësinë që do ta takojë Daçiçin, takim ky i cili ndodhi të nesërmen.

Është e pamundur që vendimi për takimin është marrë natën e së enjtes, apo mëngjesin e së premtes, kur Thaçi shkoi në Bruksel. Natyrisht se e ka ditur më herët për mundësinë e këtij takimi, natyrisht që e ka ditur më herët që e ka pranuar takimin dhe prandaj e ngutke rezolutën përmes shefit të Grupit Parlamentar, Adem Grabovcit, e ngutke rezolutën në Kuvend, duke e quajtur rezolutë urgjente, pa e dhënë as arsyetimin më të vogël pse ishte kjo urgjente. Dhe, në fund, të nesërmen pra, u kuptua urgjenca e rezolutës. Urgjenca ishte, urgjenca e Hashim Thaçit për ta takuar Daçiçin. Kjo e bëri rezolutën urgjente, asgjë tjetër.

Pra, takimi Thaçi-Daçiçi, ishte planifikuar dhe organizuar tinëz, pra jashtë syve dhe dijes së opinionit publik në Kosovë.

Ka pafund deklarata të Hashim Thaçit, po edhe të përfaqësuesve tjerë të Qeverisë, por veçanërisht të Hashim Thaçit, mbi atë se nuk do të ketë bisedime a dialog politik me Serbinë, sepse pavarësia e Kosovës tashmë është çështje e kryer dhe tashmë kjo është edhe rikonfirmuar me përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë. Pra, këto kanë qenë

deklarata të përmbledhura të Hashim Thaçit, para se ta pranojë dialogun politik me Serbinë.

Njëherë thoshte që dialogu politik është ide e tejkaluar dhe Serbia duhet ta njohë realitetin në Kosovë, pra duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës e mandej që s'ka as vazhdim të dialogut teknik pa u zbatuar marrëveshjet e deritashme. Mirëpo, ky tash e nisi dialogun politik pa asnjë kusht, madje edhe pa zbatimin e marrëveshjeve të arritura.

Pra, dikur, para dy-tre muajve thoshte që marrëveshjet e arritura në Bruksel, në një dialog tjetër që quhej teknik, i cili po ashtu ishte i dëmshëm për Kosovë, do të jenë kushte para se të nisë çfarëdo procesi i dialogut me Serbinë dhe këto tash na u shndërruan siç e tha sot, në një temë të diskutimeve, pra ku do të fillojë diskutimi edhe një herë, tash me kryeministrin e Serbisë, Ivica Daçiçin, për atë se si, a dhe kur do të zbatohen marrëveshjet e arritura në Bruksel.

Edhe Gjermania, një shtet i BE-së ose më mirë të them Parlamenti – Bundestagu Gjerman, i ka paraqitur kushte Serbisë, për Kosovë. Qeveria e Kosovës, në rastin më të mirë premtan që kushtet do të jenë pra tema të dialogut politik. Por kjo është natyrisht e padrejtë dhe s'do të jetë as e dobishme, sepse duke i shndërruar kushtet në tema, ndodh faktorizimi i Serbisë për Kosovën dhe problematizimi i mëtutjeshëm i Kosovës. Vetëm duke i vënë kushte mund ta dëshmojmë subjektivitetin. Kushtëzimi dhe reciprociteti normalizojnë marrëdhëniet me Serbinë, sepse e detyrojnë Serbinë të ndryshojë, ndërkohë që ky dialog pa kushte do ta detyrojë Kosovën të ndryshojë. Dhe po e shohim që kurrë asnjëherë nga zyrtarët politikë të institucioneve të Kosovës nuk është pranuar se në këtë dialog politik do të flitet edhe për veriun e vendit, madje as në Rezolutë nuk përmendet kurrkund, ndërkohë që këto informata na vinin nga diplomatët e ndryshëm ndërkombëtarë që flisnin për domosdonë e dialogut dhe këtë dialog politik e lidhnin drejtpërsëdrejti me gjendjen në veri dhe tash së fundi, edhe kryeministri Thaçi, e pranoi që në fakt aty kanë filluar të diskutojnë dhe do të diskutojnë edhe për veriun.

Pra, të gjithë këto fraza tjera, që thuhet që nuk do të preket sovraniteti i vendit, se çështja e pavarësisë është e kryer, në fakt po bien në ujë me këtë deklaram të kryeministrit, për shkak se po qe se flitet për veriun, atëherë kjo nënkupton që gjendja në veri do të ndryshojë duke u marrë vesh me Serbinë, që nënkupton që Serbia qenka faktor vendimmarrës për sa i përket mënyrës se si rregullohet territori i vendit. E kur Serbia është faktor vendimmarrës në çështje të brendshme të Kosovës, atëherë kjo nuk nënkupton se Kosova është e pavarur nga Serbia, për shkak se po u dashka për të marrë leje nga një shtet tjetër për atë se si do ta quajmë, si do ta rregullojmë, çfarë do të bëjmë me një pjesë të caktuar të territorit të Kosovës, që aktualisht është në pjesën veriore. Pra, kjo nënkupton që Serbia po faktorizohet edhe brenda Kosovës, për shkak se po i pranohet njëfarë forme përçudnuese të legjitimitetit të pranisë së saj ilegal, jo legjitim dhe kriminal brenda territorit të Kosovës. Dhe, në këtë drejtim, edhe kur flitet për strukturat ilegale të Serbisë, në momentin që kjo bëhet temë diskutimi me Serbinë, atëherë fuqia politike vendimmarrëse e Serbisë për Kosovën është pranuar nga kjo Qeveri. Pra, ky është edhe një aspekt tjetër, edhe i rrezikut, edhe i dëmit, por edhe i kriminalitetit të këtij dialogu

politik i cili po quhet dialog i normalizimit dhe dialog i lidhur me integrimin e Kosovës në BE.

Situata pastaj bëhet natyrisht edhe më problematike, kur dihen edhe dy faktorë tjerë, jashtëzakonisht të rëndësishëm në këtë dialog, e këta janë.

E dimë se është përmendur disa herë dhe vazhdon të përmendet, që qëndrimi fillestar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në këtë proces dialogu, është plani i Ahtisarit. Kjo paraqet edhe platformën e Qeverisë së Kosovës, prandaj nuk kemi platformë që sillet këtu në Kuvend për t'u diskutuar, se platforma tashmë dihet, është plani i Ahtisarit.

Po, Qeveria e Kosovës natyrisht që edhe nuk mund të ketë platformë tjetër, përveç planit të Ahtisarit, ndërkohë, që Qeveria e Serbisë, tash në krye me Daçiçin, ka për qëndrim fillestar ndarjen e Kosovës dhe këtë e ka thënë edhe ky person disa herë, edhe publikisht, pra që ky lufton dhe synon ndarjen e Kosovës.

Gatishmëria për dialog tash, e Qeverisë sonë, është gatishmëri për kompromis, për shkak se ç'kuptim të takohemi, ose takohet Hashim Thaçi me Daçiçin, po që se nuk ekziston një mundësi e pranuar nga të dy, që do të ketë kompromis në këtë proces dialogu, apo jo.

Rezultati do të jetë, pra, pikërisht qëllimi i Serbisë, autonomia për veriun, gjë që ata disa herë kanë tentuar në forma të ndryshme ta arrijnë. Një formë pra e entitetit të veçantë serb, ngjashëm me atë që e kanë ndërtuar përmes luftës në Bosnje, që quhet Republika Sërpska.

Pas takimit me ministrin e Jashtëm britanik Viliam Hejg, Hashim Thaçi deklaroi që në fund të dialogut politik, pra kur të arrihet normalizimi i marrëdhënieve, nuk pret që të ketë njohje të Kosovës nga Serbia, por nga 5 shtetet e BE-së, që nuk na njohin ende. Kjo paraqet edhe një zmbropsje tjetër të Hashim Thaçit, ende madje pa u nisur dialogu politik dhe heqje dorë e tij nga premtimi e zotimi paraprak për njohje të ndërsjellë të Kosovës me Serbinë, në fund të procesit.

Ne gjithmonë kemi kritikuar politikanët e huaj që shprehin mirëkuptim për mosnjohjen e Serbisë. Atyre tani iu bashkua edhe një politikan i vendit, pra Hashim Thaçi. Me këto koncesione, ende pa filluar mirë dialogu, mund të merrni me mend se çka na pret përgjatë tij e në përfundim të tij.

Pra, kur e thotë një diplomat i huaj që unë pajtohem me mosnjohjen që Serbia, ose me refuzimin e Serbisë, për ta njohur pavarësinë e Kosovës, kjo na...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit zoti, Ymeri! Fjalën e ka Adem Grabovci, replikë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, nënkryetar!
Kryeministër,

Kabinet qeverisës,
Kolegë të nderuar,

Vërtet se sa ishte me urgjencë nxjerrja e kësaj rezolute, që fillimisht dua sinjerisht t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare që na mundësuan të krijojmë atë konsensus shumë të nevojshëm, dëshmoi vetë takimi i Brukselit, ku për herë të parë u detyrua shteti i Serbisë, kryeministri i Serbisë të ulen dy delegacionet në pozita të barabarta, që vetëm simbolika e këtij takimi thotë mjaft për ata që kanë tru të mendojnë dhe të gjykojnë drejt në interes të qytetarëve të Kosovës.

Po ashtu, po i referohem përvojës sonë shumë të gjatë, që nga Konferenca e Rambujesë, spektri politik i asaj kohe dhe ai ushtarak, ishin të bashkuar dhe dihet atëherë ishte kundërshtar vetëm Serbia dhe ndonjë zë i mjerë që e kundërshtoi nënshkrimin e asaj marrëveshjeje.

Delegacioni ynë në krye me Hashim Thaçin, pati guximin dhe e mori atë përgjegjësi dhe ne sot jemi këtu. E përfaqësuan, shkuam bashkë edhe në Konferencën e Rambujesë, edhe të Vjenës, fituam edhe pavarësinë, Kushtetutën, që ky grupim politik janë kundër pavarësisë, kundër Kushtetutës, kundër institucioneve, që fatkeqësisht janë vetëm Serbia dhe ky grupim kundër këtyre të arriturave, kundër këtyre sukseseve.

Ne kemi besim të plotë te kryeministri Thaçi se do të krijojë ura të bashkëpunimit, do të thellojë atë bashkëpunim dhe dëshmia më e mirë është ardhja e sekretares së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonjës Klinton....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Grabovci. Kundër-replikë, zoti Ymeri, një minutë.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse e kam vetëm një minutë, s'po merrem me shpifje të kota të Adem Grabovcit, për atë se kush e kundërshton pavarësinë e kush e kundërshton Kushtetutën, por vetëm dua t'i them dy gjëra.

Së pari, meqenëse paska qenë pra rezoluta drejtpërsëdrejti e lidhur me Daçiqin, me takimin me Daçiqin, pse s'e përmendshi, pse ju vike marre, apo pse u tuteshit. Pse nuk e keni përmendur të enjten, sot një javë kur është diskutuar për këtë çështje?

Dhe, çështja e dytë, mos gënje, që ke konsensus. Pra, mundohu ta kuptosh qartë çka është fjala konsensus. Ti mund ta kesh shumicën e votave të deputetëve, që e ke pasur 50 e diçka për Rezolutë, por ky nuk është konsensus, se ata të tjerët që nuk kanë votuar, domethënë nuk janë pajtuar me atë. Ku e gjete këtë konsensus?

(Ndërhyrje)

Po mirë, edhe në qoftë se jam unë i vetmi kundër, prapë nuk e ke konsensusin, kështu që meqenëse nuk i kupton fjalët, mos i përdor. Të kam thënë edhe një herë në një emision, duhet ta blej një fjalor në mënyrë që ti ta këqyrësh se çka po thua.

Edhe çështja e tretë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Gjithsesi se Aleanca e ka mbështetur Rezolutën për fillimin e bisedimeve për normalizim të marrëdhënieve në mes Kosovës e Serbisë. Arsyeja pse e kemi mbështetur, është se kemi menduar që në afat të gjatë një gjë e tillë do të jetë e domosdoshme që të arrihet, dhe meqenëse në këtë proces janë kyçur Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Unioni Evropian.

Ne konsiderojmë se Rezoluta është platformë në vetvete dhe kërkojmë që Qeveria e Kosovës të mos largohet nga asnjë pikë e kësaj platforme, dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për ratifikimin e cilësdo marrëveshje në Kuvendin e Kosovës. Mendoj se ajo rezolutë ofron edhe koordinim të punës mes Qeverisë dhe Kuvendit, për sa i përket normalizimit eventual të marrëdhënieve mes dy vendeve.

Ne po ashtu kërkojmë që takimet të jenë vazhdimisht të ndërmjetësuara. Sa për takimin e fundit, duke pasur parasysh se ne nuk mund ta zgjedhim se kush është kryeministër i Serbisë, këtë s'e kemi bërë edhe atëherë kur na lypshin ta bëjmë, do të thotë para nja 15 vitesh, mendojmë që takimet e nivelit të njëjtë mes zyrtarëve të Kosovës dhe zyrtarëve të Serbisë, me ndërmjetësim evropian dhe amerikan para kamerave të botës, nuk i bëjnë keq Kosovës. Ato posaçërisht nuk i bëjnë keq Kosovës, nëse në ato takime nuk diskutohet tërësia territoriale e Kosovës dhe bëhet e qartë se një gjë e tillë nuk do të ndodhë, nuk diskutohet rregullimi kushtetues i Kosovës dhe bëhet qartë se një gjë e tillë nuk do të ndodhë dhe ne e dimë tanimë se plani i Ahtisarit nuk është dokument pune, ajo që ka mbetur prej tij është shkrirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Do të thotë, dhe po e përsëris edhe një herë, për derisa në ato takime bëhet e qartë se rregullimi kushtetues i Kosovës nuk është temë diskutimi, këto takime nuk i bëjnë keq vendit dhe e fundit, për derisa sovraniteti i Kosovës nuk diskutohet në asnjë variant, mendojmë se nuk i bëhet keq vendit.

Ne mendojmë se Kuvendi duhet të jetë vazhdimisht i informuar për të gjitha takimet që do të ndodhin, të gjitha takimet eventuale, dhe mendojmë po ashtu se ka vend që Kosova, përpos një rezolute të cilën e ka votuar dhe e cila mund të konsiderohet si një platformë, duhet të ketë dokumente pune, duhet të ketë dokumente të cilat do të jenë garant se edhe Kuvendi do të jetë i informuar, edhe spektri politik do të jetë i informuar në mënyrë që i gjithë potenciali, jo vetëm politik, po edhe intelektual i Kosovës, mund të jetë në shërbim

të bisedave për normalizim eventual të marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë vërtet nuk e kam për qëllim që ta ndal debatin, por besoj që kryetarët e grupeve parlamentare kanë mjaftuar dhe janë paraqitur disa me radhë kështu që s'kemi ndonjë tezë të cilën duhet ta miratojmë ose të mos e miratojmë. Informimi është bërë. Fjalën e ka zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar deputetë,

Sot në Kuvendin e Kosovës po krijohet një traditë e mirë e raportimit nga ekzekutivi lidhur me dialogun me Serbinë, të cilin edhe vetë Rezoluta, e cila është miratuar në këtë Kuvend të Kosovës, ia jep të drejtën ekzekutivit që të raportojë për çdo takim brenda Kuvendit të Kosovës.

Kjo praktikë e mirë, jemi të bindur, që do ta ndihmojë vetëm procesin e dialogut, sepse po krijohet mundësia që edhe ne si deputetë të kontribuojmë me idetë tona.

Koalicioni për Kosovë të Re e mbështet çdo nismë të Ekzekutivit, e cila është në interes të Kosovës dhe të paqes në rajon. Rajoni ynë ka pasur shumë konflikte dhe luftëra dhe shumë pak paqe, prandaj këto bisedime duhet të shfrytëzohen që të arrihet paqja e përhershme.

Të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm se bisedat për statusin e Kosovës kanë përfunduar dhe janë mbyllur në Vjenë dhe këtë e konfirmoi edhe vetë zonja Klinton dhe Eshton në vizitën që e patën në rajon.

Kosova ka shumë për çka të bisedojë me Serbinë, sepse akoma kemi qytetarë të cilët janë të zhdukur gjatë luftës dhe duhet të zbardhet fati i tyre. Po ashtu me Serbinë kemi edhe problemet e pensioneve, problemet e energjisë, problemet e telekomunikacionit dhe problemi më i madh, e potencoi edhe vetë kryeministri Thaçi, është problemi i strukturave paralele, të cilat duhet njëherë e përgjithmonë të shuhen nga territori i Kosovës. Koalicioni për Kosovë të Re do ta japë kontributin e rëndësishëm në të gjitha variantet, duke ndihmuar me ide dhe ekspertizë profesionale, por edhe një herë e falënderon kryeministrin për një fillim të një tradite të mirë të komunikimit Qeveri-Kuvend lidhur me bisedimet me Serbinë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Ju faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë e falënderoj kryeministrin e Kosovës për informatën lidhur me takimin e Brukselit, andaj tema që po diskutohet sot është pa asnjë dyshim ndër më themeloret dhe më të nxehtat. Janë disa arsye, që nga ato jetike, e deri tek ato vetjake.

Ne po bëhemi gati të bisedojmë me një shtet, i cili për afro një shekull ka qenë pushtues i vendit tonë, i cili ka bërë krime të shumta në Kosovë, e ndërkohë ende asnjëri prej qeveritarëve të tyre nuk e kanë ndërruar mentalitetin. Në këtë sallë, ndryshe nga çdo Kuvend i botës, jemi aq shumë të dënuar politikë nga pushteti serb, sa po të mblidhen vitet bëhen disa qindra vite burgje të ashpra. Në këtë sallë, shumë prej deputetëve u janë vrarë të afërmit, vëllezërit, motrat, prindërit e shokët pikërisht nga aparati pushtues e shtypës serb. Unë jam njëri prej tyre. Mirëpo, megjithatë, bisedimet janë të domosdoshme, duam apo nuk duam ta pranojmë këtë fakt.

Në kohë pushtimi, siç ishim ne, dialogu kur nuk ka rrugë tjetër, dhe Serbia nuk njihte rrugë tjetër, u bë nëpërmjet pushkës, nëpërmjet luftës. Ne e bëmë luftën dhe derdhëm gjak. Në kohë paqeje, tani kur jemi shteti i pavarur, kur e kemi shtetin tonë, por kur e kemi një fqinj të tillë që e kaluara e tij në dëm të popullit tonë ishte nga më barbarët, atëherë problemet nuk mund të zgjidhen më me luftë, por me bisedime. Të gjithë ne që jemi në këtë sallë e dimë se pavarësia e Kosovës erdhi nëpërmjet luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndihmës së faktorit ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. Ne dolëm nga kjo luftë jo vetëm fitues, por për herë të parë në historinë e Kosovës të radhitur aty ku duhej të ishim, në krahun e botës qytetare. Kosova u bë shtet i pavarur nëpërmjet sakrificave të pashembullta, nga njëra dekadë në tjetrën, por edhe nga përkrahja ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Kosova duhet të shkojë në bisedime për disa arsye, njëra nga të cilat, por edhe më themelore është edhe se ata që na pranuan pranë vetes, që na përkrahën, që de juro e de fakto e njohën të parët shtetin e pavarur të Kosovës, e kanë të njëjtën bindje - duhet biseduar.

Personalisht nuk brengosem a do të na njohë Serbia si shtet i pavarur. Kjo është punë e saj, por është e mundshme që pikërisht nëpërmjet kësaj rruge Kosovën ta njohin edhe 5 shtetet tjera evropiane që ende nuk e kanë njohur dhe atëherë do ta kemi një fitore të madhe politike nëpërmjet së cilës realizohen edhe ecuritë e tjera.

Kosova ka ende probleme të pazgjidhura me fqinjin e saj verior, probleme të kufijve, qarkullimit, pensioneve, e sidomos të të zhdukurve. Disa probleme kanë mbetur nga e djeshmja, e disa kanë lindur në ditët tona. Ato nuk mund të zgjidhen nëse nuk ulemi të bisedojmë. Dikush mund të më thotë se si mund të bisedohet me Serbinë kur na janë vrarë njerëzit e na janë zhdukur. Shqetësimi është i drejtë, por edhe në vllugun e luftës, në maj të vitit 1998, gazetari Dejvid Llojd, i rrjetit televiziv të BBC, bëri një intervistë me vëllain tim, Fehmi Lladrovci, i cili ishte mik juaji dhe bashkëluftëtarë me ju, deklaronte se jemi të gatshëm të bisedojmë me Serbinë. Kur ishim të gatshëm të bisedojmë në 'pikun' e luftës, përse të mos bisedojmë tani kur e kemi shtetin tonë, i kemi strukturat tona. Të kesh frikë nga bisedimet, do të thotë të mos e njohësh si duhet shtetin tënd, ose

të mos kesh besim te drejtuesit e shtetit. Nëse është e para, ky mendim duhet ndërruar. Shteti i Kosovës nuk ka frikë të bisedojë me askënd. Nëse nuk ekziston besimi te drejtuesi i shtetit, ky ka qenë verdikti i popullit në zgjedhje, e besoj se do të jetë edhe në të ardhmen.

Unë e kam besimin e madh te udhëheqësi aktual i Qeverisë së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, i cili gjatë luftës ishte udhëheqësi politik i saj dhe njëri ndër udhëheqësit kryesor në bisedimet e Rambujesë, që përfunduan me vendimin për fillimin e bombardimeve kundër makinerisë ushtarake serbe dhe objektivave strategjike të saj.

Të nderuar deputetë,

Unë nuk jam që duke i shkrirë akujt e bisedimeve, ta harrojmë gjakun që e kemi derdhur, por pikërisht këto ditë, e sidomos dje, e patëm një shembull të madh se bota është pranë nesh dhe e përkrah idenë tonë. Dy zonja të nderuara, drejtuese të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian, edhe një herë e publikuan mbështetjen për Kosovën për shtetin e saj, për pandryshueshmërinë e kufijve. Unë besoj tek ato, te fjala a tyre dhe te shtetet që i përfaqësojnë. Nuk është e parëndësishme se zonja Klinton e solli këtë mesazh në kohën kur stuhia “Sendi” po shkakton dëme të parapara deri më tani në SHBA. Me këtë rast dëshiroj t’ua shpreh ngushëllimet e mia për viktimat që i shkaktoi kjo stuhi. Ky mesazh po vjen edhe kur Amerika po bëhet gati për zgjedhjet e reja presidenciale. Pra në vlugun e punëve të saj, ajo vjen në Kosovë. Edhe ky është një mesazh.

Përfundimisht, unë e përkrah fillimin e bisedimeve me fqinjin tonë, pra shtetin serb. Në këtë proces të gjithë duhet të sillemi me përgjegjësi shtetërore, të tregojnë pjekuri, guxim dhe dinjitet shtetëror. Jam i sigurt se edhe në fund të këtij procesi do të dalim faqebardhë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër dhe i gjithë Kabinet qeveritar.

Kolegë deputetë,

Ne sot faktikisht nuk do të themi diçka të re, por nuk mund të vazhdojmë aty ku u ndalëm para një jave, sepse tema është faktikisht e njëjta. Po ndodh një ndryshim, jo shumë i madh, do të thosha jo i papritur, sepse e pata thënë edhe atë ditë që priten takime të tilla dhe ndodhi takimi i kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi me kryeministrin e Serbisë. Ne e dëgjuam paraqitjen e kryeministrit Thaçi, e cila më shumë se raport është faktikisht nënvizim i qëndrimeve të dëgjura disa herë në Kuvend edhe javën e kaluar, me një nuancë të re.

Populli thotë se shtëpia nuk mbahet pa miq, pastaj thotë miq janë ata që të gjenden, jo veç në ditë të mirë, por edhe në ditë të mira, edhe në ditë të liga, pastaj thotë që miqësia nuk ruhet me disnivelizime, por me barazi dhe me bashkëpunim, dhe tutje thotë se për ta pasur një miqësi të madhe, njeriu duhet të jetë i denjë për atë miqësi. Në të vërtetë, unë po e citoj Ibrahim Rugovën në fjalime të ndryshme, duke cituar fraza popullore, të cilat qenë

bërë si ushqim, unë do të thosha - programatik i Kosovës, sidomos në raportet me SHBA-në dhe me Bashkimin Evropian. Dua të them që si të bëjmë elozhe të kësaj ose të asaj natyre, personazhet kanë ndërruar, por ligjërimi ka mbetur pak a shumë i njëjti, e nuk kemi nevojë për çdo ditë të përbetohemi se i duam shumë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropën, sepse është interesi i provuar që SHBA-të dhe Evropa na kanë ndihmuar për ta shpallur pavarësinë e Kosovës. Nuk është punë shpallje dashurie, është punë vlerësimi logjik, politik i interesit të qytetarëve të Kosovës. Edhe në këtë moment, që nuk është moment i festivitetit të Kosovës, por as momenti i orëve më të liga që ka pasur ky vend, këto dy pika të referencës ekzistojnë dhe është mirë që ekzistojnë dhe ky komunikim ekziston në nivel.

U tha këtu dhe u përmend edhe sot, por është përmendur në mënyra të ndryshme dhe në diskutimet publike, është trimëri të bisedohet me Serbinë. Pastaj nuk duhet të ketë frikë të besohet. Unë besoj që ky diskurs është pak, deshëm apo s'deshëm, njëfarë përgjigje, një perceptim popullist për këto probleme. Unë mendoj që duhet të bisedohet dhe duhet të bisedohet dhe bisedohet nëse është interes politik i Kosovës. Atëherë as nuk është trimëri, as nuk është frikë. Është interes politik. Sepse kjo mënyrë e diskutimit mua po më duhet si ajo fraza e vjetër ballkanike që ky është vend ku njeriu bie si patriot në gjumë, e zgjohet si tradhtar në mëngjes. Këto dy karakterizime ekstreme janë te perceptimet, e unë mendoj që nuk është koha që të merremi me to. Ajo që mua më intereson sot dhe që u përpoqa edhe para një jave ta them, duhet të nënvizoj edhe një herë: Meqë bisedimet kanë filluar edhe simbolikisht me takimin e dy kryeministrave, bisedime me Bashkimin Evropian, unë e thashë edhe atëherë, e tha edhe kryeministri në një mënyrë, ka muaj që këto ndodhin, atëherë mendoj që Kosova duhet t'i sigurojë dy gjëra - një, që në këto bisedime të jetë e barabartë, me status të barabartë të bashkëbiseduesit. Kjo është themelore. Dhe, nën dy, pa marrë parasysh agjendat e koordinuara me Eshton ose me SHBA-në, Republika e Kosovës, në këtë rast kryeministri dhe ekipi i tij negociator, duhet të kenë platformë të shkruar.

Po thuhet që korniza është Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kjo nuk thotë shumë. Po thuhet që dihet për çka nuk do të bisedohet dhe nuk do të bisedohet për statusin, veçse perceptimet dhe vlerësimet janë të ndryshme. Edhe Serbia po thotë ne nuk do të bisedojmë për statusin, ajo po thotë se ju kemi brenda, ndërsa ne po themi nuk bisedojmë se ne jemi jashtë jush dhe jemi të pavarur. Prandaj, në platformë duhet të caktohet e kundërta e kësaj për çka do të bisedohet, strategjia si do të bisedohet dhe qëllimi ku do të arrihet. Këto tri çështje duhet të bëhen një platformë, një strategji dhe një qëllim i Republikës së Kosovës. A bëhet e shpallur në detaje para Kuvendit a jo, kjo mbetet çështje që duhet të diskutohet ndërmjet institucioneve, por është patjetër e nevojshme një platformë.

U bisedua për relaksim të kufijve. Shikoni! Nuk ka më mirë se sa kufijtë të jenë të relaksur. Relaksim të kufijve të jashtëm nuk mund të ketë, ose mund të jenë të çoroditur nëse krijohen kufij të brendshëm. Kini kujdes, sepse ndërtimi i kufijve të brendshëm i bën qesharakë kufijtë e jashtëm, jo të relaksuar në vështtrimin politik, jo veç në vështtrimin e qarkullimit. Dhe ajo që u tha edhe këtu - nuk duhet të frikësohemi. Nëse ne bëjmë platformë dhe themi që është normale, interes të bisedojmë me Serbinë për normalizim,

unë kisha bërë apel që ne përpara ta normalizojmë situatën në Kosovë, ndërmjet veti, se nuk ka logjikë ta luajmë egërsinë ndërmjet veti, e ta quajmë çudi normalizimin, e ta quajmë përparësi ose interes normalizimin me Serbinë. Unë mendoj se kjo është themelore, normalizim në kuptimin e standardizimit të dialogut, të marrëveshjes. Nuk ka absolutisht konsensus nëse dikush është kundër, por konsensusi më i madh krijohet, të mos luajmë me terma, sepse konsensus nuk do të thotë 100% për. Duhet të dihet edhe ky problem.

Punën e normalizimit e pata edhe pak si bashkëbisedim me Qeverinë, edhe me kryeministrin Thaçi, se ky e ka formulën që është e bukur, interesante dhe e pëlqyeshme. Thotë: uniteti qytetar dhe i spektrit politik, pak a shumë, nëse e citoj saktë. Të lumtë! Veçse, kjo është ajo që duhet të krijohet - standardizimi dhe normalizimi politik i brendshëm. Kosova duhet të bëhet demokratike, Kosova nuk duhet të shkojë kah shteti partiak, sepse nëse shkon andej, atëherë e ka konfliktin brenda. Uniteti krijohet me demokraci, me alternativa, me dialogë dhe me vendime, të cilat kanë interes qytetar. Atëherë e ke të sigurt unitetin qytetar dhe spektrit. Por, nëse shkohet kah partizanizmi në përfaqësim dhe në qeverisje është problem dhe atëherë je dhe nuk je, edhe standard, edhe i barabartë me të tjerët kur del të bisedosh për normalizim jashtë, se po e përsëris atë që e thashë edhe një javë më parë, gjithmonë të vlerësojnë kur del të matesh atje ashtu qysh të përcjellin te shtëpia. Kjo është e sigurt, në qoftë edhe me SHBA-në, qoftë me Serbinë, qoftë me Bashkimin Evropian dhe unë po e përfundoj këtë paraqitje timen, duke e kujtuar edhe një herë Mithat Frashërin, një dijetar, dhe veprimtar i madh shqiptar, i cili pak a shumë thoshte kështu: “Në robëri, lufta është puna jonë; në liri puna është lufta jonë”. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Me takimin e 18 tetorit Thaçi - Daçiq është humbur shansi i dyfishtë. Së pari, e dimë që kishim varësi të Serbisë nga Kosova për integritet evropiane. Tradicionalisht jemi mësuar me varësinë e Kosovës nga Serbia, por tash në kohët e fundit e kemi varësinë e Serbisë nga Kosova. Serbia nuk avancohet dot drejt Brukselit pa ndihmën e Kosovës. Duhet ta dëshmojë fqinjësinë e mirë dhe për këtë gjë duhet t'i shërbejë kjo Qeveri, në krye me Thaçin. Pra, nuk po shfrytëzohet varësia e Serbisë nga Kosova dhe për këtë arsye takimi i së enjtes, i 18 tetorit, paraqet shans të humbur. Por, shansi është humbur edhe në një rrafsh tjetër, sepse Serbia e koalicionit Nikoliq-Daçiq do të duhej që t'u nënshtrohej sanksioneve sikur Austria e Hajderit, bile shumë më tepër se aq. Nuk ka qenë Hajderi në Austri më neonazist se sa Nikoliqi që është në Serbi. Njësoj janë. Bile ky ka bërë krime, ekzekutime, planifikime, e kështu me radhë, të gjenocidit të kryer, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Kroaci e në Bosnje. Dhe këta njerëz nuk e kanë ndryshuar as qëndrimin, as qëllimin. Këta thonë në Srebrenicë nuk ka pasur gjenocid, Vukovari - qytet serb, ndërkaq Reçaku - teatri i NATO-s. Pra, këta nuk e kanë ndryshuar qëndrimin dhe ka qenë shans që edhe Kosova edhe Shqipëria ta fillojnë një fushatë që Serbisë të Nikoliqit dhe Daçiqit t'i vihen sanksionet, së paku sikur Austrisë së Hajderit. Edhe ky shans u humb. Pra, nuk është vetëm që janë bërë dëme dhe ka rreziqe për të ardhmen, por janë humbur edhe shanset me këtë takim.

Dialogu politik e bën shtetin e Kosovës jofunksional, sepse e suspendon shtetndërtimin. Çfarë do veprimi tash i Qeverisë të Kosovës, në veri të Kosovës, për bashkimin e Mitrovicës, për integritetin territorial, do të dalë si një veprim jo aq legjitim dhe gjithsesi i njëanshëm. Ky do të paraqesë njëlloj pabesie ndaj Daçiqit, sepse çështjen e veriut, se dialogu politik për atë gjë është, edhe normalizimi i marrëdhënieve e ka në qendër veriun, pra takimi me Daçiqin është aty ku adresohet çështja e veriut. Rrjedhimisht, nëse ti ndërmer diçka për veriun, i bie veprimi i njëanshëm. Kjo tregon që me fillimin e dialogut politik është suspenduar shtetndërtimi dhe, në anën tjetër, me vetë fillimin e tij, me përfundimin e dialogut politik, e dihet që do të jetë një kompromis i llojit të Bosnjës, me një Republika Sërpska, ngjashëm sikurse atje në veri dhe mbase jo vetëm atje, bashkimi me Shqipërinë kushtëzohet me humbjen e veriut. Pra, kjo do të jetë pasoja kryesore historike e këtij dialogu politik, që pas disa viteve, të gjitha subjekteve që janë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, do t'u thuhet: Po, në rregull, kjo edhe bëhet, por duhet ta kuptoni që kështu humb veriun, sepse veriun do ta ketë etabluar autonominë atje. Pra, me fillimin e dialogut politik suspendohet shtetndërtimi, me përfundimin e këtij dialogu, me rezultatin e kompromisit, bashkimi me Shqipërinë kushtëzohet me humbjen e veriut.

Po i theksoj 4 asimetri që i kam parë gjatë këtij takimi dhe, në përgjithësi, të këtij dialogu politik. Duket ndoshta më pak e rëndësishme, por besoj që nuk është e parëndësishme. Asimetria vizuale aty, baronesha Eshton ishte afër Daçiqit, Gjentilini ishte afër Thaçit dhe flamuri i BE-së ishte prapa Thaçit, nuk ishte flamuri i Kosovës, ndërkaq te Daçiqi ishte flamuri i Serbisë. Në anën tjetër, asimetria ishte përmbajtjesore. Mungesa e kushteve, pas plotësimit të të cilave duhet të bëheshim të barabartë. Pra, nuk ka kurrfarë simetrie në përmbajtje, duke qenë se nuk ka kushte, të cilat Qeveria e Kosovës i ka vënë për t'i plotësuar Serbia.

Dhe, tjetra është asimetria atematike. Atje do të flitet për çështjet e brendshme të Kosovës, por jo edhe për çështjet e Serbisë. Ju po e dini që Lugina e Preshevës nuk është përmendur atje. Flitet për çështjet e Kosovës, por jo edhe të Serbisë. Kjo është asimetria tematike. Dhe, në fund, është asimetria e ndërmjetësuesit. Bashkimi Evropian nuk na njeh ne, por Serbinë. Te ne ka fuqi ekzekutive, në Serbi nuk ka. Baronesha Eshton ndodhet në konflikt interesi, se edhe po ndërmjetëson ndërmjet Thaçit dhe Daçiqit, por edhe ia ka vënë fuqinë ekzekutive, kërcënuese e shantazhuese Thaçit, duke qenë se ky dihet që është i korruptuar e i shantazhuar.

Gjenocidin e Serbisë, të pagjeturit, tmerrin dhe vuajtjet nga Serbia që i përmendi Thaçi këtu, po a ia ka përmendur Daçiqit? Mos m'i thuaj mua! Të mos na i thotë neve këto gjëra! Le t'ia thotë Daçiqit! Pra, kryeministri Thaçi është dashur t'ia thënë Daçiqit këto, e jo neve këtu.

Në rezolutë e përmend luftën, humbjet, vuajtjet e popullit, gjakderdhjet e kaluara. Po pse po na i thotë neve? Thuaja Daçiqit, jo neve! Tjetra? Janë plotësuar disa parakushte, thotë Thaçi. Konsensusi i partie këtu, Rezoluta e Kuvendit, garancia ndërkombëtare për reciprocitet të plotë Kosovë-Serbi, krerët diplomatikë të SHBA-së dhe të BE-së të jenë ndërmjetësues dhe po ashtu tha që kemi kërkuar respektimin edhe zbatimin e

marrëveshjeve të deritanishme. Pra, të gjitha këto janë kushte të brendshme. Asnjë kusht nuk ia ka vënë Serbisë.

Foli për parakushtet e plotësuara që janë brenda, jo karshi Serbisë dhe, jo vetëm kaq, por të vetmin parakusht të Serbisë, e që është zbatimi i marrëveshjeve të deritanishme, që edhe ashtu nuk kanë qenë aspak të favorshme për neve, tha kemi bërë kërkesë. Pra, kushtet i ka bërë kërkesë. Nuk janë kushte, e ka paraqitur si kërkesë dhe kur i përmendi se cilat kanë qenë temat, ajo që u pa qartë se është se një mori kushtesh që i kemi shtruar ne si “Vetëvendosje” nuk janë fare as tema atje, e lëre më kushte.

Njohja e Kosovës nga Serbia, ndryshimi i Kushtetutës së Serbisë, dorëzimi i kriminelëve serbë të luftës, dëmet e luftës, shtypja politike dhe shfrytëzimi politik i Luginës së Preshevës, përkatësisht Kosovës Lindore, kërkim-falja nga Serbia, kthimi i kontributeve pensionale, i artefakteve kulturore, i regjistrave civilë dhe dokumentacionit kadastralë, jo që nuk janë kushte, por nuk janë as temë.

Mendoj që të gjithë e kemi parë sesi Gjermania ia ka vënë 7 kushte Serbisë e SHBA-ja 4 kushte, kurse Thaçi asnjë. Mos harroni që dje kanë ardhur zonja Clinton dhe baronesha Eshton, por nuk kanë ardhur realisht në Prishtinë. Kanë ardhur në dialog. Fizikisht kanë ardhur në Prishtinë, por politikisht kanë ardhur në dialog dhe nuk ka kurrfarë entuziazmi këtu për shtetin e Kosovës. Ata po e mbështetin shtetin e Kosovës në kuadër të dialogut. Dialogu po rikuptimëson gjithçka tash. Dhe, u tha se takimi me Daçiçin është vendim dhe veprim i guximshëm. Po ndaj kujt i guximshëm? Është veprim dhe vendim i guximshëm ndaj shtetit të Kosovës, ndaj popullit të Kosovës, jo ndaj Serbisë. Kushtet ndaj Serbisë janë guxim ndaj Serbisë. Bisedimet me Serbinë pa kushte ndaj saj janë guxim ndaj Republikës së Kosovës dhe kombit shqiptar, sepse këto të dyja po dëmtohen. Pra, i guximshëm ndaj kujt? Nuk ishte i guximshëm ndaj Serbisë. I guximshëm ndaj Kosovës dhe popullit të vet!

Më tutje, ky takim ishte i dobishëm për kryeministrin, sepse bëhet i përdorshëm edhe interesant për Brukselin që dëshiron t’ia heqë Serbinë Rosisë. Edhe unë jam dakord t’i hiqet Serbia Rosisë, por jo ne ta paguajmë çmimin, dhe i dëmshëm për Kosovën. Pra, i dobishëm personalisht dhe i dëmshëm kolektivisht. Thaçi nuk ka dëshirë të takohet me Daçiçin. Mund ta marr me mend që është kështu, por ky ka nevojë të takohet me Daçiçin. Nuk është çështje e dëshirës, por ka nevojë se i vyen për pushtet këtu. Pra, dakordohem që Thaçi që nuk ka dëshirë të takohet me Daçiçin, por gjithsesi Thaçi ka nevojë të takohet me Daçiçin. Nëse do ta refuzonte takimin, atëherë do ta rrezikonte pushtetin e vet dhe për këtë gjë nuk është i gatshëm. Arsyeja pse Thaçi ka nevojë të takohet me Daçiçin është se kjo i nevojitet Brukselit, e Brukseli e ka EUEX-i këtu, që e ka poshtë Qeverinë e Kosovës, me fuqinë ekzekutive që e posedon mbi të.

Në këtë dialog, mos harroni se Thaçi e përfaqëson popullin viktimë që takohet me kreun e shtetit agresor për marrëveshje - pajtim historik, siç po e quajnë. Pajtimi është gjithmonë kërkesë e xhelatit, kurrë e viktimës. E keni parë qysh viktima kur nuk kërkon pajtim, xhelati e kërkon këtë.

Thaçi, në emër të viktimave, po pajtohet me xhelatin. Kështu populli ynë po viktimizohet sërish. Xhelati nuk e ka ndryshuar as qëndrimin, pra as qëllimin, prandaj me këtë takim popullit tonë iu përsërit dhuna, iu përsërit dhunimi dhe buzëqeshja e Thaçit i shërben dekriminalizimit të dhunimit, sepse konsiderohet që Thaçi vetë po e pranon këtë. Pra, buzëqeshja e të dhunuarit është në funksion të dekriminalizimit të dhunimit dhe ky është rezultati kryesor i takimit të parë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Unë mendoj se ky proces i hapjes së Qeverisë ndaj Kuvendit dhe opinionit lidhur me bisedimet që po zhvillohen me Serbinë mund të merret si një rrethanë pozitive. Ne në E-15 e kemi pasur një bashkëbisedim të dobishëm, ku ka marrë pjesë dhe ka kontribuar edhe zëvendëskryeministri Kuçi. Megjithatë, krahas këtij, ta quaj ashtu - procesi pozitiv, nuk mund t'i iket një përshtypjeje apo edhe fakti që ende qasja e Qeverisë dhe qasja e përgjithshme e Kosovës ndaj bisedimeve me Serbisë po përcillet me improvizime dhe qëndrim jo mjaft proaktiv të Qeverisë, një qëndrim që mund të përkufizohet si një konstruktivitet pasiv.

Ne kemi dëgjuar qëndrime të ndryshme nga anëtarët e Kabinetit lidhur me platformën e bisedimeve. Ministri i Punëve të Jashtme tha se nuk nevojitet platforma, se platforma është Rezoluta e Kuvendit, Kosova i ka strategjitë, Kushtetutën e tjera. Ndërkaq, zëvendëskryeministri në bisedën e që e përmenda tha se Qeveria tani më i ka ndërtuar elementet e kësaj platforme. Mendoj se Qeveria duhet të jetë e qartë lidhur me këtë. Nga diskutimi që kemi zhvilluar herën e kaluar, dhe nga diskutimi i sotëm, është plotësisht e qartë se çdo qasje serioze ndaj bisedimeve me Serbinë kërkon platformë të zhvilluar të kujdesshëm lidhur me skenarët për qëndrimet e Kosovës lidhur me trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve: a) për të cilat Kosova është e interesuar; b) për të cilat supozohet se Serbia është e interesuar dhe c) për të cilat supozohet se bashkësia ndërkombëtare do t'i hedhë në tavolinë. Dhe këta skenarë i krijojnë Qeverisë sonë një mundësi më të madhe për të qenë proaktive për t'i prezantuar interesat e qytetarëve të Kosovës të të gjitha nacionaliteteve që këto bisedime ta kenë frytin e dëshiruar dhe të dobishëm për Kosovën.

Andaj, unë propozoj që Qeveria t'i heqë këto dilema, të jetë aktive që sa më shpejt ta sjellë platformën në Kuvend. Kolegu im Hamiti tha se ndoshta nuk është e nevojshme të vijë në Kuvend, por unë mendoj se duhet të vijë në Kuvend për shkak të rëndësisë së kësaj teme dhe të përgjegjësisë të mëdha që ndërliken me këtë temë, por kjo mbledhje e Kuvendit, në pjesë të caktuara, mund edhe të mos jetë publike për shkak të natyrës së çështjeve që mund t'i trajtojë platforma. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Kohëve të fundit është bërë praktikë që deklarimi kundër bisedimeve të reflektojë njëfarë lloj patriotizmi shterpë dhe krejtësisht folklorik. Sa më shumë dhe sa më zëshëm të jesh kundër bisedimeve, tregohesh se je më atdhedashës dhe më i përkushtuar ndaj vendit.

Sa më shumë që ta kundërshtoni qeverisjen e vendit dhe bashkëpunimin me mbështetjen ndërkombëtare, aq më shumë reflektoni idealizmin dhe i favorizoni zgjidhjet protetike për probleme të caktuara. Kjo qasje përfundimisht është zgjidhje e gabuar dhe rrugë pa krye. Kjo përfundimisht nuk duhet të jetë zgjedhja e Kosovës si option, sepse si option është jorealiste dhe si i tillë nuk duhet të ketë trajtim tjetër, pos të braktiset.

Ne duhet ta dimë se Republika e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, i themeluar dhe i ndërtuar nga qytetarët dhe institucionet e saj, i njohur ndërkombëtarisht nga afro 100 vende anëtare të OKB-së, përpos detyrave të veta të brendshme, duhet ta performojë gatishmërinë e hyrjes në aranzhime ndërkombëtare. Duhet t'i respektojë parimet bazë të trendit modern botëror dhe duhet të frymojë në frymën e lirisë, barazisë, demokracisë dhe qasjes që çfarëdo konflikti a pretendimi me shtetet tjera të pavarura duhet ta adresojë nëpërmjet bisedimeve. Kjo është fundamentale edhe në zhvillimin e paqes në vend, në rajon, por edhe më gjerë.

Mbi bazën e këtyre argumenteve nuk shoh rrugë tjetër të komunikimit edhe me fqinjin tonë verior. Bazuar në këto argumente, mendoj se nuk duhet të ndihet frikë dhe as hezitim që Kosova demokratike duhet t'u japë përgjigje të tilla subjekteve ndërkombëtare, e në këtë sfond edhe Serbisë.

Të nderuar deputetë,

Referimi në të kaluarën dhe në deklaratën nacionaliste të lidërshit serb, pa asnjë dyshim është i gabuar. Deklarimet e liderëve serbë nuk guxojnë të merren si pikë reference për politikën tonë, madje as në ato rate kur provokimet e tilla e cenojnë futjen në grackë të lidërshit tonë deri në masën që të na bëjnë të ngarendim pas agjendës së tyre politike.

Historia ka dëshmuar dhe ka treguar veprimet që kanë ndërmarrë shumica e qytetarëve të Kosovës në përgjigje të këtyre deklaratimeve serbe dhe këtë ne e patëm bërë jo vetëm për t'i koordinuar ngushtësisht me shumë shtete mike që ndihmuan në ndërtimin e shtetit tonë dhe sot po ndihmojnë në perspektivat e anëtarësimit tonë në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Të nderuar deputetë,

Në asnjë moment nuk mendoj se bisedimet duhet të trajtohen në gjuhën e gjithëpërfshirjes në tërësinë dhe ekskluzivitetin e tyre. Pra, ka tema dhe çështje që nuk bisedohen: si sovraniteti, integriteti territorial dhe rregullimi i brendshëm. Bashkë me ju e vendosëm Rezolutën për bisedime dhe me të njëjtën rezolutë temat e tilla bëhen të paprekshme. Ato janë çështje e sovranit, dhe sovranit tashmë ka vendosur për to. Të njëjtat janë njohur nga miqtë tanë, të cilët si përgjigje ia kanë dhënë vulën e mbylljes kësaj kapitule dhe kjo jo vetëm në aspektin politik me njohjen tonë, por edhe me akte juridike ndërkombëtare, siç është opinioni juridik, i dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e

Drejtësisë, dhe kjo sinqerisht më bën të mendoj se nuk kemi asnjë paqartësi dhe asnjë dilemë.

Rruga jonë kah Bashkimi Evropian përshkohet me standarde dhe detyra të njëjta, siç ishin edhe për vendet tjera. Rruga jonë e ndërtimit nuk duhet të jetë e ngarkuar me veprime tekanjoze dhe hileqare. Ajo nuk duhet të jetë e përshkruar me shfryrje inatesh, e leva kusuritjesh të politikës ditore. Duhet të jetë saktësisht e kundërta, rrugë demokratike dhe shumë serioze e qasjes dhe e frymës së lirisë dhe e demokracisë, e anëtarësimit në NATO, në Bashkimin Evropian dhe në OKB.

Kjo nuk do të thotë që ne kemi hequr dorë nga objektivat tona strategjike, por se këto duhet adresuar në rrugën institucionale dhe në pozicione të barabarta si dy shtete të barabarta, Kosova dhe Serbia. Në rrethanat e ardhshme, ne duhet të përgatitemi për beteja juridike me Serbinë.

Të nderuar deputetë,

Krejt në fund, më lejoni ta shpreh bindjen time që Kosova do të jetë pjesë e NATO-s, sepse e do paqen dhe sigurinë. Kosova do të jetë pjesë e BE-së, sepse e do rendin, ligjin, zhvillimin ekonomik dhe ndjekjen e trendëve tjerë politikë, juridikë dhe ekonomikë. Kosova do të jetë pjesë e OKB-së, sepse frymon sikur kombet tjera të lira dhe i merr mbi vete zotimet që çfarëdo problemi të vetin ta adresojë nëpërmjet bisedimeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Dhe të nderuar deputetë,

Ashtu siç pritej, më në fund filloi edhe ai i ashtuquajtur dialog politik ndërmjet kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministrit të Serbisë, Ivica Daçiq. Ky takim ndërmjet të Thaçit dhe një kriminelit të regjur antishqiptar e shënoi edhe fillimin e negociatave politike që, siç thuhet në ligjërimin zyrtar politik, ka për qëllim ta promovojë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Por, shtrohet pyetje se çka nënkupton në të vërtetë ky proces i normalizimit? Çka synohet të arrihet në të vërtetë me këtë mënyrë të re të dialogut politik? Pra, nëse analizohet me vëmendje, në të vërtetë ideja latente e krejt këtij procesi dhe përshtypja që krijohet është se jo raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por na del sikur Kosova nuk na qenka një vend normal dhe fatkeqësisht kjo situatë absurde ku, me vetëdije, apo pa vetëdije, ka rënë Qeveria e Kosovës dhe për ta tejkaluar këtë gjendje kryeministri Hashim Thaçi ka vendosur të dialogojë me Ivica Daçiqin. Paradoks më të madh besoj se nuk ka. Kështu, po të analizohet me vëmendje gjithë gjenealogjia e këtij procesi, ai ka kaluar nëpër disa faza. Fillimisht, Kosova i është nënshtruar një procesi të gjatë të monitorimit të mbikëqyrjes nga gjithfarë lloj strukturash mbi-institucionale e mbi-sovrane, që kishin për qëllim ta kontrollonin, monitoronin, disiplinonin dhe në fund gjoja ta normalizonin atë.

Ndërkaq, pas përfundimit formal të këtij procesi dhe të këtyre pjesëve të instancave përmbajtësore të saj tashmë si një tentakulë shtrihen thuajse mbi të gjitha poret e jetës

shoqërore dhe politike, atëherë normalizimi i Kosovës kaloi një fazë tjetër, atë të negociatave politike me Serbinë, ndërkohë që shteti serb, edhe pse përgjegjës për të gjitha krimet e ndodhura në të kaluarën, nuk e njohu asnjë kusht të tillë. E logjikisht duhej të ishte e kundërta. Në këtë kontest, zhvillimi i procesit mbi këto premisa, përpos efekteve të sipërcekura, ka edhe kosto tjetër politike dhe morale. Kështu, këto përfitime për Serbinë nuk përfundojnë vetëm me rehabilitimin e Daçiqit apo ultranacionalistëve racistë që e kanë pushtetin aktualisht në atë vend.

Takimi i kryeministrit të Kosovës me atë të Serbisë e fillon një rund të ri negociatash dhe bisedimesh, duke lënë jashtë disa fakte të rëndësishme, e ndër to mund të iniciojmë shpejt e shpejt 12 000 shqiptarë të vrarë, 1 750 ende të pagjetur, afro 20 000 gra të përdhunara, dhjetëra-mijëra shtëpi të djegura e pasuri të shkatërruar njëherë e përgjithmonë dhe ky takim që i barazon simbolikisht palët në tryezën e BE-së nuk merr parasysh që Serbia ende nuk ka kërkuar falje për këto, përkundrazi me krenari të madhe vijon nëpërmjet qeveritarëve të saj akte të ofendimit dhe të përbuzjes ndaj shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, si dhe aktet e tjera të cenimit të shtetësisë së Kosovës, sa herë që ka mundësi.

Madje, Serbia erdhi krejtësisht e pakushtëzuar në këtë takim, ku nuk u kërkuar as kthimi i dokumenteve kadastrale, as kthimi i kontributeve pensionale të mbledhura për dhjetëra vjet nga punëtorët e Kosovës, që sot kanë mbetur pa pensione, dhe anashkalimi i këtyre problemeve në fakt do të thotë moszgjidhje dhe këmbëngulje në të njëjtën rrugë. Janë pikërisht këto fakte që e bëjnë anomale marrëdhënien e Serbisë me Kosovën, dhe çdo përpjekje për normalizimin ndërmjet tyre, pa adresimin e drejtë të këtyre çështjeve, do të sjellë padrejtësi të reja. Pra, shihet qartë se çështja është shtruar gabimisht, sepse në tërë këtë proces është Serbia ajo e cila nuk është normale për shkak të së kaluarës së saj, të së tashmes dhe vizionit që ka për të ardhmen.

Në këtë sens, zhvillimi i negociatave të cilat nuk e dresojnë shkakun e problemit, por orientohen vetëm në pasojë, zakonisht përfundon me ruajtjen e shkakut ashtu siç ka qenë dhe kështu ka gjasë që në fund të këtyre negociatave, “suksesi” i këtij procesi do të përfundojë me një bosnjëzim të Kosovës, apo disfunksionalizim final të saj. Zyrtarizimi dhe legalizimi i strukturave serbe, që edhe aktualisht operojnë, pos si kriminale e si ilegale në veri dhe pjesë tjera të Kosovës, do të ishte hyrja përfundimtare që pritet të vijë prej këtyre bisedimeve që e pretendojnë barazinë, por siç shihet prodhojnë një pabarazi edhe më të rëndë dhe më të theksuar.

Në fund të fundit, siç shihet qartë, kjo edhe është tendenca kryesore e politikës së tanishme serbe. Ky qëllim perfid si synim themelor e ka pikërisht shndërrimin e Republikës së Kosovës si një shtet jofunksional dhe të dështuar nga kompromiset e reja që po hartohen dhe po bëhen përpjekje t’i imponohen popullit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë nuk prita që të hapet debat, sepse objektivisht ishte një informatë e ministrit dhe kryeministrit dhe në këtë rast nuk hapet debat, sado që ka qenë proceduar dhe në atë mënyrë që mund edhe të interpretohej kështu, siç u interpretua. Dhe e ndiej pastaj të nevojshme që duke qenë në Komisionin për Punë të Jashtme t'i them dy-tri fjalë. Unë e mirëpres informatën e kryeministrit dhe kryenegociatorit në këtë proces dhe e konsideroj adekuate, të përgjegjshme. Nuk kam pritur më shumë.

Jemi në fillim dhe mendoj që tash është pa subjekt të bisedojmë a duhej a nuk duhej ty hyjmë. Kemi hyrë dhe nëse kemi hyrë duhet të dalim faqebardhë. Mendoj që edhe angazhimi duhet të jetë i orientuar në këtë synim. Unë madje, në bazë të asaj që kemi dëgjuar dhe kemi mund të shohim, e konsideroj një fillim të mbarë. Uroj që kështu të jetë edhe në të ardhmen.

U theksua frika, guximi dhe tjera dhe mendoj që përsëri duhet t'i referohemi porosisë së vërtetë të pakontestueshme të presidentit Kenedi: “Kurrë frikë për të biseduar, por kurrë bisedime pa frikë”. Dhe, nuk është një tautologji, por është në parim të bisedimeve - nuk ke nevojë të frikësohesh, aq më shumë nëse e ke të drejtën me vete, por ama në bisedime nuk duhet të hysh me noshalancë, nuk duhesh të hysh i papërgatitur, nuk duhet ta injorosh, e tani jemi në këtë fazë që kemi hyrë. Tani duhet të vazhdojmë edhe qasjen adekuate në këtë proces.

Pasiguria, mosbesimi në forcat tua, në pozicionin tënd, të vë në pozitë defansive dhe të dëmton, por edhe triumfalizmi është po ashtu gracka e rrezikshme. Ne e kemi parë nga pak përvojën nga këto dy pozicione. Mendoj që angazhimi i përgjegjshëm është zgjidhja më e mirë. Angazhohem që të jetë pikërisht kështu dhe për të qenë kështu do të duhej të mos lejonim as përpjekjet për politizim, shfrytëzim në luftën ndërmjet nesh të këtij procesi, as për poenë politike, as për pozicione politike. Është interes i përbashkët dhe mendoj që do të duhej ta shikonim si të tillë. Loja e shahut luhet mirë vetëm me të gjitha figurat e shahut dhe me variante të ndryshme. Ai që nuk di të bëjë kombinime edhe me versione të ndryshme në cilëndo situatë, rrezikon ta humbë ose ta dëmtojë lojën.

Në këtë kontest, unë nuk shoh gjë të keqe edhe në qasjen kritike. I duhet pozicionit të Kosovës edhe një qasje kritike ekzigjente, nëse është e motivuar në konsolidimin e përgjithshëm të këtij procesi dhe të pozicionit tonë. Dhe, për mendimin tim, edhe në të kaluarën është dëshmuar se ka pasur raste, u përmendën disa, kur dikush mund të mos e ketë pasur krejt të bazuar qëndrimin e tij kritik e kontestues, por koha i ka dhënë të drejtë se po të mos ishte një angazhim i tillë do të mund të ngadalësoheshin proceset. Mendoj që edhe sot ka nevojë për t'i shfrytëzuar të gjitha pozicionet që i kemi në skenën tonë politike.

Nuk mendoj se duhet t'i frikësohemi procesit të normalizimit dhe procesi i normalizimit zakonisht ndodh në situata jonormale. Në situata normale nuk ka nevojë për normalizim, por nuk dua të injorohen shkaqet e situatave të krijuara dhe qysh prej latinëve të vjetër është thënë dhe ka mbetur e përhershme porosia “Cezant kauza, cezate fetus” - “Elimino

shkaqet, elimino pasojat”. Sidomos në Ballkan, përpjekjet për t’i zgjidhur problemet duke i mbuluar ato ose me sedativë, pa diagnozë të saktë, kanë dëshmuar se jo vetëm që nuk shpien në rezultatin e synuar, por përkundrazi mund të jenë shumë kundërproduktive. Shembulli i Bosnjës mendoj se është shembulli më i mirë dhe ne në Bosnje, në Sarajevë, e kemi dëgjuar porosinë edhe nga përfaqësuesit boshnjakë, edhe nga ata kroatë, madje edhe nga ata serbë - “Bëni gjithçka, mos e lejoni përvojën e Bosnjës!” Është shembulli më i keq i mundshëm. Mendoj që është një variant që duhet të parandaluar me çdo kusht dhe nuk e vë në dyshim se është përcaktim edhe i Qeverisë, edhe i atyre që e ndihmojnë këtë proces.

Informata e sjellë, për mendimin tim, në mënyrë adekuate i dha pikat kryesore, piketat kryesore të pozicionit tonë dhe, për mendimin tim, mjafton kaq në këtë fazë. Është fillimi. Të kërkoj që ne tash ta kemi këtu një strategji të detajuar e tjerë, do të thotë ta luajmë lojën e letrave me letra të hapura. Nuk luhet ashtu loja. Prandaj, mendoj që do të duhej të kuptohet edhe nevoja që procesi të ndiqet në gjithë ecurinë e tij. Por, ajo që mendoj se do të duhej insistuar në këtë fazë, e që është në përputhje me rezolutat që ka miratuar ky Kuvend, mund të them madje edhe në frymën e Rezolutës së fundit, megjithëse mënyra se si u procedura i la jashtë disa propozime që do ta kompletinin atë, por megjithatë si emërues të përbashkët e kishte kërkesën që në këtë procese të sillemi vetëm si palë të barabarta, si shtete të barabarta, e kjo nënkupton qëndrimin konsistent në këtë çështje, në të gjitha çështjet e hapura, edhe parimisht pastaj, edhe konkretisht, në secilën situatë, e kjo nënkupton edhe referencën e Rezolutës së Kuvendit për reciprocitetin. Dhe, mendoj është çelësi që e garanton edhe suksesin, edhe qëndrimin adekuat të palës kosovare në këto proces. Ka çështje të pazgjidhura edhe ndërmjet shteteve, edhe brenda shteteve tona, por ajo që mendoj se duhet të jetë bazë është qasja adekuate parimore dhe mbi parimin e reciprocitetit.

Edhe problemet e pazgjidhura lidhur me komunitetet në të dy pjesët duhet trajtuar mbi këtë bazë dhe çdo njëanshmëri në këtë bazë, mendoj që ka efekte kundërprodhuuese. Dhe tjetra që mendoj se duhet të jetë si pikënisje, është fakti se referenca e shpeshtë dhe Kushtetuta të dokumenti i Ahtisarit nuk do duhej të çonte në përfundimin e gabuar se është fjala për një pozicion me të cilën ne jemi të stërkënaqur, se është fjala për një zgjidhje maksimaliste, siç po prezantohet shpesh. Nuk është e tillë. Të gjithë e dimë. Edhe ata që e kanë dizajnuar, kanë thënë është kompromis dhe kompromis i dhimbshëm për shumicën shqiptare në Kosovë dhe duhet ta themi me plot gojën. Por, këtë kompromis të dhimbshëm e kemi pranuar me dëshirën që ta gjejmë një zgjidhje të gjithëpranueshme për gjithë Kosovën, edhe rreth Kosovës. Po ama duhet ta themi po ashtu shkoqur se çdo cenim i këtij parimi në cilëndo pjesë të Kosovës, jo vetëm që i hap çështjet ekuivalente rreth Kosovës, jo pse duam ne, por është e pashmangshme, por përkundrazi e vë në pyetje seriozisht edhe përcaktimin tonë për një zgjidhje parciale të moderuar e të dhimbshme dhe pasojat eventuale nuk duhet t’i adresohen pastaj palës që e ka pranuar një zgjidhje të tillë të dhimbshme. Mendoj se këtë ne nuk e kemi në dorë ta mohojmë, edhe po të duam dhe nuk duam. Ne besojmë se megjithatë kjo do të kuptohet në proces dhe do të sigurohet së pari baza parimore për zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, duke e respektuar reciprocitetin, duke rezultuar parimin e barabarësisë të dy palëve dhe çdo lëshim në këtë drejtim mendoj që do të ishte lëshim i pafajshëm.

Unë edhe një herë e mbështes informatën dhe angazhohem që ne me të gjitha format ta konsolidojmë, të përpiqemi ta mbështetim dhe ta forcojmë në ecje e sipër, natyrisht edhe ta mbajmë për gjuhë Qeverinë dhe ata që janë përfshirë në këto pjesë. Për gjuhë dhe për përgjegjësie...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Sot po diskutojmë për një çështje, e cila është e rëndësishme, mirëpo që ka një gjenezë, më kujtohet në pranverën e këtij viti, në këtë Kuvend, plasën disa debate mes kryeministrit dhe deputetëve të këtij Kuvendi, duke përfshirë deputetë të LDK-së, Aleancës dhe të “Vetëvendosjes”, se pse takoheshin nëpër konferenca ose kishte mundësi që të merrnin pjesë bashkërisht në konferenca ndërkombëtare, ku kishte edhe përfaqësues serbë, bile kryeministri i akuzoi, pala tjetër po ashtu akuzoi kryeministrin dhe në një moment unë ju thashë situata po qohet në absurd. Nuk mund të akuzohet as kryeministri, as deputetët pse marrin pjesë në një konferencë ku mund të ketë edhe përfaqësues serbë.

E rëndësishme është që çdo përfaqësues legjitim i Kosovës, të ketë dinjitetin dhe autoritetin që t’i përfaqësojë institucionet e Kosovës në çdo takim ku ai është e mundur që të përfaqësohet si përfaqësues i Republikës së Kosovës.

Sot jemi në një situatë ku kryeministri i vendit ka pasur një takim me kryeministrin e Republikës së Serbisë dhe po ashtu vazhdohet e njëjta logjikë.

Unë atëherë i pata thënë edhe sot i them kryeministrit, unë besoj që kryeministri nuk e shet Kosovën, unë besoj që nuk e ka atë qëllim, përndryshe nuk do të kishte kuptim që ne të jemi këtu. Unë besoj që ne duhet ta kontrollojmë, unë besoj që ne duhet t’i bëjmë presion që të nxjerrin më të mirën e mundshme nga ai dhe ky Kuvend, po në të njëjtën kohë unë besoj edhe angazhohemi që ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbrojmë interesin e Republikës së Kosovës dhe interesin e qytetarëve të Kosovës.

Po diskutohet edhe debatohet se a është dashur të shkohet në diskutime dhe a duhet të diskutohet me Serbinë? Unë jam i mendimit që duhet të diskutohet me Serbinë, por çështja është se kush duhet të diskutojë me Serbinë. A është kjo Qeveria më e mirë e mundshme për të diskutua me Serbinë, a është Kosova në pozitën më të mirë të mundshme të diskutojë me Serbinë, si do të duhej të përfaqësohej Kosova në diskutime me Serbinë? Këto janë dilema për të cilat realisht unë kam mëdyshjet e mia dhe kam probleme për të pranuar se a jemi në situatën më të mirë të mundshme ne që të bisedojmë me Serbinë?

Unë e di se sa i përket legjitimitetit demokratik dhe përfaqësues, kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përballet me sfida, sepse kontestohet legjitimiteti demokratik i

përfaqësimit, sepse vjen si rezultat i një procesi manipulues zgjedhor. Kjo e dëmton aspektin e pranueshmërisë së brendshme, kjo e dëmton po ashtu në aspektin e prezantimit jashtë.

Unë po ashtu e di se kryeministri ndoshta pa fajin e vet, jam i prirë të besoj që pa fajin e vet është dëmtuar dhe dëmtohet nga një rezolutë e Këshillit të Evropës e cila thotë se ndaj tij duhet të fillojnë hetime dhe kjo e dëmton kryeministrin, e dëmton edhe Kosovën. Unë e di që është pa fajin e tij, po në të njëjtën kohë është problem me të cilin duhet përballur.

Po ashtu unë e di që e ka problem të përballët me kryeministrin e Serbisë, jo në aspektin e kapaciteteve përballë, por në aspektin emocional, gjithsecili nga ne do ta kishte problem që të takohej apo të debatonte me kryeministrin e Serbisë. Ne nuk qejf të diskutojmë me ta dhe jam dakord me atë çka e tha kryeministri, mirëpo nuk jemi këtu për të realizuar qejfet tona dhe dëshirat tona.

Unë e di që kryeministri i Republikës së Kosovës e ka për detyrë kushtetuese që të përfaqësojë Kosovën dhe ka për detyrë që ta mbrojë interesin e qytetarëve të Kosovës, po duke i pasur këto probleme lind çështja- a është në pozitën më të mirë të mundshme për të përfaqësuar Kosovën dhe për të marrë pjesë në këto takime të rëndësishme? Unë mendoj që nuk është në pozitën më të mirë të mundshme, unë mendoj se nuk do të duhej që kryeministri i Republikës së Kosovë të futej në të njëjtin nivel me kryeministrin e Republikës së Serbisë, sepse flasin për agresorin dhe flasin për një vend i cili ka pasur një luftë çlirimtare. Këtu është disbalanca ndërmjet përfaqësimit në aspektin politik të përfaqësimit, po edhe në aspektin e përcaktimit dhe të pranimit.

Perceptimi i brendshëm dhe frika qëndron në dyshimin se a do të jetë në gjendje kryeministri i Kosovës që të përfaqësojë në mënyrën më të mirë e të mundshme interesin e Kosovës dhe dyshimi të shumica e deputetëve është i ligjshëm në kuptimin e perceptimit, sepse ka frikë gjithmonë që edhe mund të mos përfaqësohet mirë që është normale, kush do që do të ishte një kryeministër, do të ishte dozë dyshimi, sepse do të duhej t'i jepej kjo dozë dyshimi duke marrë parasysh rëndësinë e çështje të cilën diskutohet.

Është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për të cilën duhet të kemi kontrollin tonë maksimal si institucione demokratike.

Mirëpo, në kuptim të kësaj një hap pozitiv është mundësia e futjes në rezolutë të elementeve kryesore të cilat janë konsideruar si elemente të mundësisë të rrezikimit të interesi i qytetarëve të Kosovës, që i bie: tërësia territoriale, raportimi para Kuvendit, përfshirja e Kuvendit në vendimmarrje në fund të fundit ratifikimi i çfarëdo lloj marrëveshje që vjen nga këto bisedime. Këto janë elemente të kontrollit të cilat realisht sot u cituan dhe u thanë si elemente të kontrollit demokratik të institucioneve dhe mendoj se është e drejtë.

Mirëpo, në kuptimin e besueshmërisë të qytetarëve dhe besueshmërisë të përfaqësisë ka dilema, ka dilema të cilat duhet të jenë gjithmonë në aspekt dhe koncept të rritjes së

vigjilencës. Ne duhet të jemi më të kujdesshëm, sepse nuk mund t'i lejojmë vetes luksin që ndejmë vetëkënaqësi. Ne duhet të jemi më të kujdesshëm, sepse e dimë që kemi situatë specifike të përfaqësimit dhe e dimë që kemi situatë specifike në kuptimin e raporteve me Serbinë.

Dhe po ashtu ne duhet të jemi më të kujdesshëm, sepse rrethanat janë të tilla që Kosova duhet të përfaqësohet dinjitetshëm, duhet të përfaqësohet kujdesshëm dhe duhet të mbrohet arsyeshëm. Këto janë elementet mbi të cilat ne duhet të punojmë dhe kjo është vizioni mbi të cilin ne duhet të orientohejmë.

Prandaj, mendoj se në kuptim të kësaj përfshirja e Kuvendit të Kosovës në konceptin e dialogimit dhe në konceptin e raportimit është e rëndësishme, mirëpo edhe mosbesimi ndaj Qeverisë dhe kryeministrit në këtë rast është legjitim, në kuptimin e vullnetit pozitiv treguar nga përfaqësuesit politik për t'i bërë presion normal demokratik për të dhënë më të mirën e mundshme.

Edhe në kuadër të kësaj ne besoj që do të jemi shumë vigjilent, do të jemi kritik, mirëpo nuk do të jemi patetik, sepse patetizmi i filluar nga vetë kryeministri dhe disa deputetë në pranverë ku u thoshte se po takohej nëpër konferenca pa arsyeshëm ishte patetike edhe atëherë e thashë është patetike po them edhe sot, është e papranueshme, duhet të jemi të arsyeshëm dhe e dimë se koncepti i dialogimit, bisedimit është një koncept të cilën ne si shoqëri e kemi të implantuar 20 vjetët e fundit. Mirëpo, jo të kalojmë na patetizëm në të njëjtën kohë jo të kalojmë vetëkënaqësi, duhet të jemi realist dhe të bëjmë në interesin e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër, fillimisht dua të ju falënderoj për informimin e saktë, përmbajtjesor dhe shumë domethënës për ne dhe qytetarët e Kosovës.

Ne dhe qytetarët e Republikës së Kosovës kem besim të plotë në ju, në udhëheqjen e këtyre bisedimeve në interes të vendit. Ju këtë e keni dëshmuar edhe shumë herë më parë si në Rambuje, në Vjenë dhe në vitin 2008 me rastin e shpalljes së pavarësisë së vendit.

Edhe sot gëzoni mbështetjen e qytetarëve të vendit, Kuvendit dhe shumicës së shoqërisë civile për të udhëhequr bisedimet për normalizim të raporteve mes shtetit tonë dhe shtetit serb.

Jam i bindur se Serbia dhe Daçiçi nuk do të dëshironin t'ju kenë përballë në këto bisedime të cilin fakt e pohoi edhe Ivica Daçiçi.

Qytetarët e Kosovës ju besuan duke ditur qëndrimet dhe aftësitë tuaja udhëheqëse dhe dialoguese, ky është vullneti i qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Se Kuvendi mori vendim të drejtë në seancën e fundit kur votoi rezolutën për normalizim të raporteve me Serbinë, dëshmoi mbështetjen ndërkombëtare që iu dha vendit tonë dhe këtyre bisedimeve nga qendrat e vendosjes ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian dhe së fundi vizita e zonjës Clinton dhe baroneshës Eshton në Kosovë.

Sekretarja amerikane Hilari Clinton, në Beograd është shprehur qartë se Kosova është shtet i pavarur dhe se kufijtë në Evropë nuk do të ndryshohen. Ajo ka dhënë këtë porosi të qartë pas takimeve me kryeministrin serb, Ivica Daçiç dhe presidentin Tomisllav Nikoliq, në shoqërimin e përfaqësueses së lartë të BE-së Ketrin Eshton, mbështetje të cilën ia dhanë Kosovës edhe këtu në vendin tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,
 Rrugë drejtë integritetit në Bashkimin Evropian, sigurisht se nuk është e lehtë dhe kërkon edhe një proces aspak të lehtë, procesin e normalizimit të relacioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Rezoluta e votuar në Kuvend është bazë për fillimin e bisedimeve dhe një proces i normalizimit të relacionit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, gjë e cila duhet të ndodhë.

Ka shumë çështje dhe probleme që janë të hapura ndërmjet dy vendeve sovranë dhe të pavarura dhe këto çështje duhet të zgjidhen me një proces paqësor, meqë Serbia edhe më tutje ka një qëndrim armiqësorë karshi Republikës së Kosovës.

Ne besojmë se me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe të SHBA-së rezultati final i arritjes së normalizimit të raporteve në mes të dy shteteve tona do të jetë në interes të qytetarëve të dy vendeve tona sovranë të Kosovës dhe Serbisë. Dhe do ta mbyll një herë e përgjithmonë një situatë të konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo do t'i krijojë një kornizë për një paqe afatgjate dhe në të njëjtën kohë do të krijojë mundësinë që të adresohen një varg problemesh dhe brengash të qytetarëve të cilat nuk kanë mundur të adresohen dhe të marrin zgjidhje deri më tani.

Është më se e qartë se subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës dhe integriteti territorial, rregullimi i brendshëm i Kosovës, ndarja e Kosovës apo shkëmbimi i territoreve, janë çështje të mbyllura një herë e përgjithmonë, kjo u informua edhe këto ditë.

Populli i Kosovës është fitues në raport me Serbinë, populli i Kosovës është fitues, sepse paqja sot mbretëron në vendin tonë, paqja sot mbretëron në rajon dhe ne të zgjedhur e popullit duhet të punojmë që ajo të jetë afatgjate, nga nacionalizmat e shëmtuar kjo pjesë e botës, rajoni ynë ka vuajtur shumë.

Nacionalistët e prirë në Serbi nga Nikoliqi është lehtë të kuptohen, sepse nuk kanë ndryshuar as formë as në përmbajtje, por pse disa këtu janë bërë promotor të politikës së Nikoliqit e Daçiqit, le ta kuptojnë vetë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: I nderuar kryesues,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Tani me qenë se paraqitja është në nivelin e një informata, është mirë edhe pse po debatohet edhe pse mundësitë për të thanë shumë janë të vogla dhe unë përshëndes shumë kolegë që u inkadruan në këtë dhe unë do të jem shumë i shkurtër në këtë drejtim, ngase paraqitja e kryeministrit sot është një obligim në kuadër të përgjegjësisë edhe s'ka nevojë shumë të falënderohet pse e jep një informacion dhe mirë është që ne vazhdimisht të kemi këtu informacione.

Dhe paralajmërimi se deri më datën 20 shkurt duhet të ketë rezultate konkrete, të gjithë jemi kureshtarë për t'i parë ato rezultate konkrete dhe të flasim me një gjuhë popullore, të gjithë jemi kureshtarë për të parë se a do të ndodhë këtë herë ajo puna e atij borxhliu kur kërkon 1000 euro një thes miell dhe kur e pyet personi pse kërkon 1000 euro- thotë vëlla me t'u dok shumë e me ma dhënë qatë thes miell. Prandaj, ne do të përqendrohemi edhe te thesi i millit edhe te 1000 euro, edhe ajo që është ndarje dhe makro politikë edhe te kjo sjellja dhe qasja e arsyeshme e Serbisë që brenda deri në muajin shkurt do të shihet se është qasje tamam konstruktive, po bën Serbia atë çka është e obliguar dhe nuk ka qare, apo vërtet po ndodhin ndryshime të mëdha në Serbi, pra po ndodhë një ndërrim i mendësisë dhe ndërrim i sjelljes. Dhe nëse deri në muajin shkurt kur parashikohet pra që të jetë një fazë e dialogut ne kemi shuarje të strukturave paralele dhe Beogradi heq dorë nga sponzorimi i atyre strukturave, ne një mend do të themi se tani mund të vijë deri te normalizimi dhe po rrethohemi me një fqinj që tash e tutje në mënyrë konstruktive do të mund të ecet më tutje.

Përndryshe edhe vetë normalizimi po edhe vetë progresi në veri do të marrë edhe shumë vite por së paku deri më 20 shkurt kur Serbia pretendon që të marrë do të thotë datën e anëtarësimit, këto tema për të cilat sot u informuam do të duhet ta kenë rezultatin konkret. Dhe, unë shpresoj se vazhdimisht do të jemi të gjithë të kyçur dhe është në interesin e çdo qytetari të Republikës së Kosovës që t'i kontribuojë këtij procesi për të arritur këto rezultate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hoxhaj e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Kolegë ministra,
Shumë të respektuar deputetë,
Zoti kryesues të falënderoj që ma dhe fjalën,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Dëgjova me vëmendje shumë fjalime dhe shumë sugjerime, të them të drejtën nuk e pata ndërmend që të paraqitem për debat, por ishin disa elemente shumë realizues, ishin disa qasje shumë realizuese të cilat më bënë përshtypje që edhe unë në cilësinë e ministrit të Punëve të Jashtme, t'i them disa qëndrime tona në emër të Qeverisë se si e shohim këtë proces dhe çka nënkupton ky proces për ne.

Më lejoni fillimisht të them që ka disa arsye ose disa premisa, disa parakushte, se pse Kosova do të duhej të hyjë në një proces të normalizimit të relacioneve mes Kosovës dhe Serbisë, cilat janë këto arsye, të cilat janë të dhëna.

Arsyeja e parë është e karakterit edhe historik por edhe e karakterit gjeografik. Është një fakt që nuk mund ta mohojë askush që përkundër Luftës Çlirimtare të vitit 1999, përkundër ndërhyrjes së aleancës së Atlantikut të NATO-së, përkundër shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, ne edhe më tutje e kemi një konflikt të pambyllur me Serbinë. Është një konflikt i hapur mes Kosovës edhe Serbisë dhe është shumë kyç që ky konflikt i hapur, realisht të përfundojë një herë e përgjithmonë dhe mendoj që këto institucione në këtë vit, në vitin 2012 e kanë një përgjegjësi edhe historike dhe politike që një herë e përgjithmonë ta përmbyllin këtë konflikt i cili për 100 vjet ka qenë i pranishëm mes Kosovës dhe Serbisë.

Të njëjtën kohë është edhe një situatë gjeografike, Kosova nuk kufizohet me Kanadanë, as Serbia nuk kufizohet me Finlandën, ne kufizohemi me Serbinë dhe Serbia kufizohet me neve.

Nëse me vendet e tjera të rajonit ne kemi mëri që ta ndërtojmë një fqinjësi të mirë, me Serbinë do të duhej të paktën ta kemi një relacion normal të funksionimit si dy shtete sovranë dhe të pavarura dhe ky relacion normal do të mundësonte që një herë e përgjithmonë edhe të ndryshojë logjika dhe doktrina në Serbi, ekspansionit territorial dhe një diskurs i cili realisht e ka helmuar këtë relacion mes këtyre popujve.

Së dyti, premisa e dytë ose arsyeja e dytë është që me Kushtetutë tonë, me orientime politike të partive tona dhe të shoqërisë tonë, demokracia dhe vlera demokratike janë shtylla e parë mbi të cilat është ndërtuar Kosova.

Prandaj, edhe normalizimi është një kriter ynë i brendshëm si shtet dhe si shoqëri demokratike, po në të njëjtën kohë është edhe një kriter ynë i ardhshëm se ne çdo ditë themi që Kosova ka një orientim euroatlantik dhe dialogu është instrumenti i vetëm që funksionon te të gjitha shoqëritë që kanë orientim euroatlantik.

Ne e dimë që fqinjësia na Ballkan edhe në mes individëve dhe në mes të familjeve është një fqinjësi e cila bart një trashëgimi të rëndë, jo fqinjësi mes shteteve. Për këtë arsye ne do të duhej të jemi shumë të vendosur që në një proces të tillë një herë e përgjithmonë ta ndërtojmë një relacion normal me Republikën e Serbisë.

Të njëjtën kohë është edhe kriter i jashtëm, ne e dimë që normalizimi i relacioneve mes Kosovës edhe Serbisë, është paraparë edhe me studimin e fizibilitetit të prezantuar këtë vit, të prezantuar këtë muaj. Në pikën 3.1 kërkohet në mënyrë tekstuale që të ketë dialog politik për normalizimin e këtyre relacioneve dhe se synimi jonë është që përmes studimit të fizibilitetit ne të nënshkruajmë Marrëveshjen të Stabilizim-Asociimit, nuk mund të ketë nënshkrim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për pa ndodhë ky relaksim dhe ky normalizim i këtyre relacioneve.

Dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është kyçe për ne jo vetëm në kuptimin e integriteteve evropiane, po është mbështetja më e fuqishme që merr Kosova në konsolidimin e sovranitetit të saj të jashtëm, në forcimin e pozitës së saj ndërkombëtare, do të thotë është një parakusht i cili qëndron edhe për ne.

Premisa e tretë është e një natyre strategjike, po në të njëjtën kohë është edhe një filozofi e cila është krijuar në këto 13-14 vjetët e fundit. Kosova asnjëherë nuk i ka ikur dialogut dhe çdo herë në këto 13 vjetët e fundit ne kemi fituar në tavolinë dhe ky ka qenë rezultati i bisedimeve në Rambuje, e njëjtë ka qenë rezultati edhe i negociatave për statusin e Kosovës, që solli pavarësinë e plotë në Vjenë. Por po ashtu një rezultat ka qenë shumë konkret i matshëm edhe në dialogun teknik për të cilin shpeshherë në këtë Kuvend, në këtë institucion është diskutuar me tone më kritike.

Për Serbinë, Kosova ka qenë çdo herë një çështje territoriale dhe arritja më e madhe e dialogut teknik ka qenë dhe mbetet marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit.

Nëse Serbia dhe Kosova arrijnë që ta përdorin një model evropian për demarkacionin e kufirit, kjo do ta ndryshon një herë e përgjithmonë relacionin mes këtyre dy vendeve.

Së katërti, ne jem në një pozitë shumë të favorshme edhe të brendshme edhe të jashtme.

Pozita e brendshme është që mbas largimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare, pavarësia e Kosovës është e plotë, sovraniteti ynë është i plotë dhe pas debatit që ne kishim para disa ditësh në Kuvendin e Kosovës, një proces i tillë është i mandatuar edhe nga vetë Kuvendi i Kosovës nëpërmjet Rezolutës, e cila edhe i ofron parimet, po në të njëjtën kohë edhe i ofron vijat e kuqe për të cilat nuk do të duhej të bisedohet.

Po normalizimin se si ne e kuptojmë në këtë institucion dhe në Kosovë, kuptohet në mënyrën e njëjtën edhe prej partnerëve tanë.

Ne e dëgjuam dje sekretaren amerikane të shtetit e cila tha në mënyrë decisive kur fliste për normalizimin që nuk do të ketë rihapje të statusit të Kosovës, që pavarësia e Kosovës, sovraniteti i Kosovës, integriteti territorial janë çështje të mbyllura.

Po ashtu, ne e kemi një formulim të saktë në strategjinë për zgjerim të Komisionit Evropian, i cili kërkon nga Serbia që t'i normalizojë relacionet me Kosovën duke respektuar integritetin territorial të Kosovës. Do të thotë mënyra se si ne e kuptojmë normalizimin, kuptohet në mënyrën e njëjtë edhe nga miqtë dhe nga partnerët tanë me të

cilët në këto 20 vjetët e fundit ne kemi lëvizur në një situatë progresive shumë të favorshme me kërcime të mëdha kualitative ku jemi sot.

Çka presim nga një proces i tillë? Natyrisht, kryeministri i përmendi të gjitha ato që ne i presim nga një proces i tillë.

Unë isha ndalur vetëm tek ajo ana e jashtme e politikës së jashtme se çka do t'i sjellë ky Kosovës. Do t'i sjell pa dyshim njohjet nga 5 vendet anëtare të Bashkimit Evropian, që s'e kanë njohur Kosovën. Mua më kanë thënë disa ministra të punëve të jashtme të këtyre vendeve, që asnjëherë nuk mund të krijohet një rrethanë në këto 5 vende që këto 5 vende ta njohin Kosovën, një rrethanë e brendshme në këto vende, po mund të krijohet një rrethanë mes Kosovës dhe Serbisë, që këto 5 vende të lëvizin dhe ta njohin Kosovën.

Do të ndodhë integrimi i Kosovës në sistemin ndërkombëtar. Kosova deri më tash është njohur nga pothuaj se gjysma e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, po këto njohje janë bilaterale. Ne bile edhe më tutje nuk jem të integruar mirëfilli në sistemin ndërkombëtar duke përjashtuar Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Prandaj, përmes këtij dialogu ne do ta integrojmë tërësisht Kosovën në sistemin ndërkombëtar dhe të kuptohet që qëllimi ynë është edhe anëtarësimi i Kosovës në OKB, mbi të gjitha, por edhe njohja e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë.

Më lejoni të përfundoj dhe të them që dëgjova disa diskutues që realisht përshkruajnë situata që nuk ekzistojnë. Sidomos përshkruajnë situata të cilat mund të jenë veç meritë e ndonjë imagjinate shumë të zhvilluar se situata të tilla nuk ekzistojnë dhe mendova se si t'i kuptoj këto vlerësime.

Për mendimin tim edhe për politikën si krijimtari mendore, por edhe për politikën si....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Për mendimin tim një narracion që unë e dëgjova sot është narracion i frikës dhe s'ma merr mendja që Kosovën në vitin 2012, ka nevojë ta promovojë kulturën e frikës. Kosova në vitin 2012 ka nevojë ta promovojë kulturën e shpresës, ka qenë kultura e shpresës e cila ka qenë përcaktuese që na ta ndryshojmë rrjedhën e historisë dhe në vitin 2012, ne do të duhej ta kem si orientim tonë edhe më tutje kulturën e shpresës.

Kështu që i ftoj gjithë deputetët, sidomos ata që e mbulojnë edhe politikën e jashtme, që sa herë analizojnë dhe përshkruajnë situatë vërtet t'ju referohen situatave të cilat kanë të bëjnë me realitetin jo situata të cilat janë totalisht imagjinare me të vetmin qëllim që kultura e frikës të jetë kulturë e orientimit tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI: As unë s'do të përmend emra, po substancën.

Kolegët, unë e di që këtu kanë qejf nga pak të gjuajnë fjalë, por është e drejta e atyre, më lejoni që t'i them dy fjalë.

Politika s'është krijimtari, por politika është veprimtari në konceptin universal dhe si e tillë matet me veprimet, me rezultatet e mundshme.

Për sa herë që flasin do të duhej, e shumica këtu themi do të duhej, ne në një farë mënyre moralizojmë ose bëjmë politikë të brendshme me terma më neutrale që i themi si politikë e jashtme dhe kjo është normale, sepse kjo më në fund është një kulturë e diskutimit politik. Kultura e diskutimit politik është send i mirë në çdo situatë.

Ajo që unë dua të nënvizoj edhe një herë është po vullnetet tona politike janë shumë të qarta dhe janë artikuluar gjithmonë, po dëshirat tona, po prandaj unë them çka, çka, çka japim dhe çka marrim na për t'i arritur këto objektiva për të cilat po flasim dhe qëllime, sepse u tha në diskutimin e mëparshëm tri herë edhe pse në mënyrë, pra moralizuese dhe në mënyrë me kulturë, unë po e quaj të diskutimit politik që Serbia bisedon dhe vepron për territore. Edhe sot edhe në këto bisedime, Kosova shkon për të biseduar për interes qytetar, Serbia do të vijë për të bisedua për interes territorial, këtu do të mbërrin dhe ne qofshim me shëndet të gjithë, do ta shohim, ata që ballafaqohen me te, në pikë të fundit do të mbërrijnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zotit Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Përshëndetje pra edhe një herë për të gjithë, Unë nuk do të marrë shumë nga koha e juaj e çmuar pas shumë çështje u shtjelluan këtu, por njëherësh përshëndes edhe kryeministrin, i cili shprehu gatishmërinë të na sqaroj rreth dialogut që ka pasur në Bruksel. Por, edhe në anën tjetër edhe kolegë deputetë që paraqiten një pluralizëm të mendimeve të tyre ngase nga diversiteti i mendimeve përfitojmë të gjithë e veçanërisht duhet të përfitojë diplomacia kosovare kur është në pyetje në raport me bisedimet Kosovë-Serbi.

Sa i përket këtij dialogu në nivel të dy shteteve po e potencoj në nivel të dy shteteve ngase kemi këtë deklaratë edhe nga krerët, qoftë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, që debati zhvillohet në nivel të dy shteteve sovrane.

Patëm edhe deklaratën e para dy ditësh të sekretares të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Hillari Clinton e cila mu në Beograd dhe mu në Prishtinë e theksoi të njëjtën fjalë se Kosova është shtet sovran dhe nuk diskutohet integriteti territorial i kufijve të saj. Prandaj, në këto bisedime hyjmë si shtet sovran dhe pa dyshim se avantazhi është në anën tonë, përparësitë janë në anën tonë, për vetë faktin se jemi viktimë dhe nuk jemi agresori.

Kur përmendi fjalën agresor nuk kam qëllim të etiketoj shtetin e Serbisë apo popullin serb, po flas për një regjim të kaluar milosheviqian që me keqardhje edhe politika aktuale

është si një vazhdimësi i atij regjimi. Prandaj, ne si viktimë në bisedime me agresorin jemi padyshim faqebardhë, jemi në avantazh ndaj tyre ngase ne nuk jemi ata të cilët kemi shkatërruar një gjenocid, një krim, vrasje, dhunime por përkundrazi kemi qenë viktimë.

Sa i përket bisedimeve nuk jemi shteti as i parë dhe as i fundit që bisedojmë me një shtet i cili ka ushtruar agresion ndaj neve. Qysh nga Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore kemi pasur bisedime ndërmjet shteteve të ndryshme, të cilat kanë qenë viktima apo agresore dhe i kanë tejkaluar këto në frymë të mirëkuptimit.

Andaj, në anën tjetër historia jonë më shumë se një dekadë e fundit, konkretisht gjatë konfliktit dhe pas konfliktit të luftës në Kosovë, na jep të kuptojmë se kemi dal fitimtarë qysh nga Konferenca e Rambujesë kur Kosova vetëm ishte në konflikt të armatosur, pastaj nga Konferenca në Vjenë e në dy parë këto bisedime ne fituam dhe fituam jo vetëm pse ditëm të gjendeshim në ato bisedime, por ngadhënjem dhe fituam nga se e drejta ishte në anën tonë.

Andaj, çështja e këtyre bisedimeve nuk duhet shikohet me një pesimizëm, por duhet të jemi optimist të gjithë. E porosia që do të jetë për udhëheqësit të cilët na përfaqësojnë në nivel të bisedimeve do të thotë të mos jenë inferiorë, mos të ndihen të heshtur, por të jemi krenarë për faktin se jemi viktima dhe ata janë agresori dhe nëse ulemi në bisedime assesi nuk barazohet viktima me agresorin, dihet kush ka qenë, por qëllimi jonë është që një herë e përgjithmonë të dëshmojmë se kemi qenë për liri, jemi liri dhe jemi për integritet paqësor dhe liridashës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sadriu e ka kërkuar fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritet për ju për Kabinet qeveritar, për kryeministrin, kolegë deputetë.

E mora fjalën për t'ju bashkëngjitur mendimit të atyre që shprehën këtu se në bisedime duhet shkuar, por në bisedime duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Në bisedime s'duhet të kemi frikë, por duhet të kemi kujdes edhe atë kujdes maksimal.

Përballemi me një rival shumë të papërshtatshëm, një rival i cili dinë të punojë për historinë. Ta përkujtojmë se në një betejë që është shumë e dyshimtë ku s'ka as potkoj as elemente të luftës, Serbia është thirrur në të drejtën mbi Kosovës dhe pas 500 vjet e përdorë atë element historik.

Në dy mekanizmat që sot fatkeqësisht faktori ndërkombëtar edhe miqtë që na kanë ndihmuar dhe po na ndihmojnë, fatkeqësisht edhe kryeministri me një mënyrë e pranoj atë që unë mendoj se nuk është dashur, termi se ne nuk e kërkojmë që Serbia të na njeh ose nuk presim. Serbia këtë e lyp, zoti kryeministër, e lyp të drejtën historike në periudha, në rrethana të përshtatshme thotë se Kosova më është marrë. Derisa Serbia nuk kërkon falje, derisa Serbia nuk e korrekton historinë apo Kushtetutën e vet brenda të cilës është territori i Kosovës, gjithsesi ëndrra për Kosovën, ata po e thënë publikisht, por nuk do ta shuajnë këtë.

Dhe të mos harrojmë se Serbia me këto luftëra ka mbërri shumë. Serbia e ka marrë një pjesë të madhe të Bosnjës, tani po e quan Sërpska Bosnja, po tenton dhe është në rrugë për ta faktorizuar atë për ta bërë subjekt juridik.

Ne ishim në një takim regjional para 2-3 ditësh dhe atje u prezantua pos Serbisë edhe Bosnjës Federale, u prezantua edhe Sërpska Bosnja, do të thotë ajo ka marrë shumë, ajo pretendon përmes veriut ta bëjë shtetin tonë jo funksional.

Prandaj, arsyet për të frikuar, arsye për të qenë ndoshta jo për të frikuar, por për të qenë shumë syçelë dhe shumë unik, janë më shumë se kurdoherë. Andaj, ju apeloj të gjithë ata që kanë ndikim të përkujtojnë se këto janë momente historike që nuk falen, nuk ju falen as brezave të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, zëvendëskryeministri e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që të japë disa observime lidhur me temën e sotme.

Ndoshta në fillim dua të nis me atë që tha zoti Hyseni që dialogu tanimë ka filluar dhe unë e kuptoj shumë drejtë besoni edhe Qeveria e Kosovës dhe gjithë ne do ta citoj në mënyrë literate që jo frikë nga dialogu, por jo dialog pa frikë. Unë e kuptoj këtë përgjegjësi dhe besoj që secili prej nesh duhet ta kuptoj si një përgjegjësi që duhet ta kryejmë në momente të caktuara. Natyrisht që kemi qenë në mes të dy dilemave.

Dilema e parë ka qenë që të kemi presion nga një dialog që po ndodhë tani dhe dilema e dytë që të kemi presion nga një status quo që e ka Kosova edhe me BE-në edhe në OKB, por edhe në zhvillime që mund t'i kemi brenda dhe jashtë Kosovës në rajon. Dhe kemi menduar që status quo-ja është më e vështirë, është presion më i madh dhe i më papranueshëm për ne se sa të fillojmë një dialog dhe mendoj kjo ka qenë zgjidhja, nuk ka qenë ajo që ne t'i aplaudojmë dhe të themi sot se mezi që po presin që ka thënë disa herë edhe kryeministri.

Natyrisht duhet të them edhe një fakt, kërkesa për dialog del edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, nga BE-ja dhe SHBA-ja dhe nëse partnerët tanë ndërkombëtarë bën një kërkesë të tillë edhe për ne edhe të tjerët unë mendoj që ne duhet të jemi të dëgjueshëm në kuptimin pozitiv, ngase shumë qëllime i arrijmë bashkë.

Po edhe një fakt dua ta them historik, që gjithë jemi këtu. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rezistenca e armatosur është kuptuar shumë më drejtë pasi është shfrytëzua rezistenca paqësore. Dhe, unë jam shumë i bindur që edhe nëse e kemi ndërmend t'i shpallim luftë nesër Serbisë, duhet filluar sot me dialog dhe kjo është një prej rrugëve, një prej qëllimeve që secili prej nesh është dashur dhe duhet ta shfrytëzojë.

Unë e di që secili prej neve e ka dilemën si të veprohet më tutje edhe do të mundohem të japë disa përgjigje të cilat nuk janë të sakta, me siguri që nuk jemi vetëm një aktor, por disa përgjigje që ne mund t'i paramendojmë bashkërisht.

E para, jemi shumë të interesuar për aktorët e bisedimeve dhe aktorët tani më janë definuar si subjekte edhe nga Kosova, edhe nga Serbia, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare, BE-ja dhe SHBA-ja, dhe ky fuqizim u pa edhe në vizita që ka ndodhur edhe në Kosovë e Serbi dhe në rajon, po edhe aktorët brenda për brenda nesh.

Aktorët brenda nesh duke filluar nga kryeministri kanë punuar dhe punojnë vazhdimisht që ta kenë legjitimitetin e plotë dhe të duhur.

Dhe, Rezoluta e Kuvendit të Kosovës e ka dhënë atë legjitimitet. Ai legjitimitet është më shumë se koalicioni qeverisës dhe është bërë mirë, është një rast i mirë t'i falënderojmë jo vetëm deputetët e koalicionin qeverisës, por edhe ata të LDK-së, të AAK-së dhe të tjerët që e kanë dhënë një mbështetje të tillë, ngase veprimet e tilla nuk lidhen me një mandat qeverisës, nuk lidhen me një individ, por lidhen me procese që mund t'i trashëgojnë gjeneratat që do të vijnë.

Çështja e dytë është, te temat.

Ne duhet ta kem parasysh që temat i propozojmë ne, shpeshherë dikush i sheh si tema, dikush si kushte, ta dimë që edhe të tjerët janë aktorë edhe ata propozojnë tema në këtë rast Serbia, po ta dimë që është dikush tjetër që i harmonizon këto tema, në këtë rast janë BE-ja dhe SHBA-ja dhe ne duhet të punojmë në partneritet me ata që temat tona dominojnë gjatë këtij procesi.

Çështja e tretë është afati. Ne duhet të punojmë shumë dhe të insistojmë që ta kemi një afat kohor për këtë dialog.

Afati kohor mendoj që duhet të jetë i përafërt me atë që ruan legjitimitetin e negociatave apo dialogut. Nëse zgjasim në pafundësi me siguri që legjitimiteti zbehet, pastaj humb efekti i këtyre takimeve dhe mbi të gjitha unë do të thosha që hap dilema që a duhet të shkojmë më tutje apo jo. Dhe kryesore çka është rezultati?

Rezultati është mirë që është vendosur me 2/3 në Kuvendi e Kosovës dhe ky është një presion pozitiv mbi Qeverinë, është një presion pozitiv mbi ata që shkojnë me bisedua dhe është një presion pozitivë edhe mbi aktorët të tjerë ngase ne e dimë që duhet që të vijmë në Kuvend dhe t'i fitojmë 2/3 e këtij Kuvendi.

Ne e kuptojmë legjitimitetin jo vetëm ditën që e ke fituar të drejtën nga ky Kuvend për ta vazhduar dialogun, por për ta vazhduar dialogun tërë kohën sipas asaj dite që ju keni menduar dhe informata që e ka bërë kryeministri me liderët e LDK-së, të AAK-së, të subjekteve tjera politike edhe të Lëvizjes për Bashkim, gatishmërinë edhe me "Vetëvendosje", ta bëjmë një gjë të tillë, ka qenë që ta ruajmë këtë legjitimitet edhe gjatë këtij procesi.

Unë e kuptoj reagimin edhe të atyre që janë kundër, sinjerisht po e them dhe unë mendoj që reagimi duhet të jetë në këtë drejtim. Një fjalë e ortopedëve thotë: “Kurrizi duhet të drejtohet, po jo thyhet” Duhet të jetë ai presion i atyre që kundërshtojnë dialogun jo që na e thyjnë kurrizin, po presioni që ne e shfrytëzojmë para tjerëve duke thënë, ka në vendin tonë edhe njerëz tjerë që mendojnë më ndryshe dhe ata njerëz janë në presion për lëshimet eventuale që mund t’i kërkojë dikush ndaj nesh.

Unë dua të hyjë pak edhe në çështje që ka të bëjë edhe me spektrin tjetër edhe me spektrin jashtë politik. Neve na interesojnë tri lloj opinionesh, ato që vijnë nga grupet e interesit, është fjala partitë politike, shoqatat e ndryshme, qoftë veteranëve, të ish-burgosurve politikë, nga shoqëria civile dhe të tjerët, na interesojnë shumë mendimet që vijnë nga qytetarët e rëndomtë dhe ato që vijnë nga ekspertët.

Dhe unë jam shumë i bindur që në këtë dialogim do të marrin pjesë edhe ekspertët dhe të tjerët, nuk do të jemi ai zë i shurdhër që nuk e vëmë një gjë të tillë para vetes.

U përmendën çështja e harmonizimit të brendshëm, nëse më lejohet ta kuptoj drejt profesor Hamitin dhe atë të jashtëm dhe unë pajtohem në tërësi. Ne nuk mund ta ruajmë po e quaj kështu konsensusin ndërkombëtar, në raportin me dialogimin nëse nuk e ruajmë konsensusin e brendshëm dhe në raport me vetveten. Dhe harmonizimi i brendshëm duhet të jetë parakusht për harmonizim të jashtëm, por edhe harmonizimi i jashtëm na bënë një trusni pozitive për ta ruajtur harmonizimin e brendshëm. Dhe unë besoj që gjithë ne edhe sot që po bisedojmë këtu duhet ta kemi parasysh, ne jemi ata që duhet na korrektoni, ne jemi ata që duhet të jemi partner me ju, ne jemi ata të cilët duhet t’i bëjmë edhe veprime që të prezantojmë atë që secili prej jush do të thoshte do ta bëjë edhe unë të njëjtin gjë.

Por njëkohësisht duhet ta kemi po ashtu parasysh që ne jemi ata që marrim pjesë, jo një lloj sandviçi, nuk jemi ne në mes jush ose në mes të qytetarëve dhe dikujt tjetër po jemi në një anë, në një veprim. Natyrisht, në proces së sipër ne mund të lëvizim dhe mbi të gjitha informata, gatishmëria për informatë duhet të kuptohet si gatishmëri për ta ruajtur legjitimitetin, gatishmëri për transparencë dhe gatishmëri për fuqizim tonë. Dhe ne si çdo informatë jona e kryeministrit, shfrytëzohet për ta dëmtuar këtë harmonizim të brendshëm, atëherë mendoj që nuk i sjell shumë dobi sa dëm dhe mbi të gjitha edhe Qeveria, por edhe gjithë ne nuk duhet t’i harrojmë punët e përditshme.

Nuk guxojmë që në emër të një dialogu tani të harrojmë që duhet të punojmë më shumë edhe për rend e ligj, për zhvillim ekonomik, për harmoni të brendshme dhe çështje të tjera, ngase një veprim i tillë do të ishte një dëmtim dhe subjektiviteti që e kemi brendapërbrenda dhe në fund të fundit ne dëshirojmë që ta prezantojmë një shtet të fort, jo ta prezantojmë, ta citoj pak Alma s’qenka këtu Makiavelin te princi thoshte shkonte me kokë lart se prapa e kishte një ushtri të fortë. Ne duhet të shkojmë me kokë lart atje, koka e lartë shkon nëse e ke një shtet stabil të organizuar, institucione formale e kështu me radhë. E kundërta e saj na krijon pastaj telashe edhe me ata që shkojnë.

U përmenden edhe disa raste që s’kisha pas dëshirë por duhet t’i përmend.

E para, te njerëzit që tha zoti Gashi, nuk po e supozoj fjalinë, por po e them. Zoti Gashi e përmendi legjitimitetin e njerëzve që duhet të jenë aty dhe me të drejtë e përmendi, por unë po e them një. Kryeministri i Republikës së Kosovës, nuk është me rëndësi kush e ka emrin, por është kryetari i partisë politike më të madhe në këtë vend dhe unë mendoj që është e natyrshme që ai njeri ta prezantojë vendin kudo që të jetë.

Por unë besoj që në këtë legjitimitet në përqindje të caktuar ka të drejtë të merr pjesë dhe kemi bërë ftesë dhe sot po e them publikisht edhe LDK-së, edhe AAK-së edhe “Vetëvendosjes” edhe gjithë ekspertëve, që ta japin kontributin e tyre në grupe punuese apo edhe një trup formal koordinues bashkërisht jo të jetë subsitut i Kuvendit apo i Qeverisë, por ta kryej punën e vetë sipas kompetencave që mund t’i ketë.

Çështja e dytë është, për dallim prej herëve tjera, për herë të parë në këtë vend 2007 e tutje është kryeministri njeriu që i ka fituar votat më së shumti partia e tij, unë mendoj këtë duhet ta ruajmë. Dhe mbi të gjitha duhet ta kem parasysh edhe një fakt, njerëzit me legjitimitet qytetar duhet, ata që shkojnë sipas atyre zgjedhjeve që unë i konsideroj shumë demokratike, shumë fer, shumë legjitime, bile mund të them që janë parti politike kryesore më shumë e më pak ne jemi që nga 12 vjet, që po sillemi këndej pari, jam i bindur që prapë do të jenë njerëz të caktuar që mund ta bëjnë një veprim të tillë.

Sa i përket individëve që po përmend me njerëz. U përmend rasti i Daçiçit, unë e di që ne se kemi zgjedhur atë dhe po të na pyesnim neve s’e kishim zgjedhur. Po një fakt duhet ta kem parasysh dhe duhet t’i themi edhe kryeministrit edhe mua edhe kushdo që shkon, edhe sikur të ishte dikush në Qeverinë e Serbisë që e ka fitua Çmimin Nobel për paqe, nuk ndërron qëndrimi jonë, nuk është qëndrimi jonë ai është burrë i mirë ose burrë i keq duhet të takojmë apo jo.

Qëndrimi i Republikës së Kosovës, interesit tonë nuk ndërron nga pozita që mund t’i ketë dikush në Qeverinë e Serbisë, hiq më mirë s’kemi menduar në raport me Serbinë kur ka qenë Tadiq ose dikush tjetër. Por, ne kemi telashe me Serbinë, me sovranitet, me tërësi territoriale, me forcat e sigurimit dhe tjera që i bën në Kosovë, nuk kemi telashe me individë në Serbi. Kënd t’ua merr mendja atyre le ta zgjedhin, ja pafshin hairin po ne do ta kemi qëndrimin e njëjtë.

Një çështje tjetër që u përmend dhe duhet t’i përmend edhe dy fakte, takim kriminal, nuk është takim kriminal. Nëse thoni që është bërë takim mes dy kryeministrave në zyrën e Qendrës së Evropës në Bruksel, nëse shihni që ndodh mbas një rezolute në Kuvendin e Kosovës dhe t’i thuash takim kriminal është e rëndë, takim kriminal është aty ku takohen njerëzit mu marrë vesh ta mbysin dikën të ndodhë ndonjë veprim tjetër ose tinëz, nuk ka ndodhur tinëz krejt bota i ka parë fotografitë, por duket zoti Kurti nuk e ka pa mirë se po thoni ka pasur flamur të Serbisë, nuk ka pasur. Fotoja është duke qarkulluar në krejt botën. Unë ftoj që ta analizoni atë foto, t’i shini shenjat, t’i shihni flamujt. Prezantimi për herë të parë ka qenë i barabartë dhe ka qenë në suaza të normales.

Nuk dua ta kuptojmë tash atë si takim personal. Qeveria e Kosovës mund të ketë arsye për kritika, por arsyet tona për kritika në raport me Serbinë nuk besoj që duhet të jenë aq të forta se më shumë a pak njerëzit nuk mendojnë ndryshe.

Më lejoni që të them që ne duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi dhe këtë koncentrim ndërkombëtar. Koncetrimi i vizitave që bëhet edhe në Kosovë dhe në rajon i momentumit që ndodh momentalisht ta ndryshojmë status quo-n që na ka bllokuar, s'po them na ka ngulfatur në raport me BE-n dhe OKB-në dhe në këtë rast besoj që të gjithë pastaj përfitojnë qytetarët e Kosovës dhe mbi të gjitha përfitojnë gjeneratat që do të vijnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi dhe zoti Ymeri janë lajmëruar për replikë.

ARBEN GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Veç desha t' i them zotit Kuçi se unë potencova realitetet politike që diskutohen në politikën e brendshme të Kosovës, pa ndonjë lumturi të madhe pse kryeministrit të vendit tonë i cili e përfaqëson vendin tonë në takim me kryeministrin e Serbisë, i cenohet autoriteti i legjitimitetit demokratik, unë nuk jam i lumtur pse ndodh ajo dhe absolutisht nuk ndihem mirë për atë punë. Dhe po ashtu të njëjtën kohë unë e di se kryeministri e ka për detyrë kushtetuese dhe duhet ta përfaqësojë dhe ta mbrojë Kosovën kushdo që të jetë ai dhe jam shumë dakord me ju se a është Hashim Thaçi apo kush është ai, nuk ka rëndësi, e rëndësishme është që Kosova duhet të përfaqësohet me dinjitet. Ka shansin që të jetë superiore ndaj Serbisë dhe duhet të jetë e tillë dhe të sillet si e tillë dhe po ashtu jam i bindur se ne duhet të ndërtojmë një Kosovë e cila është demokratike që është e dinjitetshme, e zhvilluar dhe në kuadër të saj jemi në pozicion shumë më të mirë për të diskutuar me cilindo, e përsëris me cilindo që është i interesuar të diskutojë me Kosovën në çfarëdo lloj situatash, diskutimin e kam parasysh në aspektin diplomatik, në aspektin politik po nëse është nevoja edhe siç thatë ju për të shkuar edhe te aspekti luftarak në diskutim me argumentet e forcës edhe ushtarake.

Po kuptimi i kësaj çka thashë unë është legjitimiteti demokratik që realisht, fatkeqësisht e ka të cënueshëm dhe të sulmueshëm, nuk jam po e përsëris i kënaqur pse e ka këtë situatë dhe nuk do të duhej të ishte i kënaqur asnjë qytetar i Kosovës, sepse në këtë rast nuk flasim për Partinë Demokratike të Kosovës, nuk flasim për Hashim Thaçin, po flasim për Kosovën përballë Serbisë dhe Kosova përballë Serbisë duhet të jetë e dinjitetshme, duhet të jetë demokratike dhe duhet të jetë e mbrojtur dhe e pacënueshme dhe në këtë rast në këtë kuptim unë mendoj se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, replikë.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Së pari se u përmend që unë e përmenda që është takim kriminal edhe vazhdoj ta mendoj si të tillë, është takim kriminal për shkak se është takim me Daçiqin, i cili është kriminel lufte. Po jo të gjithë serbët janë kriminelë lufte, natyrisht dhe ka njerëz shumë në Serbi,

që nuk janë kriminelë lufte, po Daçiqi është. Daçiqi është kriminel lufte sikur Milosheviqi, sikur Karaxhiqi edhe të tjerë.

E dyta, është takim kriminal për shkak se përmes këtij takimi që e nis dialogun politik, po vritet shtet ndërtimi i Kosovës, mundësi për shtet ndërtim në Kosovë, natyrisht që është takim kriminal, ky. Natyrisht që është takim kriminal për shkak se po faktorizohet Serbia, pra po pyetet Serbia për çështjet e brendshme, natyrisht që është takim kriminal për shkak se po normalizohet prania e strukturave ilegale kriminale të Serbisë, në Kosovë përmes këtij takimi. Po këto gjitha e bëjnë këtë takim kriminal edhe dialogun politik e bëjnë kriminal.

Duhet t'i bëhet me dije haptas botës se kush është Daçiqi, po këtë nuk po e bënë Qeveria e Kosovës. Pra, Daçiqi e Nikoliqi në Serbi janë shans për Kosovës, për ta refuzuar dialogun, mirëpo këtë nuk po e bën Qeveria e Kosovës, fatkeqësisht.

E tha po ashtu zëvendëskryeministri që dikush i sheh si temë, dikush si kushte, po kjo është absurde. Pra, nuk është çështje perceptimi këtu, kushtet dallojnë prej temave, kushtet janë diçka që duhet të plotësuar para se të nisë procesi dialogues, ndërkohë që me tema, ti për ato që do të duhej të ishin kushtet po shkon po e pyet Serbinë, pra në një farë mënyre po i kërkon Serbisë, po i lutesh Serbisë, aman të qoftë, plotësoni një pjesë të tyre temave që unë po i hap.

Edhe çështja tjetër, nuk mund të ketë rend edhe ligj në veri dhe njëkohësisht dialog për veriun, pra këto të dyja nuk shkojnë bashkë. Edhe kryeministri i Kosovës, në takim me kryeministrin e Serbisë, në fakt janë marrë vesh që nuk do të ketë veprime të njëanshme, të paktën kështu ka dalë nëpër media dhe nuk u demantua këtu. Pra, kur nuk që nuk ka veprime të njëanshme atëherë nuk do të ketë kurrfarë tentimi për ta ushtruar sovranitetin institucional në veri nga Kosova, përderisa të merren vesh me Serbinë.

Dhe, çështja e fundit, se u përmend këtu disa herë. Daçiqi në takim, prapë sipas mediave ka thënë që Kosova është e imja, po aq sa është e jotja, i ka thënë kryeministrit Thaçi dhe përgjigja e Hashim Thaçit ka qenë që prandaj e kemi dy shtetësinë, ndalu veç pak dyshtetësi për kryeministrin e Serbisë, a është kjo domethënë a është pranuar?....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, kundër-replikë, një minutë e ke.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Ymeri nëse thoni që kryeministri i Kosovës është takuar me një kriminel, mund ta ndaj mendimin, po nëse thoni takim kriminal, ti po i përfshin krejt dhe ky është dallimi që duhet ta bëjmë gjithë ne.

Në anën tjetër, mendoj po ashtu ju i përmendni kushtet dhe temat. Mos harroni që njeri bën dialog me atë që ka telashe, zakonisht me atë që i ke punët mirë nuk ke nevojë të hysh në dialog, por merresh vesh shumë shpejtë.

Ana tjetër që është raporti me kushtet edhe temat. Kushtet, ai që ka fuqi vë kushte dhe duhet të jemi kështu plotësisht të vetëdijshëm. Ne nuk po kemi fuqi që 5 shtete të BE-së t'i shtimë të na njohin, nuk po kemi fuqi që ta zhbllokojmë çështjen në OKB, ne po i kemi partnerët tanë ndërkombëtarë që e kemi fuqinë edhe kohezionin nacional dhe partneritetin e tyre që po kërkojnë BE-ja dhe SHBA-ja, ku i kemi shpresat më të mëdha për një veprim të tillë dhe këto janë çështje që duhet t'i bëjmë.

Përndryshe nëse themi që Daçiqi është kështu, kështu krejt Kuvendi, krejt Kosova qohet në këmbë dhe hiq s'e ndan mendimin, bile ka njerëz që thonë edhe ma keq se ju. Po logjika është që ne po shkojmë me një përfaqësues të një shteti që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e ka kërkuar fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Anëtarë të Kabinetit,

Nuk desha të flas, realisht, por kjo çështja e debatit të dialogut në këtë fazë të procesit dhe tendenca që t'i jepet drejtim nevojës së dialogimit për të kapitalizuar qëllime politike, mendoj që në tërësi e dëmton procesin si të tillë.

Kosova e ka një histori të angazhimeve në këto procese. Tash po flitet për një dialog të normalizimit që natyrisht nuk është i lehtë dhe nuk do të jetë aspak i lehtë për të arritur rezultate dhe së paku, nuk presim rezultate ku ta dimë çfarë rezultatesh. Por, ajo që sot duhet të potencohet është së për herë të parë është ndërtuar njëloj dialogu i brendshëm dhe tendenca që këtë dialog për ta shtrimë në institucion, për ta mbërri një konsensus sa më të madh, sa më të gjerë, në mënyrë që temat në interes të Republikës dhe të vendit të shkojnë përpara.

Kundërshtues të dialogut ka pasur gjithmonë dhe kundërshtues të dialogut do të ketë gjithmonë, sepse ne jemi të prirë të besojmë ashtu dhe jemi të prirë për t'i dhënë kahe në këtë drejtim, por mendoj që është jashtëzakonisht e rëndësishme që dialogun të mos e dëmtojmë në proces, sepse është mjeti i vetëm politik dhe më efikasi, qoftë ajo para, qoftë pas konflikteve, para luftës apo pas luftës, detyrimisht palët duhet të ulen dhe t'i zgjedhin problemet përmes një mekanizmi të dialogut.

Tani unë e shoh këtë proces në kuadër të parimit apo kritereve të Kopenhagës, si proces normalizimi, i cili mundëson fillimin e zgjidhjes së problemeve, natyrisht, që marrëdhëniet e Kosovës dhe Serbisë mbesin marrëdhënie lufte. Dhe, nëse pyesim tash kush është që të fillojmë t'i zgjidhim këto probleme ka edhe të atillë që e kundërshtojnë, por marrëdhëniet e luftës nuk rregullohen ndryshe pos duhet ta gjejmë një ditë, e cila e kthen procesin në drejtim të normalizimit dhe fillon gradualisht zgjidhjen e problemeve.

Unë sot në mëngjes bëra thirrje të fillojë të zbardhet, sepse 12 vjet pas luftës Kosova ka ende probleme serioze dhe një numër i madh i problemeve duhet të zgjidhen edhe nëpërmjet mekanizmit të dialogut.

Ajo që neve na bie në përgjegjësi t'i zgjidhim vetë si institucione, duhet t'i zgjidhim vetë, ndërsa pjesën tjetër duhet gjetur mënyrën për zgjidhjen e problemeve dhe për t'i zbardhur problemet, për t' i ndriçuar deri në fund. Drejtësia e vonuar duhet të vijë në vend dhe natyrisht, bie mbi përgjegjësinë e plotë. Qeveria e ka një mandat, tash, për mandatin që ia ka dhënë Rezoluta, nuk është mirë të bisedohet, ai mandat është i plotë. Shenjë e mirë që ka filluar ta respektojë, pika e pestë ka filluar të zbatohet. Ky njoftim i sotshëm gradualisht do të shkojë drejt një raportimi dhe në fund duhet shfrytëzuar mekanizmin e ratifikimit, sepse votat e dy të tretave do të vendosin në fund, a ka vepruar apo s'ka vepruar Qeveria mirë?

Unë e kam dëgjuar intervistën e kryeministrit serb. Ne po bëjmë keq që po ia përmendim emrat shumë në institucionet e Kosovës. Të them të drejtën, është jashtëzakonisht i ngarkuar ky institucion me emra të tillë. Duke dashur ta denigrojmë kryeministrin tonë, ose ministrin tonë, ai e përmendi emrin e atij që s'duhet t'ia përmendim. Ai ka thënë tekstualisht: "Unë e kam marrë pushkën dhe kam luftuar kundër asaj klase politike në Kosovë". Nuk ka thënë kundër asaj qeverie. Ka thënë kundër asaj klase politike në Kosovë. Ai e pranon me krenari që ka luftuar. Tash, ne duhet ta shohim vetë nga ana tjetër, çka kemi vepruar ne në atë kohë për t'i realizuar qëllimet tona. Dhe, natyrisht që edhe kjo palë ka pasur armë në dorë dhe ka pasur mekanizmin e dialogut në dorë edhe ka pasur rezistencë aktive në dorë, për t'i realizuar qëllimet e veta.

Kush ka dalë fitues? Ai është fituesi i cili e ka fituar të drejtën e vet. E drejta jonë e fituar në këtë proces duhet të vulozet, duhet gjetur rrugën të vulozet. Unë e di, që proceset e dialogut nuk janë të popullarizuara, absolutisht, sidomos me Serbinë, por është rrugë me një drejtim, problemet duhet zgjidhur dhe sa më shpejtë të ndahemi me ta, është më mirë.

Ju e dini që unë besoj ndryshe, që duhet zgjidhur këto probleme dhe po e rezervoj sot të drejtën për ta ngarkuar më shumë, por besoj shumë, se në fund duhet për t'u ndarë edhe me territor edhe me gjithçka me ta, në mënyrë që të mos kemi më probleme, që do të na mbesin si guri në qafë përjetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Kur dëgjohen disa fjalime narrative për zhvillimet politike, të sjellin në meditim se mos po flitet për fenomene galaktike. Të flasësh për galaksinë edhe mund të ndërtohet fjalime hipotetike dhe kush mund ta dijë sa kohë të duhet për të vërtetuar përceptcionin ireal. Simetria e trupave në galaksi dhe asimetria e lëvizjeve të tyre edhe për një pjesë të trupave, tek e kundërta, asimetria e trupave dhe simetria e lëvizjeve, mund të përshkruhen sipas fantazisë pseudo-shkencore, por kjo nuk mund të bëhet për zhvillime politike, për të cilat jemi dëshmitarë.

Disa përshkrime të zhvillimeve politike bëhen sikur përcepcioni i trupave gjeometrik, në formë asimetrike nga një gjendje dhe pozicion i kundërit statik. Dhe, përshkrimi del natyrisht, subjektiv.

Kjo përshtypje të ndryshohet kur dëgjon fjalën e kryeministrit, të shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ndonjë tjetër këtu, që pastaj menjëherë të imponohet ideja dhe përkufizimi se kjo temë, raportet me Serbinë, do të duhej t'i bashkonte pozitë dhe opozitë, jo nga dashuria për temën, sa nga ndjesia e saj, që do të duhej të jemi së bashku, për ta plotësuar njëri-tjetrin.

Raportet historike Kosovë- Serbi, mund t'i përshkruajnë edhe nxënësit e shkollës fillore, e lëre më ne. Koha e goditjeve të hegjemonizmit të Serbisë kishte mobilizuar pjesët vitale të popullit tonë, që i përmendi me mjaftë simbolikë dhe mjaft përmbajtësish dikush prej kolegëve këtu. Dhe, e ka mobilizuar gjithashtu edhe pjesën më vitale të ndërgjegjes emancipuese qytetare dhe për 78 ditë, nga toka, uji dhe ajri, koordinoheshin aksione nga teknika dhe teknologjia e aspekteve fantastike-shkencore, që asnjëri prej nesh, para se kjo të ndodhte nuk ka mund ta marrë me mend.

Dhe, natyrisht se tani ka ardhur gjendja që ne duhet të bisedojmë. Në bisedime, nuk dua t'i përsëris të tjerët, shkojnë njerëz legjitim. Unë kisha pasur dëshirë të jem unë vetë, për shembull, aty, të më rrokin kamerat, të bëhem personalitet historik, mirëpo qytetarët kanë vendosur për dikë tjetër. Dhe, tani ne natyrisht se duhet të pajtohemi, që një njeri, pa dashur t' i hyj

në qejf tash kryeministrit, pa dashur t'i bëj elozhe dhe pa dashur të lëshohem në një nivel, që mund të bëhet pak e diskutueshme, doemos që duhet ta pranojmë dhe bashkëpunëtorët tjerë dhe i plotësuar edhe nga subjektet politike të përgjegjshme dhe natyrisht serioze, që kanë treguar gjatë historisë së veprimit të tyre dhe shoqërisë civile dhe të tjerëve, nga Akademia dhe të gjithë ata, që duan të kontribuojnë në këtë temë dhe në këtë proces, natyrisht se e begatojnë procesin e bisedimeve, që është i pakusht dhe i paalternativë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqi e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKI: Faleminderit, nënkryetar!

Pas fjalimit me humor të kolegut tim Krasniqi, nuk do ta zgjas, por vetëm do t'i jap mbështetjen time si deputete e këtij Kuvendi, duke thënë se nuk duhet të paragjykojmë rrjedhën e proceseve, por duhet të punojmë që proceset të përfundojnë mirë. Dhe, që proceset të përfundojnë mirë, duhet bashkërisht të punojmë dhe t'i japim mbështetje edhe deklaratave të sekretares Klinton dhe baroneshës Eshton, që të mbështesim pra, Qeverinë e Kosovës dhe kryeministrin Thaçi, në të gjitha proceset integruese për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Po ashtu, do ta mbyllë me fjalën e profesor Hamitit, i cili tha më herët se ende vendi ynë ka nevojë për unitet politik dhe e konsideroj, që uniteti politik arrihet nëse edhe një pjesë e opozitës politike këtu, që kemi në sallë, arrin të ndahet nga fryma e kundërshtimeve të vazhdueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatohet që edhe ky debat është i përfunduar. Nuk ka tjerë të paraqitur. Shpresoj që ishte me vend, ishte i mirë edhe përkundër mospajtimeve.

E kemi pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. Ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Agani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetohet projektligjin.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Në kuadër të pakos legjislativ reformuese dhe në përgjigje të kërkesës së Inspektoratit Sanitar, sfidave që dalin nga Raporti i Progresit, rekomandimeve të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës dhe shqetësimeve të organizatave partnere si: Organizata Botërore e Shëndetësisë; UNICEF-i; dhe shoqëria civile, Ministria e Shëndetësisë ka projektuar dhe hartuar Projektligjin për kontrollin e duhanit, i cili në fakt paraqet amendamentimin e ligjit në fuqi, për kontrollin e duhanit.

Ky projektligj, i cili sot është para jush për shqyrtim, ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasoja shkatërruese, shëndetësore e sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit.

Projektligji synon uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës, që është prioritet i parë i Ministrisë së Shëndetësisë, sipas planit të veprimit për zbatim të strategjisë sektoriale 2011 - 2014.

Me këtë projektligj përcaktohen masat për ndalimin, kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit, përbërëse të duhanit, parandalimin e pasojave të dëmshme nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit.

Projektligji është një dokument i guximshëm dhe shumë i rëndësishëm. Ai përfaqëson një mundësi kritike për vendimmarrësit e Kosovës, institucionet dhe agjencitë për zbatimin e tij, për të demonstruar qartë se shëndeti i popullatës në Kosovë, para së gjithash i fëmijëve, të rinjve dhe shtatzënave është më i rëndësishëm se çdo interes komercial, ekonomik apo politik.

Projektligji për kontrollin e duhanit përfaqëson një mekanizëm të mirë, që t'i ndihmojë Kosovës të largohet nga përqindjet e larta të duhanpirjes, meqë kërkon një ndalim 100% të pirjes së duhanit, në hapësirat e mbyllura publike, në hapësirat e mbyllura të punës, mjeteve të transportit publik dhe në disa hapësira të hapura. Vendosi gjëja më të mëdha

për bizneset dhe individët që e thyjnë ligjin dhe e fuqizon rolin e Policisë së Kosovës dhe inspektorateve në zbatimin e ligjit.

Projektligji, po ashtu, inkudron edhe Agjencinë Kosovare kundër Korrupsionit, në parandalimin e konfliktit të interesit dhe ndërveprimit midis industrisë së duhanit dhe institucioneve qeveritare.

Ndalimi i 100%-të i duhanpirjes në vende të mbyllura publike, vende të mbyllura të punës, në transportin publik dhe në vende të tjera publike, të hapura apo kuazi të hapura, paraqet esencën e ndryshimit midis ligjit në fuqi për duhanin dhe projektligjit të sponsoruar për kontrollin e duhanit, i cili gjendet para jush.

Më lejoni të theksoj se kjo masë tashmë është ndërmarrë në shumë vende të botës, përfshirë edhe vende që njihen si prodhuese të mëdha të duhanit, siç është Turqia dhe Brazili. Dhe, si masë është në koherencë të plotë me nenin 8 të Konventës- kornizë, për kontrollin e duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila kërkon që palët të ndërmarrin masa efektive për t'u mbrojtur nga ekspozimi i tymit të duhanit në hapësira të mbyllura, në vende të punës, transport publik dhe vende publike.

Ndalimi i 100% i duhanpirjes në hapësirat e lartpërmendura, krijon një detyrim për të siguruar një mbrojtje universale, si nga duhanpirja drejtpërdrejt ashtu edhe nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit apo pirja pasive e tij.

Një masë tjetër në këtë projektligj, është kufizimi i ekspozimit të shitjes, që në fakt në projektligjin aktual paraqet një elaborim më të detajuar të detyrimeve që dalin nga neni 8.3 i Ligjit aktual për duhanin, ligji numër 02/L-036, duke u bazuar po ashtu në udhëzimet e Konventës-kornizë për kontrollin e duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe nuk kërkon diçka më tepër se sa ajo që është parashikuar edhe në ligjin aktual, sepse vazhdimi i ekspozimit të produkteve të duhanit në pika të shitjes, është rezultat, në esencë, i moszbatimit të ligjit aktual.

Ne jemi koshient edhe për shqetësimet e industrisë së duhanit rreth kësaj mase të paraparë, por studimet e kryera në botë tregojnë, se reklamimet përmes ekspozimit të duhanit në pika të shitjes, nxisin konsumimin e duhanit, sidomos te të rinjtë, prandaj vlerësojmë se aplikimi i kësaj mase do të ndihmojë në dekurajimin e qytetarëve për të konsumuar duhanin dhe është në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik dhe në përputhje të plotë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Projektligji po ashtu, rëndësi të veçantë i jep parandalimit, vetëdijesimit dhe edukimit, për të promovuar dhe mbrojtur kështu shëndetin dhe të drejtat e njeriut, në përputhje me Konventën-kornizë për kontroll të duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Ky projektligj e ofron Kosovën një hap më afër përmbushjes së detyrimeve kushtetuese për të mbrojtur shëndetin publik, si dhe i siguron mekanizmat që mundësojnë zbatimin e tij. Projektligji është hartuar në përputhje me nenin 36 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 1/2007.

Projektligji është në përputhje me kërkesat e *acquis communautaire* të Bashkësisë Evropiane, nuk ka elemente diskriminuese në përbërjen e tij dhe gjatë hartimit të tij janë marrë në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Raporti i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Kosovës mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin numër 02/36, si dhe janë marrë parasysh rekomandimet e shoqërisë civile.

Për më shumë, fakti se në Raportin e publikuar mbi studimin e fizibilitetit për Kosovën, për Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim - Bashkësi Evropiane - Kosovë, theksohet nevoja për miratimin e Ligjit për kontrollin e duhanit, është një argument më shumë, për nevojën që Kosova t'i fuqizojë masat për kontrollin e duhanit përmes miratimit të ligjit, siç edhe kërkohet në raport.

Pas miratimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Projektligji për kontrollin e duhanit ka marrë komentet edhe të ekspertëve të Zyrës Evropiane të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të cilët kanë vlerësuar se ky projektligj është në koherencë të plotë me Konventën- kornizë për kontrollin e duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe si dokument është bazë shumë e mirë, për të qenë një ligj që mbron në mënyrë efektive shëndetin publik të popullatës.

Projektligji për kontrollin e duhanit ka 11 kapituj dhe 24 nene, të cilat këtë dokument e bëjnë më cilësor se sa ligji të është në fuqi.

Prandaj, i bindur se me këtë projektligj sigurohet një mekanizëm i mirë për uljen e prevalencës së duhanpirjes dhe sigurohet një mbrojtje më e mirë e shëndetit publik dhe i bindur se debati në Kuvend do t'i kontribuojë fuqizimit të këtij drafti, ju ftoj që ta votoni këtë projektligj, për t'i dhënë kështu institucioneve tona, Shoqërisë Civile, partnerëve tanë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, një mundësi reale për të jetuar në një mjedis sa më të pastër dhe të mbrojtur nga tymi i duhanit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 tetor 2012, shqyrtoi Projektligjin për kontrollin e duhanit dhe me shumicë votash vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit, që projektligji të miratohet në parim, ndërsa vërejtjet e deputetëve të adresohen

në formë të amendamenteve gjatë shqyrtimit në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministra,

Kolegë dhe kolege,

Projektligji i ri për duhanin, që është në fazën fillestare, po prezantohet pa një debat paraprak dhe pa një argumentim të mjaftueshëm për opinionin, i cili është më se i nevojshëm për këtë temë, që është shumë e rëndësishme, qoftë për shëndetin, qoftë për ekonominë.

Është e vërtetë se këtij projektligji ka qenë dashur t'i paraprijë një kësi debati i gjerë në çdo nivel, qoftë atë qytetar, profesional, të grup moshave të ndryshme, në nivelin e arsimit dhe të edukimit, në shëndetësi, në ekonomi, në kulturë e tjera.

Në formë të diskutimeve të debateve të mbyllura, të hapura dhe në media, qofshin të shkruara dhe sidomos ato vizive dhe pastaj të vijmë te një konkluzion edhe në bazë të përvojave të shteteve të regjionit në lidhje me zbatimin e ligjit për duhanin.

Dihet se edhe variantet tjera të këtij ligji paraprak kanë pasur probleme në zbatim. Nuk mendoj se duhet të bëjmë ligje sa për të bërë ligje dhe ato sado të mira qofshin, të mos zbatohen. Së pari, duhet pyetur pse nuk u zbatua ligji aktual, cilat ishin pikat më të dobëta të tij dhe a u morën për bazë rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale të këtij Kuvendi, i cili dha pas monitorimit, mjaft sugjerime? Sa është i përhapur edukimi shëndetësor dhe kultura shëndetësore në lidhje me konsumimin e duhanit në shkollat tona, në vendet e punës, në familje, në vende publike?

Dihet se ligji parasheh edhe ndëshkime. A u ndëshkua kush për moszbatimin e ligjit aktual?

Natyrisht, që nuk kemi të dhëna të tilla dhe në anën tjetër, e kemi një inspektion, që është për të dëshiruar, në numër i vogël dhe me shumë punë. Prandaj, pse duhet të besojmë që ligji i ri automatikisht do të jetë i mundur të zbatohet. Moszbatimi i një ligji nuk nënkupton nxjerrjen e një ligji të ri dhe atë shumë më rigoroz. Debati i gjerë publik do të pasojë në fazën që do të rrjedhë, pra komisioni parlamentar duhet të angazhohet që të ketë debate, pikërisht me këto kategori që u përmendën dhe, natyrisht nga këto debate të nxjerrë edhe amendamentimin e këtij ligji.

Tani, para vetes kemi disa opinione publike, të mbledhura shpejt e shpejt, natyrisht, në lidhje me ligjin. Është opinioni për shëndetin, pajtohem edhe me ministrin. Ligji është i domosdoshëm dhe natyrisht duhani është i dëmshëm për njeriun, e sidomos si mjeke e fëmijëve unë mendoj se ai është i dëmshëm së pari për vetë fëmijët në familjet tona dhe jam në favor të ligjit.

Pastaj, është çështja sociale. Shumë njerëz jetojnë nga shitja e duhanit dhe një ndalim rigoroz ata do t'i kërcënonte në pikëpamje të jetesës dhe problemeve, që rrjedhin, domethënë vetë ekzistencës së tyre familjare. Por, në pikëpamje sociale, me shitjen e duhanit merren edhe shumë fëmijë dhe duke shitur në rrugë duhanin, ata u ekspozohen edhe shumë të këqijave, që vijnë nga rruga.

Çështja e tretë, është çështja ekonomike. Dihet se nga domethënë tregtia e duhanit mbledhen shumë akciza, ose 30% e akcizave vijnë nga duhani dhe kjo do të ndikonte

edhe në vetë buxhetin tonë. Se sa janë, domethënë të ekspozuara, se a mund të fshihet ky mall në treg dhe çka do të ndodhë pastaj, gjithashtu, duhet ta marrim një opinion të përgjithshëm, që të vijmë deri te një konkludim lidhur me ligjin.

Besoj, se një mall që fshihet, i ekspozohet edhe mallit kontrabandë dhe i ekspozohet mallit jokualitativ, pastaj edhe korrupsionit dhe fshehjes së tatimit. Prandaj, duhet të njihemi me përvojat e shteteve tjera që kanë, pse jo në regjionin, dhe i njohim pak a shumë, personalisht i njoh këto përvoja që nuk flasin gjithnjë se ligji rigoroz dhe i tillë, çfarë na supozohet edhe mund të zbatohet plotësisht.

Këto dilema janë shumë reale dhe seriozisht na detyrojnë që t'i qasemi këtij ligji. Mund të votojmë për ligjin, por me shumë ndryshime dhe kjo kërkon një kohë për amendamentim pas dëgjimit të debatit dhe bisedimeve të gjëra publike. Çdo zhvillim kërkon një kohë dhe një etapë të vetë, pra edhe ligjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zoti Thaçi.

BAHRI THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 02/L-36 për duhanin dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin.

Atëherë, duke parë se ky ligj edhe ashtu siç është nuk po zbatohet me përpikëri, patëm përkrahur fuqishëm rekomandimet e Komisionit të Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për duhanin dhe t'i jepet rëndësi e posaçme mbrojtjes nga duhani.

Sot, para vetes e kemi Projektligjin për kontrollin e duhanit, që adreson krijimin e mjediseve pa tym të duhanit, përmes ndalimit të duhanpirjes në hapësirat publike, vendet publike dhe në vendet e punës, adreson masat për rregullimin, testimin dhe parandalimin e produkteve të duhanit, ndalimin e reklamave, promovimin dhe sponzorimin e produkteve të duhanit, masat parandaluese, vetëdijësuese dhe edukuese.

Qëllim kryesor ky ligj ka mbrojtjen e shëndetit publik nga konsumimi i duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit, duke inkuadruar edhe aktorë të rinj në zbatimin e këtij ligji. Por, a do t'ia dalë t'i realizojë këto qëllime, mbetet të shohim dhe të angazhohemi maksimalisht, që të bëjmë një ligj që të jetë i aplikueshëm.

Ne, si Grup Parlamentar i LDK-së kemi disa vërejtje në këtë ligj, si për shembull, te neni 4, ku flitet për testimin e produkteve të duhanit, në paragrafin 2, thotë: të gjitha produktet e duhanit që prodhohen apo importohen për tregun e Kosovës, duhet të testohen.

Patjetër duhet të testohen, por ne duhet të angazhohemi, që të krijojmë një laborator tonin, i cili do të ishte i besueshëm në analizat e përbërësve të duhanit, sepse dërgimi i këtyre mostrave në vendet fqinje, ose në laboratorët e vendeve tjera, duke marrë parasysh fuqinë e këtyre kompanive, është në pikëpyetje të madhe, se a do t'i marrim rezultatet e sakta apo jo.

Në nenin 9, paragrafi 2, produktet e duhanit thotë, nuk lejohen të vendosen apo të jenë të dukshme në asnjë vend të shitjes. Mendoj që edhe këtu duhet të kemi kujdes që t'i ruajmë të gjithë aktorët, për arsye se nuk mendoj se dikush do të blejë një pako cigare, vetëm pse e shih dikë në vitrinat e ndonjë kioske apo të ndonjë shitoreje, por sigurisht që ata që do të blejnë janë duhanxhinj të pasionuar.

Pastaj, në paragrafin 4, thotë: nuk lejohet shitja, aranzhimi i shitjes i produkteve të duhanit, përmes aparateve për shitje. Bile, shkohet aq larg sa që thuhet të gjitha këto aparate që janë për shitjen e duhanit duhet të konfiskohen. Mendoj se nuk është mirë që të konfiskohen, por edhe ky nen duhet në një mënyrë të amendamentohet, ose të kërkohet që këto aparate të pajisen me diçka, e cila do t'u mundësonte sikur në vendet tjera në botë, që është që të kërkohet që ata që i përdorin këto aparate të kenë një kartelë, e cila do të ketë një kod të caktuar, qoftë ajo ndonjë kartelë e bankës apo letërnjoftimi ose diçka, në mënyrë që fëmijët nën moshën 18-vjeçare, të mos mund të marrin duhan në këto aparate.

Edhe vërejtjet tjera, besoj që ne si Grup Parlamentar i LDK-së do të angazhohemi që t'i amendantojmë në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosja”, fjalën e ka zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Projektligjin për kontrollin e duhanit, si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar dhe do ta përkrahim. Do ta përkrahim plotësisht, pasi që konsiderojmë se ky projektligj edhe përkundër skepticizmit që do të mund të zbatohet në tërësi, ndikon në shëndetin e qytetarëve.

Gjatë kësaj kohe ne kemi marrë vërejtje edhe nga shumë përfaqësues edhe të bizneseve, kemi marrë vërejtje drejtpërdrejt edhe nga shumë qytetarë, të cilët kanë vërejtje për këtë projektligj. Pra, kur bëhet fjalë për reklamën, për bizneset e shumta që do të humbin me mos aplikimin e këtyre reklamave, pastaj me çështjen, me mënyrën si do të mbahen, ato duhen për hapësirat ku do të ndalohej, por edhe përkundër këtyre vërejtjeve, ne si grup parlamentar prapëseprapë jemi për këtë projektligj kështu siç është dhe konsiderojmë që gjatë punës në komision, duhet të mundësohet debati publik, në të cilin ata që kanë vërejtje do të mund t'i shtronin drejt në këto dëgjime publike, në këto dy debate publike dhe që në fund të dalim me një projektligj, nëse është e nevojshme, të amendamentuar.

Por, sidoqoftë Lëvizja “Vetëvendosje” nuk ka ndonjë vërejtje të veçantë dhe e përkrahë këtë projektligj kështu si është.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zonja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Plotësim-ndryshimi i këtij ligji ka qenë i nevojshëm për shkak të vështirësive në zbatimin në praktikë të ligjit në fuqi.

Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka bërë monitorimin e ligjit aktual të duhanit dhe ka parë, se vërtet nuk po zbatohet në tërësi dhe ka pasur probleme në interpretimin ligjor për këtë projektligj, mirëpo edhe ka pasur probleme në zbatim për shkak të mos punës efikase të inspektorateve dhe të institucioneve, të cilat janë kryesore për mbikëqyrjen e implementimit të Ligjit të duhanit.

Çështje që janë adresuar në projektligj, është krijimi i mjediseve pa tym të duhanit, përmes ndalimit të duhanpirjes 100% në hapësirat publike, në vendet e punës, në vendet publike, në shkolla, nëpër institucione shëndetësore e tjerë. Ne e përkrahim këtë nen në tërësi, sepse edhe gjatë monitorimit kemi parë se nuk respektohen as në lokalet afariste, as në lokalet hoteliere, po as në shkolla dhe në institucionet shëndetësore, nuk është respektuar ligji paraprak dhe duhani është pirë edhe në institucionet shëndetësore, që me ligjin aktual ka qenë i ndaluar 100% edhe në institucionet shkollore, që ka qenë i ndaluar 100%, por edhe në lokalet afariste, ku hapësira për pirjen e duhanit ka qenë e ndarë 70 me 30 dhe vërtet nuk ka pasur ndarje fizike, por veç ndarje ashtu sa për të thënë dhe edhe ajo ndarje ashtu nuk është respektuar për shkak se në lokalet hoteliere duhani është pirë 100% dhe për shkak të pamundësisë së shqiptimit të gjobave ose paqartësisë së shqiptimeve të gjobave, a duhet të dënohet lokali afarist apo duhet të dënohet ai që e ka bërë shkeljen ligjore, nuk ka pasur masa ndëshkuese dhe duhani është pirë në tërë hapësirën afariste?

Masat për rregullimin, testimin dhe raportimin e produkteve të duhanit. Gjatë monitorimit të këtij ligji dhe takimeve në Ministrinë e Shëndetësisë, kemi mësuar se nuk ka laborator për testimin e duhanit, sipas ISO standardeve. Dhe, tash një pyetje i bëhet ministrit, a do të krijohet laborator për testim dhe kur do të krijohet laborator për testimin e duhanit, në mënyrë që ky ligj të jetë i zbatueshëm, sepse ne kemi shkuar në plotësim-ndryshim dhe tash para vetes po sjellim ligjin në plotësim-ndryshim, ndërsa ende nuk është krijuar laborator për testimin e produkteve të duhanit.

Ndalimi i reklamave, promovimi dhe sponsorizimi i produkteve të duhanit, parashihet në nenin 9.2. Ky nen parasheh që pikat e shitjes duhet t'i fshehin produktet e duhanit nga konsumatorët dhe produkti duhet të shihet vetëm në momentin e blerjes.

Fshehja e produkteve në pikën e shitjes nuk mund të justifikohet për shkak të shëndetit publik, meqë nuk ka dëshmi shkencore, që të vërtetojmë që kjo masë do të ulë konsumimin e duhanit. Sot, në një konferencë për shtyp, që e ka mbajtur Oda Ekonomike e Kosovës, këtë projektligj e ka quajtur si projektligj antiekonomik, për shkak se i jepet një dritë jeshile tregut të zi të duhanit dhe ka kërkuar nga Komisioni Parlamentar që gjatë

amendamentimit t'i shqyrtojë këto nene, në mënyrë që këto nene të harmonizohen dhe të jenë në harmoni me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Masat parandaluese. Është paraparë formimi i një Këshilli Ndërmnistror, në të cilin do të përfshihen të gjithë aktorët që do të merren me monitorimin e Ligjit të duhanit, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe ministritë tjera përkatëse, gjë që është gjë e mirë.

Fuqizimi i rolit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të duhanit, që bëhet përmes inspektorateve të caktuara, edhe këtu jemi shumë skeptik se si do të bëhet fuqizimi i rolit të mbikëqyrjes, për shkak se nuk është investuar në inspektoratet e ndryshme dhe si mund të monitorohet Ligji i duhanit me inspektorate të pakta, me buxhet të vogël, me numër të pakt të inspektorëve, që nuk do të arrijnë as Inspektorati Shëndetësor, as Inspektorati i Arsimit, as Inspektorati i Tregut, me një numër kaq të vogël të inspektorëve, nuk mund të bëjnë monitorimin e Ligjit të duhanit.

Fuqizimi i dispozitave ndëshkuese, është mirë që këtu tash të qartësohen këto dispozita ndëshkuese. Në qoftë se një lokal afarist apo një lokal hotelier deklarohet se 100% ndalohet pirja e duhanit, atëherë nëse në lokalin hotelier haset se nuk po respektohet ky nen apo kjo dispozitë ligjore, kush do të ndëshkohet? A do të ndëshkohet pronari, apo do të ndëshkohet personi, i cili ka bërë thyerjen ligjore? Është mirë që këtu të ndëshkohet edhe pronari, po edhe personi, i cili e ka bërë shkeljen ligjore, për shkak se atëherë lihet mundësia e manipulimit me këtë nen.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj, do ta përkrahë, mirëpo, gjatë amendamentimit dhe gjatë dëgjimit publik, që do të bëhet për Ligjin e duhanit, do t'i marrim edhe rekomandimet e palëve të interesuara për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Pa dyshim që procedimi i këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës është i mirëseardhur. Ne si Komision Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, qysh në fillim të mandatit tonë kemi filluar monitorimin e zbatimit të ligjit aktual, që është në fuqi, Ligjit të duhanit dhe kemi gjetur shumë mangësi, qoftë në vetë ligjin, qoftë në zbatimin e tij në praktikë.

Prandaj, ky projektligj i kontrollit të duhanit me ndryshimet e parapara, padyshim që është i mirëseardhur dhe produktiv, në radhë të parë për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në sektorët e shtresave të ndryshme, në përgjithësi.

Është formuar, me keqardhje, një qëndrim i gabueshëm apo një opinion publik i gabuar se projektligji i proceduar në Kuvend nga Ministria e Shëndetësisë e ndalon duhanpirjen. Në fakt, ky projektligj nuk e ndalon duhanpirjen. Konkretisht, ky i përcakton kriteret e

duhanpirjes. Se është vërtetë jonjerëzore, jo morale që në një ambient të mbyllur, ku ka edhe duhanpirës aktiv dhe ata pasiv, që nuk e përdorin duhanin t'i ekspozohen tymit të duhanit pa dëshirën e tyre. Më të rëndë e bën situatën kur në atë objekt të mbyllur, hapësirë të mbyllur, qoftë hoteliere apo hapësirë tjetër, ndodhen edhe gra shtatzëna, se siç dihet, e besoj që edhe gjithë të tjerët e dini, se në muajt e parë të shtatzënisë, kur disa shtatzënësi nuk verifikohen disa ato që konstatohen, muajt e parë të shtatzënisë janë më të rrezikshmet, për pasojat që vijnë nga duhani, për faktin se ne jemi dëshmitarë të numrit të madh të foshnjave të lindura në Kosovë me anomali dhe sindrome të ndryshme, ku një ndër shkaktarët ka qenë edhe duhanpirja apo ekspozimi pasiv i nënave shtatzëna ndaj duhanit.

Prandaj, kufizimi i duhanit, do të thotë vetëm në hapësirën jashtë hapësirave të mbyllura, është i mirëseardhur, ngase promovon mbrojtjen në radhë të parë të shëndetit, si të atyre duhanpirësve aktiv edhe të atyre pasiv.

Në anën tjetër, duke pasur parasysh nivelin jo të mirë, jo të kënaqshëm shëndetësor të Republikës së Kosovës, padyshim e fuqizon edhe më tepër qëllimin dhe procedimin e këtij projektligji, ngase ne nuk kemi një nivel shëndetësor, i cili mund t'i bëjë ballë në mënyrë mjaft efektive pasojave të këtij duhani apo pasojave të konsumimit të duhanit.

Është e vërtetë, kemi pasur ditëve të kaluara e edhe sot, reagime, qoftë nga shoqatat e duhanxhinjve dhe privat edhe nga Oda Ekonomike, se ky projektligj cenon zhvillimin ekonomik, por me kuptim të plotë të fjalës mund të them se nuk është ashtu. Unë i kuptoj reagimet e tyre, por nuk i arsyetoj për faktin se edhe Kushtetuta e Kosovës e lejon Qeverinë që t'i procedojë ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në njërin anë. Së dyti, ne të gjithë e dimë dhe jemi kosientë se në radhë të parë është shëndeti i Kosovës, më pastaj interesat ekonomike. Këtu nuk dua të keqinterpretohen dhe të them se jam kundër interesave ekonomike, por kur është në pyetje shëndeti i qytetarëve të Kosovës, padyshim që në radhë të parë është shëndeti, pastaj përfitimet ekonomike e jo të bëhemi vetëm të njëanshëm, të shikojmë vetëm të zhvillohemi ekonomikisht në dëm të shëndetit të qytetarëve të Kosovës. Se nëse një gjë e tillë është e vërtetë, se vetëm po cenohet zhvillimi ekonomik përmes këtij projektligji, atëherë unë e marr guximin dhe i propozoj ministrit aktual të Shëndetësisë, le ta privatizojë edhe QKU-në edhe qendrat e tjera sekondare spitalore të Kosovës, le të përfitojë më shumë Buxheti i Kosovës, se sa të përfitojë shëndeti i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Por një gjë e tillë nuk kuptim dhe nuk është në esencë, që të shikohet vetëm ana ekonomike e të harrohet ana shëndetësore e qytetarëve të Kosovës.

Ne, si grup parlamentar padyshim që e mbështesim këtë projektligj dhe punën kryesore e kemi në Komisionin për Shëndetësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi "6+"-i, zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim.

Sayın Meclis Başkanı yardımcısı, Sayın Bakanlar ve Değerli Milletvekilleri.

Sigara Kanunundaki ndëgjshiklikleri i qeren bu Yasa Tasarisi grup tarafindan yakindan incelenip, gdnmndze belki saqligimizi en yakindan ilgilendiren bir Yasa olarak grup o shkilde yaklasmaktayiz.

Bu Yasa Tasarisi, sigara kullanma kosullarini, iqlecek mekanlari ve sigaranin satish reklamıyla ilgili dzenlemeyi ve cezalarin artishini beraberinde getirmektedir. Btun kapali mekanlarda iqlme yasaqini getiren bu Yasa, bizce yerinde bir karar olarak grmekteyiz ve de desteklemekteyiz.

Diger yandan sigara kullananlara da saygi gosterilip, ozel mekanlar ve shartlari da devlet kapali alanlarda saqlamal, aksi takdirde sigara kullananlar kanuna uymayip, kapali alanlarda ve herkesin bulunduqu ortamlarda sigara iqlmeye devam edecektir.

Kanunlari getirip aslinda bunun uygulanmasi bizce en onemlisi, burda gorev basta devlet buyuklerine ve halkimiza dushmektedir, yine bu Yasada sadece muffeditshler degil, ama ayni zamanda belirli maddelerin uygulanip uygulanmamasinda polisimize de yetki verildiqi gorullmektedir, bizce buda yerinde bir karar.

Bizlerin ve de en onemlisi qocuklarimizin saqliginin ve geleceqinin bu sigara yasasiyla ve uygulanmasiyla ciddi bir adim atilacaqini grmekteyiz. 6+ Parlamento Grubu olarak bu yasayi desteklemekteyiz ve onerilerimizi komisyona sunacaqiz.

Teqqkkur ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nqnkryetar!

Të nderuar deputetë, ministra,

Projektligji që jemi duke e shqyrtuar në lexim të parë, dëshiroj që edhe unë të jap kontributin tim dhe të fokusohem në nenin 9. Propozoj që neni 9, alineja 2, nën alineja a e Ligjit për duhanin, që parasheh ndalimin e makinave automatike shitëse, është tepër i panevojshëm, joadekuat dhe vetë përjashtues. Ky nen nuk është në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian e as me ligjet e shteteve rajonale, por është marrë shembull i shteteve skandinave, prandaj kontrabandimi i duhanit atje është shumë i madh.

Në këtë projektligj i hapet rrugë kontrabandimit dhe ikjes nga taksat dhe akcizat. Andaj, propozimi im është që në variantin e ri të ligjit për duhanin neni 9, alineja 2, nën alineja a, të hiqet dhe të mos figurojë fare, sepse është i panevojshëm edhe për shkakun se:

1. Nga aspekti i të drejtave të barabarta të ushtrimit të biznesit, mendoj se neni 9, alineja 2, nën alineja a prish balancën e të drejtave të ushtrimit të biznesit të shitjes, distribuimit të cigareve dhe kjo formë e shitjes, distribuimit të cigareve vihet në pozitë të barabartë dhe të disfavorshme, përkundër shpenzimeve shtesë të mjeteve, të investimeve shtesë të angazhuara për ushtrim biznesi, numrit shtesë të punëtorëve të punësuar, duke i kontribuar uljes së papunësisë dhe se është forma më e kontrolluar e shitjes, distribuimit të cigareve.

2. Formave dhe mekanizmave të mjaftueshëm, që i cekëm më lart, për sigurimin se personat që konsumojnë duhan nën moshën 18 vjeç nuk kanë as gjasë minimale të furnizohen me cigare nga këto aparate, dhe
3. Sipas analizave të ndryshme del se kjo formë e shitjes së cigareve është forma më e kontrolluar dhe më e sigurt, për parandalimin e shitjes së cigareve personave e konsumuesve të cigareve të moshës nën 18 vjeç.

Duke marrë parasysh gjithë këto angazhime afariste dhe disiplinë nënfiskale, pagesën e tatimeve, akcizave e tjera, jam i bindur se ky biznes duhet të veçohet, duhet të dallohet nga shitësit në rrugë, që janë të palicencuar, të pakontrolluar dhe që i bombardojnë pa kontroll lokalet hoteliere, turistike, kafeteritë, lokalet tregtare dhe rrugët.

Shpresoj, që gjatë leximit të dytë të këtij projektligji, do të merren parasysh vërejtjet e mia dhe se do të inkorporohen gjatë leximit të dytë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj që ka ardhur për kontrollin e duhanit, është më i plotë dhe i strukturuar se ai i mëhershmi, duke i plotësuar disa vakume, paqartësi dhe probleme në zbatim.

Duhani është pa mëdyshje kancerogjen. Mbi 40 kemikalie që gjenden në duhan janë të njohura si shkaktarë të kancerit, dëmtojnë pothuajse çdo organ të trupit. Pirja e duhanit është shkaktari kryesor i kancerit të mushkërive, gojës, fytit, laringut dhe të gjitha organeve.

Kosova është e dyta për konsum më të lartë të duhanit, për kokë të banorit në botë, mbas Greqisë, me 2687 cigare në vit, për një të rritur. Mungesa e kontrollit, se ku mund të përdoren produktet e duhanit, është një kontribuues i madh në sëmundjet që janë të lidhura me pirjen e duhanit në Kosovë dhe rrezikon në vazhdimësi joduhanpirësit, me ekspozim në duhan, pothuajse në të gjitha hapësirat publike.

Shprehia e pirjes së duhanit në Kosovë është duke i vrarë fëmijët e saj. Të paktën 21% të grave shtatzëna në Kosovë konsumojnë duhan gjatë shtatzënësisë, derisa 54% të porsalindurve në Kosovë i ekspozohen pirjes së duhanit për çdo ditë në mjediset e tyre familjare, aty ku rriten dhe zhvillohen. Fëmijët vazhdimisht i ekspozohen pirjes së duhanit, në shtëpi, në automjete private, publike, në shkolla, në institucione shëndetësore, në restorante, në kafene dhe në të gjitha hapësirat publike.

Duke u nisur nga fakti se jemi vendi i dytë në botë, për duhanpirje, që kemi bajrakun në rajon për duhanpirje nga ana e fëmijëve, që kemi një numër të madh të foshnjave si duhanpirës pasivë, që kemi një vdekshmëri perinatale shumë të lartë, një morbiditet perinatal të lartë, një numër të madh të fëmijëve të lindur me peshë të ultë dhe të

parakohshëm, atëherë ky projektligj dhe që të gjitha këto ndërlidhen në mënyrë indirekte me pirjen e duhanit, domethënë, pirja e duhanit është njëri prej faktorëve kryesorë që ndikon në këto, atëherë ky projektligj duhet të miratohet dhe të gjejë një implementim të gjerë që të mundemi sadopak të ndikojmë në zbutjen e problemeve, të cilat paraqiten , të cekura më herët në shëndetësinë publike.

Unë e miratoj dhe i ftoj të gjithë deputetët që ta miratojnë këtë projektligj edhe në mënyrë direkte apo indirekte të ndikojnë në implementimin sa më të gjerë të tij, në mënyrë që të ndikojë në zbutjen e këtyre problemeve, të cilat paraqiten në shëndetësi te ne në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për kontrollin e duhanit është një projektligj që vjen pas Ligjit për duhanin dhe Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin, që nuk u treguan të suksesshëm.

Unë së pari do ta filloj këtë diskutim duke i përmendur disa fakte rreth duhanit dhe atyre që e konsumojnë atë, që të arsyetoj se përse jam përkrahëse e një ligji rigoroz për kontrollin e duhanit.

Tymi i duhanit përmban mbi 4 mijë e 800 kemikalie, prej të cilave 69 janë substanca kancerogjene. Pirja e duhanit e dëmton pothuajse çdo organ të njeriut. Duhani është përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejt për rreth 90% të vdekjeve nga kanceri i mushkërive. Sëmundjet që shkakton pirja e duhanit janë: bronkiti kronik obstruktiv, infarkti i zemrës, pika në tru, leukemia akute mieloide, kanceri i fshikzës së urinës, ezofagut, lukthit, laringut, të gojës, fytit, veshkave dhe pankreasit. Pirja e duhanit është faktor kyç edhe për lajmërimin e ulcerës pektike apo të thatit në lukth si dhe infertilitetit. Mesatarja e jetëgjatësisë është shumë më e shkurtër te duhanpirësit se sa te ata që nuk pinë duhan. Kështu, duhanpirësit meshkuj jetojnë mesatarisht 13,2 vjet më pak se sa joduhanipirësit, ndërsa femrat duhanpirëse jetojnë mesatarisht 14,5 vjet më pak se sa ato joduhanipirëse.

Duhanpirja pasive e atyre që nuk pinë duhan, por qëndrojnë në ambiente ku pihet duhani, është po aq e rrezikshme. Në SHBA është vlerësuar se për shkak të duhanpirjes pasive brenda vitit vdesin mesatarisht 3 400 persona nga kanceri i mushkërive dhe 4 600 nga sëmundjet e zemrës. Duhani-pirja nga prindërit është e shoqëruar me shumë efekte të dëmshme për fëmijët e tyre, duke përfshirë ekzacirbimin e astmës, ftohjet e shpeshta, infeksionet e veshit, si dhe sindromën e vdekjes së papritur te foshnjat.

Duke pasur parasysh gjithë këto efekte të dëmshme të duhanit dhe shumë më tepër, ne jemi për një ligj rigoroz dhe të zbatueshëm të kontrollit të duhanit. Masat që parashihen me këtë ligj besojmë se do të ndikojnë në uljen e duhanpirjes te ne dhe t'i mbrojnë në masë shumë më të madhe duhanpirësit pasivë. Ne kërkojmë një punë më të mirë të inspektorateve përkatëse. Kam nxjerrë disa të dhëna të vendeve që e kanë implementuar

Ligjin për kontrollin e duhanit dhe ato tregojnë për rënie të duhanpirjes pas implementimit të tij. Kështu, një studim i kryer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada ka dëshmuar se punëtorët që punojnë në vende ku duhani është krejtësisht i ndaluar kanë gjasë dy herë më shumë për ta ndërprerë duhanpirjen se sa punëtorët që kanë punuar në ambientet ku duhani mund të pihet çdo kund.

Në Nju-Jork, për shembull, pas implementimit të Ligjit gjithëpërfshirës për duhanin, ngritjes së tatimeve në cigare, kampanjave mediatike dhe iniciativave për ndërprerje të duhanit, si dhënia falas e flasterëve të nikotinës, ndikuan që numri i duhanpirësve të zvogëlohet për 140 000. Sa i përket ndikimit të ligjit të rinjtë, do ta përmendi një shembull. Sipas një hulumtimi, rinia që jeton në qytetet, ku në restorante është e ndaluar tërësisht pirja e duhanit, kanë gjasa dukshëm më të vogla të shndërrohen në duhanpirës të rregullt, krahasuar me rininë që jeton në qytete me restriksione të dobëta ndaj duhanpirjes.

Nikotina shkakton varshmëri, prandaj ndërprerja e duhanit është e vështirë. Propozoj që Ministria e Shëndetësisë ta hapë një zyrë që do të merrej ekskluzivisht me masat për ndalimin e duhanit që, ndër të tjera, do ta përkrahë formimin e grupeve këshilluese dhe të furnizohet me medikamente që ndihmojnë në ndërprerjen e duhanit.

Ne si Lëvizje për Bashkim në parim do ta votojmë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qëllimi i këtij ligji është synim i mbrojtjes të shëndetit publik të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese nga konsumimi i duhanit dhe ekspozimi në tymin e tij.

Me këtë ligj përcaktohen masat për parandalim, kufizim, përdorim të produkteve të duhanit dhe përbërësve të tij. Për këtë qëllim, ligji përcakton një mori masash për ta limituar nxitjen e pirjes së duhanit dhe masat tjera për ta informuar popullatën lidhur me rreziqet dhe dëmet specifike të përdorimit të produkteve të duhanit dhe pasojat e dëmshme shëndetësore që shkakton pirja e tij. Edhe kolegët tjerë i thanë, mirëpo do të ndalem te disa vërejtje të cilat mendoj që duhet të jenë të inkuorpuara në kuadër të këtij ligji.

Në kreun 3 të nenit 6, te vërejtjet dhe shenjëzimet në paketim të produkteve të duhanit, edhe në diskutimet e mëhershme për këtë çështje, por edhe tani kërkoj që në këtë projektligj të përfshihet emetimi i fotove të të sëmurëve me kancer, fotove jo të këndshme, të cilat do ta japin një imazh dhe një pasqyrë rreth pasojave shkatërruese të duhanit. Mendoj se do të ishte mirë që në vend të shumicës të deklarimeve apo fjalive, të cilat janë të paraqitura, të obligueshme me këtë ligji, në pakot si “Pirja e duhanit vret”,

“Pirja e duhanit shkakton vdekje të parakohshme” dhe “Duhani dëmton shëndetin tuaj”, të pasurohet edhe me foto, të cilat i pasqyrojnë pasojat e pirjes së duhanit.

Pastaj, te kreu 5, neni 6, kufizimi i shitjes së produkteve të duhanit, mendoj që këtu duhet pasur parasysh, për arsye se te neni 3 dhe neni 4, ku ndalohej shitja e duhanit, në veçanti ekspozimi i këtij produkt, mendoj se nuk do të ishte mirë të krijohet një mundësi që duhani të shitet nën tezga, apo të shitet fshehurazi, sepse kjo do ta krijonte një mundësi të një tregu ilegal të duhanit. Gjithsesi, duhet pasur parasysh që te ndalesat të parashihet për arsye se një sasi e madhe e duhanit sot tregtohet në tregun e hapur dhe i ekspozohet tregut të lirë, përveç duhanit, i cili është në formë të paketimeve edhe duhanit që është duhan refuz, që shitet në tregun e Kosovës. Duhet pasur parasysh që këto masa parandaluese të merren edhe për këta shitës ilegal të duhanit në tregjet e Kosovës.

Dhe, në nenin 10, parandalimi i qasjes së të miturve në produktet e duhanit, mendoj që është një qasje shumë korrekte e hartuesit të ligjit, mirëpo gjithsesi mendoj që këtu duhet pasur parasysh te neni 2, në të cilin thuhet se asnjë person nuk lejohet ta punësojë një të mitur për të shitur produkte të duhanit. Ju e dini se sa është numri i shitësve ilegalë të duhanit në Kosovë, të cilët kryesisht janë të mitur. Zbatimin e këtij neni duhet precizuar me masa të sakta të mbikëqyrjes dhe përgjegjësi për t’i parandaluar të miturit për të shitur duhan. Dhe te masat parandaluese, parashihet që Qeveria e Kosovës të formojë këshillin ndërministror për kontrollim të duhani, gjë që është mirë. Edhe nenin 4 jepen edhe mesazhe nëpërmjet radio-televizionit publik dhe televizioneve private, duke emetuar programe edukative, që mendoj që është krejt në rregull, mirëpo gjithsesi me ligjin e kaluar kemi pasur vështirësi në zbatimin e tij. Nuk kemi pasur vështirësi në aspektet edukative. Mendoj që aspektin edukativ si Kosovë në këtë lëmi kemi qëndruar mirë, janë mbajtur shumë emisione dhe forume të tjera, diskutime rreth dëmeve të duhanit, mirëpo kemi pasur problem në zbatueshmërinë e ligjit.

Dhe, te neni 19, te mbikëqyrja, ekzekutimi dhe mbikëqyrja e zbatueshmërisë kompetencat janë ndarë në disa inspektorate, domethënë thuhet që përgjegjës për këtë lëmi janë Inspektorati Sanitar, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati i Tregut, Inspektorati i Punës, Inspektorati i Arsimit, Inspektorati i Transportit, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Policia e Kosovës.

Më pas shpjegohet veç e veç se cili inspektorat cilat kompetenca i ka. Mendoj që do të jetë një çështje e koklavitur për zbatimin në praktikë, prandaj përgjegjësia duhet të adresohet në inspektoratet e caktuara, të jetë një inspektorat i saktë dhe preciz. Më së shumti dy inspektorate duhet të merreshin me mbikëqyrjen dhe zbatueshmërinë e këtij ligji. Mendoj që në këtë rast, Inspektorati Sanitar dhe ai Komunal do të ishin inspektoratet më të përgjegjshme, të cilat do të merreshin me zbatimin e mbikëqyrjes së këtij ligji dhe gjithsesi këto adresime të përgjegjësi duhet të jenë të sakta dhe që ky ligj vërtet të jetë i zbatueshëm. Ne e kemi pasur edhe ligjin tjetër, i cili mendoj që ka qenë i mirë, mirëpo për shkak të mosfunksionimit edhe moskryerjes së detyrës nga inspektorët dhe inspektoratet, në përgjithësi, kemi ardhur në situatë që ligji i kaluar nuk ka funksionuar. Shpresoj që ky ligj i hartuar mirë dhe i përbërë nga standardet evropiane vërtet të ketë zbatueshmëri dhe fillimisht të nisë zbatimin këtu në Kuvend, e pastaj edhe më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Unë mendoj se është me rëndësi të bëjmë politika të bazuara në praktikat më të mira dhe në shkencë, e jo vetëm politika simbolike.

Rreziku nëse i tejkalojmë praktikat më të mira dhe përvojat më të mira është që këto politika në fund sjellin pasoja të paparashikuara dhe përfundimi del të jetë krejt i kundërt. E para që do të them është se e kemi një ligj në fuqi, i cili nuk ka arritur të implementohet në tërësi, prandaj në parim unë e përkrah këtë projektligj, me gjithë të metat që i ka, që i theksuan edhe kolegët tjerë. Mendimi është që Projektligji i duhanit ka nevojë për amandim serioz, në mënyrë të veçantë sa i përket dispozitës që parashikon që produktet e duhanit nuk duhet të vendosen në vendet e dukshme nëpër shitore. Megjithëse në memorandumën shpjegues të Ministrisë së Shëndetësisë nuk flitet aspak për këtë masë, ju mund të lexoni në nenin 9, pika 2, ku thuhet: “Produktet e duhanit nuk do të lejohen të vendosen apo të jenë të dukshme në asnjë vend të shitjes, përveç në momentin e transaksionit të shitjes dhe nuk duhet të jenë të shfaqura për qëllime komerciale në asnjë vend tjetër”.

Kolegë deputetë,

Unë mendoj se kjo masë ekstreme do ta dëmtojë shumë jo vetëm biznesin, por shumë më tepër edhe vetë konsumatorët dhe buxhetin e shtetit dhe nuk do të sjellë, ashtu siç pritet, ulje të duhanpirjes te moshat e reja. Eksperienca konkrete nga ato pak vende që kanë zbatuar diçka të ngjashme me këtë provon një fakt të kundërt, të cilin unë do ta parashtroj. Për shembull, studimet shkencore të pavarura tregojnë se në Kanada, Islandë, Irlandë, Estoni, niveli i duhan pirjes tek të rinjtë u rrit ose mbeti i pandryshuar, por në asnjë vend nuk u ul si rezultat i ndalimit të ekspozimit të duhanit. Ndonëse qëllimi i ndalimit të ekspozimit të duhanit ishte reduktimi i duhanpirjes tek të rinjtë, ndërkohë që shumë shitës të vegjël me pakicë i kanë humbur bizneset e tyre më kot, si pasojë e këtij legjislacioni dhe është shtuar kontrabanda e duhanit.

Mua më janë drejtuar shumë shitës me pakicë me këtë shqetësim, e unë jam këtu që t’i përfaqësoj edhe interesat dhe shqetësimet e tyre. Kjo do të thotë, nëpërmjet devijimit të biznesit për të shitësit më të mëdhenj me pakicë që krijon monopol dhe kosto më të mëdha operationale, me vjedhje, me kosto shtesë në mbajtjen e produkteve nëpër raftet e mbyllura e të dedikuara. Këto humbje do të ishin jashtëzakonshme, duke pasur parasysh se në Kosovë dhe në qendrat urbane janë së paku 4 000 kioska, markete, bare, restorante dhe hotele, ndërkohë që një pjesë e mirë e këtij tregu do të kalojë tek individët ambulantë, që ua ofrojnë produktet konsumatorëve në rrugë. Nëse ky numër merret parasysh, kur llogariten pasojat që mund të sjellë zbatimi i këtij ligji, ndikimi politik dhe ekonomik do të jetë shumë më i madh se ai ligjor.

Çështje tjetër, për të cilën duhet të kemi kujdes, është shëndeti i konsumatorit madhor e duhanpirës do të dëmtohet shumë më tepër se sa nga produktet e ligjshme të duhanit,

sepse konsumatorët nuk do të mund të jenë të informuar për produktin që do ta konsumojnë, pasi nuk do të mund ta shikojnë atë të ekspozuar ligjërisht e në mënyrë të kontrolluar dhe mund të mashtrohen fare lehtë me produktet e falsifikuara, kontrabandë e të pakontrolluara. Shteti do të përballet me ulje të të ardhurave të tij dhe me kosto të shtuar për ta luftuar tregtinë e paligjshme të produkteve të duhanit, e cila do të jetë në rritje. Kontrabanda dhe tregtia e paligjshme në Kosovë do të lulëzojë, pasi produktet kontrabandë dhe produktet e falsifikuara do të shpërndahen dhe shiten më lehtë.

Mendoj që niveli i konsumit të duhanit nuk do të ulet, dhe kjo provë, e provuar edhe nga shkenca, në vendet që e kanë aplikuar, tregon se kjo masë ekstreme në njërën anë nuk e redukton konsumin e duhanit, por në anën tjetër e dëmton rëndë industrinë e ligjshme të duhanit, duke rezultuar në problematikë të shtuar për të gjitha palët e përfshira. Prandaj, propozimi im është që të hapet një debat i gjerë publik me komisionin përkatës sa i përket projektligjit në tërësi, e sidomos të rishikohet neni 9 dhe pika 2 e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër, ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se organi më i lartë legjislativ i vendit më së paku ka nevojë që të ketë simpozium shkencor se sa i dëmshëm është duhani. Të gjithë e dimë këtë. Nuk ka nevojë këtu që të diskutohet aq gjatë se sa është i dëmshëm për fëmijët, sa është i dëmshëm për të rriturit, për nënat lehona. Ne duhet të diskutojmë strategjikisht se çka po ndodh, në çfarë gjendje është vendi sa i përket duhanpirjes, shitjes etj., si ta ndalim, si ta parandalojmë. Kjo duhet të jetë tema.

Çështje tjetër që do ta kisha përmendur fillimisht është që ajo që deputetja Flora Brovina e tha: nëse një ligj ka pësuar kolaps, edhe ne të gjithë jemi dëshmitarë se ka pësuar kolaps Ligji paraprakisht i duhanit, nuk mund të riparohet gjendja duke e sjellë një ligj edhe më rigoroz, do të thotë pa e provuar t'i rregullojmë elementet tjera institucionale, të cilat është dashur të merren me këtë ligj. Në bazë të përvojës, në bazë të asaj që e kemi shikuar rreth e rreth nesh në Unionin Evropian, edhe në vendet tjera, çmimi ka qenë elementi kryesor që ka ndikuar në uljen e pirjes së duhanit. Për Britani të Madhe, të paktën, jam në ngjarje, ndalimet, sistemet e informacionit, informatat e bollshme kanë pasur ndikim, por kanë pasur ndikim më të vogël se çmimi. Tani te çmimi jemi në një kurth, për shkak se Ballkani është një vend ta quajmë ashtu "poroz" dhe nëse njëri prej vendeve do ta kishte rritur në mënyrë enorme çmimin e duhanit, do të kishte lulëzuar kontrabanda, d.m.th. nëse diku rritet akciza, diku tjetër jo, do të ishte problem tepër i madh.

Për tre vjet, tri herë kemi bërë Ligj të duhanit, që domethënë se diçka nuk po funksionon, diçka është problem. Domethënë, nëse tre vjet legjislaturat merren, gati e njëjta legjislaturë, dy herë, tash edhe kjo, merren me të njëjtin ligj, provojnë të bëjnë diçka, por gjendja në terren nuk ndryshon fare, diçka është keq dhe dikush duhet të kujtohet se çfarë po ndodh me ne. Ku është problemi? Pse ne për çdo vit duhet të bëjmë Ligj të duhanit?

Gjithmonë e më rigorozë, ndërsa situata jashtëzakonisht pak ndryshon, për të mos qenë ashtu ekstrem edhe të them - fare. Mendoj se ky projektligj, i cili ka ardhur, i ka sjellë disa elemente jashtëzakonisht të mira, ka elemente pozitive, sidomos te aspektet e informimit, mirëpo mendoj se ka edhe të meta për shkak se po tenton në masë tepër të ashpër, në mënyrë shumë të egër ta parandalojë pirjen e duhanit, përderisa, shembull ta marrim, dështimi është se institucionet tona, inspektoratet dhe të tjerat kanë dështuar ta zbatojnë ligjin. Arsyeja kryesore pse kanë dështuar ta zbatojnë ligjin është se dy prej tre personave që duhet ta parandalojnë pirjen e duhanit, pinë duhan vetë.

Domethënë, ne e kemi një problem pak më të madh se sa vetëm ta shkruajmë një ligj edhe ta sjellim në Kuvendin e Kosovës për ta kaluar. Elemente problematike të projektligjit janë se duket që ka edhe elemente të prohibicionit, domethënë ndalim total. Edhe historia njerëzore na tregon se në momentet kur një fenomen ka qenë i përmasave më të mëdha se sa që mund ta parashohë vetëm dikush që e shkruan një letër, prohibicioni e ka sjellë ekzakt të kundërtën e asaj që ka synuar ta parandalojë. Ka shkuar në nëntokë, janë ndërtuar bare nëpër bodrume, është pirë duhani etj., etj. Bile- bile, nëse e lexoni mirë, me këtë ligj praktikisht, nëse interpretohet rigorozisht, ndalohet pirja e duhanit edhe në park, gjë që në Kosovë është problematike.

Mendoj se në strategjinë e luftimit kundër duhanit janë tri ose katër elemente kryesore, që çdo vend provon t'i ketë dhe i ka. Është: parandalimi i nisjes të duhanpirjes te të rinjtë që bëhet nëpërmjet ndalimit të reklamimit në televizor, ndalimit të pirjes së duhanit afër shkollave, aq më tepër brenda shkollave, nëpër spitale, afër çerdheve etj., etj., do të thotë që sa më pak që të jetë e mundshme të rinjtë të ekspozohen, qoftë ndaj tymit të duhanit, qoftë ndaj njerëzve që pinë duhan, që do t'i kishin parë duke pirë duhan. Por, edhe ky projektligj i ka disa elemente pozitive në këtë drejtim, duhet pranuar.

Është parandalimi i ekspozimit të joduhanpirësve në tymin e duhanit, që ndërlidhet me të parin, mirëpo është një kategori e veçantë dhe këtu hyn ndalimi i pirjes së duhanit nëpër shumicën dërmuese të hapësirave publike, mirëpo problematike mbeten baret dhe restorantet. Sidoqoftë do të kthehem pak te kjo. Arsyeja e fundit ose aspekti i fundit strategjik është ulja sa më e madhe e numrit të duhanpirësve për shkak se u tha sa i dëmshëm është duhani dhe mendoj se nuk kemi nevojë të diskutojmë për dëmin që e sjell duhani në shoqëri.

Tani, fillimisht kemi menduar se projektligjet, të cilat vijnë për duhanin kanë për të shkuar, më falni këtë shprehje, pak a shumë deskriptive, duke shtrënguar nga pak - nga pak atë hapësirën e pirjes së duhanit, jo duke bërë "hope" ose duke bërë thyerje, për shkak se po pëson kolaps ligji, nuk po respektohet. Domethënë, njëfarë forme inkrementale e rritjes ose e ngushtimit të hapësirave të duhanpirjes. Me këtë ligj nuk po ndodh ashtu, por po ndodh diçka ndryshe. Po ndodh një prerje e madhe.

Çështje tjetër, që u përmend disa herë, dhe nuk po dua të ndalem gjatë, është ndalimi i ekspozimit. Edhe në aspektin praktik, edhe në aspektin teorik, ose ekonomik, me një ligj të ndalohet të ekspozohet një mall që lejohet të shitet. Domethënë, nëse duhani lejohet të

shitet, është legale shitja e duhanit në Kosovë, e në të njëjtën kohë ndalohet ekspozimi, mendoj se edhe për logjikën ekonomike, por edhe për logjikën tjetër, nuk është në rregull.

Tani shkaktohet edhe konfuzion dhe duhet të amendohen këto që po i them. Për shembull, në Ligjin paraprak është përmendur puroja dhe duhani i llullës. Në këtë ligj nuk përmenden fare, përmendet vetëm sasia, katrani prej nikotinës dhe monoksidit të karbonit të lejueshëm për tregtim në Kosovë. Mirëpo puro ka shumë më tepër, shembull ta marrim katran, nikotinë, edhe monoksid karbonit se që lejohet këtu. A do të thotë që purot duhet të shiten në tregun e zi, nën tezgë, për shkak se në bazë të këtij ligji del se është e ndaluar. Domethënë, në këtë mënyrë rritet kontrabanda.

E thashë që nëse vetëm interpretohet strikt edhe në park është e ndaluar pirja e duhanit, që është absurd për Kosovën, bile edhe për vendet tjera. Edhe elementi i fundit është ndalimi i pirjes së duhanit nëpër bare, restorante, kafeteri, klube të natës - diskoteka etj. Nëse këto provizione mbeten kështu si janë, ky ndalim i pirjes së duhanit nëpër bare e restorante prapë do të pësojë kolaps, për shkak se është ndërtuar një kulturë tepër e gjatë dhe do të marrë kohë për ndalim. Në shumë restorante në Kosovë tanimë janë ndarë zonat e duhanpirjes dhe të joduhan pirjes, gjë që mendoj se është një gjë e mirë që ka rrjedhë prej ligjit të kaluar, i cili po shfuqizohet, nëse kalon ky ligj, mirëpo mendoj se në këtë temë dhe, sipas të gjitha gjasave, unë ose së bashku me Grupin Parlamentar të Aleancës, do të provojmë ta sjellim një amendament, i cili do të ketë elemente të ndalimit të pirjes së duhanit nëpër bare, restorante e klube të natës, të cilat deklarohen se janë vende ku nuk pihet duhani. Çka po mendoj me këtë? Nëse një restorant deklarohet se aty nuk pihet duhani, atëherë do t'i paguajë taksat e rregullta, ndërkaj nëse një restorant deklarohet se e lejon pirjen e duhanit do të paguajë taksë shtesë, e cila duhet të diskutohet me ministrin e Financave, se ku duhet të shkojë ajo taksë, a do të shkojë direkt për shëndetësi, apo çka do të bëhet me atë taksë.

Dhe, në këtë rast, nëse në një lokal, i cili është deklaruar se nuk pihet duhani, shihen njerëz duke pirë duhan, atëherë shkelja do të jetë e dyfishtë, edhe shkelet Ligji për duhanin, edhe vidhet tatimi, që do të thotë do të ketë mundësi të kontrollohet prej më tepër institucioneve. Mirëpo, mendoj se Kosova në këtë fazë nuk është e përgatitur që duhani të ndalohet plotësisht, për shkak se nëse ndalohet plotësisht, përsëri nuk do të respektohet dhe nëse duam ta kufizojmë numrin e duhanpirësve dhe vendeve ku pihet duhani, nuk e ndalojmë plotësisht, sepse atëherë pihet gjithkund, por e ndalojmë aty ku kemi mundësi dhe i lejojmë vendet e caktuara që, ata që pinë duhan, të cilët ia kanë nisur të pinë duhan kur nuk ka qenë e ndaluar - by the way, domethënë po flasim gati për diçka retroaktive këtu, ata i kanë vendet e caktuara. Çka ndodh në atë rast? Është ajo që në vendet ku pihet duhani, me siguri çmimi i pijeve dhe i ushqimit do të jetë më i lartë, e ata njerëz që zgjedhin të paguajnë për t'u helmuar mund të shkojnë të zgjedhin të paguajnë aty.

Domethënë, këto janë temat të cilat unë desha t'i përmend për projektligjin. Me siguri se do të bashkëpunojmë me ministrin e Shëndetësisë, edhe me ministrin e Financave, që një amendament eventual i caktimit dhe i deklarimit të zonave ku duhanpirësit mund të pinë duhan, ndoshta mund të sjellë një dalje prej kësaj situatë dhe atëherë të jemi shumë

rigorozë për ato vende ku nuk lejohet pirja e duhanit, përderisa diku tjetër të lejohet. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Petar Miletqi.)

PETAR MILETIQ: Hvala! Reč ima poslanik Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Përshëndetje, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Tani fare në fund është e pamundur të mos përsëritet diçka dhe unë kërkoj falje nëse ndodh kjo, por unë dua të vij te një çështje që mendoj se ky ligj do ta ketë një problem.

Plotësisht pajtohem me qëllimin dhe me vullnetin e mirë që e ka ligji, por thjeshtë dyshoj se do t'i kemi efektet që po i dëshirojmë. Unë po përsëris diçka edhe nga ajo që u tha. E para, ka pas kohë së paku prej momentit kur është krijuar ideja që të amendamentohet ligji, ka zgatur tre apo gjashtë muaj, apo një vit, se më vonë dëshmitë se cili është kapaciteti në implementim të këtij ligji ekzistues për të na bindur se ne mund ta implementojmë një ligj në të ardhmen. Dhe, nëse është konstatuar se ligji ekzistues nuk po jep rezultate, si duket dikujt i ka rënë ndërmend se duke qenë më rigoroz, atëherë me një akt ne ta rregullojmë një problem siç duhanpirja, që unë besoj se këtu ekziston një lajthitje, sepse shumë më lehtë paska qenë të bëjmë ligje tepër të forta, e të mos ndërmerret kurrgjë, sepse ligji vetvetiu implementohet. Por, nuk është ashtu.

E dyta, sikur të kishim dëshmuar ne si vend me këtë ligj se e kemi luftuar informalitetin, pra që diku afro 40% e cigares - duhanit hyn në formë të fshehtë në këtë vend, pastaj kualiteti i atij duhani, sasia e materieve të dëmshme, që s'kemi bërë kurrgjë hiç, dhe për një moment ballafaqohemi me një ligj shumë të mirë, por që do të jetë shumë vështirë. Por, ajo që tani dua të them: Cili do të jetë problemi, sipas mendimit tim? Problemi do të jetë te ajo drejtësia selektive. Unë e kam një përvojë personale. Kur ishte koha e futjes në cisterna të naftës ilegale në Kosovë, kam qenë dëshmitar një herë kur një qytetari, te stadiumi i ri, tek Ura e Suhodollit, janë marrë dy litra naftë dhe distanca ndërmjet pompës së benzinës ku kishte naftë dhe ku ishte vendosur policia ishte vetëm një urë. Policia nuk e ruante pompën e benzinës, por e priste qytetarin kur dilte në këtë anë ia mori një litër naftë apo benzinë domethënë prej dy litrave dhe e "shpëtoi këtë vend, e shpëtoi këtë shtet". Do të thotë, dyshimi ishte se në atë pompë të benzinës po shkon cisterna, ndërsa qytetarin e priste me dy litra naftë. Dhe unë tash po them, nëse ky ligj hyn menjëherë kështu, pa u amendamentuar, sidomos amendamenti neni 9, pika 2, 4 edhe 6, që janë shumë qesharake, atëherë unë do të them i lumi ai që i ka inspektorët e njohshëm, e atij i vijnë pas gjashtë muajve, i punon lokali, i punon restoranti etj., e vaj halli për atë që ia ka marrë inat, edhe kurdo del e i thotë "ku po e pi duhanin në rrugë, apo në restorant?" etj.

Edhe unë pyes: A kemi kapacitet ta implementojmë këtë ligj, apo do të fillojnë të bëjmë drejtësi selektive, dikujt t'i themi "mirë, ty po të punon lokali", dikujt t'i themi: "ti paguaj nga 5 000, 10 000, 7 000 e 20 000". Unë dyshoj në këtë, sepse nuk kemi dhënë dëshmi që mund ta implementojmë këtë ligj, që është shumë i mirë. Prandaj, unë pajtohem edhe me

deputetin Gjini, sikur të kishin dhënë dëshmi që ngadalë-ngadalë në progres të shkojmë, sepse vendet ku është marrë ky ligj kanë filluar së paku ta 20 vjet ta implementojnë këtë ligj dhe tash kanë të drejtë t'i thërrasin të gjitha këto masa që po ceken në ligj. E ne që po startojmë thua gati prej zeros, me këto masa është e pamundur që t'i trajtojmë të gjithë ata shkelës të ligjit dhe është e pamundur të kemi kapacitete, por do të fillojmë ngadalë e ngadalë të bëjmë drejtësi selektive dhe të bëjmë hile, siç kemi bërë shumë herë deri tash.

Unë i përgëzoj të gjithë ata që besojnë se ky ligj mund të implementohet dhe e përshëndes qëllimin e ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Reç ima poslanik Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm se duhanpirja është problem i madh i shëndetit publik dhe në këtë drejtim unë e përshëndes ministrin e Shëndetësisë për sjelljen e këtij projektligji në Kuvend, me qëllim që ta mbrojë shëndetin e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme.

Nëpërmjet këtij projektligji duhani ndalohet t'u shitet fëmijëve, përkatësisht personave nën moshën 18-vjeçare. Bile propozoj që mund të precizohet në rast të dyshimit të moshës, shitja e duhanit t'u bëhet vetëm personave që kanë letërnjoftim, siç është praktikë në shumë vende të botës. Jam i vetëdijshëm që gjenerata e vjetër ose duhanpirësit duhet të kenë mirëkuptim dhe do ta zbatojnë ligjin për hir të rendit të vendosur dhe për ruajtjen e shëndetit publik, përkatësisht për ruajtjen e shëndetit të gjeneratave të reja. Masat e vendosura janë të pranueshme dhe thërras për zbatimin e ligjit në nivele sa më të larta, respektivisht që Inspektorati ta kryejë punën e vet.

Përshëndes edhe ndalimin e reklamimit të këtij produkti me qëllim që ta ruajmë shëndetin e qytetarëve dhe ta kemi parasysh që shëndeti është para përfitimit ekonomik. Nuk na duhet pasuria kur s'kemi me çka ta gëzojmë atë. Po e përfundoj fjalimin tim me thënien e mirënjohur: "Duhani vret". Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Reç ima poslanik Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues Miletiq!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Sot për shqyrtim e kemi një projektligj, i cili, sa është i rëndësishëm, është edhe aq delikat.

Projektligji për kontrollin e duhanit është i rëndësishëm, meqenëse për synim e ka një ambient pa tym apo një ambient të pastër. Pastaj, kjo ndërlidhet edhe me shëndetin e popullatës, kurse në mënyrë indirekte edhe me reduktimin, shpenzimet për trajtimin e sëmundjeve që shkaktohen nga duhani. Ndërkaq, është delikat meqenëse duke synuar një ambient pa tym nuk janë marrë parasysh interesat edhe të drejtat e shumë subjekteve që

ndërlidhen me këtë çështje. Mënyra se si është hartuar ky projektligj e shkel Kushtetutën aty ku bëhet fjalë për të drejtat dhe liritë e njeriut, pastaj për të drejtën e pronës, si dhe për të drejtat komerciale të shumë subjekteve afariste. Në të njëjtën kohë ka rrezik që Buxhetit të Kosovës t'ia mbyllim një burim të rëndësishëm të parasë, meqenëse vjet importi i duhanit dhe i zëvendësuesit të tij ishte afro 50 milionë euro.

Për arsytet e përmendura, kur kemi parasysh përmbajtjet e këtij dokumenti, atëherë kur në fakt nuk do të jetë Ligji për kontrollimin e duhanit, por për ndalimin e qarkullimit dhe të konsumit të duhanit, këtë të drejtë nuk e ka askush, meqenëse ajo bie ndesh me Kushtetutën dhe me Konventën Ndërkombëtare, përkatësisht me agjencitë qeveritare, me secilin kontakt me industrinë e duhanit. Kjo nuk është zgjedhje e mirë, duke pasur parasysh se për rregullimin e tregut të duhanit pa dyshim se duhet koordinimi me industrinë e duhanit. Kush mund të kontribuojë më shumë në parandalimin e kontrabandës së këtij artikulli, pos industrisë së duhanit?

Unë do t'i kisha cekur disa nene, të cilat edhe parafolësit i përmendën, por më duket pak më i ndërlikuar është neni 9, pika 2, për ndalimin e ekspozimit në pikat e shitjes. Ky nen e shkel të drejtën dhe lirinë komerciale, rrezikon tregun e lirë dhe të konkurrencës, por edhe të drejtën e konsumatorit të moshës madhore që ka të bëjë me përzgjedhjen e artikullit të markës që ai e dëshiron. Kjo ndalesë, sikur edhe insistimi që në pakot e cigareve të vendosen fotot që dekurajojnë pijen e duhanit nuk sjellin asnjë efekt të reduktimit të konsumimit të tij. Për këtë kemi shumë shembuj në Evropë dhe në rajon, po i përmend disa vende vetëm të rajonit: Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria, Sllovenia, Turqia, Kroacia dhe shumë vende të tjera, ku ekziston ekspozimi i duhanit nëpër minimarkete dhe në vendet ku është duke u shitur, e unë mendoj që duhet të lejohet shitja e këtij produkti, të jetë i ekspozuar dhe ta dijë konsumatori se çfarë cigaresh duhet të përdorë, apo ta blejë.

Në këtë nen përfshihen edhe aparatet për shitjen e cigareve, të vendosura në ambiente publike. Pse duhet hequr dorë edhe nga një praktikë e njohur në botë? Të gjithë e dimë se aparatet për blerjen e duhanit ekzistojnë, jo vetëm në Ballkan, por edhe në shtetet e Evropës dhe me heqjen e tyre i shkelim të drejtat e njeriut, i cili në mbrëmje, për shembull, kur të gjitha lokalet mbyllen dhe nuk ka ku ta blejë duhanpirësi, mund të blejë duhan në ato aparate, të cilat duhet të jenë të vendosura në ambiente publike. Duhet të insistojmë që instalohen aparate speciale, të cilat nga blerësit kërkojnë që nëpërmjet dokumenteve personale ta identifikojnë moshën. Nuk ka cigare për ata nën moshën 18-vjeçare, edhe nëse përdoren dokumentet e prindit, apo të ndonjë personi tjetër, atëherë kjo mbetet përgjegjësi e tyre. Kështu aparatet në këtë kohë janë të tilla ku mund të blihet vetëm me ndonjë kartelë, apo me letërnjoftim. Dhe unë propozoj që të gjitha ato aparate, të cilat janë këtu edhe nuk e kanë një kartelë që mund të blejnë cigare, atëherë duhet të ndërrohen dhe të sjellin aparate të tjera.

Pika tjetër është shitja e cigareve në rrugë, përkatësisht nga fëmijët. Plotësisht e përkrah synimin që këta fëmijë të largohen nga rruga dhe të merren me ndonjë punë më të përshtatshme për moshën e tyre, apo të jenë në shkollë. Kjo ndalesë nuk mund të bëhet në mënyrë represive, por duhet ofruar zgjidhje të pranueshme për ta. Këtë shqetësim e

dëgjova edhe dje në konferencën për shtyp të Odës Ekonomike dhe të përfaqësuesve të tregtarëve me pakicë në Kosovë, të cilët e paraqitën një petition, nga 4 000 kioska, për ta kundërshtuar Projektligjin e paraqitur aktual, si pasojë e ndalimit të shitjes në mënyrë të dukshme të duhanit, ku bëjnë pjesë prej 12 mijë deri 18 mijë familje, të cilat jetojnë me këtë shitje direkte apo indirekte dhe e kanë financim të tyre.

Krejt në fund, më duhet të them se projektligji, në mënyrën si është prezantuar, nuk është zgjidhja. Ai do t'i favorizojë veprimet kriminale, meqenëse fillimisht nuk është punuar fare në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për dëmet që shkakton konsumimit i duhanit. Ndërkaq, shërbimi i inspektoratit nuk ka kapacitete për të krijuar rend në këto fusha, e as kompetenca të veprorë në preventivë.

Dhe, në parim, unë propozoj që të votohet ky projektligj, por me ndryshimet të cilat u cekën nga shumë deputetë dhe kishin të bënin më së shumti me dy pika: për ekspozimin e duhanit, nga çdo deputet pati vërejtje, dhe për aparatet, të cilat në projektligj thuhet që çdo aparat të konfiskohet nëse gjenden në territorin e Kosovës. Për këtë arsye, unë mendoj se me këto dy ndryshime, të cilat Ministria e Shëndetësisë duhet t'i aprovojë, të ndryshohen këto në komisionet përkatëse të tyre, të cilat do ta vazhdojnë punën e tyre dhe unë jam për ta mbështetur këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Reç ima poslanik Muhamet Mustafa, ukoliko želite.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,

Unë do të diskutoj shumë shkurt. Mendoj se duhet përshëndetur të gjitha masat dhe projektligjet që po i sjell Ministria e Shëndetësisë, që kanë të bëjnë me duhanin dhe me zvogëlimin e konsumimit të tij. Shembuj të suksesit në këtë drejtim kemi. Përhapja e duhanpirjes në shumë vende të rajonit, sidomos në Turqi, ka qenë ndoshta edhe më e madhe se në Kosovë, por sot atje ekziston një ligj që respektohet në mënyrë rigorozë.

Megjithatë, mendoj se disa dispozita të këtij ligji mund ta rritin informalitetin dhe ta dëmtojnë edhe buxhetin, t'i dëmtojnë edhe bizneset. Esenciale është që me ligj ne ta ndalojmë pirjen e duhanit, aty ku në këtë moment i pengon ata që nuk e pinë duhanin. Le të fillojmë prej këtij hapi. Le të jemi rigorozë. Për shembull, në një kafene nuk mund të pihet duhan, gjysma të pinë duhan, gjysma jo. Unë e mbështes atë. Se kjo kur në gjysmën e kafenesë pihet duhan, e në gjysmën tjetër jo, kjo nuk po ndihmon asgjë, faktikisht. Por, le të ketë edhe kafene ku mund të pihet duhani, aty ku janë duhanpirësit dhe ku dikush shkon me vullnet. Si fazë kalimtare, duhet të shkojmë në proces. Kjo që, faktikisht, e bën gati pothuajse gjysmë-ilegale shitjen e duhanit, unë jam i bindur që do ta rrisë informalitetin për një artikull, i cili ka akcizë dhe i cili ka rëndësi edhe për buxhetin, edhe për të tjerët. Nuk do të ndikojë në uljen e pirjes së duhanit, por do të ndikojë në dëmtimin e buxhetit. Dhe gjithashtu do të ndikojë në një transparencë më të vogël rreth çmimeve, rreth kontrollit të cilësisë, kështu që le të veprojmë siç veprojnë shumica e vendeve në Evropë, ku duhani është i ekspozuar në kënde të caktuar të shitoreve, njerëzit e blejnë, e dinë çmimin, e dinë cilësinë, e të mos e teprojmë ne me masa radikale.

Esenciale është që duhanpirësit të mos dëmtojnë ata që nuk pinë duhan. Kjo faza e parë. Faza e dytë, shkojmë me masa më radikale. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

NËNKRYETARI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë do ta paraqes shqetësimin, i cili ishte më herët, edhe në ligjin që ishte nga sponsoruesi, në këtë rast nga ministri i Shëndetësisë. Pikërisht ka të bëjë me çështjen e deklaratës financiare dhe pikërisht ka të bëjë me koston shtesë buxhetore, meqë edhe në këtë projektligj është paraqitur kosto shtesë buxhetore, e cila nuk është e aprovuar me buxhetin e vitit 2012 dhe njëkohësisht nuk është në kornizën afatmesme, 2013-2015.

Ministër, shqetësimi është ky sepse ne në këtë Parlament i kemi aprovuar edhe disa ligje të tjera, të cilat kanë pasur të bëjnë me kosto shtesë buxhetore dhe pa buxhet fare, dhe këto ligje realisht nuk po implementohen. Do të thotë, krejt esenca dhe qëllimi, pavarësisht nga vërejtjet që janë thënë nga kolegët se këto dy projektligje, edhe ky projektligj në këtë rast, kanë disa defekte, të cilat mund të korrigjohen edhe në amendamentimin e dytë, njëkohësisht shqetësimi im është se me kosto shtesë buxhetore, e cila nuk është e aprovuar as me buxhetin e vitit 2012, e nuk është në kornizën afatmesme 2013-2015, ne realisht po bëjmë shkeljen e Rregullores, edhe të Rregullores së Qeverisë, e po ashtu të Rregullores të Parlamentit. Prandaj, do të ishte mirë që të kihen këto parasysht. Kjo vlen edhe për krejt Qeverinë, që të sjellë ligje me kosto buxhetore të mjaftueshme dhe ato të jenë të implementueshme pas aprovimit nga Parlamenti i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuleta e ka fjalën, i fundit.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke qenë se në fjalën e saj deputetja Bakalli e vuri në pah domosdoshmërinë e këtij ligji për shkak të peshës së madhe që ka në mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve dhe në mbështetjen që ne si subjekt i japim atij, unë nuk do ta zgjas shumë. Megjithatë, unë dua ta theksoj këtu një brengë timen që nga diskutimet doli të mos jetë vetëm e imja sa i përket njërës nga masat që parashihen në këtë ligj.

Fjala është për masën e paraparë në kreun 5, neni 9, pika 2, ku thuhet: “Produktet e duhanit nuk lejohen të vendosen, apo të jenë të dukshme në asnjë vend të shitjes, përveç se të jenë të dukshme në momentin e transaksionit të shitjes dhe nuk duhet të jenë të shfaqura për qëllime komerciale në asnjë vend tjetër”. Sa i përket këtij neni, shqetësimi kryesor është rreziku për efektet anësore që mund të prodhojë ai, të cilat po i numëroj më poshtë: nxitja e kontrabandës, mbajtja në vend të fshehtë mundëson shitjen e cigareve pa banderola në pako, gjë që rrit kontrabandën dhe ka implikime gjithashtu edhe në buxhetin e shtetit, nxitja e korrupsionit, do të thotë kompanitë e caktuara mund t’i korruptojnë shitësit e caktuar, në mënyrë që t’i privilegjojnë produktet e tyre. Dëmtimi anësor i shitësit, kjo është një brengë e të gjithë shitësve që u përmend këtu shumë fuqishëm,

angazhimi i shitësit për ta nxjerrë pakon e cigareve nga vendi i fshehtë u krijon një hapësirë klientëve të pandershëm që të mos e marrin fshehurazi ndonjë produkt tjetër të ekspozuar.

Pra, arsyeja pse e shtrova këtë çështje është e thjeshtë: të jemi të kujdesshëm dhe ta trajtojmë me shumë vëmendje këtë çështje, në mënyrë që të mos gabojmë, që duke e bërë një të mirë të shkaktojmë disa të këqija të tjera. Me këtë rast, në funksion të arritjes së qëllimit të këtij ligji është për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve, ne po krijojmë vështirësi në zbatimin e ligjeve të tjera gjithashtu të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndalimin e kontrabandës dhe të korrupsionit.

Në fund, ligjin do ta votojmë, kurse këtë shqetësim do ta adresojmë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Ju faleminderit për këtë debat përmbajtjesor dhe në përgjithësi për përkrahjen në parim të Projektligjit. Natyrisht që ju falënderoj edhe për sugjerimet dhe komentet që i dhatë, për vërejtjet dhe propozimet për përmirësimin e tij.

Unë vetëm desha të theksoj se nuk kemi të bëjmë me ndryshime radikale dhe të përnjëhershme, megjithatë kemi të bëjmë me amendamentim të një ligji ekzistues, i cili është në zbatim e sipër me vështirësi të mëdha tani e disa vite. Arsyeja pse i është hyrë ndryshimit të këtij projektligji ka qenë kërkesa e Inspektoratit Sanitar, që e ka mbikëqyrur zbatimin e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe kërkesa e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës, i cili ka dhënë rekomandime konkrete se në çfarë drejtimi të shkohet në amendamentimin e këtij projektligji.

Arsyeja kryesore që është identifikuar pse ligji ekzistues nuk është zbatuar ka qenë ndarja e ndalesës së përdorimit të duhanit në 70% me 30% të hapësirave publike, që ka qenë shumë vështirë të monitorohet dhe ky është identifikues si një nga problemet kryesore dhe projektligji e adreson këtë sfidë.

Çështja e dytë që u shtrua këtu dhe u aktualizua e u debatua shumë ishte çështja e ekspozimit në pikat e shitjes. Kjo dispozitë ligjore është në ligjin aktual, kjo dispozitë ligjore nuk po sillet me këtë ligj, kjo dispozitë ligjore është në ligjin aktual dhe është detajuar, është elaboruar mënyra se si mund të mbikëqyret më mirë zbatimi i kësaj dispozite me projektligjin, të cilin tani e keni para jush. Pra, kjo dispozitë ligjore nuk ka arritur të monitorohet në mënyrë adekuate. Ka pasur shkelje ligjore në këtë aspekt për arsye se s'ka qenë qartë e elaboruar. Tash me këtë kemi propozime shumë konkrete, të cilat shkojnë deri atje sa monitorimi do të jetë më i lehtë.

Unë ju kisha lutur, të nderuar deputetë, që kur të diskutojmë për baraspeshën dhe balancën ndërmjet interesave ekonomike dhe shëndetësore të qytetarëve ta kemi të qartë

se nuk ka asnjë investim më të madh në ekonominë e një vendi se sa investimi në shëndetin e qytetarëve të atij vendi dhe të fuqisë punëtore, e cila de fakto atë vend duhet ta çojë përpara. Dhe, në qoftë se konsumimi i duhanit nuk e ka efektin aty për aty, nuk duhet harruar se pasojat e konsumimit të duhanit janë shumëvjeçare, shihen pas shumë dekadave dhe janë të vazhdueshme, dhe shtrihen nga gjenerata në gjeneratë dhe kostoja e përdorimi të duhanit është shumëfish më e madhe se sa janë të ardhurat që vijnë nga tatimet ose doganat në kufi.

Çështja e kontrabandës - sikur ne nuk do miratonim ligje vetëm për shkak të frikës se mos po rritet kontrabanda, atëherë shumë ligje nuk do t'i kishim miratuar në këtë Kuvend, ose ato do të ishin shumë më të dobëta sesa që janë. Është çështje e institucioneve shtetërore ta monitorojnë dhe zbatojnë ligjin. Në qoftë se nuk janë të gatshme ta zbatojnë ligjin, atëherë duhet ndryshuar ata të cilët i udhëheqin, përndryshe si do ta synojmë avancimin e shtetit? Në çfarë mënyre ne mund të mendojmë për një shoqëri më të përparuar, për një shtet më bashkëkohor, në qoftë se nuk i ngremë edhe kapacitetet për zbatimin e ligjeve?

Prandaj, unë ju kisha lutur që projektligji të mbështetet në parim, e ajo që për mua është më me rëndësi, zbatimi i një ligji të tillë e kërkon një konsensus të gjerë shoqëror. Në qoftë se ky konsensus nuk arrihet në institucionet e shtetit, në të gjitha nivelet, në të gjitha degët e institucioneve të vendit, si në Kuvend, ashtu në Qeveri, po edhe në Gjyqësor, që është një segment shumë i rëndësishëm se do t'i zbatojë ato masa ndëshkimore, pra në qoftë se nuk ekziston një koherencë e të gjithë këtyre faktorëve, atëherë do ta kemi shumë vështirë ta zbatojmë këtë ligj. Në qoftë se në Kuvendin e Kosovës fillojnë dilemat të paraqiten lidhur me atë se a duhet apo jo të kemi një qasje rigoroze ndaj parandalimit të përdorimit të duhanit, parandalimit të sëmundjeve dhe çrregullimeve në popullatë, atëherë do të kemi shumë probleme në zbatimin e këtij ligji, duke pas parasysh fuqinë e institucioneve të vendit, fuqinë e inspektorateve. Por, në qoftë se e kemi një konsensus të gjerë publik për nevojën e parandalimit të përdorimit të duhanit me të gjitha masat e mundshme, të cilat janë të dokumentuara në legjislacionet e shteteve tjera demokratike, evropiane, në radhë të parë, atëherë të jemi të bashkuar dhe unikë rreth kësaj dhe të provojmë ta lëmë anash këtë dilemë.

“Është ky ligj anti-ekonomik!” Si mund të jetë një ligj, i cili është për shëndetin publik të qytetarëve të vendit anti-ekonomik? Për mua kjo është e pakuptueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua të cek së pari që qytetarët e Kosovës pinë duhan të keq, të helmuar, të prodhuar pa standarde dhe të pakontrolluar. Dhe, fenomeni i dytë, që është shumë më i rëndë, te ne akoma konsiderohet nder t'ia ofrosh dikujt një cigare. Prandaj, ne vërtet duhet të zhvillojmë fushata edhe nëpër zonat rurale, edhe gjithkrah, që të mos e konsiderojmë cigaren nder, por helm. Në qoftë se këtë e bëjmë, besoj që kemi fituar edhe mbi ligjin.

Unë ju falënderoj! Nuk kemi kuorum për ta votuar këtë projektligj, prandaj vazhdojmë nesër në orën 10:00. Mirupafshim!

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes më 2.11.2007, e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Kemi pritur më shumë se 10 minuta akademikë. Deputetët i kemi pritur 20 minuta, por nuk kanë ardhur, e pasi nuk kemi kuorum për votim, seanca shtyhet për të hënë, në orën 11:00. Faleminderit!

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes më 5.11. 2012, e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 1 nëntor 2012.

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Para se të fillojmë me pikën e mbetur të rendit të ditës, u kërkuar nga Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re që të njoftojmë me përbërjen e re të anëtarëve në komisionet parlamentare.

Me propozimin e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re dhe Grupit Parlamentar të SLS-së propozohen zëvendësimet, si vijon: deputeti Gëzim Kelmendi emërohet anëtar në Komisionin për Amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës në vend të deputetit Amir Ahmeti. Deputeti Gëzim Kelmendi emërohet anëtar në Komisionin për Legjislacion në vend të deputetit Amir Ahmeti. Deputetja Sevdije Lama emërohet anëtare në Komisionin për Buxhet dhe Financa në vend të deputetit Muhamet Mustafa. Deputeti Danush Ademi emërohet anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje në Forcën e Sigurisë së Kosovës në vend të deputetit Emin Gërbeshi. Deputeti Boban Todoroviq emërohet anëtar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në vend të deputetit Emin Arifi. Këto ishin sa për njoftim.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

- Votimi në parim i Projektligjit për kontrollin e duhanit

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në mbledhjen plenare të datës 1 nëntor 2012, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar votimi.

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!
Të pranishëm janë 78 deputetë.

Konstatohet se me 59 vota për, 4 kundër, 3 abstenime Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kontrollin e duhanit. Ngarkohen komisionet funksionale dhe komisionet

e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim. Zëvendëskryeministri nuk është këtu, prandaj kalojmë në pikën tjetër.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e pagesave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore dhe ekspertët e Bankës Botërore, e ka hartuar Projektligjin për sistemin e pagesave, i cili sot është para jush dhe i cili ka për qëllim rregullimin ligjor të sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës.

Nëpërmjet këtij ligji do të përcaktohet një infrastrukturë ligjore bashkëkohore në pajtim me direktivat përkatëse të kësaj sfere të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, dëshiroj që të ju informoj se me nxjerrjen e këtij ligji do të shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/26 e datës 8 tetor 2001. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka paraparë të nevojshme që infrastruktura ligjore në këtë fushë të plotësohet dhe azhurnohet nëpërmjet zëvendësimit të kësaj rregulloreje me nxjerrjen e Ligjit për sistemin e pagesave.

Nxjerrja e këtij ligji pritet të ndikojë substancialisht në avancimin e efikasitetit të procesit të kryerjes së pagesave, si dhe ta përshpejtojë modernizimin e sistemit të pagesave në vend. Projektligji e rregullon në mënyrë të detajuar sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës dhe është një projektligj që përmban 59 nene të strukturuara në katër pjesë. Miratimi i këtij ligji nuk do të ketë kosto për Buxhetin e Republikës së Kosovës, sidoqoftë miratimi i tij mund të krijojë të hyra shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Duke e konsideruar Projektligjin për sistemin e pagesave si një projektligj që i plotëson të gjitha standardet ndërkombëtare në fushën e pagesave, rekomandoj që të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka, nëse e do, kryetarja e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj. Nënkyetari Naser Osmani e ka fjalën!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për sistemi e pagesave e rregullon çështjen e licencimit, operimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës, si dhe i përcakton të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në sistemin e pagesave, operatorëve dhe institucioneve që ofrojnë shërbime të pagesave.

Me këtë projektligj shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut mbi transaksionin e pagesave dhe Rregullën 18 mbi kliringun dhe funksionimin e llogarive për shlyerje të pagesave që e ka rregulluar këtë fushë deri më tani dhe bëhet avancimi në konsolidimin e bazës ligjore që ka të bëjë me veprimtaritë bankare, financiare dhe ato bankare të institucioneve që angazhohen në qarkullimin e pagesave me qëllim të garantimit të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave dhe si i tillë projektligji në pajtim me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian që e rregullojnë këtë fushë.

Çështjet kryesore të adresuara në këtë ligj janë: rregulli sipas të cilave autorizohen institucionet e pagesave që ofrojnë shërbime të pagesave dhe licencohen operatorët e sistemit të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave në vlerë nga Banka Qendrore, kushtet dhe standardet, sipas të cilave mund të ofrohen shërbime të tilla dhe mund të funksionojnë sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së pagesave, si dhe mjetet dhe procedurat sipas të cilave Banka Qendrore i ushtron kompetencat e saj mbikëqyrëse.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 10.10.2012, e ka shqyrtuar Projektligjin për sistemin e pagesave dhe ka vlerësuar se projektligji përmbush kushtet formalo-juridike të parapara me Rregulloren e Kuvendit, që do të thotë se Projektligji përmban memorandumin shpjegues për objektivat që synon të realizojë ligje dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, projektligji përmban edhe deklaratën për ndikimet buxhetore që vlerësohet pa kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe deklaratën për përafrimin dhe harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e sistemit të pagesave. Komisioni ka vlerësuar se projektligji është i hartuar mirë në aspektin formalo-juridik dhe sipas ndarjes së dispozitave dhe në gjuhë zyrtare për hartimin e legjislacionit dhe si i tillë i përmbush kushtet për miratim në parim. Prandaj, komisioni njëzëri i rekomandon Kuvendit ta miratojë në parim Projektligjin për sistemin e pagesave.

Zoti kryesues, nëse më lejoni që edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të konstatoj se ligji do të votohet, për arsye se është një ligj i mirë, meqë në kohën e fundit jemi mësuar me ligje të mira që e rregullojnë fushën e financave dhe të ekonomisë, si ato që vijnë edhe nga Banka Qendrore edhe nga Ministria për Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash do t'i dëgjojmë deklaratimet e grupeve politike në Parlament. Për PDK-në, Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për sistemin e pagesave është një projektligj i rëndësisë së veçantë, i cili e shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë projektligj dhe në parim e mbështet, duke pasur parasysh se me këtë projektligj përcaktohen rregullat, sipas të cilave autorizohen institucionet e pagesave që ofrojnë shërbime të pagesave dhe licencohen operatorët e sistemeve të pagesave, të kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë nga Banka Qendrore.

Po ashtu, me këtë projektligj përcaktohen kushtet dhe standardet, sipas të cilave mund të ofrohen këto shërbime, si dhe përcaktohen mjete dhe procedura, sipas të cilave Banka Qendrore i ushtron kompetencat e saj mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe rastin e falimentimit të ndonjë pjesëmarrësi në sistem. Ky projektligj është në përputhje të plotë me direktivat e BE-së dhe nuk përmban kosto shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Atëherë, gjithë kontributin tonë si Parti Demokratike do ta japim në Komisionin Funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, shefi i Grupit Parlamentar, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë këtë ligj. Natyrisht që vërejtjet tona, që mund t'i kemi teknike, do t'i japim nëpërmjet komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Ministra dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar këtë projektligj. Ky projektligj e rregullon infrastrukturën ligjore në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian, e rregullon licencimin, operimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës në përputhje me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj do ta forcojë bazën ligjore të sistemit të pagesave për bankat dhe institucionet jobankare dhe institucionet tjera që merren me qarkullimin e pagesave, me qëllim të garantimit dhe të sigurisë dhe efikasitetit të këtyre pagesave. Thamë edhe në fillim, edhe nga ministri dëgjuam që e shfuqizon edhe Rregulloren e UNMIK-ut, e cila ka pasur të meta të shumta rreth qarkullimit dhe sistemit të pagesave. Prandaj, Grupi i Aleancës e përkrah në parim dhe vërejtjet tjera, si dhe kontributin e vet do ta japë në

Komisionin Funkcional dhe komisionin e përhershëm, ku do të kalojë projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

I Parlamentarna grupa “6+” je razmatrala ovaj Nacrt-zakona o platnom sistemu, i s obzirom na to da reguliše vrlo važne stvari, mi ćemo ga podržati u načelu. Svoj doprinos daćemo kroz rad u funkcionalnoj Komisiji. Hvala!

KRYESUESI: Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëndetje për ministrat dhe deputetët!

Duke marrë parasysh prezantimin që e bëri ministri për Projektligjin për sistemin e pagesave mund të themi se edhe ne si Koalicion për Kosovë të Re e kemi shqyrtuar dhe e kemi parë rëndësinë e tij dhe përpunimin e këtij projektligji, e mund të themi se ka ardhur një projektligj në mënyrën më të duhur të përpunuar dhe mund të themi se me këtë projektligj e kemi shfuqizimin e Rregulloreve të UNMIK-ut, që do të thotë se ky projektligj është në përputhje me Ligjin për Bankat Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në parim, Koalicioni për Kosovë të Re do ta përkrahë projektligjin dhe të gjitha mundësitë që i ka do t'i japë në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Si deputet, fjalën e ka kërkuar Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari, zoti nënkryetar Hamiti!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Ligji për sistemin e pagesave është dokumenti më i rëndësishëm për ndërtimin e raporteve dhe përgjegjësi në këtë sistem.

Pra, secili institucion apo individ i kyçur këtu në çfarëdo mënyre e ka përgjegjësinë për rregullshmërinë e pagesave, për korrektësinë gjatë dhënies së shërbimit. Duke i pasur parasysh këto çështje, atëherë ligji duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për secilin qytetar, e jo vetëm për bankierët dhe profesionistët e kësaj fushe. Kjo është me rëndësi, meqenëse secili qytetar mund të jetë pjesëmarrës në sistemin e pagesave nëpërmjet ‘kesh’-it, kartelës apo pagesave elektronike.

Stili me të cilin është hartuar ky ligj, si dhe terminologjia e përdorur janë mjaft të rënda, me fjalë të stërzgjatura, të cilat nganjëherë krijojnë konfuzion. Po ashtu, ai është mjaft i rëndë për t'u kuptuar, posaçërisht në kaptinat që e rregullojnë raportin ndërmjet institucionit të pagesave dhe klientëve dhe qytetarëve. Mirëpo, është e qartë se kemi të bëjmë me një ligj specifik, me një rëndësi të veçantë, prandaj edhe është i dominuar nga terminologjia profesionale, e cila mund të jetë e paqartë për qytetarin e rëndomtë,

pjesëmarrës në sistemin e pagesave. Kur e kemi parasysh këtë gjendje, atëherë do të ishte mirë që tekstit të këtij ligji t'i bëhet edhe një reduktim dhe lekturë, në mënyrë që të eliminohet konfuzioni që vërehet në disa nene, apo edhe të thjeshtësohet terminologjia, por vetëm deri në masën sa nuk e dëmton përmbajtjen e tij.

Po ashtu, në disa nene ka gjëra që nuk janë të sqaruara sa duhet. Me këtë rast po i paraqes disa vërejtje konkrete: 1) neni 5 - operimi i sistemeve, në pikën 2.2.6 bëhet fjalë për personat e propozuar për anëtarë të menaxhmentit të lartë të operatorit të sistemit, ndër tjera në këtë pikë kërkohet që ata të jenë profesionalisht të kualifikuar dhe të ndershëm. Këtu askund nuk bëhet fjalë për nivelin e kualifikimit të këtyre kandidatëve, e as të përcaktohet ndonjë mënyrë për verifikimin e ndershmërisë së tyre.

Në nenin 6 - procedurat e autorizimit dhe të licencimit. Në pikën 1.2 aplikuesit i kërkohet që ta paguajë një tarifë të pakthyeshme të caktuar nga Banka Qendrore. Askund nuk tregohet se për çfarë shume bëhet fjalë dhe cili është qëllimi i kësaj pagese, apo ndoshta kjo i është lënë Bankës Qendrore ta rregullojë me një akt të veçantë, por as kjo nuk thuhet askund.

Pika 1.5 e po këtij neni bën fjalë për refuzimin e licencës. Në fund, thuhet se aplikuesi ka mundësi të ankohet dhe sërish të paraqesë kërkesë. Por, kujt t'i ankohet dhe kur mund të paraqesë këtë kërkesë. Në këtë ligj nuk e cakton se çka domethënë kjo.

Në pikën 1.6 të po këtij neni i lejohet Bankës Qendrore që gjatë procesit të dhënies së aprovimit ta kufizojë këtë me një numër kërkesash dhe kushtesh. Së pari, cila është arsyeja që Banka Qendrore mund të bëjë kushtëzime dhe, e dyta, cilat duhet të jenë këto kërkesa dhe arsye që kjo çështje të mos mbetet në nivel të disponimit individual. Atëherë në mënyrë të përafërt duhet të saktësohet kërkesa dhe kushtet që mund t'i parashtrojë në Bankën Qendrore dhe për këtë duhet të ceket në këtë ligj se çka duhet të përcaktojë nga Banka Qendrore.

Neni 11 - kufizimi qasjes. Pika 3 siguron që kufizimi i qasjes të jetë i drejtë dhe jodiskriminues, mirëpo nuk thuhet asgjë më shumë dhe nuk është e qartë se kush e garanton qasjen e drejtë dhe jodiskriminuese që do ta ketë Banka Qendrore. Sa do që kjo mund të jetë e kuptueshme për shkak të rëndësisë që ka ky institucion, megjithatë këto gjëra duhet të sqarohen nëpërmjet këtij ligji. Janë këto vetëm disa vërejtje konkrete në kaptina dhe nene të këtij ligji që kanë të bëjnë me mënyrën e licencimit të subjekteve pjesëmarrëse në sistemin e pagesave dhe mbikëqyrjes së tyre. Pjesa tjetër e ligjit kryesisht ka të bëjë me operationet teknike, mënyrën e pagesave dhe përgjegjësitë e secilës palë pjesëmarrëse. Vlerësoj se në këtë pjesë gjërat janë më të qarta sesa në pjesën e përgjithshme.

Për fund, më duhet ta shtoj edhe nevojën që të miratohet ky ligj për shkak të rëndësisë që ka, mirëpo duhet të përfshihen disa vërejtje, të cilat i kam cekur në komision, nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe në grupet punuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë nuk ka diskutues tjerë dhe ministri nuk e ka kërkuar fjalën, unë kërkoj në vazhdim që të deklarohemi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për sistemin e pagesave.

Në mbledhje janë të pranishëm 78 deputetë. Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 71 votë për, asnjë abstenim dhe 1 kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për sistemin e pagesave. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afat të paraparë me Rregullore ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike

Ministrja Mimoza Kusari-Lila nuk është e pranishme për ta prezantuar, nëse nuk ia ka kaluar këtë detyrim ndonjë ministri tjetër. E kalojmë edhe këtë pikë, pasi mungon zëvendëskryeministrja.

Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me nenin 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme dhe ia ka propozuar Kuvendit që ta paraqes raportin dhe ta procedojë më tutje.

Meqenëse e kam fjalën, zoti kryesues, unë kërkoj, pavarësisht që nuk është këtu përfaqësuesi i Qeverisë, që edhe projektligjin që pak më parë e kaluat për mospraninë e ministres që ta procedojmë, meqenëse komisioni e ka trajtuar po ashtu. D.m.th. edhe Projektligjin për zonat ekonomike ta procesoni, në mënyrë që ne të kemi kohë ta punojmë edhe këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për diskutimin për pikën e rendit të ditës, e për atë tjetrën lexoje Rregulloren. Ajo nuk bëhet ashtu. Kur të vijë përfaqësuesja e Qeverisë, e paraqet ligjin dhe bisedojmë. Nuk shoh asnjë njeri që është paraqitur të diskutojë për

amendamentimet rreth këtij projektligji në lexim të dytë. Një qetësi të vogël e kërkoj, sepse edhe veten e dëgjoni më mirë.

Atëherë, kalojmë në votimet e amendamenteve të propozuara.

Amendamenti 1

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 2

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 3

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 4

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 5

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 6

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 7

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 8

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 9

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 10
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 11
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 12
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 13
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 14
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 15
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 16
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 17
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.
Kalon.

Amendamenti 18
Kundër apo abstenim?
Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 19

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 20

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 21

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 22

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 23

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 24

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 25

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 26

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 27

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 28

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 29

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 30

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 31

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 32

Kundër apo abstenim?

Nuk ka.

Kalon.

Tash bëhemi gati ta votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Ju lutem, të pranishëm janë 71 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Më 59 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për regjistrin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Kthehemi tash në pikën tjetër në 11, sepse e kemi këtu përfaqësuesen e Qeverisë, thënë më mirë zëvendëskryeministren. Pra, e kemi:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. E ftoj ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, zonjën Mimoza Kusari-Lila, njëherësh zëvendëskryeministren, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zonja Kusari, urdhëroni!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj edhe një herë për mirëkuptimin dhe për kthimin në pikën për prezantimin e Projektligjit për zonat ekonomike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si bartëse e këtij projekti legjislativ shkurtimisht do ta paraqesë para jush qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për zonat ekonomike. Arsyeshmëria për këtë projektligj është përmirësimi i infrastrukturës ligjore për themelimin, funksionimin, menaxhimin, si dhe mbikëqyrjen e zonave ekonomike në Kosovë. Zonat ekonomike në Kosovë deri më tani janë rregulluar me Ligjin Nr. 03/ L - 129 për zonat ekonomike, dekretuar më 18.5.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Po ashtu, janë nxjerrë të gjitha aktet që janë paraparë me këtë ligj, mirëpo gjatë zbatimit të këtyre dispozitave është hasur në vështirësi, apo më mirë të themi janë identifikuar nevojat e plotësimit të këtyre dispozitave dhe si rezultat i kësaj e kemi përgatitur Projektligjin, të cilin e keni para jush sot për shqyrtim dhe aprovim.

Ky ligj ka për qëllim që nëpërmjet zhvillimit të zonave ekonomike të mundësohen investime të reja, aktivitete industriale dhe prodhimi për eksport. Të lehtësohen hyrjet e mallrave dhe kapitaleve, të aplikohet teknologjia e përparuar, të krijohen vende të reja të punës dhe të përfitohet nga mundësia e investimeve dhe financimeve e shkëmbimeve tregtare. Projektligji është hartuar në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare të marra gjatë vizitave studimore dhe konsiderojmë që është në përputhshmëri me praktikatat e mira ndërkombëtare, si dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky ligj e rregullon themelimin, funksionimin, menaxhimin, si dhe mbikëqyrjen e zonave ekonomike në Kosovë. Me këtë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, përdoruesve, operatorëve, si dhe subjekteve të tjera që ushtrojnë aktivitete në lidhje me zonat ekonomike, llojin e veprimtarive që kryejnë brenda zonave ekonomike, mënyrën lëvizjes së mallrave nëpër to dhe lehtësirat dhe mbështetjen për bizneset e parashikuara në kuadër të zonave ekonomike.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të arrihet përmirësimi i infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me rregullimin e fushës së zonave dhe zonave të lira ekonomike, nëpërmjet të cilave do t'i ofrohet mbështetje sektorit privat, si dhe rritjes së investimeve të reja, përmirësimi i infrastrukturës fizike për bizneset dhe krijimi i kushteve për biznes për qasjen më të lehtë në transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit. Në këtë ligj janë inkorporuar dispozita që do ta rregullojnë edhe themelimin e zonave të lira ekonomike. Parashihet të themelohet Këshilli Kombëtar për zona ekonomike. Po ashtu, me këtë projektligj parashihet të rregullohen inkubatorët e biznesit, qëllimi kryesor i të cilëve është të prodhojnë biznese, të cilat tregojnë potencial për të qëndruar mirë financiarisht, pasi të dalin nga inkubatori i biznesit, zakonisht pas një periudhe afatshkurtër.

Pra, inkubatorët e biznesit janë mjete lehtësuese për bizneset me një staf menaxhues dhe mbështetës, i cili ka për qëllim sigurimin e hapësirave fizike për punë, lehtëson dhe mundëson mbështetjen dhe shërbimet teknike të biznesit. Projektligji përmban dispozita për: qëllimin e krijimit të zonave ekonomike, themelimin i zonave ekonomike, themelimin i zonave të lira ekonomike, propozimi për themelimin e zonave ekonomike, arsyetimi për

themelimin e zonës ekonomike, plani kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhja e zonës ekonomike, administrimi, shfrytëzimi i zonës, veprimtaritë e lejuara në zonat ekonomike, lehtësirat për biznese që operojnë në kuadër të zonave ekonomike, regjistri i zonave të themeluara, promovimi i zonave ekonomike, librat e kontabilitetit dhe raportimi, bashkëpunimi me autoritetin doganor dhe Administratën Tatimore të Kosovës, inkubatorët e biznesit, Këshilli Kombëtar për zona ekonomike dhe dispozitat për zbatimin e këtij ligji, që parashihen me nxjerrjen e akteve nënligjore.

Duke ju falënderuar për diskutimet dhe trajtimin e këtij ligji dhe duke e ditur rëndësinë që ky ligj do ta ketë në zhvillimin e mëtutjeshëm të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës, ju ftoj që ta miratoni, pas diskutimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zonja zëvendëskryeministre, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar edhe këtë projektligj në mbledhjen e vet të rregullt.

Komisioni po ashtu e ka bërë edhe grupin e veçantë punues për ta trajtuar këtë projektligj. E kemi planifikuar, si zakonisht, po ashtu edhe involvimin e grupeve të ndryshme këtij interesi. Ne i involvojmë të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare që të kyçen, ta japin kontributin e tyre në këtë projektligj të rëndësishëm.

Zonja ministre, ju përgëzoj për dinamikën me të cilën i keni sjellë këto projektligje të fundit kaq të nevojshme për zhvillimin e vendit dhe, po ashtu, sot të falënderoj që ma dhe rastin ta rilexoj Rregulloren e Punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i komisionit! Tash do t'i dëgjojmë deklaratimet e grupeve politike parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministre zonja Kusari-Lila,

Përshëndetje kolegë deputetë dhe të gjithë të pranishëm,

Projektligji për zonat ekonomike ka qenë në strategjinë legjislative të Qeverisë në këtë vit dhe në strategjinë legjislative edhe të Kuvendit dhe është sjellë me kohë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe konstaton se në përgjithësi zonat ekonomike njihen si “parqe” të biznesit, “parqe teknologjike” apo “parqe industriale”. Ndërkaq brenda parqeve, por edhe jashtë tyre ka edhe inkubatorë të biznesit, të cilët kanë për qëllim grumbullimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në një objekt.

Në Kosovë deri më tani janë marrë gjithsej 10 iniciativa për krijimin e zonave ekonomike në tetë komuna të ndryshme të Kosovës. Prej tyre, pesë janë të llojit “parku i biznesit”, katër të llojit inkubatorë biznesit dhe një është i llojit “parku industrial”. Sipas një broshure që e ka nxjerrë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2010, zonat ekonomike në Kosovë përfshijnë këto parqe të biznesit: parku i biznesit dhe inkubatori i biznesit në Drenas, parku i biznesit holandez në Prizren, parku i biznesit në Therandë, parku i biznesit në Mitrovicë, parku industrial dhe inkubatori i biznesit të Shtime, inkubatori i biznesit në Deçan dhe inkubatori i biznesit në Gjilan.

Sot, shumica e këtyre parqeve të biznesit janë gjysmë-funksionale, prandaj ka qenë një domosdoshmëri që t’i hyhet plotësimit dhe ndryshimit të këtij ligji dhe ne si grup parlamentar e mbështetim në parim. Kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amandamentimit në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për LDK-në, Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari nënkryetar i Kuvendit, zoti Hamiti!

E nderuar ministre zonja Kusari-Lila,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për zonat ekonomike me Nr. 04/ L-159. Projektligji për zonat ekonomike ka mundësi që të jetë njëri prej dokumenteve bazë për nxitjen e zhvillimit të bizneseve, të punësimit, të investimeve, të promovimit të prodhimit.

Ky qëllim në mënyrë të qartë thuhet edhe në këtë dokument, mirëpo nga projektligji nuk del shumë i qartë se si do të bëhen të gjitha këto, si do të duken ato në jetën praktike dhe cilat janë përparësitë që ky ligj ofron për bizneset që veprojnë në kuadër të një zone ekonomike.

Në nenin 14, pika 1, thuhet se ministria, në këtë rast ajo për Tregti dhe Industri, me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe lehtësirat për bizneset që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të zonave ekonomike. Më tutje, pika 2 e këtij neni tregon se cili duhet të jetë qëllimi i këtyre lehtësirave, mirëpo askund nuk ka asnjë fjalë për lehtësirat, të cilat tani lihen në kompetencë ministrisë. Këtu ka disa defekte. Ministria është një term i gjerë, prandaj është vështirë të përcaktohet se kush është përgjegjës i drejtpërdrejtë për nxjerrjen e këtij akti nënligjor, si dhe për implementimin e tij. Nëse mendohet se këtë do ta bëjë ministria apo kabineti i saj, atëherë kjo paraqet ngarkesë për të dhe njëkohësisht vështirë se mund të ketë kapacitete njerëzore për zbatimin e këtij ligji.

Nën 2, ligji i përcakton afatet kohore për nxjerrjen e aktit nënligjor, ndërsa kërkon që një vit pas miratimit të ligjit të miratohet plani kombëtar për zonat ekonomike. Së pari, ky afat është shumë i gjatë, meqenëse ne nuk kemi kohë të presim një vit për këtë ligj që të jetë operativ dhe, e dyta, edhe nxjerrja e akteve nënligjore në aspektin kohor duhet të koordinohet me planin kombëtar. Kjo do të mundësojë që në momentin kur kemi plane, së bashku me këtë do të kemi edhe akte të tjera nënligjore dhe atëherë ligji do të jetë funksional.

Nën 3, ligji duhet t'i përfshijë kushtet dhe lehtësirat që mund t'i shfrytëzojnë bizneset që veprojnë në kuadër të asaj zone ekonomike. Kjo do të ishte zgjedhja më e mirë sesa ajo që propozohet, përkatësisht që kushtet dhe lehtësitë të përcaktohen me këtë akt nënligjor. Arsyeja është e thjeshtë, ato janë më të qëndrueshme dhe më të besueshme kur parashihen në ligj. Meqenëse akti nënligjor mund të ndryshojë shpesh, edhe në bazë të vlerësimit të një grupi të ngushtë të njerëzve, ndërkaq në interes të biznesit është që kushtet nën të cilat ai operon të jenë sa më stabile dhe të mos ndryshojnë prej momentit në moment. Qëndrueshmërinë afatgjatë dhe stabilitetin e garanton vetëm përfshirja e tyre në një nen të veçantë në këtë ligj.

Nën 4, pos kësaj, Ministria paraqitet kompetente edhe për shumë çështje që kanë ndikimin në operacionalizimin e zonës ekonomike. Ajo e përcakton formën dhe kushtet për dhënien në shfrytëzim të hapësirave të zonës ekonomike, pastaj ajo e propozon këshillin kombëtar për zonat ekonomike, i kryen të gjitha punët administrative e teknike të këtij këshilli, si dhe i nxjerr të gjitha aktet nënligjore për implementimin e këtij ligji. Në parim, duket se krejt është në rregull, meqenëse për zbatimin e këtij ligji askush nuk është më kompetent se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, mirëpo edhe këtu vlen e njëjta që e thashë edhe më parë, këto kompetenca dhe përgjegjësi janë të koncentruara krejt në një institucion, që ka kuptim shumë më të gjerë. Kur thuhet se përgjegjëse është ministria, atëherë nuk dihet se kush është përgjegjës i drejtpërdrejtë rreth kësaj çështjeje. Nëse mendohet se këtë përgjegjësi e ka ekskluzivisht ministri apo ministrja, atëherë bëhet koncentrimi i madh i kompetencave te një individ. Kjo është në kundërshtim me parimet demokratike. Madje, nëse ministri apo ministrja mund t'i pranojë të gjitha këto kompetenca e përgjegjësi, atëherë pse na duhet e tërë ajo administratë dhe të gjitha ato agjenci brenda ministrisë. Për këtë arsye propozoj për përgjegjësitë të shtrihen edhe brenda agjencive, të cilat i raportojnë ministrit apo ministres, e më vonë nëpërmjet tij/saj, nëse ka nevojë, të barten edhe në Qeveri.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka edhe një vërejtje tjetër, të cilën e ka parashtruar edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Është mospërputhja e këtij ligji me Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Ligji për zonat ekonomike mundëson që pronat të jepen në shfrytëzim deri në 99 vjet, kurse ligji tjetër, domethënë i komunave, mundëson shfrytëzimin 10 deri 40 vjet. Kjo mospërputhje do të krijojë paqartësi. Nëse zonat ekonomike themelohen në pronën komunale, do të jetë e pakuptueshme nëse këtë pronë Qeveria e Kosovës me një vendim të posaçëm ia jep dikujt për shfrytëzim për 99 vjet, derisa pronari i vërtetë i saj, në këtë rast Komuna, nuk e ka atë të drejtë.

Grupi Parlamentar i LDK-së propozon që të bëhet amendamenti i Ligjit Nr. 03/ L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, ashtu që ai të jetë në përputhje me Ligjin për zonat ekonomike. Grupi Parlamentar i LDK-së i ka edhe disa vërejtje të tjera, por në parim e përkrah Projektligjin për zonat ekonomike dhe kontributin e vet do ta japë nëpërmjet anëtarëve të vet përkatës në komisione dhe në grupe punuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit Parlamentar, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Po e filloj këtë fjalë timen me një çështje që mendoj që duhet të bëhet praktikë në Kuvend. Pra, kur flasim në emër të komisioneve, si kryetar komisionesh apo si përfaqësues komisionesh, mendoj që duhet të flasim për atë që është diskutuar në komision, e jo si ndihemi ne personalisht, ta zëmë.

Pra, unë nuk mendoj që Komisioni për Zhvillim Ekonomik e ka falënderuar ministren për dinamikën e ligjeve, siç e tha kryetari, e as që mendoj që komisioni ka diskutuar për atë se kur do ta lexojë si kryetar i komisionit Rregulloren.

Sa i përket ligjit për të cilin po flasim, dua të nisem nga ajo që e tha ministrja, pra me një lloj përmbledhjeje të asaj se çfarë rëndësia paraqet ky ligj dhe dobitë që mund t’ia sjellë ky ligj Kosovës, e këtë e bazoj në hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin ekonomik, sjelljen e teknologjive të reja, qarkullimin e kapitalit të njerëzve, e kështu me radhë. Pra, të gjitha këto, të them ashtu, fraza të një ideologjie të caktuar, të cilën ne jemi duke e dëgjuar tash e 12 vjet këtu në Kosovë, e sa më shumë që nuk ka zhvillim të tillë ekonomik, aq më shumë po i dëgjojmë këto fraza. Pra, kjo po e përmbush atë që thuhet se është fjala zëvendësim për aktin, veprën apo sendin. Ndërkohë që po ashtu u tha se ligji është i mirë për shkak se bazohet në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kushdo që e përcjell debatin sot në botë për atë se çfarë modeli të zhvillimit ekonomik duhet ta marrin shtetet, shihet që për çdo ditë e më pak ka praktika më të mirë ndërkombëtare, për shkak se për çdo ditë e më pak ka pajtueshmëri ndërkombëtare për atë se çfarë rruge e kursi duhet të ndjekin shtetet për ta zhvilluar veten ekonomikisht dhe në aspektin social.

Ndërkohë, këtu në Kosovë çdo gjë na shitet si praktikë më e mirë ndërkombëtare, ndërkohë që një praktikë e tillë, pra të gjithë e dimë që nuk ekziston, për shkak se nuk është një model ekonomik që zbatohet në botë. Asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk mendoj se do të jetë ndonjëherë.

Gjykuar nga kjo dhe duke e parë se çdo gjë që ka ardhur këtu në Kosovë, pra çdo lloj ndryshimi në sistemin ekonomik, por edhe në atë institucional që ka të bëjë me ekonominë është shitur si praktikë më e mirë ndërkombëtare, atëherë në rastin e Kosovës, në zbatimin në Kosovë, e kemi parë që në fakt këto janë praktikën më të dëmshme ndërkombëtare për shkak se e kanë lënë Kosovën të pazhvilluar edhe 12-13 vjet pas luftës.

Tash po flas për ligjin, në përgjithësi. Janë dy çështje që janë në ligj goxha problematike dhe janë afër papranueshmërisë. E para është që ky ligj parasheh që krijimi i zonave ekonomike, apo një plan kombëtar për zonat ekonomike të jetë plani kryesor, pra shënjeshti kryesor i rregullimit dhe i planifikimit të hapësirës, e pastaj të gjitha planet hapësimore komunale duhet t’i përshtaten këtij ligji. Pra, prapë e kemi një lloj logjike të prapakthyer, të ngjashme me atë që e kemi pasur me Ligjin për ndërtim. Është kërkuar që

planet hapësinore t'i nënshtrohen Ligjit për ndërtim, tash e kemi në këtë rast Ligjit për krijimin e zonave ekonomike, apo planin kombëtar të zonave ekonomike, zonat e lira dhe të tjera.

Dhe, pra, është kjo në shpërfaqje e kësaj kundërshtisë ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe asaj që mund të quhet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, i cili domosdoshmërisht e merr parasysh edhe planifikimin hapësinor, zhvillimin e tokave bujqësore, planifikimin rural, e kështu me radhë, domethënë për ta gjetur një lloj optimumi ndërmjet zhvillimit ekonomik, zhvillimit industrial dhe mbrojtjes së mjedisit, e cila është e drejtë e garantuar për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Kjo çështje, pra, për planin kombëtar, si dhe këto planet tjera, do t'i nënshtrohet asaj që është e mbuluar në nenin 9. Ne konsiderojmë që kjo duhet ndryshuar në mënyrë që këtu të paktën ta kemi një lloj diskutimi më të gjerë publik për atë se ku dhe si dhe çfarë zonash ekonomike do t'i kemi të ndërtuara nëpër hapësirat e Kosovës.

Çështja tjetër është te lehtësirat. Te neni 14 thuhet që ministria me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe lehtësirat për biznese dhe pastaj i lihet mëshirës apo në dorë të ministrisë të përcaktojë se çfarë lehtësirash, në cilat zona ekonomike, e kështu me radhë të përcaktohen, gjë që unë konsideroj që duhet të jetë pjesë e ligjit. Domosdoshmërisht, Kuvendi duhet të votojë se çfarë lehtësira dhe deri në ç'masë do të jepen këto lehtësira për këto zona ekonomike dhe veçanërisht për ato bizneset afariste, të cilat do të jenë të interesuara të bëhen pjesë e këtyre zonave ekonomike, për shkak se kjo lidhet drejtpërdrejt me sovranitetin shtetëror dhe atë se deri në ç'masë shteti është i gatshëm dhe çfarë lehtësirash është i gatshëm të bëjë shteti për zonat e veçanta, apo për sektorët privatë.

Pra, ligji, në përgjithësi, dhe jo rastësisht e përmenda atë në fillim, për fjalën e ministres, është prapë një lloj vazhdimësie e kësaj thjerrëze të fshehtësisë së politikës, me të cilën Qeveria e Kosovës e shikon çdo gjë në Kosovë. Pra, një lloj thjerrëze, e cila nuk lejon në asnjë mënyrë, as nga aspekti ekonomik, e as nga aspekti utilitar, të bëjë dallime ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe operuesve të ndryshëm ekonomikë dhe kjo lloj fshehtësie, pastaj në përgjithësi, në një qasje holistike e shkatërron vetë ekonominë e një vendi, për shkak se nuk lejo të zhvillohen dhe zbatohen ata sektorë të ekonomisë, të cilët mund të jenë më të dobishëm edhe për mirëqenien sociale, por edhe për zhvillimin ekonomik, në përgjithësi. Dhe, këtë e kemi pastaj te dy momente, ajo shfaqet në mënyrën më të vrazhdë. Pra, momenti i parë që ligji ia lejon ministrisë apo themeluesit, për shkak se edhe komunat kanë të drejtë të themelojnë zona ekonomike, ua lejon këtyre themeluesve pra, që këto zona së pari t'i themelojnë nëpërmjet partneritetit publiko-privat dhe pastaj ta bartin menaxhimin e tyre, pra pronësinë menaxhuese mbi to tërësisht te sektori privat, gjë që pastaj ua pamundëson në njëfarë mënyre themeluesve dhe pamundëson kontrollin publik mbi këto zona ekonomike dhe zona industriale, veçanërisht në atë se çfarë aktivitete dhe kush i kryen këto aktivitete përbrenda këtyre zonave.

Pra, në nenin 12, pika 11, thuhet që themeluesi mund t'i delegojë të drejtat e tij sipas këtij neni te operatori privat, i cili nëpërmjet partneritetit publiko-privat pastaj përzgjidhet ta ndërtojë ose ta mbikëqyrë.

Ne jemi kategorikisht kundër kësaj. Kjo është një formë më e butë e privatizimit të këtyre zonave, të cilat mund të ndërtohen me kapital publik, pra me para publike dhe pastaj t'i barten një autoriteti privat për t'i menaxhuar ato dhe, natyrisht, për të përfutur nga ato, për shkak se këto janë zona ku afaristët mund të fitojnë.

Dhe, pastaj, për fund e kemi në nenin 20 krijimin e një këshilli kombëtar për zonat ekonomike dhe janë të renditura disa paragrafë, gjithsej 9 sish, të cilët e përcaktojnë procedurën e krijimit të këshillit. Pra, kush e inicion, kujt i raporton këshilli, e kështu me radhë, ndërkohë që nuk e përcakton se çfarë bën ky këshill. Dhe, ky këshill kombëtar! Mendoj unë që kjo procedurë e krijimit të këshillit kombëtar, edhe pse nuk jam domosdoshmërisht kundër tij, do të ishte dashur të jetë çështje e brendshme e Qeverisë. Pra, mënyra se si e themelon Qeveria një këshill apo një organ të brendshëm për zonat ekonomike, kjo duhet të jetë e drejtë ekskluzive e Qeverisë dhe në vend se ta kemi cilat lehtësira të zonave ekonomike, që do të duhej t'i caktonte Kuvendi, ne e kemi një procedurë të brendshme të Qeverisë, e cila po kërkohet të votohet nga Kuvendi. Pra, janë këto disa prej vërejtjeve, të cilat ne si Grup Parlamentar i shtrojmë ndaj këtij ligji.

Ligjin do ta votojmë, mirëpo votimi i dytë do të varet shumë nga përfillja e këtyre vërejtjeve që i thashë në këtë fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zenun Pajaziti e do fjalën, urdhëro!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse e pata një koment rreth prezantimit tim, si kryetar i komisionit, dëshiroj të ritheksoj se unë e lexova këtu qëndrimin e komisionit, e nuk është e thënë të paraqiten aty në detaje edhe kush ka qenë kundër, ose për. Vetë grupet parlamentare në prezantimet e tyre, në projektligj, mund t'i prezantojnë ato. Ndërsa, unë vetëm e falënderoj që m'u dha rasti, që edhe ashtu nuk fola për cilësinë e projektligjit. Kjo mbetet në leximin e dytë, pas punës që duhet ta bëjmë, të flitet për atë cilësi, unë si kryetar i komisionit të paktën. Ndërsa, falënderoj që m'u dha rasti edhe një herë ta përgëzoj ministren dhe Ministrinë për dinamikën, me të cilën i kanë sjellë për trajtim këto projektligje të rëndësishme, e edhe këtë ligj të fundit në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti nënkryetar i Kuvendit,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe mund të themi lirisht se është njëri prej projektligjeve shumë me rëndësi, për arsye se paraqet qëllimet, kahet e

zhvillimit ekonomik dhe, do të thosha, ligjet tjera të zhvillimit ekonomik do të ishin shumë më mirë sikur ta kishim një strategji të zhvillimit ekonomik.

Unë besoj që Komisioni i Zhvillimit Ekonomik do ta ketë një punë dhe grupi punues që do të merret me amendamentimin e këtij ligji do ta ketë një punë bukur të vështirë që t'i harmonizojë edhe disa ligje, që kanë kaluar nëpër Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, siç është Ligji për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Mandej aty ka agjenci për promovimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, agjenci për investime. Tani kemi këshill kombëtar të zonave ekonomike, kurse anglezët e kanë një fjalë, që e përdor shpesh. Thonë: “Në një vend ku ka kuzhinierë shumë, ndonjëherë dreka mbetet pa kripë”. Unë po frikohem, në mos me ligje të shumta për zhvillim ekonomik, për investime të huaja, të mos kemi ligje të shumta që nuk janë duke funksionuar.

Është mirë atëherë që të rrumbullakohen me këto të zonave ekonomike dhe të fillohet me të vërtetë një zhvillim i mirëfillt ekonomik. Me të vërtetë le të funksionojnë ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme dhe mikro-ndërmarrjet të fillojnë të funksionojnë dhe të bëjnë hapje të vendeve të punës, sepse shumë me prioritet për këtë vend është zhvillimi ekonomik dhe i biznesit.

Grupi i Aleancës do ta japë kontributin e vet dhe deputeti Kelmendi është edhe në grupin punues, meqë e njeh mirë këtë lëmi, prandaj besoj që kontributi i tij do të jetë me rëndësi në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovën e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministren, për prezantimin e ligjit,

Duke marrë parasysh se Projektligji për zonat ekonomike ka qenë përpara dhe po shihet që zbatueshmëria e tij nuk ka qenë shumë e mirë, atëherë kisha kërkuar këtu nga ministrja dhe zëvendëskryeministrja për çështje të zhvillimit ekonomik që projektligji të quhet Projektligj për zonat e lira ekonomike. Se, ne e patëm një projektligj për zonat ekonomike dhe u pa që nuk pati sukses. Dhe, në rast se e marrim qëllimin e projektligjit, tregon se ai është për një zhvillim të zonës ekonomike, që të mundësojë investime të reja apo aktivitete industriale dhe prodhime për eksport, t'i lehtësojë hyrjet e mallrave dhe të kapitalit.

Qëllimi i projektligjit: Në rast se shkojmë në nene tjera të projektligjit, fatbardhësisht që ministrja është këtu dhe e sqaron shumë mirë, çka është zona ekonomike, që është një territor që ka status të veçantë ekonomik, që mund të jetë zonë e lirë, park industrial ose park teknologjik, sipas përcaktimeve të mëposhtme. Ndërsa, ku paraqitet pika 1.5, zona e lirë e ka kuptimin e zonës së lirë të përcaktuar sipas Kodit Doganor të akcizës së Republikës së Kosovës.

Dhe, për këtë arsye, kërkoj që komplet titulli i ligjit të jetë: Projektligji për zonat e lira ekonomike. Në rast se e shohim çështjen e inkubatorëve të biznesit, atëherë mund të

themi se Kosova është shumë e vogël në çështjen e ndërtimit të inkubatorëve, për arsye se nuk kemi territor aq të madh që të bëjmë inkubator.

Kalojmë në çështje tjera, qëllimi i krijimit të zonave ekonomike, themelimi i zonave ekonomike. Unë do të ndalem te neni 6, themelimi i zonave të lira. Thashë edhe një herë, fatbardhësisht që zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Tregtisë dhe Industrisë është këtu, që të sqarojë, meqë neni 6, pika 1, thotë që Qeveria me vendim e themelon zonën e lirë në bazë të propozimit të Ministrisë dhe pas konsultimit me Doganat e Kosovës dhe komunën në territorin e secilës, parashihet të themelohet zona e lirë ekonomike.

Një zonë e lirë ekonomike mund të themelohet ndoshta edhe në bashkëpunim të dy apo tri komunave. Thashë, për arsye se Kosova është territor shumë i vogël dhe pasi Qeveria merr vendim në bazë të kërkesës apo në bazë të propozimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në konsultim me Doganat e Kosovës, atëherë edhe këtu do të ishte një sugjerim imi për ministren, që ai vendim i Qeverisë të vijë në Kuvend, pavarësisht kush do të jetë në Qeveri, çka do të përfitojë Kosova nga formimi i zonave të lira ekonomike.

Për themelimin dhe administrimin e zonës së lirë zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Doganor dhe të akcizës së Republikës së Kosovës. Ministrja ndoshta në mendjen e saj e ka pasur më të qartë, por gjatë përpunimit të ligjit është parë që këtu diçka nuk është cekur shumë mirë çështja e Kodit Doganor në zonat e lira ekonomike.

Koalicioni për Kosovë të Re do ta përkrahë në parim Projektligjin për zonat ekonomike, por prapëseprapë insistoj që ky ligj të quhet Projektligji për zonat e lira ekonomike dhe të gjitha sugjerimet dhe këto vërejtje që i dhamë do t'i implementojmë në këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për zonat ekonomike thuhet se ka për qëllim, që nëpërmjet zhvillimit të zonave ekonomike të mundësohen një sërë aktivitetesh ekonomike, që supozohet se do të kenë impakt pozitiv në ekonominë vendore.

Grupi i ekspertëve të ekonomisë së Lëvizjes për Bashkim konsideron se, në fakt, zonat ekonomike përdoren nga qeveritë si arsyetim i investimit për zhvillim ekonomik.

Në fakt, krijimi i tyre nuk është ndonjë invencion, por vetëm një imitim i praktikave të shteteve tjera. Një gjë është e ditur, se këto janë funksionale për shtetet, të cilat tanimë e kanë një bazë ekonomike dhe të cilat ofrojnë llojllojshmëri prodhimi. Ndërkaq, ne konsiderojmë se një model i tillë nuk i përshtatet secilit vend dhe nuk presim që ky model të ketë sukses edhe te ne, për shkak të tri arsyeve kryesore:

- mangësisë së territorit,
- numrit të madh të popullsisë së paprofilizuar, dhe
- nivelit të zhvillimit ekonomik në vendin tonë.

Në Kosovë, veprimtaritë e ndryshme mund të kryhen në objektet ekzistuese, vlerat e rentimit të cilave nuk janë shumë të larta dhe në të shumtën e rasteve ofrojnë kushte të mjaftueshme operimi. Pra, Kosova është një territor i vogël, me një prodhim të mangët dhe të dyja këto elemente sugjerojnë për operim në nivel urban ekzistues dhe në asnjë mënyrë në zona ekonomike, që kërkojnë investime të mëdha.

Kosova do të duhej ta zhvillojë veprimtaritë ekonomike në mënyrë racionale, me zhvillim gradual dhe nëse këta hapa do të tregohen të suksesshëm, atëherë presupozojmë pas një periudhe dhjetëvjeçare do të vinte koha e investimeve në zona ekonomike. E ndoshta deri atëherë ky do të bëhet një model inekzistent. Prandaj, le të fillojmë të mendojmë racionalisht dhe realisht, e jo të përdorim modele, të cilat janë një xhakëtë tepër e madhe për një trup të vogël.

Për aq më tepër, duke qenë të gjithë të vetëdijshëm për problemet e furnizimit me rrymë dhe ujë, që aktualisht i ka Kosova, dështimi i zonave të tilla ekonomike bëhet krejtësisht evident. Në anën tjetër, parku i biznesit është shembull i mospjekës në këtë fazë të tipave të tillë të ekonomizimit.

Për fund, ne si Lëvizje për Bashkim konsiderojmë se duhet ndërprerë imitimin e ekonomive të zhvilluara, por duhet dizajnuar plane origjinale të zhvillimit ekonomik, të cilat do t'u përshtaten rrethanave tona.

Po e përsëris, ne konsiderojmë se në këtë fazë nuk jemi të gatshëm për një hap të tillë. Në anën tjetër, po qe se ky ligj hyn në fuqi, në një të ardhme të afërt kërkon reformim të infrastrukturës ligjore horizontale, nëse dëshironi që ky ligj të bëhet i aplikueshëm, për faktin se shërbimet dhe kompanitë në kuadër të këtyre zonave kërkojnë trajtim të veçantë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar ministre,

Në fakt, ne e kemi një ligj që aktualisht është në fuqi dhe qëllimi i këtij projektligji të sotëm është për ta avancuar atë ligj, që aktualisht ekziston. Cili është dallimi ndërmjet këtij projektligji dhe ligjit që ekziston?

Kujtoj që janë tri çështje kryesore:

1. plani kombëtar për zhvillimin në zonat ekonomike,
2. këshilli kombëtar për këto zona ekonomike, dhe
3. në nenin 12 është paraparë mënyra e shfrytëzimit të këtyre zonave ekonomike.

Në esencë, në krejt projektligjin, vërehet se nuk janë sistemuar dhe harmonizuar në një anë dispozitat brenda projektligjit, duke krijuar kështu një kohezion, por në anën tjetër edhe me ligjet tjera, që janë në fuqi. Për shembull, në nenin 5 thuhet që zonat ekonomike, me përjashtim të zonave të lira, themelohen me vendim të Qeverisë, pas propozimit të

Ministrisë dhe pas konsultimit me komunat. Por, në nenin 6 jepet kjo mundësi njëjtë edhe për krijimin e zonave të lira ekonomike, që do të thotë që neni 5 e suspendon nenin 6 dhe në të njëjtën kohë neni 6 e rregullon të njëjtën lëmi.

Një çështje tjetër është çështja e planit kombëtar të zonave ekonomike. Në nenin 9 thuhet se Ministria, në konsultim me komunat dhe doganat e përgatit planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike komunale dhe qendrore për periudhën dhjetëvjeçare. Por, në nenet tjera pasuese ua jep këtë të drejtë themeluesve që të paraqesin kërkesë dhe me pëlqim të Ministrisë t'i themelojnë zonat, çka do të thotë që në njërin anë kërkohet të ketë një plan për dhjetëvjeçar, që do të respektohet e, në anën tjetër, krijohet mundësia që themeluesit t'i krijojnë këto zona.

Çështje tjetër është krijimi i këtij këshilli kombëtar për zonat ekonomike. Kujtoj që çdo projektligj që po na vjen këtu e ka krijimin e do këshillave ndërministrorë, këshillave qeveritarë, këshillave koordinues, të cilët po e ngarkojnë vazhdimisht edhe buxhetin, por po e stërngarkojnë edhe në kuptimin e koordinimit të aktiviteteve për ta zbatuar ligjin.

Nuk e di në Qeveria e ka ndonjë evidencë që të dihet saktësisht sa kësi këshillash ndërqeveritarë janë ose mbikëqyrëse, e në këtë rast këshill kombëtar, që unë mendoj ndoshta, në terminologjinë kombëtare, sigurisht Ministria do ta bëjë ndonjë plan edhe jashtë kufijve shtetërorë, po gjithkrah quhet kombëtar.

Është shumë interesant që në memorandumin shpjegues, që i është bashkëngjitur këtij projektligji, asnjë ministri asnjë kontribut tjetër nuk e ka dhënë, përveç kërkesës për të hyrë në atë farë këshilli kombëtar. Është shumë e çuditshme pse insistojnë kaq shumë ministratë të jenë në këta këshillat koordinues, në këta këshillat kombëtarë, siç po quhet tash. Dhe, në asnjë koment tjetër, në asnjë normë, në asnjë dispozitë nuk e kanë dhënë, përveç kërkesës për të hyrë.

Edhe një çështje tjetër, që për mendimin tim është në kundërshtim me ligjet aktuale, është neni 12, shfrytëzimi i zonave ekonomike, apo ndoshta edhe qëllimi dhe pretendimi kryesor i hartimit të këtij projektligji. Shiko nenin 12, thotë: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do t'i përcaktojë kushtet e vendosjes së subjekteve afariste, pavarësisht themeluesve. Ministria ta përcaktojë me akt nënligjor, thuhet edhe procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit për vendosjen e subjekteve afariste në këto zona.

Kujtoj që kjo është në kundërshtim me ligjet tjera, që janë në fuqi dhe paraqet një logjikë jo të mirë të ndërtimit të këtyre projektligjeve, sepse nëpërmjet këtyre normave pretendohet të sigurohet një bazë juridike e kontrollimit të dhënies të këtyre pronave në shfrytëzim subjekteve afariste.

Prandaj, kujtoj që ky projektligj ka nevojë, që në fazën e shqyrtimit nga komisionet funksionale të ndryshohet dhe të plotësohet, në mënyrë që të jetë i zbatueshëm dhe të mos jetë në kundërshtim me ligjet tjera që janë në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ky ligj e ka një rëndësi të madhe. Të jem pak më preciz, do të mund ta kishte rëndësinë e madhe, sikur vërtet të bazohej më tepër në përvoja të avancuara, siç thotë.

Në fakt, nëse e lexojmë ligjin, ky nuk sjell pothuajse asgjë të re në praktikën tonë, përpos asaj që u tha, e krijon një këshill kombëtar, i cili ndoshta s'ka ndikim buxhetor, por ma merr mendja që duhet të ketë një implikim buxhetor. Dhe, ne jemi lodhur me administrimet e këtyre këshillave kombëtarë.

E dyta, e rrit administrimin dhe interferimin e Ministrisë në krijimin e kushteve për biznes, gjë që është në kundërshtim me përmirësimin e mjedisit biznesor. Ky ligj nuk krijon favore, në fakt kurrfarë favoresh për investitorët, por thirret në ligjet tjera dhe, unë mendoj, që ky ligj në tekstin si ka ardhur këtu, nuk është fare i nevojshëm. Nuk është fare i nevojshëm dhe unë mendoj që ky ligj duhet të kthehet dhe nuk duhet të votohet në përmbajtjen që ka ardhur këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë dhe deputete të Kuvendit të Kosovës,

Pas shqyrtimit me kujdes të Projektligjit për zonat ekonomike, gjithsesi vërejtja e parë që mund t'i bëhet ndërlidhet me vetë emërtimin, respektivisht dy nenet e para të tij, sepse nga emërtimi dhe dy nenet e para shihet se ky ligj nxirret për ta rregulluar themelimin, funksionimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zonave ekonomike në Kosovë. Mirëpo, nga përmbajtja e tij shihet, se në asnjë nen apo në asnjë dispozitë nuk përcaktohen disa prej kriterëve, të cilat duhet plotësuar një hapësirë e caktuar, që në atë të themelohet zona ekonomike.

Kështu, askund nuk theksohet madhësia e sipërfaqes së nevojshme të një hapësire, të përshtatshme për themelimin e zonës, apo largësia minimale nga vendbanimi, ose ndonjë kriter tjetër specifik për themelimin e zonës ekonomike.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me nenin 7 të këtij draftligji, në të cilin theksohet se një ose më shumë shoqëri tregtare, si dhe një ose më shumë asociacione afariste mund të paraqesin propozimin për themelimin e një zone ekonomike.

Sipas mendimit tim, janë tri mungesa serioze të dispozitave të këtij neni:

1. së pari, sipas këtij neni, ushtruesit të propozimit i njihet vetëm e drejta për propozim, por fare nuk trajtohet apo nuk rregullohet më për së afërmi përmbajtja e propozimit, respektivisht shkresat apo dokumentet përcjellëse, që duhet bashkëngjitur këtij propozimi,
2. nuk rregullohet fare procedura e veprimt dhe vendosjes lidhur me propozimin, që domethënë nuk përcaktohet se brenda cilit afat kohor themeluesi duhet të vendosë për propozimin, a ka të drejtë ankese nëse nuk aprovohet propozimi, në çfarë afati kohor dhe kujt mund t'i drejtohet ankesa, dhe detaje tjera procedurale,

3. vërejtja e tretë ka të bëjë me ushtruesin e propozimit për themelimin e zonës ekonomike. Sipas këtij neni, propozimin e tillë mund ta bëjnë vetëm shoqëritë tregtare dhe asociacionet afariste. Andaj, nuk është e qartë se a mund ta bëjë edhe Ministria propozimin e tillë, respektivisht Qeveria dhe komunat, meqë sipas këtij ligji janë themelues të zonave.

Vërejtja tjetër mund t'i bëhet edhe nenit 10, paragrafit 2, në të cilën përcaktohet se zonat ekonomike vendosen në sipërfaqe tokësore, në të cilën themeluesi e ka të drejtën e shfrytëzimit për tërë kohëzgjatjen e zonës ekonomike. Këtu kontestuese është shprehja "tërë kohëzgjatja e zonës ekonomike", sepse vërtet askund me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar afati kohor se sa do të jenë aktive zonat ekonomike. Andaj, duket tejet i rrezikshëm dhe i pasigurt themelimi i zonave ekonomike në tokat, në të cilat nuk është rregulluar pronësia mbi to.

Vërejtja e radhës ka të bëjë me strukturën apo përmbajtjen e këshillit kombëtar për zonat ekonomike. Sipas nenit 20, paragrafi 3, ky këshill përbëhet, citoj: "nga Ministria e Tregtisë, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Bujqësisë". Kështu siç është e shkruar mendoj se është gabim, sepse këshilli nuk mund të përbëhet nga ministrinë, por mund të përbëhet ose nga ministrat e resorëve të caktuar, ose nga përfaqësues të këtyre ministrive.

Dhe në fund, për këtë draftligj mund të thuhet, sikur edhe për draftligjet tjera që vijnë në Kuvend, se përcillen me gabime të caktuara gjuhësore dhe mospërputhje ndërmjet versioneve në gjuhën shqipe dhe versioneve në gjuhën serbe. Ekzistimi konkret i kësaj vërejtjeje mund të konstatohet pas krahasimit të paragrafit 5, nenit 13 të versioneve në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Diskutuesi i fundit është deputeti Sadri Ferati!

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar kolegë,

Tani rreth qëllimit të ligjit dhe efekteve u tha mjaft dhe unë pajtohem që janë tejet të rëndësishme, sepse ta aprovosh një ligj që do ta rrisë zhvillimin ekonomik, që do ta rrisë punësimin, pastaj që do ta instalojë teknologji moderne, që do ta rrisë konkurrencën në biznes, është tejet e rëndësishme dhe natyrisht që secili prej nesh do ta përkrahë.

Mirëpo, bazuar në gjendjen momentale, se ne edhe ashtu, pra për momentin kemi ligj për zonat ekonomike, përkatësisht ligji numër 03/L-129 po ta marrim tani ta lexojmë dhe të shikojmë se çka në esencë, është ndryshimi kryesor. Ne nuk shohim asgjë në këtë ligj, që ka guxuar ministrja dhe të gjithë ata të cilët kanë punuar të marrin më shumë përgjegjësi për ta ndihmuar këtë fushë. Dhe, në njëfarë forme është një përsëritje e ligjit dhe është shtuar një këshill kombëtar. Dhe, nuk e dimë se cili do të jetë roli i këtij këshilli kombëtar. Edhe ashtu është paraparë - koordinues, që do t'i ndihmojë shumë zhvillimit të kësaj fushe. Dhe, e dimë se edhe deri tash ka pasur përpjekje për zonat ekonomike, siç

edhe u tha, nëpërmjet inkubatorëve, domethënë parkut të biznesit dhe parkut industrial. E dimë se rezultati i deritashëm është i pakënaqshëm.

Pastaj, në vetë bërjen e ligjit janë anashkaluar edhe vetë biznesi, pastaj organizatat biznesore, që do të kishin mundur bashkë me ministrinë dhe ekspertët ta rritin ambicien, të shihet që me këtë ligj, përveçse vërtetojmë se kemi të drejtë të themelojmë zona ekonomike dhe ato në dy nivele, atë qendror dhe në nivel lokal.

Dhe, po ta marrim ashtu siç është ligji tash, unë do të kisha mundur lirisht t'ia ndërroj termin dhe në vend “zona ekonomike”, ndoshta do të kisha mundur ta quaj “ligji për dhënien e tokës në shfrytëzim”. Sepse, ky ligj bën vetëm dhënien e pronës në shfrytëzim. Dhe, po të bisedosh me bizneset dhe pritjet nga ky ligj, vërtet ambiciet janë fare të vogla. Me apo pa qëllim, mungon koncepti, mungon strategjia, apo dikush ka dashur që shumë kompetenca të ruajë për vete dhe pastaj nëpërmjet planit dhe udhëzimit administrativ ta rregullojë këtë fushë, kështu apo ashtu, gjë që në të dyja rastet, mendoj se nuk i kontribuojnë kësaj fushe.

Dhe, plani ekonomik, bazuar edhe në praktikat më të mira, që u tha edhe nga ministrja, patjetër që me ligj rregullohen tri çështje elementare së paku, siç është:

1. Specifikimi i zonave me interes, që pastaj shndërrohen në zona ekonomike, të cilave u jepet mbështetja dhe ato pastaj zhvillohen.

Unë po i marr vetëm dy situata, meqë më herët kam qenë i angazhuar dhe kam kërkuar që të mos jetë vetëm dhënia e tokës në shfrytëzim, për shembull për Mitrovicë dhe për Prizren, kur e kemi një traditë të përpunimit të arit dhe të argjendit, pasi prodhimet kosovare gjithmonë kanë qenë shumë të njohura edhe përtej Kosovës. Atje e kemi një biznes, që vetëm sa ekziston, ndërsa i mungon dora e shtetit për fillim, që ata pastaj të zhvillohet.

Dhe, investimet ose kostoja buxhetore, 500 mijë euro të parapara. Unë nuk e di se si do të zhvillohet, si do të mbështetet kjo. Do të thotë, zonat ekonomike nuk do ta kenë dorën e shtetit, por mendohet që të mbeten kësioj. Kjo do të jetë përgjigja më tutje.

2. Dhe, çështja e dytë do të jetë infrastruktura, e cila akoma nuk është kompletuar me vite të tëra edhe atje ku ekzistojnë inkubatorët dhe parqet e bizneseve.
3. Dhe çështja e tretë, te lehtësirat. Vërtet zonat ekonomike, në masën më të madhe do të varen nga investitorët dhe shtrohet pyetja: Me këtë ligj, çfarë përgjegjësish dhe detyrimesh po krijohen për institucionet përgjegjëse, që të bëjmë tërheqjen e investitorëve? Ose, të përgjigjemi në pyetjen: Pse do të vinte një investitor të investojë në këtë zonë ekonomike, apo në këtë komunë, apo në Kosovë, e jo diku tjetër? Nuk e kemi përgjigjen në këtë ligj.

Dhe atë, duke filluar që nga lehtësirat në taksa, ka mundur me ligj, shumë guximshëm, Ministria të propozojë që lehtësirat në taksa, për vitet e para të themi 2, 3, 4 apo 5, sepse kemi modele të ndryshme, do të jetë e kësaj forme, si për biznesin, po ashtu edhe për punëtorët që punojnë aty.

Pastaj, ndoshta do të ishte diçka fantastike, që me këtë ligj të themelohet banka për investime, ose fondi për investime, ku njerëzit do të kishin mundur, bizneset në rend të parë, t'i shfrytëzojnë ato fonde, që të mund të investojnë dhe, fillimisht, ta kenë mbështetjen e shtetit, e pastaj duke u zhvilluar ky biznes, është gjë e natyrshme, do ta kthente atë mbështetje financiare dhe do të krijonte pastaj akumulim edhe për më tutje.

Në këtë ligj ne fare nuk kemi pas guxim as të flasim për një bankë, as të flasim për një fond, as të flasim për ulje, zbritje, ose së paku të hyjmë në relacion me banka, të cilat kishin për ta dhënë ose në formë të grandeve ndonjë përqindje të vogël, ose me kamata shumë të arsyeshme dhe stimulative.

Prandaj, po kthehem te mungesa e këtij guximi, që në ligj të krijohen këto detyrime, tregon ose krizë koncepti, ose dashje që pas këtij ligji dikush ta marrë fuqinë e kësaj fushe dhe të rregullojë, sepse me plan të rregullohen çështjet e kësaj natyre, ose të themi: “Kjo çështje rregullohet me akte nënligjore”. Ku ke parë ti që akti nënligjor përfshin diçka më shumë se ligji? Akti nënligjor i zbërthen dhe i lehtëson provizionet e ligjit.

Prandaj, unë them komplet se nuk është problem për ta votuar këtë, po sikur ta kishim quajtur “dhënia e tokës në shfrytëzim”. Përndryshe, po të flasim për stimulimin e investimeve dhe zhvillimeve, unë mendoj se është dashur shumë më guximshëm Ministria të fusë provizione lehtësuese, çfarë edhe e ka kuptimin zona ekonomike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Kërkoj falje! Thashë i fundit, por tash fjalën e kërkon Ardian Gjini. Urdhëro Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Do të flas tepër shkurt, meqenëse u tha një pjesë e asaj që e pata ndërmend ta them. Mendoj se duhet ta kemi një përgjigje pak më të saktë në atë se çka do të ndodhë nëse Kuvendi në komision e amendamenton nenin 14 të ligjit, nen i cili jep të drejtë, për shembull, nëse Kuvendi e ndryshon nenin 14, nen i cili i jep të drejtë ministrit që t'i përcaktojë vetë të gjitha ato çka kërkohen, do të thotë t'i vendosë kushtet, siç thuhet këtu, dhe lehtësirat për të dhënë tokë në shfrytëzim për zona ekonomike, ashtu siç thuhet. Ky nen e bën këtë ligj, që vetëm sa ia jep ministrit mundësinë, dhe atë jo Qeverisë, por drejtpërdrejt ministrit. Dhe, çfarë kuptimi do të kishte pasur ligji, nëse ky nen ndryshohet në komision dhe Kuvendi e voton, shembull ta marrim, pa këtë nen. Çka do të ndodhte, a do të kishte kuptim totalisht ligji.

Edhe një herë po them: nuk jemi kundër krijimit të zonave ekonomike si të tilla, mirëpo mendojmë se vendimmarrja po kufizohet në një ministri, ndërsa kemi të bëjmë me diçka

jashtëzakonisht të rëndësishme, duke e pasur parasysh gjendjen ekonomike, territorin, numrin e banorëve e tjetër çka kemi në Kosovë.

Mendoj se kjo temë është goxha problematike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E do fjalën ministre? Urdhëro!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

I falënderoj të gjithë deputetët, shefat e grupeve parlamentare për komentet!

Konsideroj që pas gjithë asaj që u tha, ndiej obligim institucional t'i bëj vetëm disa sqarime elementare, që besoj janë në dobi të të gjithëve.

Si e para, konsideroj se dallimi esencial i këtij ligji me ligjin paraprak është se parasheh themelimin e zonave të lira ekonomike, që sot nuk ekzistojnë në Kosovë. Zonat e lira ekonomike janë ato të cilat do të lirohen, të gjithë ata që operojnë në kuadër të tyre, nga Dogana dhe TVSH-ja, për materialin e importuar, lëndën e parë, gjithashtu edhe makinerinë.

Dhe, synimi kryesor i zonave të lira ekonomike është që të ketë aktivitete prodhuese.

Si e dyta, këshilli kombëtar për zonat ekonomike, u tha shumë për këtë si trup. Të gjithë ata kryetarë të komunave, që bazuar në ligjin e kaluar, kanë shkuar prej ministrisë në ministri, që të marrin pëlqime për zonat ekonomike. E dinë sa kohë dhe sa mund u duhet të presin, që secila ministri veç e veç ta trajtojë kërkesën e tyre. Esenca e krijimit të këshillit kombëtar në kuadër të këtij ligji është që së bashku të gjithë përfaqësuesit e ministrive, ose edhe vetë ministrat, ta japin pëlqimin në një ditë, në një takim, domethënë në bazë të materialit që u dorëzohet më herët dhe të mos prolongohet dhënia e pëlqimit për zonat ekonomike.

Sa i përket menaxhimit të zonave ekonomike, nëse flasim për zonë ekonomike, natyrisht se pas themelimit dhe fillimit të veprimtarisë, ajo do të jepet me partneritet publiko-privat, për shkak se me siguri një operator mund ta menaxhojë shumë më mirë se sa me gjithë administrimin nga Ministria, apo nga një institucion tjetër qeveritar.

Gjithashtu, nuk dua që ky ligj të shkaktojë konfuzion mbi funksionimin, apo menaxhimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, apo strategjinë e zhvillimit ekonomik. Ekziston strategjia e zhvillimit ekonomik. Ky ligj është në përputhshmëri me strategjinë e zhvillimit ekonomik. Në kuadër të Ministrisë do të jetë Agjencia për përkrahje të biznesit. Ju, së shpejti, ose nëse vetëm nuk e keni një ligj për themelimin e Agjencisë, e cila bën fuzionimin e dy agjencive ekzistuese, agjencisë për promovim të investimeve dhe agjencisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, për dallim nga krijimi i trupave të ndryshëm, ne po shkojmë në shkrirje të dy trupave në një dhe një ngritje të funksionalitetit dhe do të jetë një agjenci për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe është në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Gjithsesi, prapë dua të theksoj se është një ligj me shumë rëndësi. E krijon domethënë një praktikë dhe e krijon një formë të operimit të biznesit, të cilën nuk e kemi pasur në Kosovë, nëpërmjet zonës së lirë ekonomike ngrit efikasitetin dhe dhënien e pëlqimit për zonat ekonomike dhe besoj se do të jetë në funksion të asaj që të gjithë e synojmë, një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Edhe njëherë, ju falënderoj shumë për komentet dhe përkrahjen!

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për zonat ekonomike. Në sallë i kemi 77 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, 46 deputetë janë për projektligjin, kundër janë 19, dhe 3 abstenojnë. Domethënë me këtë shumicë që e deklarova, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për zonat ekonomike.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme, që në afat të paraparë me Rregullore të Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e trembëdhjetë:

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të punës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Radhe e diskutimeve është e këtillë: Anëtari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Liburn Aliu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëro Liburn!

LIBURN ALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të obligimeve të parapara me nenin 53 të Rregullores së Kuvendit e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës.

Duke u mbështetur në nenin 53 të Rregullores, komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 15 shkurt 2012, e miratoi iniciativën për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës dhe në funksion të realizimit të këtij procesi, komisioni e ka themeluar grupin punues nga anëtarët e komisionit, detyrat e të cilëve ishin:

- përpilimi i planit të realizimit të monitorimit në afatet kohore;

- identifikimi i institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve relevante për zbatimin e Ligjit të punës, që do të ishin edhe objekt monitorimi;
- organizimi i vizitave në terren, në institucionet relevante qeveritare dhe të nivelit lokal, si dhe të kompanive publike-private, me qëllim të marrjes së informacionit të nevojshëm nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave në takimet e realizuara;
- mbledhjen, studimin, analizimin dhe diskutimin e informacionit të marrë nga këto vizita, përgatitjen e draft-raportit, i cili u trajtua në komision.

Grupi punues, bazuar në autorizimet e tij, ka arritur me sukses t'i përmbyllë aktivitetet e planifikuara në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës. Gjatë periudhës shkurt 2012 dhe tetor 2012, grupi ka realizuar 26 takime dhe vizita në terren. Gjithashtu, janë mbajtur takime të rregullta të grupit, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve.

Vizitat dhe takimet e grupit punues në terren u përqendruan në tri nivele institucionesh, në ato qendrore relevante, siç është: Ministria e Punës, Mirëqenies Sociale dhe Inspektorati i Punës; në gjykatat komunale në Pejë dhe Therandë; institucionet lokale: Komuna e Pejës, Komuna e Suharekës; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës; si dhe në kompanitë private ELKOS-Group Pejë; NEW Company Ballkan Suharekë; "NEW Company Ferronikel" në Drenas; "Behtel-Enka" në Prizren; "Coral Sola" në Fushë-Kosovë dhe Fabrika e Vajit në Besianë.

Njëra ndër pengesat kryesore në procesin e mbikëqyrjes dhe identifikimit të mangësive në Ligjin e punës dhe zbatimin e tij është faza fillestare, në të cilën ndodhet implementimi i këtij ligji, periudha kohore nga miratimi deri tani është relativisht e shkurtër, për të ofruar ndonjë përvojë të mjaftueshme të zbatimit të këtij ligji, e që do të mundësonte identifikim më të plotë të problemeve.

Megjithatë, grupi punues gjatë punës së tij ka arritur t'i identifikojë të arriturat nga njëra anë, si dhe ka identifikuar probleme, të cilat janë rrjedhojë e mangësive në ligj, e po ashtu si rezultat i moszbatimit të tij. Duke u bazuar në punën e bërë, në procesin e mbikëqyrjes së Ligjit të punës nga grupi punues, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë analizë për të arriturat dhe mangësitë e Ligjit të punës dhe zbatueshmërisë së tij. Komisioni konsideron se miratimi i Ligjit të punës e ka avancuar gjendjen e marrëdhënies së punës në Republikën e Kosovës në aspektin legjislativ.

Me gjithë sukseset e arritura, janë identifikuar edhe probleme në funksionimin e marrëdhënieve në punë, që vijnë si rezultat i vetë ligjit nga mospërbushja e obligimeve ligjore nga institucionet dhe organizatat tjera relevante, e po ashtu edhe nga mospërbushja e obligimeve ligjore nga punëdhënësit.

Problemet e identifikuar, si rezultat i mangësive në ligj:

- Ligji nuk e përcakton afatin minimal të kohëzgjatjes së kontratës dhe për pasojë lidhen kontrata afatshkurta dhe punëmarrësit i nënshtrohen presionit të humbjes së vendit të punës, në mënyrë periodike;
- Dispozitat e ligjit lejojnë që me rrogë minimale të paguhen edhe punëmarrësit, që bëjnë punë të rënda,
- Për shkak të mundësive ligjore, për moslidhje të kontratave të puna praktike, haset në punëmarrës informalë, në emër të punës praktike.
- Pastaj, mosdefinimi i punës vullnetare me ligj e lejon punën pa kontratë dhe pa pagesë në afate të pacaktuara të punëmarrësve, në emër të nxënies të shkathtësive artizanale.

Problemet e identifikuar si rezultat i mospërmbushjes së obligimeve ligjore nga institucionet dhe organizatat relevante:

- Ministria nuk ka arritur të sigurojë buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e ligjit dhe të akteve miratuara nënligjore;
- Ministria, nëpërmjet procedurave të komplikuar për aplikim, në gëzimin e së drejtës për pushim të lehonisë, i ka dekurajuar nënat për gëzimin e kësaj të drejte;
- Ministria ka ndarë buxhet të pamjaftueshëm për realizimin e kësaj të drejte dhe pengesë në realizimin e kësaj të drejte është po ashtu mungesa e institucioneve publike, që përkujdesen për fëmijët e moshës nën 1-vjeçare;
- Në mungesë të interpretimit më të detajuar të dispozitave ligjore nga Ministria ndodh mospërmbushja e obligimeve ligjore nga punëdhënësit, me ç'rast pagesa për punë në ditë festash nuk realizohet sipas ligjit dhe në dëm të punëmarrësit;
- Mungesa e një plani konkret për vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe të masave konkrete mbrojtëse për të punësuarit, konform natyrës së punës që bëjnë;
- Inspektorati i Punës nuk arrin t'i përmbushë detyrat e tij në informimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve në lidhje me dispozitat ligjore nga marrëdhënia e punës;
- Inspektorati i Punës, në mungesë të kapaciteteve, nuk e përmbush kënaqshëm nivelin e inspektimit në shtrirje territoriale dhe në sasinë e inspektimeve, në raport me numrin e bizneseve. Pra, 45 është numri gjithsej i inspektorëve në raport me 117 061 biznese;
- Inspektorati i Punës duhet t'i japë prioritet inspektimit të pushimit vjetor dhe të lehonisë;

- Inspektorati i Punës nuk ka arritur ta kontrollojë në masë të duhur punën e fëmijëve nën moshën 18-vjeçare;
- Gjykatat nuk janë të efektshme në trajtimin e lëndëve nga Ligji i punës dhe vonesat e mëdha janë evidente. Në mungesë të efikasitetit të gjykatave, ndikon edhe mungesa e bashkëpunimit të mirëfilltë ndërmjet gjykatave dhe Inspektoratit të Punës;
- Efikasiteti i Këshillit Ekonomiko-Social nuk është i kënaqshëm;
- Organizimet sindikale nuk kanë arritur të kenë shtrirje edhe në sektorin privat, me përjashtim të disa ndërmarrjeve të mëdha private dhe në të cilat organizimi sindikal është trashëguar;
- Po ashtu, edhe organizimi ekzistues sindikal, me përjashtime, ka mungesë nismash konkrete dhe të punës aktive në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve;

Mospërbushja e obligimeve ligjore nga punëdhënësit:

- Numër i madh i punëmarrësve pa kontratë pune;
- Mospërbushje e obligimeve nga kontrata;
- Tejkalimi i normës së punës dhe moskompensimi adekuat;
- Mospërbushje e obligimeve ligjore në lidhje me pushimin ditor, javor dhe vjetor;
- Mospërbushje e obligimeve ligjore në lidhje me masat për ruajtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë; dhe
- Po ashtu, ka mospërbushje të obligimeve ligjore në lidhje me pagesat e rregullta për punëmarrësit.

Komisioni i ka dhënë edhe rekomandimet krahas këtij raporti dhe këto rekomandime janë së pari në fushën në funksion të plotësimit dhe ndryshimit të ligjit, në çështjet si vijon:

- të përcaktohet afati minimal për kontratat;
- qartësimi i dispozitës ligjore për punën gjatë festave;
- përcaktimi me ligj i lidhjes së kontratave për punën praktike dhe vullnetare;
- përcaktimi me ligj i klasifikimit të rrogës minimale, për profesione dhe lloje të ndryshme të punës;

- me planifikimet buxhetore të Qeverisë, të parashihet rritja e buxhetit në favor të zbatimit të Ligjit të punës;
- Ministria të ndërtojë kapacitete për informimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve në lidhje me Ligjin e punës;
- përpilimi dhe zbatimi i planit konkret nga Ministria për vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe të masave konkrete mbrojtëse për të punësuarit, konform natyrës së punës që bëjnë;
- të thjeshtohen procedurat për aplikim për tremujorin e tretë të pushimit të lehonisë;
- të rriten kapacitetet e mbikëqyrjes nëpërmjet rritjes së numrit të inspektorëve, përmirësimit të kushteve për punë dhe shtrirjes proporcionale të inspektorëve nëpër çdo komunë;
- nga gjykatat të trajtohen me prioritet lëndët nga Ligji i punës,

- të rritet efikasiteti i punës të Këshillit Ekonomiko-Social dhe të ofrohen kushte për themelimin dhe forcimin e organizimit sindikal, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Po ashtu, është rekomandimi shtesë që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet t'i raportojë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për nivelin e zbatimit të ligjeve së paku një herë vit. Kjo përgjegjësi e Ministrisë buron nga Rregulla 73, paragrafi 2, e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYSUESI: Përfaqësuesi i Qeverisë e merr fjalën e ka fjalën. Urdhëro ministër!

MINISTRI NENAD RASHIQ: Hvala gospodine predsjedavajući, Dame i gospodo narodni poslanici,

Pre svega moram da kažem da je izveštaj dotakao stvarno neke problematike sa kojima se suočavamo i naravno ja bih ohrabrio i Komisiju koja radi i ovaj izveštaj, i svaku drugu komisiju koja bude htela da ne samo ovaj zakon, nego bilo koji zakon iz Ministarstva koji dolaze, bilo kad i bilo u kom momentu da proveru, da analiziraju, da vide njegovo sprovođenje. Ministarstvo će uvek biti na usluzi da pomaže.

Ali pored toga, moram da naglasim neke tačke koje su predložene kao preporuke, koja, da tako kažem, nisu možda najadekvatnije predložene ili nisu možda najadekvatnije objašnjene, jer smo u većini od tih predloga mi već uradili dovoljno toga da bi mogli da značajno pokažemo te rezultate.

Uglavnom, ja ću biti konkretan pa ću krenuti na posebne komentare, odnosno posebne preporuke koje su došli od komisije, da ne bih ulazio u onu opštu sferu oko samog i samih tačaka zakona.

Na primer, u preporuci, član 10. koji se zakon o radu i određeni ugovori mogu da se sklapaju za jedan neodređeni i određeni period za specifične poslove i zadatke, tako da Ministarstvo, uzećemo u obzir ovu preporuku, i prilikom izrada amandamena za Zakon o radu izaći sa konkretnim odredbama za minimalan rok o ugovoru o radu, kao što se i tražio, koji se sklapaju na određeno vreme. Procena od strane Ministarstva za minimalni rok prilikom sklapanja ugovora o radu na određeno vreme obaviće se odnosno uradiće se do kraja godine.

Odredbe vezane za rad u praktičnim danima, koje je takođe od preporuka bilo, je do sada inspektorijat je insistirao na poštovanje tog zakona po kome je jedan zakon je omogućio benifit odnosno dobijenu dnevnicu za taj dan kada je u toku praznik i takođe samim zakonom o radu regulisano je da bude 50% od redovnog plaćanja koje radnik ima. Tako da, tokom meseca novembra ponovo Inspektorijat za rad izaći sa dodatnom informacijom u vezi ovog pitanja, odnosno preporuke.

Takođe, sklapanje ugovora sa pripravnici je regulisano članom 16. zakona o radu, gde kaže: poslodavac koji angažuje pripravnike u svom preduzeću može da sklopi ugovor i bez neke kompenzacije odnosno plate.

U ovom slučaju, poslodavac je dužan da održi spisak na kojim evidentira ove pripravnike i za to predlog za sklapanje ugovora za praktični rad već je regulisan Zakonom o radu.

Za eliminisanje ove pojave, pošto znamo i sami da se dešava da se na takav način krije taj informalitet ili neformalna ekonomija, za eliminisanje ove pojave koje jeste u porastu, moramo da priznamo, i koja povećava informativno zapošljavanje na Kosovu Ministarstvo za rad uzeće u obzir ovo pitanje, analiziraće i izaći će sa konkretnim predlogom iako i to pitanje nije regulisano u zemljama u regionu.

Minimalna plata u našoj zemlji određuje se preko sporazuma socijalnih partnera, dok se određuje, znači donose se odluka samom odlukom Vlade. Preko zakonskim pravilima minimalna plata se utvrđuje na kraju svake kalendarske godine. Tako ćemo i mi na sledećem sastanku KEBS-a odnosno socijalno-ekonomskog saveta - Këshillit Ekonomiko-Social - imaćemo raspravu o tom minimalnom zaradu.

Što se tiče radnih knjižica, koje je naznačeno kao jedan od vrlo bitni elemenat koji kaže da Ministarstvo nije planirao dovoljno budžet i samim tim nije uspelo da izvrši sve odredbe zakona, ja moram da naglasim da to nije bilo zbog budžeta, to je bilo zbog toga što je praksa radnih knjižica jedna praksa koja je dosta stara, odnosno praksa koja se više ne koristi u savremenim zemljama, i za to ćemo vam dati primer, recimo Austrije i Nemačke, a najsvežiji primer je Hrvatska koja do 2016. bi trebalo da se oslobodi radnih knjižica, sad se koristi neki novi model takozvane kart-poiment ili kartica za zapošljavanje, koje će preko ID tehnologije svaki od tih korisnika imati karticu kojom će moći proveriti u svakoj data-bazi dali je on radio i gde je on radio pre toga.

Znači, mi ćemo se držati ovog novog sistema pravljenja tih plastičnih kartica, takozvanih kartica za zapošljavanje koja će na sebi nositi sve podatke o jednom određenom posla primaocu ili određenom poslodavcu.

Takođe, informacija o zaposlenih i poslo-primaoca u vezi prava i obaveza koje proizilaze iz Zakona o radu, jeste pitanje koje se povezuje sa kapacitetima Inspektorijata za rad. Ja moram da napomenem da Inspektorijat sam nema obavezu i dužnost da obaveštava poslodavce i posloprimaoca, ali zato postoji i socijalno-ekonomski savet. Mi svakog meseca imamo jednomesečni sastanak sa Savetom gde predlažemo odnosno gde ta komunikacija postoji. Mi smo išli toliko daleko da imamo konstantne dogovore sa racimo predstavnicima BSPK, predstavnika sindikata i svih ostalih koji su u KES-u da redovno imaju sastanke sa Inspektorijatom odnosno sa glavnim inspektorom, što je do sad urodilo plodom da Inspektorijat i po samoj obavezi po zakonu ima obavezu da svaki prijavljen slučaj ispita, što znači da u tom segmentu mislim da je komunikacija dobra i da smo do sada imali stvarno neke dobre rezultate a to kažu i sami sindikati.

Znači to ne dolazi iz Inspektorijata, nego to dolazi iz sindikata.

Pored toga, mi smo i već dostavili jedan projekat UIP-a 2012. koje bi trebalo da počne, mislim, do kraja novembra i započeti taj projekat, koji je predviđen negde u iznosu od pola miliona evra, koji baš ima za cilj povećanje kapaciteta Inspektorijata.

Procena rizika u radu u preduzimanju zaštitnih mera, nije direktna nadležnost Ministarstva za rad. Preduzimanje zaštitnih mera će biti obaveza svakog poslodavca. Mi izrađujemo politike koje u ovom slučaju podrazumevaju da ćemo izraditi administrativna uputstva koja će dati informacije poslodavcima na koji način oni trebaju da preduzmu mere i da osiguraju da jedan od njihovih radnika mora da bude odgovorno lice za zaštitu na radu.

Znači mi smo organ koji će formirati politiku, i ta politika treba da bude završena... Ovaj zakon koji je bio podnet on je odobren u oktobru, on je taj prvi preduslov i kada bude bio na drugom čitanju ovde verovatno ćete znati i posle toga i sam deo odgovornosti koji snosimo mi će se nastaviti u vidu formiranja tih dve administrativnih uputstava koje će odrediti koje su to organizacije koje mogu licencirati radnike u samoj kompaniji za zaštitu na radu i pored toga formiraće odbor koji će biti u stanju da potvrdi njihovo licenciranje.

Znači, videćete i sami kada bude zakon bio, možda sad nisu još sve stvari razjašnjene, odnosno zakon je apsolutno u oktobru usvojen, on će verovatno do kraja godine biti usvojen i ovde, prema tome mere su preduzete.

Procedura za primenu trećeg tromesečja porodijskog odmora, koji ste vi napomenuli kao jedan vrlo element za zabrinutost, je apsolutno isti kao i u zemljama u regionu. Znači mi ništa tu nismo izmislili posebno. Kad kažem to, mislim da nikakva procedura dodatna nije od one koje već postoji u regionu.

Takođe u Inspektoratu za rad zapošljeno je 50 inspektora, još za 5 dodatnih pozicija je procedura u toku.

Ponavljam opet da smo mi, jer ja znam da možda 50 inspektora u ovom momentu nije dovoljno, zbog toga što sama svest poslodavaca nije na odgovarajućem nivou i da oni

sami preduzimaju mere, ne da ih teramo mi silom. Ali mislim da u poređenju sa 50 inspektora koji postoje, odnosno u ovom slučaju 55, da je učinjen jedan pomak, da smo zaposlili 10% više inspektora i mislim da će u daljem periodu i to sigurno doći do izražaja.

A što se tiče ekonomsko-socijalnog saveta, kao što sam već rekao do sad, svakog meseca naši sastanci budu vrlo konkretni. I pored onoga što sam napomenuo, bio za minimalnu platu, mi radimo na toj razini, da kažem, i njihovih kapaciteta, ne samo inspektorijata ali kapaciteta i poslodavaca i posloprimaoca, tako da takođe u projektu IPA 2012. imamo projekat takozvanog podrška socijalnim partnerima. On je takođe u pripremnom periodu, biće verovatno započet do kraja novembra ili eventualno početkom decembra koji ima za cilj poređenje sadašnje odnosno aktualne situacije ovde kod nas sa nekim razvijenim zemljama koji imaju taj ekonomski i socijalni dijalog mnogo više nego ovde.

KRYESUESI: Faleminderit, zotni ministër.

(Ndërhyrje - reagim)

Asnjë minutë, kohën tëndë mësohu ta shfrytëzosh më mirë. Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale për monitorimin e Ligjit të punës.

Konsiderojmë se është një raport gjithëpërfshirës dhe i përkrahim edhe rekomandimet e dala nga ky raport.

Për monitorimin e Ligjit të punës, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka punuar një kohë të gjatë, qysh prej muajit shkurt.

Siç është cekur edhe në raport, pengesë kryesore në procesin e mbikëqyrjes dhe identifikimit të mangësive në Ligjin e punës dhe zbatimin e tij, është faza fillestare në të cilën ndodhet implementimi i këtij ligji.

Periudha kohore nga miratimi e deri më tani është relativisht e shkurtër për të ofruar të dhëna të mjaftueshme të zbatimit të këtij ligji.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i ka nxjerrë të gjitha udhëzimet administrative të parapara me ligj, mirëpo ka nevojë për fuqizim të kapaciteteve mbikëqyrëse, e sidomos në rritjen e numrit të inspektorëve të punës dhe shpërndarjen e tyre nëpër komuna.

Gjatë monitorimit kemi parë se në shumicën e komunave nuk ka fare inspektorë të punës, por ata kanë zyra vetëm në nivele regjionale. Për këtë arsye punëtorët nuk kanë ku t'i lajmërojnë shkeljet nga punëdhënësit, por shpesh drejtohen në drejtoritë komunale.

Nga të gjitha vizitat e bëra, kemi hasur në informim të pamjaftueshëm për Ligjin e punës, sidomos nga punëmarrësit.

Meqenëse ministri pak më herët e sqaroi se ky është obligim i Këshillit Ekonomiko-Social, kërkojmë nga ministri, meqenëse është anëtar në Këshillin Ekonomiko-Social, të punojë më shumë në këtë drejtim, që të njoftohen punëmarrësit dhe punëdhënësit me Ligjin e punës.

Gjatë monitorimit të Ligjit është vërejtur se shkeljet më të mëdha janë në sektorin privat, dhe atë në ndërmarrje të vogla, përderisa në sektorin publik dhe në ndërmarrjet e mëdha private ka më pak shkelje në zbatimin e Ligjit të punës.

Vlen të theksohet se dispozita ligjore lidhur me shpalljen e konkurseve, veçanërisht në sektorin publik, respektohet.

Gjatë mbikëqyrjes së këtij ligji janë vërejtur mangësi në zbatimin e dispozitave për ruajtjen e shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjes në punë.

E përshëndetim vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht të Qeverisë, që e ka sjellë në Kuvend projektligjin për siguri dhe shëndet në punë.

Me aprovimin e këtij projektligji do t'i lehtësohet puna Inspektoratit të punës në zbatimin e Ligjit të punës, sepse deri më tani edhe Inspektorati i Punës ka pasur probleme në terren në zbatimin e kësaj dispozite, sidomos gjatë inspektimit në ndërtimtari.

Të nderuar kolegë,

Nuk është e lehtë që Komisioni parlamentar gjatë monitorimit të Ligjit të punës t'i identifikojë të gjitha mangësitë në ndërmarrjet e vizituara, sepse këto vizita janë zyrtare dhe lajmërohen punëdhënësit paraprakisht për vizitë. Për këtë arsye, edhe një herë dua të theksoj se Inspektoratit të Punës duhet plotësuar kushtet për punë, si të shtohet numri i inspektorëve të punës, të shpërndahen në të gjitha komunat, t'i jepet mundësi Inspektoratit të Punës që edhe pas orarit të punës të jenë në terren, sepse pas kësaj kohe edhe ndodhin shkeljet më të mëdha. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nazane Breca, për LDK-në.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!

I nderuari kryesues,

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Raportin e Komisionit për Shëndetësisë, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me monitorimin e implementimit të Ligjit të punës.

Grupi ynë ka parë se në këtë raport ekzistojnë mjaft të dhëna nga gjetjet në terren që i ka bërë ky komision dhe se ekzistojnë një sërë rekomandimesh, të cilat mendojmë se në një

të ardhme do të ndihmojnë në plotësimin e zbrazëtirave, të cilat ekzistojnë në Ligjin e punës dhe do ta pasurojnë atë.

Gjithsesi pajtohem se duhet t'i krijohen më shumë kushte Inspektoratit të Punës, në mënyrë që ata në terren të jenë më efikas, të rritet numri i inspektorëve të punës dhe gjithsesi t'u plotësohen kushtet, në mënyrë që ta kemi një monitorim sa më të mirë të implementimit të Ligjit të punës.

Unë nuk do t'i përsëris ato që u thanë nga kolegët e mi, por ne si Grup Parlamentar do ta miratojmë këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën, në emër të “Vetëvendosjes”, e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës, si Grup Parlamentar, do ta votojmë.

Raporti para nesh është diskutuar mjaft në komision dhe si i tillë me rekomandimet që ka dalë, ka dalë me përkrahje të plotë nga Komisioni.

Procesi i monitorimit ka qenë i frytshëm, jo vetëm në aspektin e përmbushjes së obligimit me Rregulloren nga Komisioni, por edhe si shqyrtim për së afërmi i mënyrës së funksionimit të sistemit politik në Kosovë, në përgjithësi, pasi marrëdhënia e punës është njëri nga aspektet që e pasqyron natyrën e funksionimit të një shteti, dhe nga ky monitorim del se ka të arritura, por ka edhe mangësi që do të duhej të përmirësoheshin.

Nga pikëvështrimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, marrëdhëniet në punë në vendin tonë janë të lidhura ngushtë me politikën e shtetit në mënyrë të ndërsjellë. Ato janë pasqyra e sistemit politik nga njëra anë, pasi janë të ndikuara drejtpërdrejt nga sistemi politik dhe, në anën tjetër, ky sistem politik në fund të fundit mirëmbahet nga kjo natyrë e marrëdhënies në punë.

Sistemi pra mban punëtorë të varur dhe sistemi varet nga punëtorët e varur. Sistemi i mban ata të varur, pasi varet nga varësia e tyre. Kjo pasi e kundërta, pra punëtori i lirë me të drejtat e garantuara, paraqet potencial për kundërshtim. Varësia është e ndërlidhur me frikën nga humbja e vendit të punës dhe kjo vjen nga lidhja jetike me vendin e punës për shkak të varfërisë. Rrogat e lidhura me kufijtë e ekzistencës dhe kreditë e shumta e forcojnë këtë varësi. Dhe, kjo nuk lidhet vetëm me aspektin e relacionit të drejtpërdrejtë pushtet-punëtor, duke qenë shteti si njëri nga punëdhënësit kryesor dhe që pushteti ndihet si padron i kësaj punëdhënie, por edhe nga politika e pushtetit në aspektin ekonomik.

Raporti thotë që ka të arritura në aspektin legjislativ, gjë që është e vërtetë. Por, nuk duhet të harrojmë se kjo është një anë më elementare e shtetit dhe në këtë aspekt nuk duhet të harrojmë se ky ligj i mirë, në shumicën dërmuese të përmbajtjes, ka pjesë që e bëjnë atë

totalisht të përshtatshëm për funksionimin e politikës aktuale. Ta zëmë, ligji i ka mjaft mirë të definuara dispozitat që e kushtëzojnë punëdhënësin në raport me largimin e punëtorit nga puna. Punëdhënësi nuk mund ta largojë lehtë punëtorin nga puna, bazuar në këto dispozita. Dhe, kjo është e mirë. Por, njëkohësisht është e kotë, pasi po ky ligj, në anën tjetër, lejon që punëdhënësi të bëjë kontratë të shkurtër me punëtorin dhe ta largojë atë pa i interesuar fare dispozitat e ligjit. Pra, një punëdhënës mund të lidhë kontratë njëmuore dhe pas një muaji nuk ka obligim ta vazhdojë atë kontratë.

Pra, ky ligj ua lejon pronarëve të “Ferronikelit” që punëtorët që punuan me vite të tëra në këtë fabrikë, me gjithë përgatitjen profesionale që kanë, t’i mbajë ata me kontrata tremujore dhe ata punëtorë çdo tre muaj përballen me frikën se do të largohen nga puna, dhe një pjesë e tyre largohen, e të tjerët mbeten me shpresën edhe për tre muaj të tjerë. Dhe, kështu, në mënyrë periodike, ata i nënshtrohen një presioni dhe numri i tyre shkon duke u rralluar.

Kjo shkelje e të drejtave të tyre mundësohet me ligj. Dukuria e tillë e thyen solidaritetin ndërmjet tyre dhe i dobëson ata si potencial në çdo aspekt. Dhe, nga bisedat me ta kuptuam se këto kontrata të shkurtra janë që kur është ligji në fuqi. Logjika e tillë e veprimi me punëtorët haset në vendet ku pushteti e ka frikën e shqetësimeve sociale. Tani pra edhe ligji bëhet instrument i shkeljes së të drejtave.

Edhe përkundër shumë dispozitave të mira të përpiluara në këtë ligj, ky ligj po ashtu e mundëson edhe një formë tjetër të shfrytëzimit. Gjatë vizitave të bëra dhe konkretisht në kompaninë “Behtel&Enka”, në ndërtimin e autostradës, kemi hasur që kjo kompani është mjaft e përpiktë në zbatimin e ligjit, por ja që ligji ia mundëson asaj që punëtorët, me gjithë punën e rëndë që e bëjnë, pasi ata bëjnë punë në ndërtim, kurse paguhet me rroga tejet minimale, edhe pse kjo kompani paguhet me qindra milionë dhe edhe pse deklaron bashkë me Qeverinë se e ka zvogëluar papunësinë.

Këta punëtorë bëjnë punë stinore të shkurtra, pasi autostrada lëviz, merr fillimisht punëtorë nga Prizreni, pastaj Theranda, pastaj Malisheva, e kështu me radhë. Pra, punëtorët bëjnë punë disamujore, me përjashtim të disave që mbeten nga fillimi dhe këta punëtorë që mbeten po ashtu paguhet me paga tejet të ulëta, me mëditje, madje 90% e tyre. Kjo mundësohet, natyrisht nga varfëria. Varfëria i bën punëtorët të punojnë edhe për më pak, sepse edhe ato pak u nevojiten, pavarësisht punës që e bëjnë. Dhe nuk është e drejtë që ata të paguhet me minimumin e përcaktuar me ligj. Fakti se kompania shkon në minimumin e pagës së lejuar, tregon që po të ishte ky minimum edhe më i vogël, ata punëtorë do t’i kishin edhe më të vogla rrogat. E nëse e shikojmë nivelin e varfërisë në Kosovë, i bie që edhe po të ishte mëditja 5 bukë në ditë, prapë do të kishte punëtorë që lajmërohen, sepse janë të shumtë që jetojnë në varfëri të skajshme. Pra, varfëria mundëson që në treg të punës të kemi punëtorë të lirë, por kjo nuk do të thotë që ata tani është e drejtë të shfrytëzohen. Së paku, mendonim se nga ato qindra milionë të autostradës do të bëhen të lumtura ca familje, pasi do të punësojnë dikë, edhe pse po i bie se qenkan disa familje që po u ngopkan me bukë për disa muaj. Kjo logjikë e këmbimit të punës, me mbijetesë i takon shekujve të kaluar, duke mos i menduar këta dy të fundit.

Gjatë vizitave me grupin punues, pjesë e tyre ishin edhe kompanitë prodhuese private. E kemi vizituar kompaninë “Koral-Sola” dhe atë të vajit në Besianë. Jemi informuar edhe me vështirësitë që ato i kanë. Përderisa e para kishte punëtorë aktivë dhe i përmbushte obligimet ligjore, ajo e dyta, në atë kohë nuk kishte punëtorë, sepse nuk kishte as punë. Të jesh prodhues në Kosovë e ke vështirë të mbijetosh si kompani, po u more me tregti, e ke më të lehtë. E para, pra kompania “Koral-Sola” mbijeton me vështirësi dhe mbahet nga pjesa e kompanisë që merret me tregti dhe ata me fanatizëm e mbajnë prodhimin, sepse aty e shohin të ardhmen. Në fakt, aty edhe është e ardhmja e shtetit.

Të dytët që janë të varur nga prodhimi punojnë me periudha të shkurtra, pasi prodhimi i tyre shkelet nga Serbia. Për të dy kompanitë, periudha e artë ishte ajo e reciprocitetit. Asokohe ajo e vajit punonte me tri ndërrime, po përgatiteshin kushte që prodhimi i saj të shtohet, punëtorët e rinj të punësohen dhe tokat bujqësore në rrethinë, të mbillen me lule dielli, prodhim që ky me dekada ka qenë pjesë e bujqësisë në Kosovë. Sot janë mbjellë sipërfaqe me luledielli, që mund të jenë edhe për pak vite, nëse vazhdon kjo politikë, por punëtorë në fabrikë ka pak.

Në takim me disa prej tyre, që tani nuk punonin, kuptova se pas humbjes së punës rrugë e vetme u mbeti tash punimi i tokës bujqësore dhe shitja e prodhimeve bujqësore. Dhe, prapë ato prodhime bujqësore, u kalbën si pasojë e futjes në treg të produkteve nga jashtë.

Pra, nuk mund të shikohet Ligji i punës ndaras nga politika fiskale, ndaras nga interesat e pushtetit. Nëse duam zbatim të Ligjit të punës, mosshtypje të punëtorëve, duhet zhvillim, duhet prodhim, respektivisht politika e shtetit e përcakton këtë.

Për sa u përket vërejtjeve me zotin ministër, përse pagesat në ditë festash u bëhen 50%, e do të duhej t’u takonte një mëditje e gjysmë, sepse u paguhet vetëm gjysmë mëditje. Pra, ky është keqinterpretim dhe në “Ferronikel” ndodh kjo gjë. Ata punojnë në ditë festash, pra është dita që punojnë, por plus duhet të paguhet edhe një ditë tjetër, që është ditë feste. Pra, po të mos punonin atë ditë, ata do ta merrnin një ditë e gjysmë, sepse ligji e thotë këtë. Meqenëse punojnë, i bie që e marrin edhe një mëditje.

Po ashtu, te Këshilli Ekonomiko-Social është një problem mjaft serioz që sindikata, pavarësisht sado joaktive që është, ajo çdoherë mbivotohet dhe çdoherë ka për t’u mbivotuar në Këshillin Ekonomiko-Social për shkak se 5 janë nga sindikata, 5 nga punëdhënësi dhe 5 nga Ministria. Punëdhënësit dhe Ministria në çdo vend është një koalicion i natyrshëm dhe sindikata çdoherë në mënyrë të natyrshme mbetet e mbivotuar. Kjo është mjaft e logjikshme me këtë.

E tash, sa i përket afatit minimal, duhet të ketë afat minimal. Është rasti i “Ferronikelit”, që e përcakton...

Ndërsa, te kontratat e punës praktike, Ligji thotë që mund të bëhet kontrata, jo që e obligon se duhet. Dhe kjo që e lë mundësinë që të mos bëhet, konkretisht raste kemi edhe nëpër ndërtesat-institucionet publike dhe ato shtetërore, që ata që kryejnë shërbimet shpeshherë janë praktikantë, të cilët nuk kanë kontratë dhe madje janë edhe të mitur. Këtë e kemi hasur vetë, konkretisht mund ta gjemë saktë atë.

Te klasifikimi i rrogës minimale, dakord është KES-i që e bën atë punë. KES-i pra e përcakton rrogën minimale, mirëpo duhet që me ligj të caktohet obligimi për t'u klasifikuar ajo në bazë të bazë të profesionit.

Mirë është që zbatimi do të fillojë nga Ministria, do të thotë të përcaktohet çështja e rrezikshmërisë në punë. Natyrisht se rrezikshmëria në punë përcaktohet nga vetë punëdhënësit, por politikat dhe kriteret e përgjithshme i përcakton Ministria, respektivisht i përcakton shteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të AAK-së, Xhevdet Neziraj. Atëherë, kush është me radhë? Atëherë deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Qëllimi i mbikëqyrjes së Ligjit të punës ka qenë të vlerësohet niveli i zbatueshmërisë të këtij ligji në praktikë.

Gjatë monitorimit, Grupi punues ka realizuar vizita në nivelin qendror, në nivelin lokal - në komuna, por edhe në kompanitë në mënyrë që praktikisht të informojnë për pengesat e zbatueshmërisë së këtij ligji.

Bazuar në këtë ose në problemet e identifikuara, Komisioni ka vendosur për iniciimin e procedurës për plotësim-ndryshimin e këtij ligji.

Ligji i punës është ligj i ri dhe është faza fillestare e zbatimit të tij dhe e implementimit të këtij ligji, e ka qenë shumë vështirë të identifikohen problemet. Pra, edhe pse është ligj i ri, komisioni ka vendosur dhe një prej rekomandimeve është që ky ligj të shkojë në plotësim-ndryshim për shkak të mangësive që i ka në implementimin e këtij ligji. Dhe, është e pakuptueshme se si në Kuvendin e Kosovës miratohen ligje që pas një kohe kaq të shkurtër duhet të kërkohet plotësim-ndryshim i këtyre ligjeve.

Ministria nuk ka mund të sigurojë buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e tij. Numri i vogël i inspektorëve të punës ka bërë që disa nga ndërmarrjet të inspektohen shpesh, e disa shumë rrallë, gjë që nuk jep garanci për zbatueshmërinë e ligjit. Nuk ka koordinim ndërmjet inspektorëve të nivelit qendror dhe inspektorëve në nivelin lokal.

Ka edhe raste kur shumica e të punësuarve, por edhe punëdhënësit nuk janë të informuar se ekziston Ligji i punës, në mënyrë që të dinë për të drejtat e tyre, andaj është dashur që të gjenden mekanizma që edhe punëdhënësi, por edhe punëmarrësi, të jetë i informuar se ekziston Ligji i punës dhe të orientohen të dinë për të drejtat e tyre që ekzistojnë.

Gjyqësia nuk është shumë efikase në shqyrtimin e rasteve të marrëdhënies së punës, e në raste të tilla debitojnë Buxhetin e Kosovës, sepse punëtorët kërkojnë kompensim për të drejtat e tyre. Ka shkelje që lidhen me kontratat e punës, pushimin vjetor, pushimin gjatë festave.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar Raportin e monitorimit të Ligjit të punës dhe përkrah rekomandimet e dhëna nga Komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me monitorimin e Ligjit të punës pa dyshim se është i domosdoshëm, por mendoj që e kërkon një trajtim më të veçantë për faktin se qysh në fillim të mandatit janë ngrehur shumë çështje në ankesa sa i përket edhe Ligjit të punës dhe vetë zbatimit të Ligjit të punës në praktikë.

Unë e shfrytëzoj rastin t'i përshëndes të gjithë kolegët nga Komisioni dhe stafin mbështetës që na kanë ndihmuar dhe organizatat tjera joqeveritare për monitorimin e këtij ligji, por mendoj se ky ligj e kërkon një trajtim edhe më të gjerë. Është një ligj mjaft i ndjeshëm, dhe përfshin gati të gjitha shtresat e shoqërisë kosovare.

Moszbatimi i mirëfilltë në praktikë po ndikon në shkeljen e shumë fushave, në radhë të parë shkeljen e të punësuarve - punëmarrësve konkretisht në Republikën e Kosovës, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, kemi edhe shkeljen e të drejtave të lehonave në Kosovë dhe fëmijëve të porsalindur, prandaj vetë fakti se këto shkelje bëhen në fusha shumë të gjera, kërkon një trajtim më të madh dhe më të gjerë. Shkeljet e punëtorëve kryesisht bëhen, sikur edhe që u përmendën nga kolegët tjerë, kryesisht në sektorin privat, ndërmarrje të mesme e të vogla, por edhe të mëdha, pa i përjashtuar ato.

Ne jemi munduar si Komision t'i hasim ato, edhe pse një gjetje e tillë ka qenë mjaft e vështirë dhe po ashtu, si u përmend nga kolegët tjerë, vizitat tona kanë qenë kryesisht zyrtare dhe të paralajmëruara dhe në raste të tilla shkeljet eventuale që mund të kenë, kryesisht maskohen dhe nuk ekspozohen para komisionit. Prandaj, ne jemi të gjithë koshientë dhe të gjithë të vetëdijshëm për shkelje që bëhen kryesisht në sektorin privat.

Një faktor tjetër, i cili u ndihmon këtyre shkeljeve të punësuarve është fakti që Inspektorati i Kosovës, konkretisht inspektorët, nuk e kanë të rregulluar me ligj çështjen e inspektimit jashtë orarit të punës, do të thotë pas orës 16:00 dhe vikendeve. Kjo i jep një komoditet apo luks më të madh kompanive konkretisht punëmarrësve që të kenë një komoditet të shkeljeve të drejtave të punëtorëve, pasi ne e dimë se shkeljet kryesisht bëhen në aspektin kohor të punës së tyre, pas orarit të plotë të punës dhe punëtorët detyrohen të punojnë më shumë, pastaj vikendeve punojnë pa kompensim dhe faktorët tjerë që ndikojnë kryesisht në Ligjin e punës, duke e përfshirë edhe vetë sigurinë e punëtorëve në punë.

Gjatë vizitave tona, për fat të mirë, ne si Komision menjëherë pas monitorimit, apo konkretisht para monitorimit të këtij ligji, e kemi monitoruar Inspektoratin e punës, i cili na ka ofruar mjaft të dhëna dhe e kemi kuptuar një realitet i cili nuk është i mirë në

Republikën tonë. E kemi një moskoordinim ndërmjet komunave dhe nivelit qendror, kryesisht në nivelin e Inspektoratit për faktin se ankesat që vijnë nga komunat janë se nuk kanë fare qasje në inspektorat, inspektorët janë të pavarur në punën e tyre, prandaj unë mendoj se Ministria duhet të punojë në këtë aspekt mjaft shumë, me një seriozitet më të madh në bashkëpunim me ekspertë të kësaj fushe dhe duke mos e përjashtuar as dëgjimin publik, që të harmonizohen këto qëndrime dhe të rregullohen njëherë e përgjithmonë, për faktin se nuk bën që në mungesë të këtij koordinimi të pësojnë më së shumti qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, jemi edhe dëshmitarë po ashtu se ky ligj e ka paraparë edhe pushimin për lehonit, i cili mendoj se aktualisht nuk zbatohet sa duhet. Kjo është një mungesë mjaft e madhe. Gratë lehona janë të diskriminuara në Republikën e Kosovës dhe shumë prej tyre detyrohen që ta ndërpresin pushimin e lehonisë e t'i qasen punës, e në anën tjetër dëmtohet edhe shëndeti i fëmijës, ngase në moshë të hershme, pa i mbushur një vit, detyrohet të jetë pa kujdesin e nënës.

Prandaj, unë mendoj se ky ligj e kërkon një trajtim edhe më të gjerë, një debat shumë më të madh. Është një ligj mjaft i ndjeshëm, i përfshin të gjitha shtresat në Republikën e Kosovës dhe në kuptimin e plotë të fjalës nuk po gjend praktikë dhe nuk zbatohet si duhet. Nuk duhet harruar për të përmendur edhe ngathtësinë e sindikatave në Republikën e Kosovës, që nuk janë shumë aktive në shkeljen e të drejtave të punëtorëve që bëhen, qoftë në sektorin publik, apo në sektorin privat, dhe në anën tjetër edhe moskoordinimi dhe puna joefikase e Këshillit Ekonomiko-Social ka ndikuar që të arrihet një imazh jo i mirë i këtij ligji dhe unë kërkoj nga të gjithë deputetët që të jemi të gjithë më aktivë, por në anën tjetër edhe nga Ministria që ta amendamentojmë këtë ligj dhe të kërkojmë nga ajo ta rrisë potencialin e inspektorëve të punës për faktin se, ashtu siç e përmendi edhe ministri i nderuar, edhe në takimet tona, një ndër mungesat kryesore të zbatimit të këtij ligji në praktikë është mungesa e kapacitetit të inspektorëve të Kosovës. Është e palogjikshme që me 45 inspektorë të inspektohen mbi 117 mijë biznese në Republikën e Kosovës. Prandaj, kjo është punë që duhet trajtuar me një urgjencë më të madhe, me një seriozitet më të madh, ngase po shkelen të drejtat e punëtorëve, po shkelen të drejtat e lehonave, po shkelen të drejtat e fëmijëve të porsalindur.

Ne si Koalicion për Kosovë të Re do t'i mbështetim këto rekomandime, me shpresë që ministri, në bashkëpunim edhe me Kuvendin dhe me institucionet tjera, të reflektojnë pozitivisht në sjelljen e një ligji më të mirë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deklarime nga grupet tjera parlamentare nuk kemi. Zotërinj deputetë, ju informoj që janë paraqitur për të diskutuar edhe 7 deputetë. Është puna juaj sesi e shfrytëzoni kohën. Nuk do ta ndërpresim mbledhjen pa e kryer këtë pikë, prandaj po jua lexoj emrat me rend: Rita Hajzeraj-Beqaj, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Nijazi Idrizi, Jeton Svirca, Visar Ymeri dhe Muhamet Mustafa. Fjalën e ka Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

Sot pra po flasim për zbatimin e Ligjit të punës, i cili është miratuar më 2 nëntor të vitit 2010 dhe ka hyrë në fuqi më 16 dhjetor të vitit 2011.

Është ndër ligjet më të shumë pritura nga qytetarët e Republikës së Kosovës, por sa po zbatohet ky ligj? Sigurisht që lë shumë për të dëshiruar.

Të drejtat e punëtorëve në Kosovë nuk po respektohen. Pra, edhe pse ekziston ky ligj, i cili i obligon punëmarrësit që t'i mbrojnë punëtorët, shkelja e të drejtave të tyre bëhet kryesisht duke filluar nga mungesa e kontratave dhe orari i stërzgatur i punës së tyre, i cili nuk kompensohet dhe në këtë rast çdo normë ligjore e këtij ligji shkelet.

Akoma më shqetësuese mbetet siguria në punë, sidomos në sektorin e ndërtimtarisë, ku në shumicën e rasteve mungojnë edhe mjetet më elementare mbrojtëse dhe në këtë sektor e kemi një numër mjaft të madh të punësuarve. Kurse në sektorin publik bëhen shkelje të të drejtave të punëtorëve kryesisht në moszbatimin e kritereve ligjore, pra pas shpalljes së konkursit për një vend pune, pastaj në shumicën e rasteve të institucioneve publike ndodh që njerëzit të punësohen pa konkurs, pastaj shpallet konkursi vetëm sa për sy e faqe. Kjo i bie se ka një nepotizëm të theksuar në institucionet publike.

Punëtorët ballafaqohen me padrejtësi edhe më të shumta, e që janë puna pa kontratë, puna gjatë vikendeve, të cilat përcillen edhe me pasiguri në vendin e punës.

Ju më herët, zoti ministër, thatë se këtë çështje duhet ta mbikëqyrë Këshilli Ekonomiko-Social dhe për vendin e punës dhe sigurinë në vendin e punës duhet të kujdeset punëmarrësi.

Zoti ministër, Ligjin e punës duhet ta zbatoni edhe ju, që jeni anëtar i Këshillit Ekonomiko-Social, e po ashtu edhe Këshilli Ekonomiko-Social, sepse ligji është mbi të dy këto organe, apo ju si ministër dhe ai si këshill.

Nuk është mirë të arsyetoheni dhe ta gjuani fajin herë te Këshilli Ekonomiko-Social dhe herë te mungesa e inspektorëve të punës, sepse para 6 muajve, kur ta kam bërë një pyetje parlamentare, se a do ta rritni numrin e inspektorëve, meqenëse është pengesë e moszbatimit të Ligjit të punës, ju keni thënë se është në procedurë, ndërsa 6 muaj kanë kaluar dhe ende ato procedura po vazhdojnë. Pra, çfarë procedurash dhe çfarë kriteresh duhen që ata inspektorë të pranohen dhe të punojnë e t'i inspektojnë bizneset tona.

Kjo, pra, është edhe si pasojë e tyre, pra e mungesës së inspektorëve. Sot në Kosovë i kemi vetëm 50 inspektorë, të shpërndarë nëpër komuna, jo vetëm në komunën e Prishtinës. Së pari, ky numër i inspektorëve është shumë i vogël për t'i mbuluar të gjitha bizneset që operojnë në Kosovë, pastaj shpërndarja e inspektorëve nuk është në nivelin e duhur.

Zoti ministër, Komuna e Suharekës dhe Komuna e Istogut nuk e kanë asnjë inspektor dhe këto dy komuna janë mjaft të mëdha, që besoj e meritojnë, sepse kanë edhe numër shumë të madh të bizneseve dhe meritojnë ta kenë nga një inspektor për t'i inspektuar.

Pastaj, kemi raste kur komunat e mëdha, si Ferizaj dhe Lipjani, janë të mbuluara me vetëm nga një inspektor, kurse sa i përket Prizrenit, që është qyteti i dytë në Kosovë, edhe për nga numri i popullsisë edhe për nga numri i bizneseve, i ka vetëm 2 inspektorë.

Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, sot janë rreth 107 000 biznese. Pra, në bazë të konventës së ILO-s, e që është edhe themeluar inspektorati i punës, ku inspektorët e punës duhet ta inspektojnë një biznes sa herë që është e domosdoshme, pa harruar se një numër i bizneseve duhet riinspektohen brenda një viti. Pra, në bazë të ligjit, Inspektorati i punës e ka për detyrë që një herë në vit ta inspektojë një biznes, apo një ndërmarrje publike. Ndërsa, nëse këto i llogaritim, pra inspektorët duhet ta inspektojnë çdo biznes çdo ditë. Nëse i kemi vetëm 50 inspektorë, atëherë i bie që mesatarisht secili prej inspektorëve duhet t'i vizitojë nga 2 000 biznese në vit, e kjo i bie që 10 biznese duhet të inspektohen brenda dite, pa asnjë ditë pushim. Pra, asnjë inspektor nuk duhet ta ketë asnjë ditë pushim për t'i vizituar 2 000 biznese brenda vitit, e kjo është absolutisht e pamundur.

Nuk mund të identifikohen problemet duke u thirrur në kohën e shkurtër që e ka kaluar ky projektligji.

Ju më herët thatë se është një kohë shumë e shkurtër e miratimit. E pranojmë edhe ne që është shumë e shkurtër, mirëpo është dashur që rezultatet e para të shihen për zbatimin e këtij projektligji, ndërsa ne ende nuk po i shohim rezultatet e para të zbatimit të këtij projektligji.

Sot punëtorët tanë ballafaqohen me mungesa të të drejtave elementare të tyre. Nuk po flas më shumë për sektorin publik, por për sektorin privat. Unë konsideroj që ky raport, i cili është punuar nga Komisioni për Shëndetësi, është jashtëzakonisht i mirë dhe është punuar mirë dhe meriton të përkrahet, por gjithmonë nëse sugjerimet dhe rekomandimet e tyre bien në vesh të Qeverisë dhe Qeveria i zbaton ato, sepse ne jemi të vetëdijshëm se çdo ditë po vijmë në Parlament dhe po e dëgjojmë edhe kryeministrin e Kosovës, i cili çdo ditë fjalën e parë e ka një mirëqenie më të mirë për qytetarët, ndërsa ligji për të drejtat elementare për mirëqenien e qytetarit nuk zbatohet. Kjo nuk është në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Kontributin tim në këtë raport për Ligjin e punës do të mundohem ta ndaj në dy grupe, të cilat i kam vështirë ta kuptoj edhe nga raporti i Komisionit, sepse kategoritë e punësuar në Republikën e Kosovës janë në sektorin publik dhe në sektorin privat.

Se ka shkelje në të dy sektorët, është e padiskutueshme, se ka mosrespektim të ligjit në fuqi, edhe nga sektori privat, edhe publik, është e padiskutueshme. Do të shkoj me radhë, në sistemin publik, për shembull, ka raste të cilat nga të gjitha qeveritë që kanë qenë deri

më tani punonjësit të cilët punojnë në administratën publike përdoren si një lloj malli, i cili mund të përdoret lehtësisht nga punëdhënësi, të nxirret nga puna. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i kthen në punë dhe nuk kam hasur ende asnjë dënim, i cili është shkaktuar me dëm material dhe me dëm funksional të institucionit nga institucionet, të cilat e kanë flakur nga puna një punonjës. Dhe, ligjet janë në fuqi, vetëm se duhet të respektohen. Për shembull, nëse një punonjës nga institucioni publik është larguar nga puna dhe paguhet në mënyrë retrograde, ose është paguar nga mosqëndrimi në punë, është rrjedhimisht dëmtues i sistemit të Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe nuk kam dëgjuar ende që është dënuar dikush për çështje të tilla. Ose, ka pasur raste edhe më flagrante, ka pasur edhe burgosje dhe ka dalë nga burgu dhe janë kthyer mjetet. Ekzistojnë institucionet brenda, të cilat duhet të jenë të ngritura në nivelin ku Inspektorati i punës mund t'i lexojë raportet nga institucionet, jo të shkojë inspektorati fizikisht të vizitojë, sepse është e pamundur, jo vetëm në shtetin tonë, por në asnjë shtet nuk shkohet të vizitohen në mënyrë të tillë.

Problemi tjetër është në pjesën private, për shembull, ka kompani private të cilat raportimin mbi punëdhënien dhe mbi nxjerrjen nga puna të punonjësve e sanksionojnë me kërcënimin e punonjësit, për shembull, nuk ia japin pagën 3 muaj, 6 muaj dhe kërcënojnë, i thonë se ne do të nxjerrim nga puna. De fakto, ligji dhe institucionet e Republikës së Kosovës duhet ta kërcënojnë edhe punëdhënësin. Nëse nuk e paguan punëtorin në punë dhe e kërcënon se do ta nxjerrë nga puna, nëse ju i kërkonit pagat tuaja, duhet të kërcënohet me marrjen e licencës të punës njëherë e përgjithmonë, sepse është shkelës i madh i tyre.

Komisioni për Shëndetësi po ashtu mendoj se nuk është duke bërë punë mjaft të mirë lidhur me analizën edhe të ligjeve tjera. Ne do të kemi këtu ligje, të cilat do të vijnë në Parlament, e edhe përcaktimi i Ligjit të punës në orarin e punës, në sistemin publik dhe në sistemin privat.

Se sa është e lejuar, për shembull, ne do ta kemi një ballafaqim edhe me Ligjin e Shëndetësisë, kur të vijë këtu, me çka përcaktohet ligji që punonjësit shëndetësor nuk do t'i lejohet të punojë pas orarit të punës, që e mbush konform normativit ligjor në sistemin publik dhe do të na sjellë në një problem, i cili nuk do të ketë zgjidhje, por i cili më mirë duhet të anulohet.

Prandaj, në vlerësimin edhe të ligjeve ku përfshihen me punëdhënësin dhe punëmarrësin, Ministria e Çështjeve Sociale duhet të jetë kontribuuese aktive, të mos deklarohen komisionet në Qeveri dhe në Komisionin Parlamentar se ka aquí communautaire, të gjitha të plotësuara, kur ne e dimë që nuk janë të plotësuara dhe mundohemi t'i aprovojmë. Më mirë është ta aprovojmë një ligj, i cili është funksional, se të aprovojmë shumë ligje e asnjëri nuk funksional. Dhe, në këtë mënyrë ne nuk tregojmë kualitet të administratës publike, sepse në atë mënyrë mund të japim shumë mundësi për abuzime, për frikësime të punëmarrësit dhe për kërcënime nga punëdhënësi mbi bazën e asaj që nuk monitorohet dokumentacioni nga Inspektorati i Punës dhe ku të dhënat duhet të jenë të pasqyruara si nga publiku, po ashtu edhe nga privati mbi kualitetin e punës, i cili është një punonjës në

një institucion dhe mbi kualitetin e dënimit, të cilin do t'ia japë punëmarrësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Do të bisedoj pak për një gjë tjetër, sa i përket rregullimit të kësaj fushe. E shohim që raporti jep shumë elemente, apo jep shumë pika, në të cilat kemi shkelje të Ligjit të punës dhe thjesht e kam besimin tim që nganjëherë si ky ligj, por edhe ligjet tjera që janë të ngurta dhe i rregullojnë disa çështje më tepër se që është e nevojshme.

Në parim, kur e rregulloni një çështje e keni konceptin për ta rregulluar deri në detale apo maksimumi që mund, apo të lihet një hapësirë, që ligji ta ketë një rregullim shumë më liberal.

Posaçërisht te lami i punës, unë besoj se duhet të kemi shumë kujdes dhe duhet të jetë një fushë shumë liberale e organizimit, apo ligji t'i rregullojë vetëm gjërat në vija të trasha, kurse të mos futen në detale se çka të bëjë.

Unë do t'i përmend posaçërisht rekomandimet që kanë të bëjnë me pikën e parë.

E para, thuhet të përcaktohet afati minimal për kontratë. Shumica e bizneseve, nëse e përcaktoni një afat minimal për kontratë, do të hezitojnë të përpilojnë fare kontrata, në shumicën e rasteve ato do t'i mbajnë punëtorët aq sa kanë nevojë, por nuk do të përpilojnë kontrata. Kështu që në parim nuk duhet të kufizohet afati i një kontrate.

Unë besoj se më mirë është që bizneset të bëjnë kontrata pavarësisht afatit, nëse merret vesh me punëtorin me punua një ditë, apo një javë, apo një muaj, apo tre muaj është çështje e biznesit në marrëveshje me punëtorin, por jo të kufizohet afati minimal në kontrata. Nëse e marrim një afat minimal rregullisht do të kemi ikje nga biznesi për ta lidhur një kontratë, kështu që liberalizimi i plotë apo dhënia e plotë e lirisë së lidhjes së kontratës është zgjidhja më e mirë sa i përket rregullimit me kontratë të një marrëdhënieje të punës.

Çështje tjetër është çështja e klasifikimit të rrogës minimale për profesione dhe lloje të ndryshme të punës.

Ministri me siguri e di më mirë, veç më duket që jemi të vetmit në rajon që i kemi dy paga minimale, apo të them të vetmit në botë ku ekzistojnë dy paga minimale. Paga minimale për ata nën 35 vjet edhe për ata mbi 35 vjet. Kah arsyeshmëria ekonomike, të jem i sqartë këtu, nuk e kam të qartë pse i kemi dy paga minimale, por nëse fillojmë tash prej pagave minimale të hyjmë edhe në një klasifikim tjetër për profesione të ndryshme sa të jenë pagat, unë besoj se do të kemi shumë e më shumë probleme në tregun e punës. Për shembull, nëse e marrim ta caktojmë pagën minimale për dikë që ka

fakultet të kryer, apo për një profesion të caktuar, rregullisht do ta kemi një kërkesë nga bizneset apo e punëdhënësit që ta punësojnë një kandidat me profesion më të ulët se sa kanë nevojë për atë vend pune. Kështu që unë besoj që është gabim edhe më tutje të shkohet në specifikim apo në detajim të pagave minimale, por duhet ta kemi vetëm një pagë minimale.

Kështu që, në përgjithësi, unë besoj se Ligji i punës duhet të jetë shumë më liberal, duhet të ndryshohet, punëdhënësit duhet të jenë të lirë në zgjedhjen e marrëdhënies së punës apo në lidhjen e kontratave të punës me punëdhënësin, por punëdhënësi duhet ta respektojë atë që e nënshkruan, por jo që të kemi kufizime apo ngurësime të tepërta me kontratat e punës.

Për rastin konkret, po e marrim se i kemi kontratat e punës për punë specifike. Ligji e përcakton që duhen 120 ditë. Është e pakuptimtë nëse dikush nevojiten për 150 ditë, tash për 120 ditë duhet ta ndërpresë atë kontratë, të fillojë kontratë tjetër apo të gjejë vrima në ligj, apo në hapësira tjera, në mënyrë që të mbuloresh me kontratë dhe që të ikësh nga një sanksion ligjor.

Kështu që propozimi im është që përgjithësi ligji duhet të ndryshohet, të bëhet shumë më liberal, të lejohet hyrja e lehtë në tregun e punës dhe të kemi po ashtu një dalje të lehtë nga tregu i punës, pa u obliguar me shumë sanksione punëdhënësit, po natyrisht që punëmarrësi ta ketë garancinë e plotë në atë që e lidh kontrata me punëdhënësin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Monitorimet e zbatimit të ligjeve janë jashtëzakonisht pozitive nëse i marrin parasysh vlerësimin e efekteve që mund t'i japin ligjet kur ato zbatohen, domethënë efektet pozitive apo negative që ato japin në një fushë të caktuar.

Për mua do të ishte me rëndësi nëse ky monitorim na bënë me dije se në ç'vend është Kosova, domethënë a është Kosova konkurrent në tregun e konkurrencës së lirë në botë, domethënë a mundëson ky ligj që vendi ynë të jetë konkurrent.

Nën dy, a është joshës për investimet e huaja që bëhen në Kosovë.

Nën tre, a u mundëson punëtorëve publikë që ata të jenë efikas në ofrimin e shërbimeve për qytetarët tanë.

Unë kam arritur t'i nxjerr vetëm këto tri objektiva, që është dashur t'i arrijë ky monitorim.

Në të vërtetë, nga ato që ne i shohim në raport edhe me këtë ligj, edhe me ligje tjera, sepse ky ligj krijon sinergji me ligjet tjera, ne e shohim se në Kosovë shumë pushohet, e pak punohet.

Ne kemi pushime vjetore, kemi pushime për festa, pushime mjekësore, pushime të lehonisë, pushime gjatë orarit të punës.

Festat zyrtare sipas kalendarit të tashëm për vitin 2012, ne i kemi pushim 12 ditë, domethënë jo vetëm ditë kur rastisin pushimet, por këto ditë merren nga ditët e punës, me qëllim që të plotësohen edhe të rumbullakohen, të bëhen 12 ditë.

Ne kemi festa komunale, diku një festë, diku edhe më shumë. Kemi pushim vjetor me ligj, që janë 20 ditë, nga i cili ligj për çdo 5 vjet shtohet nga një ditë e punës. Ju ministër, e dini këtë punë.

Pushimi mjekësor është 10 ditë, zakonisht te ne shumica e punëtorëve këtë pushim e shfrytëzojnë si një pushim të shtuar, domethënë vjetor.

Po ashtu, e kemi pushimin e lehonisë që për femrat është 12 javë, pushimi për punëtorët. Kjo është shumë e rëndësishme të theksohet, sepse në bazë të ligjit pushimi duhet të llogaritet 30 minuta gjatë orarit të punës, i cili mund të merret jo në fillim, po as në fund të orarit të punës, por gjatë orarit të punës, kurse te ne e kemi një orë pushim në orar të punës, nëse këtë pushim e llogaritim, ministër, gjatë një viti del që 32 ditë e gjysmë punëtorët tanë pushojnë.

Nëse i marrim këto dhe i llogaritim bashkërisht na del që ne me ligj jemi të detyruar që të mos punojmë. Domethënë, këto janë 75 ditë pune, nëse i zvogëlojmë nga 260 ditëve që janë ditë pune, atëherë neve na dalin 185 ditë pune, që realisht i bie se ne një ditë punojmë, e një ditë nuk punojmë.

Me këtë gjendje që e kemi, unë mund të konstatoj që Kosova nuk është konkurrencte në tregun ndërkombëtar të punës, nuk është aspak joshëse për investimin e kapitalit të huaj në Kosovë, punëtorët tanë të administratës nuk mund të jenë efikas në përmbushjen e obligimeve të tyre, sepse ata realisht nuk lejohen që të punojnë aq sa janë të detyruar në bazë të ligjit.

Në një rast të tillë më duhet të them se ne, në një farë mënyre edhe e shkelim Kushtetutën, e cila thotë se shpenzimet publike edhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës. Sepse ky është një ligj shumë i rëndësishëm për Kosovën, do të ishte shumë e rëndësishme që Ministria, ju si ministër të kishit ndërmarrë fushata të ndryshme me të cilat do të kishim mundur të konstatojmë afërsisht gjendjen që e kemi në zbatimin e Ligjit të punës nëpërmjet anketimeve, nëpërmjet intervistave të ndryshme, me qëllim që ne ta kem një dije reale se çka të veprojmë më tutje me këtë projektligj.

Unë mendoj që ky ligj nuk është i mirë, së bashku me ligjet që e plotësojnë, duhet të ndryshohet, duhet të plotësohet, me qëllim që Kosova të bëhet konkurrense në tregun ndërkombëtar.

Do të kisha dashur ta theksoj që ju jeni një ministër për një kohë të gjatë aty, e keni një staf që punon jashtëzakonisht gjatë aty, këto punë t'i bëni sa më shpejt, sepse përndryshe ne nuk do të kem mundësi që as të thithim investime të kapitalit të huaj në Kosovë, me këtë gjendje që e kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Të gjithë jemi dëshmitar të realitetit në terren për këtë çështje. Jemi mirë të informuar se çka ndodh në bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha. Në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve që ndodhin, e që ne si deputetë duhet të jemi më të zëshëm në këtë drejtim.

U tha shumëçka këtu nga kolegët deputetë dhe do të përpiqem që të flas sa më i shkurt.

Faktikisht me gjendjen në terren po humb shteti dhe po humb qytetari, kurse po përfitojnë bizneset e ndryshme, të cilat po i shfrytëzojnë zbrastëirat në ligj.

Unë i falënderoj deputetët për punën e bërë, andaj rekomandimet e tyre Qeveria dhe Kuvendi duhet gjithsesi t'i kenë parasysh, e sidomos rekomandimet për rritjen e buxhetit, plotësim-ndryshimin e ligjit, si dhe shtimin e numrit të inspektorëve që të inspektohen rastet dhe të ketë gjobitje më të mëdha, me shpresë që do të marrin mësim dhe të formohet një kulturë për respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe respektimin, faktikisht realizimin e detyrave ligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Visar Ymeri, ndërkaq deputetët le të hyjnë në sallë.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, u tha shumëçka për Ligjin e punës dhe për zbatimin e tij.

Unë do t'i ngre disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt pra me Ligjin e punës, e jo me zbatimin e tij, për shkak se natyrisht që ka të meta edhe ky ligj dhe këto të meta nuk janë vetëm në disa instanca nga moszbatimi i tij, por edhe vetë ligji është i mangët në disa aspekte.

Për ta nisur këtë fjalë timen dua ta tërheq vëmendjen te një çështje që është më e gjerë, natyrisht te rendi republikan, pra ku publikja, ku hapësira publike është hapësirë barazie, hapësirë barazie në kuptimin që garanton jo shans të barabarta për shkak se shanset e barabarta natyrisht nuk janë garanci barazie, meqenëse kur të gjithë i kanë shanset e

njëjta, atëherë dikush mund t'i ketë mundësitë tjera dhe si të tilla natyrisht që do të kenë përparësi apo avantazh që në start. Mirëpo, një hapësirë publike, e cila në fund siguron që edhe rezultatet të jenë të barabarta dhe me këtë drejtim kjo nënkupton që intervenimi institucional duhet të jetë ndaj atyre dhe ndaj asaj pjese, e cila është në disavantazh dhe në këtë drejtim, kur po flasim për Ligjin e punës, natyrisht që apriori punëmarrësit, pra punëtorët, janë në disavantazh karshi punëdhënësve për shkak se punëtori këtu është individualizuar. Pra, individualizimi i punëtorëve që bëhet edhe me Ligjin e punës, po në përgjithësi me politika qeveritare, e vendos punëtorin në një pozitë të pafavorshme karshi punëdhënësit, i cili edhe me mjete dhe me pronësi është më i fuqishëm, por edhe me organizim, dorën në zemër, janë edhe më të fuqishëm. Dhe, në këtë drejtim konsideroj që puna në asnjë mënyrë nuk bën të trajtohet si çështje private.

Pra, çdo vend pune është vend publik pune dhe si i tillë duhet edhe të trajtohet. Prandaj, edhe ekziston logjika e pasjes së një Ligji për punën dhe mbrojtjes institucionale për punëtorin për shkak se pavarësisht nëse kontrata është individuale dhe pavarësisht nëse kjo kontratë sjell përfitime individuale për punëmarrësin dhe punëdhënësin, prapëseprapë kjo nuk është çështje private dhe nuk duhet të llogariten si çështje private, por duhet të llogariten si çështje publike dhe si e tillë duhet të trajtohet edhe nga institucionet publike.

Në këtë fushë, pra në tregun e punës, do të kishte me qenë e udhës dhe natyrisht është domosdoshmëri që Qeveria ta luajë atë arbitrin që formalisht është i paanshëm karshi antagonizmit të përhershëm ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, por që në fakt, duke u nisur edhe nga ajo që e thashë më herët, për të garantuar rezultate të barabarta, atëherë natyrisht që Qeveria do të duhej të ishte në favor, apo në anën e punëmarrësve, duke e pasur parasysh pozitën e tyre të disavantazhit karshi punëdhënësit.

Ndërkohë që këtu edhe u dëgjua domethënë edhe për mangësitë në zbatimin e ligjit, por edhe në përgjithësi nga përvoja mund të shihet shumë qartë që Qeveria zakonisht del në anën e punëdhënësve, gjë që e dëmton punëtorin.

Mendoj që problemi numër një, siç i kam radhitur unë, jo për nga rëndësia, i Ligjit të punës është vetë fushëveprimi i këtij ligji.

Pra, në nenin 2, paragrafi 1 të këtij ligji përkufizohet se dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Kjo është në rregull. Që parimisht nënkupton se dispozitat e këtij ligji vlejnë për rregullimin e marrëdhënies së punës si për të punësuarit në sektorin publik, po ashtu edhe ata në sektorin privat.

Po brenda tekstit ligjor pastaj mund të haset kundërthënia edhe në nenin 8, të paragrafit 1, ku theksohet se konkursi publik është i obliguar për sektorin publik, duke mos e përmendur fare sektorin privat, e që e bën të nënkuptohet se shpallja e konkursit publik nuk është fare i obliguar për sektorin privat.

Në rast të inicimit të plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit të punës duhet të propozohet ndryshimi i nenit 8.1, me tekst pasues, si në vijim: “Pra, punëdhënësi në sektorin publik

dhe privat është i obliguar që të shpallë konkurs publik sa herë që e pranon një punëmarrës dhe e themelon një marrëdhënie të punës. Pra, kjo është për ta garantuar atë lloj barazie për të gjithë qytetarët e Kosovës që ta kenë mundësinë e punësimit në punëdhënës të ndryshëm, por edhe për ta garantuar një lloj kushtëzimi të njëjtë me sektorët publikë dhe privatë.

Po ashtu, në paragrafin 4, te neni 2 i këtij ligji është përcaktuar se dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhënie të punësimit brenda misionëve ndërkombëtare, misionëve diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, pranisë ushtarake të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të propozimit gjithëpërfshirës për statusin dhe organizatave ndërkombëtare qeveritare.

Sipas kësaj dispozite, të punësuarit pranë këtyre subjekteve, pa marrë parasysh se a janë shtetas të Kosovës, apo kanë ndonjë nga statutet tjera, marrëdhënia e punës nuk rregullohet domosdoshmërisht me Ligjin e punës së Kosovës.

Në praktikë janë evidentuar disa raste kur të punësuarit në këto misione nuk e kanë pasur të qartë se cila rregullativë është duke u zbatuar për rastin konkret, ku në disa raste subjektet ndërkombëtare e kanë shfrytëzuar këtë rast në mënyrë të njëanshme, duke e interpretuar kontratën e punës herë sipas ligjit vendor, e herë sipas atij nga vendi i prejardhjes. Kjo shpesh ta pamundëson edhe zhvillimin e procesit kontestimor në rast të nevojës së inicimit të kontekstit gjyqësor nga marrëdhënia e punës, si dhe mungesës së monitorimit të zbatimit të legjislacionit nga Inspektorati i Punës.

Andaj, duke pasur parasysh se qytetarët e Kosovës me rastin e punësimit nuk heqin dorë nga shtetësia e Kosovës, është e drejtë e tyre kushtetuese që rregullimi i marrëdhënies së punës të bëhet sipas legjislacionit vendor.

Te kontrata e punës, sipas dispozitave të neni 10 të Ligjit të punës, është paraparë që raportet ndërmjet të punësuarit dhe punëdhënësit të rregullohen nëpërmjet marrëveshjes në formë të shkruar, të cilën e lidhin të dy subjektet sipas vullnetit të tyre të lirë.

Sipas dispozitave të paragrafit 2, me nënparagrafët 2.1, pikë 2 dhe pikë 3 është paraparë se kontrata e punës në aspektin e kohëzgjatjes dhe natyrës së punës mund të lidhet në tri forma, sipas kohëzgjatjes mund të lidhet për periudhë të caktuar dhe të pacaktuar, ndërsa në aspektin e natyrës së punës mund të lidhet për punë dhe detyra specifike.

Në dispozitat e këtij neni nuk është paraparë fare kohëzgjatja minimale për të cilën mund të lidhet kontrata e punës, gjë e cila ndikon dukshëm në interpretimin në dëm të të punësuarit.

Në këtë aspekt, pas paragrafit 2, mendojmë se duhet të shtohet një paragraf i ri me këtë formulim: “Kontrata e punës në asnjë mënyrë nuk mund të lidhet për një periudhë më të shkurtër se një vit, duke përfshirë në këtë periudhë kohore punën provuese”.

Gjithashtu sipas paragrafit 5, të nenit 10, është paraparë se kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 vjet konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Periudha e paraparë në këtë paragraf është e stërzgjatur, duke pasur parasysh se e keqëson pozitën e të punësuarit në marrëdhënien e punës. Në këtë mënyrë, kjo periudhë duhet të reduktohet në tre vjet.

Neni 11 i Ligjit të punës përfshinë dispozitat sipas të cilave përcaktohet përmbytja e kontratës së punës.

Në kuptimin e këtij neni, pas paragrafit 1, me nënparagrafët e tij duhet të shtohet një paragraf pasues me këtë përmbytje: “Në çdo rast të zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, dispozitat e ligjit, kontratës kolektive apo kontratës së punës, do të interpretohen in favorem të punësuarit”.

Te detyrimet e punëdhënësit - në përmbytjen formale të Ligjit të punës nuk është materializuar ndonjë dispozitë me të cilën janë përfshirë detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit. Kjo nuk do të thotë se në përmbytje të Ligjit të punës nuk ka dispozita, të cilat i përkufizojnë detyrimet e punëdhënësit, por se nuk ekziston një dispozitë ekzakte, e cila në mënyrë të përgjithshme do t'i përmbledhë të gjitha detyrimet parimore që i bart punëdhënësi në marrëdhënien e punës.

Së pari, kjo dispozitë do të shërbente në lehtësimin e zbatimit të dispozitave ekzakte me të cilat rregullohen segmentet e veçanta të marrëdhënies së punës, si dhe do të shërbente në procesin e konstatimit të zbatimit të ligjit, në përgjithësi. Për shembull, Inspektorati i Punës do të ketë shumë lehtë konstatimin e respektimit të të drejtave elementare në marrëdhënien e punës, si dhe bazën juridike për shqiptimin e gjobës në rast të shkeljes së dispozitave ligjore në rastin konkret.

Për një përgjithësim të detyrimeve të punëdhënësit është e përcaktuar edhe doktrina juridike, ku janë të identifikuara një mori të detyrimeve që i bart punëdhënësi në marrëdhënien e punës.

Te ndërprerja e marrëdhënies së punës, në Kreun VII të Ligjit të punës është paraparë edhe çështja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në disa modalitete. Kështu që, sipas dispozitave të Ligjit të punës, ndërprerja e marrëdhënies së punës mund të bëhet: sipas fuqisë ligjore, ndërprerja me marrëveshje, ndërprerja e marrëdhënies së punës nga i punësuar, si dhe ajo nga punëdhënësi.

Te ndërprerja e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore, çështja më diskutabile është ndërprerja e marrëdhënies së punës me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës. Kjo i mundëson punëdhënësit që të ketë pozitë supremative në raportin e punës dhe me këtë mënyrë dukshëm të jetë subordinativ pozita e të punësuarit. Është tejet e qartë se liria e

kontraktimit duhet të jetë evidente, mirëpo të mos lejohet mundësia që kjo liri të keqpërdoret.

Në këtë mënyrë, nënparagrafi 1.3 i nenit 67 duhet të ndryshohet me këtë përmbajtje: “Me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës, nëse të punësuarit i është tërhequr të paktën një herë vërejtja në formë të shkruar për mospërmbushje të kënaqshme të detyrave të punës”. Kjo mendoj se do ta zgjidhte deri në njëfarë mase ose do ta reduktonte arbitraritetin e punëdhënësit karshi përjashtimit të punës apo ndërprerjes së marrëdhënies së punës ndaj të punësuarit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Muhamet Mustafa, deputet i pavarur tash, e ka fjalën

MUHAMET MUSTAFA: Po, mirë që e korrigjove, unë jam deputet i E15-shit. Mendoj që ky raport ka nxitur një debat shumë domethënës, Ligji mbi punën është njëri nga ligjet më të rëndësishme për klimën e investime dhe për mjedisin biznesor.

Në fazën në të cilat gjendet Kosova, duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të mos e rritim administrimin, meqë ndikon në dy drejtime negativisht.

Në një, e rrit informalitetin, domethënë punën e njerëzve pa kontrata. Në qoftë se jemi në interes të punëtorëve, ne duhet të krijojmë aso zgjidhesh në ligj, të cilat e zvogëlojnë hezitimin e punëdhënësve për të bërë kontrata.

Dhe, në dy, duhet të kemi aso zgjidhesh ligjore, të cilat i tërheqin më shumë investime. Me disa propozime këtu dhe me disa dispozita të këtij ligji, ne e bëjmë pikërisht të kundërtën. Mu për këtë, unë e kisha përkrahur zotëri Zharkun lidhur me pikën e parë. Mendoj se nga rekomandimet duhet të hiqet, të përcaktohet afati minimal për kontratat. Nuk mund të ketë afat minimal për kontratat. Ajo është çështje e punëdhënësit dhe punëmarrësit, e interesave të tyre reciproke dhe këtu duhet të kemi kujdes, sepse kjo do të shtojë njerëz të mos të bëjnë kontrata hiç për të punuar në të zezë. A jemi të interesuar që njerëzit të punojnë në të zezë, apo me kontrata?

Edhe alinea e fundit e këtij neni, “përcaktimi me ligj i klasifikimit të rrogës”, është administrim. Do ta rrisë administrimin, do t’i rrisë kontaktet e njerëzve, do ta rrisë intervenimin, do t’i rrisë problemet e mëdha, e kjo nuk na nevojitet për asgjë.

Çështja shumë e rëndësishme ka të bëjë me rekomandimin nën 5. Ne e kemi një sistem të kompensimit të pushimit të lehonisë 6 muaj për bizneset, 3 muaj Qeveria dhe 3 muaj pa pagesë. Domethënë, lindja e fëmijëve, që është një akt shumë i rëndësishëm për shoqërinë, e vëmë në përgjegjësi të bizneseve. Bizneset i shndërrojmë në sociale, në një institucion që do të japë ndihma sociale, e kjo e pengon punësimin e femrave. Në qoftë se një biznesi i duhet ta kompensojë 6 muaj dikë që nuk punon, ajo do të bëhet pengesë për punësimin e femrave. Unë nuk di qysh mund për shembull kolegët që e kanë grupin që kujdeset për të drejtat e femrave ta marrin këtë çështje kështu.

Çdo biznes racional që duhet t'ia paguajë dikujt rrogën 6 muaj pa punë, ai do të hezitojë, prandaj kjo duhet të korrigjohet, sepse kjo do ta pengojë punësimin e femrave, nën një.

Nën dy, do të ndikojë edhe më tutje në rënien e natalitetit në Kosovë. Rënia e natalitetit në Kosovë është drastike. Nuk është normale në një tranzicion normal demografik të ndodhë kjo dhe ne duhet të kujdesemi për fëmijët, duhet të kujdesemi për nënat, duhet të kujdesemi për bizneset, por bizneset nuk mund të jenë ato institucione të cilat kujdesen për çështje sociale për lindje të njerëzve. Këto duhet t'i marrë shteti, shteti e ka përgjegjësinë për këto. Edhe buxheti duhet t'i marrë këto. Ne mund t'i lëmë eventualisht bizneset që ta marrin një pjesë, por jo pjesën kryesore.

Prandaj, unë kam propozim që pika 5 të ndërrohet dhe të thotë: "Të rishqyrtohen dispozitat e këtij ligji lidhur me aplikimin e kompensimit për lehoninë në atë mënyrë që të evitohet pengesa për punësimin më të madh të femrave dhe kujdesin ndaj fëmijëve". Ju faleminderit!

KRYESUESI: Tash e kemi edhe një është paraqitur për fjalë, Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse unë diskutova në emër të grupit dhe i thashë qëndrimet tona, tash gjatë diskutimit e fitova përshtypjen se e kemi Projektligjin për ndryshim-plotësim nga disa diskutues, e jo raportin e punës së Komisionit dhe dua të theksoj se ne kemi obligim që gjatë hartimit të Ligjit të punës, gjatë plotësim-ndryshimit të kujdesemi edhe për punëdhënësit, edhe për punëmarrësit, e jo të bëhemi popullistë, gjoja se po i mbrojmë punëtorët- punëmarrësit, pro është obligim yni edhe për punëdhënësit. Kështu që mendoj se duhet diskutimet tona të jenë më të qarta, e jo të diskutohet thua se e kemi projektligjin në shqyrtim të parë, e jo raportin e punës. Vetëm këtë vërejtje desha ta tërheq.

KRYESUESI: Mirë, e dëgjuam edhe këtë vërejtje si rezyme, por unë vetes s'do t'ia jepja atë të drejtë t'i rezymoje diskutimet tuaja, pa marrë parasysh a më pëlqejnë, a jo.

Fjalën e do edhe një herë ministri. Vetëm përpiku sa më shkurt! Veç përgjigje, jo komente.

MINISTRI NENAD RASHIQ: Hvala gospodine predsedavajući!

Ja moram nekoliko bitnih stvari da napomenem, pre svega ne znam koliko se gospodin da mi da vremena ,tako da ću biti vrlo konkretan i jasan

KRYESUESI: Koliko ti sleduje znaš, čitaj Pravilnik!

MINISTRI NENAD RASHIQ: Faleminderit shumë! Hvala!

Ja vas molim, pošto je i po planiranom onom rasporedu i planu koji smo imali mi, da do kraja godine pripremimo eventualno amandamentiranje Zakona. Prema tome, od danas i od juče, kad god, ja vas molim da sve eventualne vaše predloge apsolutno možete da se konsultujete sa nama, može da nam predložite, možemo da razgovaramo o tome kad god Kancelarija moja ili moji saradnike će biti uvek otvorena za to. Jer stvarno se vidi da je

ovo jedan od vrlo, vrlo bitnih Zakona. I ovaj izveštaj koji danas dat sa preporukama, iako lično imao sam neke preporuke koje smo mi već obavili, ipak ok-ej u koliko se usvoji, zbog toga što ćemo i dalje raditi i nastaviti da radimo u pravcu kao što smo radili do sad.

Ali vrlo bitno neke tehničke stvari da razjasnimo. Tačno da postoji jedan jaki element neformalne ekonomije kod nas, i tačno da ima jedan veliki broj, odnosno jedan određeni broj ne registrovanih radnika.

Mi smo u prošloj godini imali 3 200 po prvi put registrovanih radnika, znači novih registrovanih radnika. Oni su radili već u našoj ekonomiji, ali nisu bili registrovani. Ove godine očekujemo da će biti 4 hiljade registrovanih radnika po prvi put u kosovskom sistemu. Znači ipak inspektorijat radi svoj deo posla, i ovo što sam rekao za ove brojke taj deo svoje posla pretvarao u konkretne brojke za ovih radnika koji se registruju za prvi put.

Sigurno sa radu naravno da je jedna od osnovnih stvari osnovnih pojmova, i socijalni savet ne nadgleda rad inspektorijata, i nema ni moralnu političku a ni institucionalnu odnosno zakonsku obavezu. On može u saradnji sa Vladom koji je u kesu od 5 članova, nije 5 člana Ministarstvo za rad, nego jedan član je Ministarstvu za rad, jedan član Ministarstvu za obrazovanja, jedan član je Ministarstva poljoprivrede, jedan član Ministarstva ekonomije. Znači 5 ministarstva ima u tome, 5 poslodavca odnosno predstavnika poslodavca i 5 posloprimaoca.

Inspektorat ima 50. radnika plus 5. koja su ponavljanje konkursa za radnike na severu Kosova. Znači od onih 45. postojećih mi smo dodatnih 5 većih poslovi. Ovih 5. na severu su ponovno javljani konkursa, zbog toga što smo hteli da promenimo malo to razmišljanje u vezi Inspektorijata na severu, da ljudi budu dinamičniji, odgovorniji, vredniji i radnji.

Jednom godišnje apsolutno je tačno da ne može jedan inspektor da kontroliše 2 hiljade privrednih subjekata. Naravno da ne. Ali mi radimo na način kada se radi akcije, pa skupimo recimo 5. ili 6, 7, nije bitno, inspektora zajedno, po oni radi određenu akciju u određenom gradu. Tako radi ne samo u, bilo da je u Prizrenu, bilo da je u Prištini, inače u Prištini postoji 4 inspektora, ne može ih imati više. Ima svugde u svakoj opštini inspektora za rad, izuzev kašem Istoka i Suva Reke, sve ostala opština imaju inspektora za rad. Nije bilo lako podijeliti od 50. radnika, odnosno 55. inspektora na 36. ili 38. opština, ali mi smo morali neko to da uradimo. I jedina funkcionalna može biti ukoliko šaljemo zajedno u grupe inspektora na određena mesta da bi mogli da utiču ne samo direktor na one firme koji su kontrolisane nego na sve druge, koje budu čuli da su te neke firme kontrolisane.

U kesu apsolutno se pozvani od danas ko god hoće, pogotovo hoću da ohrabrim Komisiju za zdravstvo i socijalnu staranje, da budete deo koji ćemo moći da bude neaktivno učesnik ali posmatrač. Nećete biti aktivni učesnik zbog toga što nemam mandat ni ja to da vam pružim. Ni zakon to ne kaže da treba biti predstavnik poslanika, ali u svakom slučaju vas pozivam da budete posmatrač, da vidite način na kojem mi funkcionišemo.

Apsolutno insistiram i naši Inspektorat za rad je radio to sve vreme. Nadoknada za pravnike je, ako hoćete 250%, odnosno ukoliko bi jedna plata bila podeljena na dnevnice, onda bi taj radnik tog dana primio 250% od njegove zarade, odnosno njegove dnevnice....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, shpejt e kryen. Vazhdoja edhe pak!

MINISTRI NENAD RASHIQ: Dobro, imam još druge stvari, ali moram da kažem još ovo.

Minimalna plata je stvarno nešto o čemu sam ja razmišljao puno u zadnjih nekoliko meseci. Moram da budem iskren. Ja i za do vas pozivam u koliko stvarno možemo da imamo konsultivne predloge koje će ići i u korist, moram ovo da kažem, poslodavaca, a i u korist posloprimaca. Ne možemo biti ni na jednoj strane. Mi moramo da budemo neutralnih, jer svih su za nas dragoceni, i poslodavci, i posloprimaoci. Prema tome, što se tiči minimalnih plata, ja jesam spremam da razgovaram da unutar naših mogućnosti možemo možda da napravimo jedan pomak napred i tačno da nema takvih primera u okruženju da ima dve minimalne zarade, dve minimalne plate, ali ipak mi imamo jednu populaciju mlađih ljudi koja na viskom nivou, i ako ne budemo dozvoliti na neki način da dođe do stimulacije većeg zapošljavanja tih mladih ljudi, stvarno neće moći da planiramo adekvatni. I za to ja mislim da je neophodno da ima dupla minimalna zarada, ali svim da se ta minimalna zarada možda na kraju ove godine reformuliše, odnosno da eventualno predložimo da bude malo, malo veće. Hvala puna, imao sam još više stvari, ali toliko za sad. Hvala!

KRYESUESI: Kolegë të nderuar,

Ne i dëgjuam diskutimet rreth këtij raporti. Ju e keni marrë një raport dhe në pjesën e tetë të tij rekomandimet. Unë e kisha përpara gjithë kohën dhe u përpoqa të evidentoj konkretisht nga diskutuesit ku ka vërejtje në rekomandime.

Vërejtja ime themelore është që këtu një rekomandim shtesë thotë, unë nuk kuptoj pse është shtesë, nëse është hartuar të njëjtën ditë nga të njëjtit njerëz. Kjo i bie ndoshta, ose, apo, që s'ka logjikë të ketë rekomandim shtesë kur e shkruan të njëjtën ditë, i njëjti njeri, ose i njëjti komision.

Unë evidentova variacion në këtë raport dhe jam i detyruar të jua paraqes ju, te rekomandimi numër një, alineja që ka të bëjë me përcaktimin e afatit minimal me kontratë, dhe e katërta, që ka të bëjë me përcaktimin e kualifikimit të rrogës minimale, si dhe pika pesë, që ka të bëjë me problemin e pushimit të lehonisë. Këto vërejtje i kanë bë deputetët Mustafa dhe Zharku.

Unë, para se të ju thërras të votojmë, e lus Komisionin që ta thotë para deputetëve nëse i pranon plotësimet në këto tri pika të deputetëve që i dëgjuam. Një mendim, pastaj po i nxjerr në votim. Urdhëro!

Po kështu shkon, ndryshe s'ke si e bën.

LIBURN ALIU: Te afati minimal për kontratat, unë e mora shembull konkret "Ferronikelin"

KRYESUESI: A e pranon vërejtjen, a jo?

LIBURN ALIU: Jo.

KRYESUESI: Nuk e pranon. Tjetër?

LIBURN ALIU: Njëjtë është te klasifikimi i rrogës. Kjo nuk do të thotë që ne t'i ndajmë dhe t'i përcaktojmë, rroga e punëtorëve që bëjnë punë të rënda në minierë nuk mund të paguhet me rrogë minimale. Ky ka qenë diskutim në Komision. Tash duhet ta përcaktojmë rrogën për punët e rënda, të cilat nuk mund të paguajmë me rrogë 160 euro, a sa është?

Dhe, çështja tjetër, te pushimi i lehonisë. Te pushimi i lehonisë, 3-mujori i tretë është çështje tjetër a duhet të diskutohet a jo? A duhet të hiqet krejt a jo? Po ky që është, e kemi diskutua në Komision, për t'u thjeshtësuar procedurat, se në fund të fundit është pagesë shumë e vogël dhe ka braktisje, pasi vetë lehonat heqin dorë nga ky pushim.

Pra, është pagesa e vogël, në njërën anë, në anën tjetër janë procedurat e komplikuar. Mund të jetë e njëjta me rajonin, por është pagesë jashtëzakonisht e vogël.

KRYESUESI: Unë po të përpiqem pak a shumë të sublimojë nga çfarë dëgjova. U përpoqa të bëhemi tamam demokratik. Ky zotëri, si pjesë e Komisionit, i refuzoi të tri ofertat për tri pika. Unë jam në pozitë që s'dua të diskutoj. Kisha çfarë të flisja, por nuk dua të flas, sepse do të zbritja atje, e s'kam kë ta lë këtu. Veç një moment! Këto rekomandime, nëse doni zonja e zotërinj, janë dëshira, formulimet janë si dëshira. Mënyra e formulimit nuk jep mundësi ekzekutimi. Edhe ashtu, rekomandimet nuk e kanë të drejtën e ekzekutimi, por japin ide.

Deputetët u përpoqën tri pika t'i bëjnë konkrete. Ju fatkeqësisht nuk e pranuat konkretësinë, prandaj mua nuk më mbetet tjetër vetëm se të tilla çfarë i keni në dorë t'i votoni, ose të mos i votoni.

Të pranishëm janë 78 deputetë. Votoni ose mos votoni sipas dëshirës tuaj për këto rekomandime për zbatimin e ligjit. Votojmë tash!

Atëherë, 61 deputetë votojnë për rekomandimet, 3 janë kundër dhe 7 kanë abstenuar.

Seanca vazhdon në orën 15:30. Faleminderit!

(Vazhdimi i mbledhjes pasdite, e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve

Të pranishëm janë 65 deputetë.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve, Kuvendit i ka paraqitur raportin për procedim dhe miratim.

Ftoj nënkryetarin e Komisionit, deputetin Sadri Ferati, të paraqesë në emër të Komisionit, mendimin.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Pra, në bazë të nenit 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, nenit 38 dhe 39 të Ligjit nr. 04/L-044, për Komisionin e Pavarur për Media, Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, në mbledhjen e mbajtur me 18.10.2012, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të bëjë zgjedhjen e 3 anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, nga 6 të propozuarit me votim të fshehtë, emrat e të cilëve i kemi të bashkëngjitur në raport.

2. I rekomandohet Kuvendit që pas zgjedhjes së tre anëtarëve të Bordit për Ankesa, të bëjë zgjedhjen e kryetarit të Bordit për Ankesa.

Ndërsa, për hir që të mos bëhet, domethënë, përsëritja e procedurave dhe vonesa, unë kisha një propozim nëse Kuvendi e aprovon, që paraprakisht të merret një qëndrim që ai anëtar i cili merr më shumë vota, në mënyrë automatike të jetë edhe kryetar, domethënë, i këtij Komisioni, për hir që të përshpejtohen procedurat. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Por, për këtë propozim na duhet një votim formal i Kuvendit. A jeni dakord? Kush është për?

Ju faleminderit! A ka kundër? 4, Abstenim? Jo.

Pra, miratohet propozimi i nënkryetarit të Komisionit, deputetit Sadri Ferati.

Të pranishëm janë 67 deputetë.

Para se t'ua japim fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare, po ju njoftoj se në pajtim me nenin 83 të Ligjit nr. 04/L-44, për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, Kuvendi duhet të bëjë zgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, nga 6 të propozuar me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Gjithashtu, në pajtim me nenin 40 pika 2, të Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, Kuvendi zgjedh kryetarin e Bordit për Ankesa nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve. Megjithatë, ne për këtë e morëm vendimin e Kuvendit.

Atëherë është radha sipas grupeve parlamentare, në emër të Partisë Demokratike, na duhet një anëtar i Komisionit. Urdhëro, deputeti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për këtë komision e propozon Ganimete Musliu, deputete. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, LDK-ja - Vjollca Krasniqi, a?

ISMET BEQIRI: Veç po ta konfirmoj, domethënë Vjollca Krasniqi.

KRYETARI: Mirë. Grupi i “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, kryetar!

Ne si grup e propozojmë deputeten Albana Gashi.

KRYETARI: Albana Gashi, mirë. Nga AAK-ja?

ARDIAN GJINI: Ne e propozojmë deputeten Kimete Bajraktari

KRYETARI: Nga Koalicioni për Kosovë të Re?

MYZEJENE SELMANI: Koalicioni për Kosovë të Re propozon zotin Jeton Svircën.

KRYETARI: SLS-ja?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Mi predlažemo Milivoja Stojanovića.

KRYETARI: “6+”?

MUFERA SHENIK: “6+” Parlamenter grubu, Albert Kinolli.

KRYETARI: Lus deputetët që ta ngrenë dorën, të deklarohen për Komisionin e formuar. Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka, abstënim nuk ka, atëherë ftoj anëtarët e Komisionit që t'i zënë vendet e tyre.

Një vërejtje procedurale ose një vërejtje e ka nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotëni kryetar!

Unë procedurale s'e kam vërejtje asnjë fije, sepse ajo qysh ju e interpretuat është vërtet qysh e jep ligji në fuqi, veç se mendoj që është momenti tash që të thuhet që kemi ligje të çuditshme për institucionet e pavarura që janë alogjike. Ju e dëgjuat, kryetari saktësisht e interpretoi në bazë të ligjit në fuqi, tha: "Për ta fituar mandatin këta konkurrent duhet t'i marrin votat e shumicës të të pranishmëve që votojnë", që matematikisht, i bie, mund të votojnë shumica e të pranishmëve 31-shi, e shumica e tyre që votojnë 31-shin një 15-ësh. Është absurde që të votohet me vota të fshehta për emra personal në Kuvendin e Republikës të Kosovës, po në të cilin kuvend doni tjetër që të luhet demokracia dhe me vota të fshehta të merren mandate. Unë po them, është e mundshme, ndoshta nuk ndodhë kështu, me 15 vota. Keni kujdes çka thotë 15-shi në 120. Kjo është vërejtje për ne si ligjvënës, për ligjet që i kemi në fuqi dhe për institucionet e tjera që mund të vijnë, jo sot, por nesër apo pasnesër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ne e respektojmë që jo vetëm ky ligj, por mendoj që edhe disa ligjet e agjencive tjera, sa i përket përzgjedhjeve të kandidatëve meritojnë të ndryshohen dhe Kuvendit të jetë më përgjegjës. Përndryshe, kështu si po i zgjedh Kuvendi, ai veç po i legjitimon ata që po dëshirojnë të tjerët, por jo që është vullneti i Kuvendit. Por këto ligje duhet t'i respektojnë kështu siç janë.

SABRI HAMITI: Komisioni është gati. Atëherë marrin fletët për votim: Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri; Afrim Hoti, Afrim Kasolli; Gëzim Kelmendi; Agim Kuleta, Ahmet Jusufi; Albana Fetoshi, Albana Gashi; Albin Kurti, Albulena Haxhiu; Ali Sadriu, Albert Kinolli; Alma Lama, Anton Quni; Arben Gashi, Ardian Gjini; Armend Zemaj, Aurora Bakalli; Azem Sylja, Bahri Thaçi; Arsim Bajrami, Bali Muharremaj; Berat Buzhala, Behar Selimi; Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu; Biserka Kostiq, Blerim Shala; Blerta Deliu Kodra, Burim Ramadani; Danush Ademi, Daut Haradinaj; Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje; Elmi Reçica, Emilija Rexhepi; Enis Krvan, Nahit Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi; Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca; Flora Brovina, Florim Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjuvca; Goran Marinkoviq; Njazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje; Hydajet Hyseni, Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi; Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi; Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri; Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkovic, Jelena Bontiq; Kimete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu; Lirije Kajtazi, Lumni Morina, Lutfi Haziri; Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi; Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa; Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani; Nazane Breca, Kimete Bytyqi; Sasha Milosavleviq, Petar Miletiq, Rada Trajkovic, Ramë Vataj; Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri; Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sadri Ferati; Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha Shala; Sali Asllanaj, Sali Morina, Salihe Mustafa; Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanovic, Sevdije Lama; Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todorovic, Sretan Ivanovic; Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj; Ukë

Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq; Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani; Valbona Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqu; Xhevdet Neziraj edhe Zenun Pajaziti.

Ia jepni mikrofonin, regjia!

GANIMETE MUSLIU: Të nderuar deputetë!

Procesi i votimit ka përfunduar. Gjithsej kanë votuar 82 deputetë, sa ishin të pranishëm në seancë. Tani vazhdojmë me numërimin e votave.

Albion Kelmendi,
Avdi Dinaj,

Nesrin Lushta,
Albion Kelmendi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,

Albion Kelmendi
Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,

Albion Kelmendi,

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Sylejman Klinaku,

Nesrin Lushta,
Albion Kelmendi,

Avdi Dinaj,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Një është e pavlefshme,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku

Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
Nesrin Lushta,
Albion Kelmendi,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku

Është e pavlefshme një.

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sulejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,

E pavlefshme edhe një.

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
Albion Kelmendi,
Emine Kaçiku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,

Sylejman Klinaku,

Nesrin Lushta,
 Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,

Albion Kelmendi,
 Duat Krasniqi,
 Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,
 Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,
 Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
 Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
 Albion Kelmendi,
 Emine Kaçiku,

Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,
 Sylejman Klinaku
 Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,
 Sylejman Klinaku,

Është e pavlefshme edhe një, e zbrazët.

Nesrin Lushta,
 Emine Kaçiku,

Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,
 Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
 Daut Krasniqi,
 Sylejman Klinaku

Albion Kelmendi,

Emine Kaçiku
Sylejman Klinaku,

Nesrin Lushta,
Emine Kaçiku,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Emine Kaçiku
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Nesrin Lushta,
Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,

Avdi Dinaj,
Albion Kelmendi,
Emine Kaçiku,

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
Albion Kelmendi,
Emine Kaçiku

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku

Emine Kaçiku.
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Daut Krasniqi,

Albion Kelmendi
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Nesrin Lushta,
Albion Kelmendi,
Emine Kaçiku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Është edhe një e pavlefshme.
Është e pavlefshme edhe një tjetër.

Albion Kelmendi,

Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Avdi Dinaj,
Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,

Edhe një është e pavlefshme.

Daut Krasniqi,

Emine Kaçiku,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku,

Albion Kelmendi,
Daut Krasniqi,
Sylejman Klinaku.

I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Komisioni votues për përzgjedhjen e anëtarëve në Bordin për Ankesa të Medieve, raporton për rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve në Bordin për Ankesat e Medieve, në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38, paragrafi 2.4 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe neni 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të mbledhjes plenare të datës 5 nëntor 2012, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, si vijon:

1. Ganimete Musliu, PDK,
2. Vjollca Krasniqi, LDK,
3. Albana Gashi, “Vetëvendosje”,
4. Kymete Bajraktari, AAK,
5. Jeton Svirca, AKR,
6. Milivoje Stojanoviq, SLS dhe
7. Albert Kinolli, Grupi “6+”.

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për përzgjedhjen e anëtarëve në Bordin për Ankesat e Medieve, në mbledhjen plenare të mbajtur me 5 nëntor 2012, konstatoi si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë.

- Për Avdi Dinaj, kanë votuar 11 deputetë,
- Për Nesrin Lushtën, kanë votuar 8 deputetë,
- Për Albion Kemendin, kanë votuar 54 deputetë,
- Për Emine Kaçikun, kanë votuar 23 deputetë,
- Për Daut Krasniqin, kanë votuar 57 deputetë,
- Për Sylejman Klinakun, kanë votuar 55 deputetë,
- Të pavlefshme janë 7 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 paragrafi 2.4 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se:

- Daut Krasniqi, me 57 vota,
- Sylejman Klinaku, me 55 vota dhe
- Albion Kelmendi, me 54 vota,

zgjidhen anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve.

Komisioni e ka nënshkruar raportin në përgjithësi dhe ia dorëzon Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në bazë të rezultateve të votimit, konstatoj se Kuvendi i zgjodhi anëtarët dhe kryetarin e Bordit për Ankesa të Medieve, në mandat 3-vjeçar:

- Kryetar: Daut Krasniqi,
- Anëtarë: Sylejman Klinaku dhe Albion Kelmendi.

Tani është pika e fundit për sot:

15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2012, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit, që deri në mbledhjen plenare, më 1 nëntor 2012, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve.

Ftoj kryetarët, përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Radha është e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, t'i propozojë 2 anëtarë.

E ka fjalën kryetari i Grupit, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së, për anëtarë të këtij Komisioni propozon:

1. Idriz Vehapin dhe
2. Xhevahire Izmakun

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike i propozon dy kandidatë:

SABRI HAMITI: Ne propozojmë Lirije Kajtazin dhe Sadri Feratin.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi i “Vetëvendosjes” e propozon 1 anëtar.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë deputeten Alma Lama.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi i Aleancës, e ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar! Ne propozojmë deputeten Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë Emilija Rexhepin

KRYETARI: Ju faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i SLS-së, fjalën e ka Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

SLS predlaže Milivoja Stojanovića.

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Grupi parlamentar “6+”, fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Ne e propozojmë Albert Kinollin.

KRYETARI: Faleminderit!

Pas propozimit të kandidatëve, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 61 deputetë.

Atëherë, me 55 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës, që të veprojë në përputhje me nenin 26, pika 2.3 e Ligjit nr. 04/L-046 për Radio-Televizionin e Kosovës.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim e Lekturë